



Qyteti i Prishtinës Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër

Gusht 2021



Mott MacDonald
Mott MacDonald House
8-10 Sydenham Road
Croydon
CR0 2EE
Mbretëria e Bashkuar

T +44 20 8774 2000
mottmac.com

Qyteti i Prishtinës Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër

Gusht 2021



Falënderime

Prodhimi i këtij PVQGJ-je është financuar nga Ministria Federale Austriake e Financave (BMF).

Një varg përfaqësuesish teknikë nga e gjithë komuna kanë përkrahur hartimin e PVQGJ-së, duke kontribuar në faza të ndryshme të programit, derisa po hartohej Plani, duke ofruar kontribute e komente kthyesë të vlefshme për Ekipin e Konsulentëve.

Ekipi i konsulentit ka qenë një konsorcium i udhëhequr nga Mott MacDonald Ltd (MB), me mbështetje nga E Co. Ltd (MB) dhe një numër ekspertësh të pavarur sektorialë, vendorë e ndërkombëtarë.

Një varg institucionesh dhe individësh të tjerë kanë kontribuar në zhvillimin e Planit të Veprimit të Qytetit të Gjelbër përmes punëtorive dhe takimeve të ndryshme, duke përfshirë ndërmarrjet publike dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe anëtarët e grupeve të shoqërisë civile dhe akademikët.

Falënderojmë shumë Z. Ferdi Limani, Fotografën e Komunës së Prishtinës, për sigurimin e fotografive zyrtare.

Ne falënderojmë të gjithë që janë angazhuar për kontributet e tyre konstruktive në proces.

Ky Raport i Vlerësimit Teknik është përgatitur nga Mott MacDonald Limited për të mirën e Qytetit të Prishtinës. Çdo qëndrim, mendim, supozim, deklaram apo rekomandim i shprehur në këtë dokument i përket Mott MacDonald Limited, si dhe nuk pasqyron detyrimisht politikën apo qëndrimin zyrtar të Qytetit të Prishtinës.

Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, Ministria Federale Austriake e Financave (BMF), ose Qyteti i Prishtinës, nuk marrin përsipër asnjë lloj përgjegjësie lidhur me çfarëdo pretendimi nga cilado palë e tretë, në lidhje me, drejtpërdrejt apo tërthorazi, rolin e BERZH-it në përzgjedhjen, angazhimin apo monitorimin e Mott MacDonald Limited dhe/ose si pasojë e shfrytëzimit apo mbështetjes tek shërbimet e Mott MacDonald Limited.

Përmbajtja

Parathënie	vi
Përmbledhje Ekzekutive	1
1. Hyrje	1
1.1 Sfondi	2
1.2 Si është hartuar ky plan?	2
1.3 Identifikimi dhe prioritizimi i sfidave mjedisore - definimi i gjendjes bazë të Qytetit të Gjelbër	3
1.4 Realizimi i PVQGJ-së dhe Angazhimit të palëve të interesit	5
1.5 Si i kemi përfshirë palët e interesit?	6
2 Gjendja bazë e Qytetit të Gjelbër	9
2.1 Shtrirja gjeografike	10
2.2 Planet aktuale strategjike	10
2.3 Gjendja bazë për Qytetin e Gjelbër	11
Sfidat prioritare mjedisore - Përmbledhje	18
3 Vizioni i Qytetit të Gjelbër & Qëllimet Strategjike	20
3.1 Cili është Vizioni ynë i Qytetit të Gjelbër për Prishtinën?	21
3.2 Qëllimet Strategjike të Qytetit të Gjelbër	21
3.3 Zhvillimi i Veprimeve të Qytetit të Gjelbër	23
4 Veprimet për Qytetin e Gjelbër të Prishtinës	29
4.1 Lëvizshmëria urbane	30
4.2 Ndërtesat	53
4.3 Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës	66
4.4 Energjia	76
4.5 Industria	88
4.6 Sektori i Ujërave	91
4.7 Mbeturinat inerte	105
4.8 Ndryshimet klimatike	112
4.9 Çështje të tjera të ndërthurura	123
5 Opsionet e Financimit të PVQGJ-së	130
5.1 Përmbledhje e gjendjes financiare të Qytetit	131
5.2 Burimet e mundshme të financimit	132
5.3 Vlerësimi i Veprimeve kundrejt Opsioneve të financimit	133
6 Implementimi dhe Monitorimi i PVQGJ-së	144
6.1 Hyrje	145
6.2 Struktura e qeverisjes dhe ajo institucionale për PVQGJ-në e Prishtinës	145
6.3 Implementimi dhe Monitorimi i PVQGJ-së	146
6.4 Programimi i Implementimit	151
6.5 Monitorimi i Ndikimit të PVQGJ-së	152
6.6 Monitorimi i Ndikimit të Skemave	158
6.7 Raporti Vjetor & Planifikimi i Veprimeve PVQGJ në të Ardhmen	159
7 Përmbledhje e dobive	137
7.1 Hyrje	138
7.2 Dobitë kryesore mjedisore	140
7.3 Dobitë kyçe të kombinuara ekonomike dhe sociale	142
Shtojcat	144
A. Të Dhënat Kryesore të Databazës së Treguesve	162
A.1 Treguesit e Gjendjes	162
A.2 Treguesit e Trysnisë	165
B. Përmbledhje e Strategjive dhe Planeve Kryesore	173
C. Lista e grupeve të interesit të PVQGJ (të ndarë në sektorë)	188

Parathënie

Është kënaqësi për mua të prezantoj Planin e parë të Veprimit të mbështetur bujarisht nga Ministria Federale Austriake e Financave dhe e menaxhuar përmes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). PVQGJ-ja është zhvilluar, duke identifikuar, priorizuar dhe adresuar sfidat më urgjente mjedisore të Qytetit, dhe duke vendosur një vizion të ri për të ardhmen e Gjellbër të Qytetit.



Së pari, unë do të doja të falënderoja administratën e qytetit, palët e interesit në të gjithë qytetin, ekipin e BERZH-it, si dhe ekipin ndërkombëtar të konsulencës të udhëhequr nga Mott MacDonald Limited, për përpjekjen, përkushtimin e tyre të madh dhe bashkëpunimin për të prodhuar këtë dokument të rëndësishëm strategjik.

Fushat e trajtuara nga ky plan janë të gjerësishme duke mbuluar: lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane, ndërtesat dhe efikasitetin e energjisë, menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, menaxhimin e cilësisë së ajrit, burimet e rinovueshme, planifikimin hapësinor dhe të lagjeve dhe ndryshimet klimatike. Të gjithë kanë një rol thelbësor në drejtim të përmirësimit të mjedisit urban dhe cilësisë së jetës në Qytetin tonë.

Balancimi i mbrojtjes së mjedisit është një sfidë e madhe përballë rritjes ekonomike dhe ndikimeve të ndryshimit global të klimës. Është e rëndësishme që Qyteti të vazhdojë të rritet dhe të përparojë, duke tërhequr investime, tregti dhe turizëm, ndërsa në të njëjtën kohë duke krijuar një Qytet të pastër dhe të shëndetshëm të cilin banorët tanë do e gëzojnë.

Puna tashmë është duke u zhvilluar në drejtim të trajtimit të sfidave mjedisore - ne kemi qenë duke punuar me BERZH për prezantimin e një flote dhe infrastrukture të re për autobusët, për të tërhequr pasagjerë të rinj dhe për të ndihmuar në uljen e nivelit të emetimeve të automjeteve në të gjithë Qytetin. Ne jemi gjithashtu duke punuar me BERZH për të bashkëfinancuar një sërë masash të eficientës së energjisë në ndërtesat në pronësi të komunës, që do të çojnë në kursime të energjisë dhe ulje të CO₂.

Unë besoj se masat e përcaktuara në këtë dokument do të luajnë një rol të madh duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit të Qytetit, duke adresuar sfida të rëndësishme që janë identifikuar. Unë shpresoj në mbështetjen dhe kontributin tuaj të vazhdueshëm për të ndihmuar që Prishtina të bëhet një vend më i mirë për të jetuar, punuar dhe vizituar.

Shpend Ahmeti
Kryetar i Komunës së Prishtinës

Përmbledhje Ekzekutive



Qyteti i Prishtinës ka kënaqësinë të marrë pjesë në Programin e Qyteteve të Gjelbra të BERZH-it, si dhe është i përkushtuar vendosmërisht në trajtimin e një numri sfidash kyçe mjedisore, të cilat ndikojnë negativisht në performancën mjedisore të gjithë Qytetit.



Që nga qershori i vitit 2019, kemi punuar me konsulentë, ofruar shërbimesh si dhe një gamë të gjerë të palëve të interesit në qytet, për të analizuar e priorizuar sfidat kryesore mjedisore në Prishtinë, si dhe për të paraqitur një numër masash që do të transformojnë performancën mjedisore të Qytetit, por edhe të ofrojnë një gamë të gjerë të dobive shoqërore dhe ekonomike. Një pjesë thelbësore e procesit ka qenë hartimi si dhe pajtimi mbi një Vizion të Ri të Qytetit të Gjelbër, që përmbledh drejtimin që Prishtina dëshiron të marrë në drejtim të arritjes së një qyteti më të qëndrueshëm dhe më të favorshëm për mjedisin. Në bashkëpunim me zyrtarët e qytetit dhe palët e interesit në të gjithë qytetin, kemi krijuar vizionin vijues të Qytetit të Gjelbër për Prishtinën, i cili ka ndikuar në zhvillimin e Planit të Veprimit të Qytetit të Gjelbër (PVQGJ) dhe masat e renditura në Plan:

"Prishtina është qytet që e duam, me shoqëri aktive e të përgjegjshme, standarde të larta jetese dhe me përdorim efikas të resurseve e me mbrojtje të mjedisit"

Pjesëmarrja e palëve të interesit

Për të kontribuar në hartimin e planit, janë identifikuar një numër i palëve të interesit, ku përfshihet stafi i komunës, përfaqësues të tjerë të sektorit publik, biznese private, organizata civile. Palët e interesit janë ftuar të ndajnë pikëpamjet e tyre mbi pikat kyçe të programit PVQGJ: priorizimi i sfidave mjedisore, përcaktimi i objektivave strategjike dhe zhvillimi i veprimeve konkrete në PVQGJ. Për shkak të situatës së vazhdueshme me pandeminë COVID-19, është kërkuar kontributi me anë të punëtorive virtuale dhe pyetësorëve elektronikë.

Cilat janë sfidat kryesore mjedisore të qytetit?

Është krijuar Gjendja bazë për Qytetin e Gjelbër, duke matur performancën e Qytetit tonë kundrejt një numri standardesh mjedisore. Janë identifikuar fushat kryesore vijuese brengosëse:

Gjendja Aktuale

Cilësia e ajrit - nivele të dobëta të cilësisë së ajrit, me nivele të larta të PM2.5, për shkak të niveleve të larta të qarkullimit në qendër të qytetit, si dhe afërsisë me termocentralin me qymyr, si dhe përdorimit të lartë të lëndëve djegëse inerte në disa zona të qytetit.

Biodiversiteti - qasshmëri e dobët në hapësira të gjelbra për banorët e Qytetit - mungesë e të dhënave të besueshme për biodiversitetin.

Cënueshmëria klimatike - Prani e madhe e infrastrukturës së vjetëruar, jo efikase në përdorim të energjisë, e joadekuate, si dhe mungesa e planifikimit të integruar dhe koncepteve të menaxhimit adaptiv brenda qytetit.

Trysnitë / Reagimet tek Infrastruktura dhe Shfrytëzimi i tokës

Mobiliteti/Lëvizshmëria Urbane - Vëllime të mëdha trafiku, si dhe flotë e vjetëruar e automjeteve, që krijojnë probleme të ngarkesave në qytet dhe cilësisë së ajrit në qendrën urbane, të cilat rëndohen edhe më shumë nga numri i madh i automjeteve dizel. Nivele të ulta të çiklizmit.

Ndërtesat - Aktualisht nivele të ulëta të efikasitetit të energjisë (përfshirë mungesën e ngrohjes termike, si dhe nivele të ulëta të pajtueshmërisë me standardet.


Shfrytëzimi i tokës - Mungesa e master-planit urban dhe kontrollit rregullator për të parandaluar përhapjen e popullsisë në qytet, si dhe përhapjen (shkapërderdhjen) urbane, që ushtron trysni mbi shërbimet dhe rrjetet e qytetit.

Hapësirat e Gjelbra - Përderisa hapësirat e gjelbra përbëjnë 26% të zonës urbane të qytetit, ka mungesë të lidhjeve me komunitetet lokale dhe banorët.

Konsumi i resurseve - Konsum i tepruar i resurseve si uji, energjia dhe prodhimi i mbeturinave, si dhe joefikasiteti i shërbimeve, të gjitha ishin brengosëse. Nivel shumë i ulët riciklimi në Qytet.

Cili është vizioni dhe qëllimet strategjike të Planit?

Plani parasheh një Vizion të ri të Qytetit të Gjelbër, i cili duhet përbushur gjatë 10 viteve të ardhshme. Ky Vizion mbështetet nga 11 Qëllime Strategjike, që synojnë adresimin e sfidave prioritare mjedisore – për çdo sektor, si edhe ato gjithëpërfshirëse/ ndërsektoriale. Këto të fundit adresojnë ndryshimet klimatike dhe rezistencën, adoptimin e një sistemi më të mirë të menaxhimit mjedisor, dëshirën për angazhim më efektiv të palëve të interesit, si dhe aplikimin e teknologjive SMART.



Çfarë përfshihet brenda planit?

Gjithsej 29 veprime të ndryshme, si politika dhe investime, janë identifikuar për implementim në kuadër të Planit. Këtu përfshihen 17 veprime investive, si dhe 12 veprime politikash/studimi. Një pasqyrë e llojeve të veprimeve është paraqitur si më poshtë:

Sektorët e veprimit	Kostoja (milionë €)	
	Gjithsej CAPEX vlerësuar	OPEX plotësuese vjetore
Ndërtesat dhe Energjia		
Investimet në rinovimin e ndërtesave komunale për të përmirësuar eficiencën e energjisë, si dhe në rrjetin e Ngrohjes Qendrore (prodhimi, rrjeti primar e sekondar) për të zvogëluar humbjet dhe për të siguruar rrjet të qëndrueshëm në afat të gjatë.	89.65€	0.02€
Transporti dhe Mobiliteti/Lëvizshmëria		
Investime në rrjetin e transportit publik urban, përfshirë zhvillimin e rrjetit të autobusëve për gjithë Qytetin, infrastrukturën përcjellëse, si dhe zëvendësimin e flotës së automjeteve. Investimi në rrjetet e Transportit Aktiv (ecje/çiklizëm) dhe infrastrukturën që synon përmirësimin e lidhshmërive dhe uljen e ndotjes së ajrit. Menaxhimi i parkimit, për të ushtruar ndikim tek kërkesa dhe veprimet në qarkullim/udhëtime.	250.54€	6.86€
Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës		
Mbështetja e investimeve në rehabilitimin e pjesëve të ndërtuara (brownfield) për destinime ekonomike (komerciale e banesore), por edhe në infrastrukturën e gjelbër, si pemët, muret e gjelbra dhe hapësirat e vogla të gjelbra urbane.	6.62€	0.01€
Mbeturinat		
Mbështetja e investimeve në infrastrukturë (kryer në kuadër të një programi të veçantë të mbështetur nga BE), me përfundim të institucioneve e vetëdijesim të publikut	5.05€	0.21€
Ujërat		
Zvogëlimi i humbjeve të ujit, si tek zvogëlimi i humbjeve jotarifore të ujit, ashtu edhe me investime në sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve atmosferike.	15.30€	0.77€
Ndërsektoriale		
Një varg masash të politikave dhe veprimesh mbështetëse për adresimin e çështjeve ndërsektoriale, si Rezistenca Klimatike, Monitorimi i Cilësisë së Ajrit për të mbështetur planifikimin e veprimeve, vendosja e rregulimeve të reja për të menaxhuar realizimin e PVQGJ-së.	1.25€	0.12€
Totalt	368.44€	7.99€

Cilat janë dobitë kryesore mjedisore të Planit?

- **Cilësia e ajrit** - Cilësi më e mirë e ajrit nga reduktimi i emisioneve nga automjetet, niveli më i lartë i qarkullimit jo-motorik, si dhe ndërtesa më efikase në energji, por edhe ngrohje qendrore që shpie drejt reduktimit të varësisë nga lëndët djegëse fosile ndotëse.
- **Zbutja e efekteve klimatike** - Zvogëlimi i emisioneve të gazrave serrë me mbi 176,000 ton CO₂/vit.
- **Shfrytëzimi i tokës** - sigurimi i qasjeve të reja të planifikimit të shfrytëzimit të tokës që parandalojnë përhapjen, përmirësojnë lidhshmëritë me hapësirat e gjelbra si dhe ndërmjet lagjeve të qytetit.
- **Përdorimi i ujit** - kurseme në kërkesën për ujë, si dhe zvogëlim i humbjeve në rrjet.
- **Shfrytëzimi i energjisë** - të reduktohet konsumi i energjisë përmes rritjes së efikasitetit të energjetike në ndërtesa, si dhe përmes rritjes së efikasitetit të rrjetit të ngrohjes qendrore.
- **Përdorimi i materialeve** - arrihet përmes vetëdijesimit, për të ulur prodhimin e mbeturinave, si dhe për të rritur nivelin e riciklimit.

Cilat janë përfitimet e kombinuara sociale e ekonomike

Përveç dobive mjedisore, është po ashtu e rëndësishme të merren në konsideratë dhe të kuptohen përfitimet e kombinuara ekonomike e sociale, që ndërliken me veprimet në PVQGJ. Këto janë si vijon:

- **Shëndeti publik** - dobitë nga zvogëlimi i ekspozimit ndaj ndotjes, rritja e mirëqenies përmes përmirësimit të hapësirave të gjelbra, si dhe mundësitë për të promovuar stile jetese më aktive
- **Barazia gjinore** - përmirësimin e angazhimit për të dëgjuar më mirë zërat e qytetarëve, si dhe sigurimin e infrastrukturës që është e projektuar për të plotësuar nevojat e ndryshme të burrave dhe grave
- **Qasshmëria** - dobi duke siguruar infrastrukturë dhe pajisje të cilat janë dizajnuar sipas standardeve moderne të cilat mundësojnë qasje më të mirë për përdoruesit me lëvizshmëri të kufizuar.

- **Kursimet në efikasitet** - për ata që investojnë në projekte, shumë prej të cilëve gëzojnë ose kurseme në efikasitet, ose rritje të të ardhurave
- **Dobitë ekonomike jo-financiare** - qyteti bëhet perspektivë më tërheqëse për investime; ulen kostot operative; reduktime potenciale të tarifave për përdoruesit; mundësi të gjelbra punësimi, si dhe me krijimin e një ambienti të besueshëm e efikas që mundëson përparimin e punëtorëve e bizneseve.

Implementimi, Monitorimi e vlerësimi

Kemi krijuar tashmë kornizën qeverisëse, për të menaxhuar mënyrën se si realizohet, monitorohet e vlerësohet PVQGJ-ja, për të siguruar që Plani të jetë i suksesshëm në realizimin e qëllimeve strategjike. Monitorimi i progresit dhe ndikimit të PVQGJ-së do të matet në dy mënyra:

- Vlerësimi i Veprimeve që janë identifikuar për ciklin e parë (2021-2025) janë kryer (**Monitorimi i Zbatimit**);
- Vlerësimi i ndikimit të Veprimeve që janë implementuar, duke i kushtuar vëmendje të posaçme ndryshimeve të performancës kundrejt treguesve mjedisorë të PVQGJ-së (**Monitorimi i Ndikimit**).

Përfundimisht, këto informata monitorimi do të ketë rëndësi kritike për ciklet e ardhshme të procesit PVQGJ në Prishtinë, duke ofruar informatat inteligjente për gjendjen e mjedisit kundrejt treguesve.



Lista e veprimeve në PVQGJ të Prishtinës

#	Veprimi	Kostot e vlerësuara të investimit (milione EUR)	Tipi i investimit të qytetit
T1	Masa të avancuara për këmbësorë	3.00	Investimet
T2	Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë	4.00	Investimet
T3	Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente të tjera infrastrukturore	4.00	Investime / PPP
T4	Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve	9.30	Investime / PPP
T5	Investimet për çiklizëm në të gjithë qytetin	3.24	Investime / PPP
T6	Korridor i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme	227.00	Investimet
B1	Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë	0.00	Stafi i angazhuar
B2	Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale	15.90	Investime / PPP
B3	Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale	0.56	Studim
B4	Instalimi i njehsorëve të energjisë për konsumatorë individualë	17.50	Investime - ndërmarrje e komunës
I1	Strategjia e Angazhimit dhe Plani i Veprimit për Promovimin e Efiçencës së Energjisë	0.00	Stafi i angazhuar
E1	Rehabilitimi i Ndrichimit Publik - Zëvendësimi i Llambave Ekzistues me Llamba Efiçientë në Energji	0.40	Investime / PPP
E2	Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit	3.90	Investime / PPP
E3	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore	17.70	Investime - ndërmarrje e komunës
E4	Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore	33.69	Investime - ndërmarrje e komunës
L1	Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive	6.00	Investimet
L2	Shqyrtimi i planeve aktuale urbane për të ndihmuar në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban	0.30	Studim / zhvillim i veglave/mjeteve
L3	Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të Pasurive të Gjelbra dhe Sistemit të Financimit të Granteve	0.32	Studim / zhvillim i veglave/mjeteve
WA1	Përditësimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në Prishtinë	0.05	Studim
WA2	"3R-Reduktim, Ripërdorim, Riciklim"- Koncepti i menaxhimit të mbeturinave	5.00	Investime - ndërmarrje e komunës
W1	Investime në sistemin e ujës-jellësit (sistemi i gypave)	7.00	Investime - ndërmarrje e komunës
W2	Sistemi i shfrytëzimit të ujërave atmosferikë	8.00	Investime - ndërmarrje e komunës
W3	Rritja e efikasitetit në shfrytëzim të ujit	0.05	Stafi i angazhuar
W4	Iniciativa për zvogëlimin e humbjeve të ujit	0.25	Investime / PPP
CC1	Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent	0.15	Studim
CC2	Përgatitja e Planit të Veprimit për Rreziqe Emergjente Klimatike	0.30	Studim
CC3	Vlerësimi i Rrezikut të Përmbytjeve	0.05	Studim
EN1	Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit	0.75	Studim / përkrahje e vazhdueshme
C1	Krijimi i Ekipit / Zyrtarit/es për Zbatimin e PVQGJ-së	0.00	Stafi i angazhuar
	GJITHSEJ	368.44	

1. Hyrje



1.3 Sfondi

Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër ("**PVQGJ**") i Prishtinës ("**Qyteti ose Prishtina**") paraqet ambicien e Qytetit për t'u bërë Qytet i Gjelbër.

Qëllimi i PVQGJ-së është të mundësojë përmirësimet në performancën mjedisore urbane të Qytetit tonë, duke aplikuar qasje sistematike për adresimin e sfidave mjedisore urbane, me zbatimin e Qasjes së Qytetit të Gjelbër. Kjo qasje do të na ndihmojë të përforcojmë qëndrueshmërinë e përgjithshme të qytetit tonë.

Qytet i Gjelbër është qyteti i cili:

- 1) *Ruan ose rrit cilësinë e aseteve të tij mjedisore (ajri, uji, toka, dhe e biodiversiteti), si dhe i përdor këto resurse në mënyrë të qëndrueshme*
- 2) *Zbut dhe përshtatet ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike*
- 3) *Ruan dhe përmirëson rezistencën e infrastrukturës, shërbimeve, operacioneve dhe komuniteteve të tij, kundrejt katastrofave e trysnive*
- 4) *Siguron që politikat mjedisore të kontribuojnë në mirëqenien sociale dhe ekonomike të banorëve, pavarësisht nga gjinia, vendi i lindjes, mosha, orientimi seksual, aftësia e kufizuar ose rrethana të tjera.*

Metodologjia PVQGJ e BERZH-it

PVQGJ-ja shqyrton sistematikisht sfidat tona mjedisore urbane, si dhe përcakton Vizionin 15-vjeçar dhe identifikon Qëllimet Strategjike mbështetëse, për t'u ballafaquar me sfidat e Vizionit, ashtu që të adresohen ato në përputhje me prioritetet e palëve kryesore të interesit. Për më tepër, PVQGJ rekomandon një sërë veprimesh dhe masash të synuara për të kontribuar në arritjen e Qëllimeve.

Ndryshimet strukturore për të dekarbonizuar ekonominë dhe sistemet e energjisë tashmë janë duke u zhvilluar në Qytet. Një tranzicion i drejtë kërkon të sigurojë që përfitimet thelbësore të një tranzicioni të ekonomisë së gjelbër të shpërndahen gjerësisht, duke mbështetur gjithashtu ata që humbasin ekonomikisht. Përfshirja e konsideratave

të një tranzicioni të drejtë në PVQGJ i lejon qytetit të identifikojë investimet ose politikat brenda sektorëve përkatës, të cilat mund të ndihmojnë në zëvendësimin e mundësive të humbura ekonomike dhe punësimit, si dhe të ndihmojë fuqinë punëtore lokale të përfitojë nga çdo mundësi e re e gjelbër punësimi.

Zbatimi i veprimeve do të kontribuojë në realizimin e Vizionit dhe Qëllimeve tona Strategjike në PVQGJ-në e parë midis viteve 2021 e 2026, në mënyrë që sistematikisht të përforcohet qëndrueshmëria e përgjithshme e Qytetit tonë. Më në fund, ai përcakton procesin me të cilin PVQGJ do të realizohet, e të raportohet mbi të.

Ky Plan i Veprimit për Qytetin e Gjelbër është përgatitur nga Qyteti i Prishtinës, si pjesë e pjesëmarrjes së tij në Programin e Qyteteve të Gjelbra të BERZH-it. Ai shtjellon ambicien tonë për t'u bërë Qytet i Gjelbër, në pajtim me metodologjinë e hartuar nga BERZH, bashkë me Organizatën për Bashkëpunim e Zhvillim Ekonomik ("**OECD**") si dhe Këshillin Ndërkombëtar për Iniciativa Mjedisore Lokale ("**ICLEI**"), si dhe është e disponueshme në faqen e Bankës ("**Metodologjia PVQGJ e BERZH**").

Përgatitja e PVQGJ-së është financuar nga Ministria Federale Austriake e Financave (BMF).

1.2 Si është hartuar ky plan?

Një konsorcium konsulence, udhëhequr nga Mott MacDonald Ltd, është zgjedhur për të ofruar mbështetje teknike në ndërmarrjen e vlerësimeve të nevojshme, identifikimit e vlerësimit të mundësive dhe hartimin e dokumentit PVQGJ.

Është kryer edhe një shqyrtim i politikave ekzistuese për të siguruar që PVQGJ-ja të bazohet në politikat urbane të zhvilluara më parë. Shqyrtimi i politikave po ashtu ka vlerësuar nivelin e mbështetjes politike brenda qeverisë komunale, rreziqet ligjore e politike në lidhje me zbatimin e PVQGJ-së, si dhe potencialin për investime të ardhshme komunale.

Analiza e palëve të interesit është kryer për të identifikuar individët dhe grupet e interesit më kyçe, përfshirë përfaqësuesit e sektorit privat, akademikët lokalë, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe organizatat përgjegjëse për shërbimet komunale, si energjia, uji, mbeturinat dhe shërbimet e transportit. Këto palë të interesit janë angazhuar vazhdimisht gjatë gjithë zhvillimit të PVQGJ-së.

1.3 Identifikimi dhe prioritizimi i sfidave mjedisore - definimi i gjendjes bazë të Qytetit të Gjelbër

Gjendja bazë e Qytetit të Gjelbër përbën elementin diagnostik të procesit PVQGJ, si dhe dokumenton performancën aktuale mjedisore të qytetit, përfshirë kornizat e qeverisjes që ndikojnë në të. E rëndësishme është që ajo identifikon një sërë sfidash prioritare mjedisore që Qyteti do të adresojë përmes një programi veprimesh të hartuara si pjesë e këtij Plani. Vlerësimi i gjendjes bazë të sfidave mjedisore në Prishtinë është paraqitur në Kapitullin 2.

1.3.1 Korniza 'Trysnia - Gjendja – Reagimi' në PVQGJ


Për të siguruar që Plani ynë i Veprimit për Qytet të Gjelbër të jetë objektiv dhe i mbështetur në dëshmi, kemi aplikuar kornizën metodologjike Trysnia - Gjendja - Reagimi të PVQGJ-së ("**Korniza TGJR**"). Kjo Kornizë TGJR identifikon aktivitetet njerëzore që:

- Ushtrjnë trysni mbi mjedisin urban (Transporti, Energjia, Ndërtesat, Industrinë, Ujërat)¹, Mbeturinat e Ngurta dhe Shfrytëzimi i tokës), të komplementuara me sfidat e Ndryshimeve Klimatike ("**Sektorët e PVQGJ-së**"); dhe
- Ndryshojnë gjendjen e tij në aspektin e performancës mjedisore.

Kjo identifikon edhe se si shoqëria reagon ndaj këtyre trysnive dhe ndryshimeve, përmes politikave të përgjithshme mjedisore, ekonomike e sektoriale, si dhe përmes ndryshimeve në sjellje. Prandaj, Korniza TGJR e Qytetit të Gjelbër ndërton ndërlidhjet midis:

- Performancës mjedisore të Qytetit të gjelbër, karakterizuar nga **Gjendjet e tij**;
- Aktiviteteve kryesore shoqëruese ekonomike që ushtrojnë **Trysnitë** e tyre mbi këto Gjendje; dhe
- Investimeve, shërbimeve e instrumenteve të politikave që përfaqësojnë **Reagimet** ndaj këtyre sfidave.

Metodologjia PVQGJ shtron një tërësi të gjerë të Treguesve që mbulojnë këto çështje, si dhe kjo ka ushqyer procesin PVQGJ.



Të dhënat që mbulojnë 11 treguesit e Gjendjes dhe 39 treguesit e Trysnisë janë grumbulluar e përmbledhur në "Databazën e Treguesve" që përfshin të gjitha. Të dhënat janë shqyrtuar e konfirmuar nga palët e interesit prej organizatave të ndryshme, për të siguruar korrektësinë dhe saktësinë e mundshme të tyre, duke pasur parasysh kushtet dhe programet aktuale të monitorimit. Këto të dhëna të gjera ofrojnë gjendjen bazë për PVQGJ-në, që ndihmon në diagnostikimin e sfidave të cilat duhen adresuar, si dhe kjo është bashkangjitur në Shtojcën A (*Të dhënat kyçe të Databazës së treguesve*) të këtij raporti.

¹ Përfshijnë edhe ujërat e zeza.

Në të ardhmen, kjo gjendje bazë do të mundësojë monitorimin e suksesit të realizimit të PVQGJ-së.

Ne kemi vënë në hartë performancën mjedisore të qytetit, duke mbledhur e krahasuar performancën mjedisore kundrejt treguesve të vendosur me metodologjinë PVQGJ. Këta tregues janë dizajnuar sipas modelit të OECD-së² Trysni-Gjendje-Reagim, që është kornizë që përdoret zakonisht për të definuar performancën mjedisore, ku trajtohen marrëdhëniet midis **Trysnive** që ushtrijmë mbi mjedis (përmes aktiviteteve si transporti, përdorimi i energjisë, konsumi i resurseve), **Gjendjes** së mjedisit (për shembull cilësia e ajrit ose disponueshmëria e burimeve të tilla si uji), si dhe **Reagimet** që ndërmerren për të menaxhuar trysnitë që ushtrijmë mbi mjedis.

Lista e plotë e treguesve (me të dhëna të mbledhura për gjithsej 50 tregues) të vlerësuar si pjesë e PVQGJ-së së Prishtinës janë renditur në Shtojcën A.

Puna në Vlerësimin Teknik është kryer për të identifikuar sfidat e ndryshme sektoriale të Qytetit të Gjelbër. Ne kemi identifikuar fushat e theksuara të brengosjes - "prioritetet mjedisore" - në lidhje me cilësinë aktuale të pasurive mjedisore, trysnitë e mundshme të ardhme nga zhvillimi, së bashku me çdo mangësi në politika apo strategji të sektorëve përkatës.

Një numër aktivitete të angazhimit të palëve të interesit janë mbajtur për të prezantuar gjetjet tona themelore, ndërsa Ekspertëve të Qytetit dhe përfaqësuesve të palëve të interesit iu është ofruar mundësia të konfirmojnë çështjet e identifikuara në Prishtinë. Bazuar në këto gjetje, PVQGJ i Prishtinës është bazuar në:

- Vizionin afatgjatë (10 vjeçar) për zhvillimin e Qytetit të Gjelbër;
- Caqet afatmesme (5 - 10 vjet); dhe
- Veprimet afatshkurtra ("veprimet PVQGJ") (1 deri në 5 vjet) që mund të ndërmerren për të arritur vizionin afatgjatë.

1.3.2 Planifikimi i veprimeve të Qytetit të Gjelbër

Si pjesë e Hapit 2 (Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër), janë identifikuar një numër Veprimesh për Qytetin e Gjelbër për realizim gjatë periudhës ndërmjet viteve 2021-2026, si dhe më tej. Veprimet që përfaqësojnë masat afatshkurtra janë kategorizuar si më poshtë:

- **Investimi:** Veprime që përfshijnë investimet kapitale në zonat e ndërtuara;
- **Politika apo Rregullore:** Koncept-politika, politika shtetërore apo komunale, strategji, plan veprimi, ligje, rregullore, standarde teknik, apo të tjera;
- **Angazhimi i palëve të interesit:** Veprime që angazhojnë individë apo organizata që mund të ndikohen nga PVQGJ-ja, ose mund të ndikojnë në zbatimin e tij, si fushatat publicitare, punëtoritë, seminarët, si dhe forume të tjera publike.
- **Zhvillimi i kapaciteteve:** Veprime me qëllim të sigurimit, përmirësimit dhe/ose ruajtjes së aftësive, njohurive, veglave, pajisjeve apo resurseve të tjera të nevojshme për të kryer rolet e tyre në mënyrë kompetente, apo me më shumë kapacitet;
- **Menaxhimi i të dhënave:** Veprime që përfshijnë sigurimin, verifikimin, ruajtjen, mbrojtjen, si dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për të siguruar qasshmërinë, besueshmërinë dhe afatshmërinë e të dhënave të PVQGJ-së për shfrytëzuesit e tyre.
- **Studimi, Monitorimi dhe Vlerësimi:** Veprimet që konsistojnë në hulumtim e analizë të hollësishme të një teme apo gjendjeje (p.sh. studimi i fizibilitetit, vlerësimi i rezistencës klimatike, etj.).

Lista përfundimtare e veprimeve të PVQGJ-së u përcaktua pas disa trajtimeve. Së pari, një listë e gjatë e veprimeve ishte hartuar në bashkëpunim me ekipin konsulent, si dhe duke marrë parasysh idetë që kishin dalë nga punëtoritë me palë interesi. Diskutimet me Ekipin

² Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Teknik të Qytetit gjithashtu kontribuan për të marrë parasysh pikëpamjet dhe idetë e tyre mbi veprimet e mundshme sektoriale.

Lista e gjatë e opsioneve u vlerësua nga Ekipi i Konsulentit, duke përdorur kornizën e vlerësimit Analiza me Kriteret e Shumëfishta (MCA), që përbëhet nga kriteret e mëposhtme:

- Vlerësimi i nivelit të dobisë që rezulton (ekonomike, sociale, mjedisore);
- Potenciali për të siguruar përkrahje financiare;
- Niveli i realizueshmërisë teknike; dhe
- Përputhshmëria e politikave.

Kjo pastaj rezultoi me një listë më të shkurtër të opsioneve, të cilat iu nënshtruan konsultimeve të mëtejshme me palët e interesit, për të ndihmuar në nxjerrjen e një tërësie përfundimtare të veprimeve për t'u përfshirë në Plan. Përzgjedhja përfundimtare e 29 veprimeve të PVQGJ-së është përshkruar në një numër "Kartelash Veprimi" në Kapitullin 4.

1.3.3 Zbatimi dhe monitorimi i veprimeve të Qytetit të Gjellbër

Plani Zbatues i PVQGJ-së identifikon afatet kohore dhe resurset e nevojshme për të realizuar, por edhe përcjellur, statusin e veprimeve të PVQGJ-së.

Plani i Monitorimit të Ndikimit mat ndikimin e projekteve dhe politikave të PVQGJ-së në performancën mjedisore të qytetit. Ky përcakton përgjegjësitë brenda Komunës, për të siguruar që aktivitetet të jenë të koordinuara midis drejtorive përkatëse, me udhëheqjen e duhur dhe burimet financiare që ndahen në përputhje me rrethanat. Ne do të raportojmë për përparimin kundrejt planit, në aspektin e përparimit në realizim, si dhe të grumbullojnë të dhëna në lidhje me secilin veprim, për të ndihmuar në përcaktimin e rezultatit dhe nivelit të ndikimit që kanë pasur investimet.

1.4 Realizimi i PVQGJ-së dhe Angazhimit të palëve të interesit

Nënkryetari Muhedin Nushi u emërua si Udhëheqësi Politik për hartimin e PVQGJ-së. Ai mbështetej nga Donika Çapriqi, Koordinatore e PVQGJ-së, si dhe Merita Maliqi, Udhëheqëse e Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian të kabinetit të Kryetarit të Komunës, si Administratore e PVQGJ-së nga Qyteti. Përfaqësuesit e drejtorive të ndryshme komunale u emëruan për të marrë pjesë në Ekipin Teknik të PVQGJ-së, i cili ofroi kontributin dhe mbështetjen e tij për Konsulentin përgjatë gjithë përgatitjes së PVQGJ-së.

1.4.1 Identifikimi dhe prioritizimi i palëve të interesit

Angazhimi i palëve të interesit është thelbësor për të siguruar që PVQGJ-ja të plotësojë nevojat dhe ambiciet e Qytetarëve.

Prishtina ka organizuar disa runde të angazhimit të palëve për pikat kyçe të hartimit të PVQGJ-së. Kemi bërë përpjekje të angazhojmë një gamë të gjerë të palëve të interesit, si dhe kemi marrë kontribute nga organizatat lokale të shoqërisë civile ("**OSHC**"), subjekte të sektorit privat dhe autoritete të tjera publike. Gjithsej 137 aktorë të ndryshëm janë identifikuar, që mbulojnë një gamë të gjerë të organizatave të ndryshme.

Palët e interesit në vijim janë identifikuar të kenë prioritet angazhimi gjatë përgatitjes së PVQGJ-së:

- Drejtori e sektorë të ndryshëm nën mbikëqyrjen e Ekipi të Qytetit për PVQGJ, si dhe organizatat dhe ndërmarrjet që i përgjigjen Qytetit;
- Autoritete të caktuara shtetërore, të tilla si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamenti i Mjedisit), Agjencia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, si dhe ndërmarrjet përkatëse shtetërore që ofrojnë shërbime në Prishtinë. Këto autoritete shtetërore kanë ofruar mbështetje politike me mbledhjen e të dhënave, por edhe

me identifikimin dhe prioritizimin e sfidave dhe aktiviteteve, duke përfshirë edhe veprimet potenciale.

- Institucionet dhe organizatat hulumtuese qeveritare. Jemi angazhuar me institucione kur drejtorive dhe komisioneve tona u mungonin të dhëna të caktuara;
- Drejtoritë e Qytetit të Prishtinës kanë ofruar mbështetje sidomos gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe konsultimeve pasuese gjatë procesit të hartimit të Vizionit, Qëllimeve Strategjike dhe Veprimeve të PVQGJ-së;
- Organizata kyçe jo-qeveritare mjedisore, OShC-të, aktivistët e Qytetit dhe promovuesit e iniciativave dhe fushatave kryesore të lidhura me mjedisin në Prishtinë; dhe
- Përfaqësues të Sektorit privat.

Implementimi i veprimeve të PVQGJ-së do të sigurojë trajtim të barabartë të grave dhe burrave, si dhe integrimin e grupeve të ndryshme të cënueshme dhe të pafavorizuara (p.sh. të moshuarit, emigrantët, fëmijët, pakicat, etj.). Aty ku është e nevojshme, hapat e implementimit të PVQGJ-së duhet të reflektojnë dhe adresojnë sfidat me të cilat përballen qytetarët, të cilët hasin në pengesat e pabarazisë ekonomike. Komuna do të ndërmarrë masa për identifikimin aktiv të grupeve të tilla dhe vendosjen e politikave dhe masave përfshirëse përkatëse. Një objektivi kryesor i PVQGJ-së është të promovojë që burrat, gratë dhe grupet e cënueshme të kenë mundësi të barabarta në qeverisjen e qytetit dhe të gëzojnë përfitime të barabarta nga zhvillimi i infrastrukturës së Prishtinës.

1.5 Si i kemi përfshirë palët e interesit?

1.5.1 Lansimi zyrtar i PVQGJ-së

PVQGJ-ja e Prishtinës u prezantua zyrtarisht para publikut më 24 shtator 2019. Kjo u mbajt në ndërtesën e Administratës së Qytetit në Rrugën Radovan Zogoviç, nr. 1. Gjithsej 85 përfaqësues morën pjesë në Hapjen Zyrtar, ndërsa 36 pjesëmarrës u angazhuan në një seminar pasues për të diskutuar sfidat mjedisore.



Për të lehtësuar angazhimin e palëve të brendshme të interesit në qytet, organizatat e tij dhe palë të tjera në nivelin kombëtar, krijuam një grup pune nga Kryetari i Komunës sonë. Ky grup punues, i kryesuar nga Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, përbëhej nga përfaqësues

kryesorë të Drejtorive të Qytetit si dhe përfaqësues të Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Departamentit Ligjor (“Grupi Punues”). Grupi Punues ka qenë organi kryesor përgjegjës konsultativ për përmbajtjen e PVQGJ-së së Prishtinës, komentet dhe rekomandimet mbi aktivitetet në PVQGJ, miratimin e versioneve e drafteve të dokumentit PVQGJ të Prishtinës para konsultimeve publike dhe dorëzimin e dokumentit PVQGJ të Prishtinës për aprovim zyrtar.

1.5.2 Pasqyrë e Angazhimit të Palëve të Interesit

Angazhimi i palëve të interesit ka qenë kritik për hartimin e PVQGJ-së, si dhe kemi punuar shumë për të përfshirë palë të ndryshme nga qyteti gjatë të gjitha fazave. Tabela 1.1 më poshtë rendit emrin, datën dhe objektivin e secilës prej seancave të angazhimit të palëve të interesit që janë mbajtur gjatë procesit të hartimit të PVQGJ-së.

Tabela 1.1: Lista e ngjarjeve kryesore të angazhimit të Palëve të Interesit në lidhje me PVQGJ-në

Ngjarja	Data	Objektivi
Takimi Nismëtar përfshirë takimet individuale me Departamentet e Komunës (ngjarje e drejtpërdrejtë) (20 pjesëmarrës)	02.07.2019	Finalizimi i protokollit të koordinimit me Qytetin. Sigurimi i detajeve për procesin e parashikuar të zhvillimit të PVQGJ-së në Prishtinë, përfshirë rolet e Qytetit, Konsulentit dhe BERZH-it; dakordimi mbi marrëveshjen për lansimin zyrtar të PVQGJ-së së Prishtinës.
Lansimi zyrtar – Sesioni i I-rë (ngjarje e drejtpërdrejtë) (85 pjesëmarrës - 29 Female (34%) and 56 Male (66%))	24.09.2019	Angazhim e përfshirje e palëve kryesore lokale të interesit dhe ekipin e PVQGJ-së së Prishtinës, për të nisur zyrtarisht procesin e PVQGJ-së.
Lansimi zyrtar – Sesioni i II-të (ngjarje e drejtpërdrejtë) (36 pjesëmarrës 19 Male (53%) and 17 Female (47%))	24.09.2019	Punëtori me palët e interesit për të diskutuar pikëpamjet fillestare mbi çështjet dhe sfidat mjedisore të qytetit.

Ngjarja	Data	Objektivi
Konsultimi me palë interesi për të konfirmuar vlerësimet teknike (ngjarje virtuale) (26 pjesëmarrës, 50% meshkuj/femra)	05.06.2020 08.06.2020 dhe 09.06.2020	Paraqitja e një pasqyre të gjetjeve nga vlerësimet teknike të kryera nga konsulentët për një gamë të gjerë të palëve të interesit, si dhe diskutimi i sfidave me të cilat përballlet Qyteti.
Punëtori për priorizim (ngjarje virtuale) (16 pjesëmarrës 44% femra, 56% meshkuj) (17 të anketuar në sondazhin online)	30.07.2020	Dakordimi mbi sfidat prioritare mjedisore të Prishtinës ku duhet të fokusohet PVQGJ-ja, e të cilat rrjedhin nga analiza e gjendjes bazë e performancës mjedisore të qytetit
Vizioni & Qëllimet Strategjike (ngjarje virtuale) (18 pjesëmarrës, 62% femra, 38% meshkuj) (11 të anketuar në sondazhin online)	21.10.2020	Përcaktimi i një vizioni afatgjatë, cilësor për zhvillimin e qëndrueshëm të Prishtinës deri më 2035, si dhe hartimi i një liste Qëllimesh Strategjike më të prekshme për Prishtinën, që duhen arritur brenda dhjetë viteve të ardhshme, të cilat paraqesin qëllime të qarta për performancën mjedisore të Prishtinës dhe qëndrueshmërinë urbane
Punëtori për Veprimet (ngjarje virtuale) (16 pjesëmarrës, 69% femra, 31% meshkuj) (16 të anketuar në sondazhin online)	28.04.2021	Diskutimi dhe dakordimi mbi veprimet kryesore që duhen përfshirë në PVQGJ - mbështetur me një pyetësor elektronik për veprimet në sektorë të ndryshëm.
Takimi i Planit të Veprimeve (ngjarje virtuale) (17 pjesëmarrës, 70% femra, 30% meshkuj) (24 të anketuar në sondazhin online)	19.05.2021	Takimi për të finalizuar dhe përzgjedhur veprimet përfundimtare për përfshirje në PVQGJ.
Takime të shumta individuale me Ekspertët e Komunës Virtuale/ drejtpërdrejtë (8 pjesëmarrës)	Qershor 2021	Konsultime individuale me Ekspertët e Komunës për të diskutuar dhe pajtuar detajet e veprimeve të PVQGJ-së.

Ngjarja	Data	Objektivi
Draft Dokumenti i i PVQGJ-së të Prishtinës	Gusht 2021	Për të kërkuar reagime / komente mbi draft dokumentin e PVQGJ-së

Ky angazhim i palëve të interesit na ka ndihmuar të krijojmë Gjendjen Bazë të Qytetit të Gjelbër, si dhe në hartimin e Planit të Veprimit të Qytetit të Gjelbër.

Për të përmbushur planin ambicioz të PVQGJ-së, kemi krijuar një strukturë organizative për PVQGJ-në, përshkruar në planin e monitorimit dhe raportimit të PVQGJ-së, duke caktuar rolet dhe duke vendosur zyrtarët përkatës të qytetit. Këta trupa do të drejtojnë dhe/ose koordinojnë zbatimin e Veprimeve të parapara në PVQGJ, të monitorojnë përparimin dhe ndikimet e zbatimit të tyre gjatë viteve 2021-2025, si dhe përfundimisht, të ushqejnë Planin e dytë të Veprimit të Qytetit të Gjelbër në Prishtinë, në ciklin pasues.

1.5.3 Ndikimi i Pandemisë Covid-19 në angazhimin e palëve të interesit

Mundësia e angazhimit të palëve të interesit u ndikua nga shfaqja e pandemisë COVID-19 në mars të vitit 2020. Sa i përket angazhimit të palëve, kjo kryesisht ndikoi në mundësinë tonë për të pasur dialog të drejtpërdrejtë me njerëzit, e sidomos për ekipet ndërkombëtare të ekspertëve për të qenë fizikisht të pranishëm në punëtori, të cilat normalisht do të mbaheshin. Sidoqoftë, përdorimi i programit/platformës Zoom i mundësoi Ekipit të Konsulentit për t'u angazhuar në mënyrë efektive me palët e interesit dhe përfaqësuesit e qytetit gjatë fazave kryesore në zhvillimin e PVQGJ. Për më tepër, pyetësorët online u përdorën për të mbështetur aktivitetet e angazhimit, duke marrë reagime/komente mbi çështjet dhe pikëpamjet kryesore në mbështetje të vlerësimit të çështjeve mjedisore, pikëpamjet mbi vizionin dhe qëllimet strategjike, si dhe opsionet për përfshirje në planin e veprimit.

Ne dëgjuam palët e interesit të Qytetit përgjatë kohës së zhvillimit të planit, nëpërmjet një numër punëtorish në internet të mbajtura në etapat kryesore gjatë gjithë programit, për të marrë pikëpamje mbi çështjet prioritare mjedisore, si dhe preferencat mbi opsionet për Planin

KOMENTE TË PËRGJITHSHME - Uji dhe Mbetjet e Ngurta

Grupet e Konsultimit



Që nga fillimi i PVQGJ-së informacioni është ndarë me palët e interesit dhe publikun, nëpërmjet mbulimit të lansimit zyrtar nga mediat lokale, publikimeve të qyteteve të gjelbra të BERZH. Materialet u ndanë me palët e interesit të qytetit para ngjarjeve të punëtorisë për të mundësuar marrjen e reagimeve/ komenteve gjatë diskutimit në grupet e punëtorisë.



2 Gjendja bazë e Qytetit të Gjelbër



2.1 Shtrirja gjeografike

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës, si dhe qendra administrative e qarkut të Prishtinës dhe rajonit të Prishtinës. Si kryeqytet, Prishtina vepron si qendër politike, ekonomike, kulturore, logjistike dhe shkencore e vendit. Në total, pothuajse 215 mijë banorë të saj jetonin në territorin prej 572 km² në fund të vitit 2018 në Komunën e Prishtinës, duke përfshirë vendbanimet urbane dhe rurale³.

Zona urbane e Prishtinës mbulon rreth 77.7 km katrorë, ku më shumë se 164 mijë banorë, me dendësi prej mbi 2.1 mijë njerëz për km² banonin në kohën e regjistrimit të vitit 2011⁴.



³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019) - të dhënat e siguruar nga Departamenti për Statistika Sociale.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013): Popullsia sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe vendbanimeve. <http://ask.rks-gov.net/media/1614/population-by-gender-ethnicity-at-settlement-level.pdf>.

Prishtina është udhëkryqi më i rëndësishëm i transportit në Kosovë, për transportin ajror, hekurudhor dhe rrugor. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës është aeroporti më i madh i vendit dhe ndër më të mëdhenjtë në rajon.

Struktura themelore administrative e qytetit ("**Komuna e Prishtinës**") si dhe vendbanimi më i populluar urban i komunës është Kryeqyteti i Prishtinës. Që të 145 mijë banorët e qytetit⁵ jetonin në 30.7 mijë ekonomi familjare, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë (2011)⁶.

2.2 Planet aktuale strategjike

Ekziston një numër strategjish, planesh e iniciativash që pasqyrojnë reagimet e nivelit të lartë aktual të qyteteve në ballafaqim me sfidat e tyre, përfshirë sfidat mjedisore. Ka edhe plane të shumta sektoriale në nivel kombëtar e lokal, që mbulojnë temat si energjia (furnizimi, stabiliteti, efikasiteti), ndërmarrjet publike, banimi, transporti dhe menaxhimi i mbeturinave. Janë identifikuar edhe një numër strategjish ndër-sektoriale, duke përfshirë ato për inovacion, zhvillim digjital, zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, shëndetësi dhe ndryshime klimatike. Këto mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme të dokumenteve strategjike:

- Programet mbizotëruese, që synojnë të adresojnë sfidat kombëtare ose të qytetit;
- Planet sektoriale që synojnë të adresojnë sfidat specifike në sektorët e infrastrukturës ose shërbimeve (p.sh. energjia, banimi, shërbimet komunale); dhe
- Politikat Ndër-sektoriale që synojnë të adresojnë çështje të ndërthurura (si p.sh. Zhvillimi i Sektorit Privat, Ndryshimet klimatike)

Këto plane janë përzgjedhur pasi ato ofrojnë orientime mbizotëruese politike, por duhet të theksohet se këto orientime zbatohen përmes strategjive dhe planeve të renditura në këtë pjesë.

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013): Popullsia sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe vendbanimeve. <http://ask.rks-gov.net/media/1614/population-by-gender-ethnicity-at-settlement-level.pdf>.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019): Baza e të dhënave publike ASKDATA. <http://askdata.rks-gov.net/>.

Tabela 2-1 më poshtë ofron një pasqyrë të planeve që janë më relevante për PVQGJ-në e Prishtinës.

Tabela 2-1: Planet kryesore relevante për PVQGJ-në e Prishtinës

Titulli	Periudha e relevancës
Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Plani i Veprimit Mjedisor (PNVM)	2013-2022
Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit (SKB)	2011-2020
Strategjia e Cilësisë së Ajrit dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Cilësisë së Ajrit	2013-2022
Strategjia Kombëtare për Ndryshimet klimatike	2018-2027
Strategjia Kombëtare e Ujërave të Kosovës	2015-2034
Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022
Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës	2017-2026
Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë (ESIP)	2018-2020
Dokumenti i Strategjisë dhe Politikave të Kosovës për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë	2010-2020
Plani i veprimit për Biodiversitet	2011-2020
Plani i veprimit për strategjinë e ndryshimeve klimatike (PVNK)	2018-2020
Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve	2018-2027
Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtërishme (PKVER)	2011-2020
Plani i 4-rt Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE)	2019-2021

Burimi: Konsulentit

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe me ministritë e tjera në Kosovë, është organi përgjegjës për zhvillimin e strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike.

Në veçanti, Strategjia e Ndryshimeve klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit 2019-2021, paraqesin planet për masat e adaptimit. Qëllimi i këtij Programi është të zbatohet masa për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike, duke siguruar njëkohësisht zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë. Ai synon të ulë emetimet e gazrave serrë (GS) për 21% deri në vitin 2021, të zbatohet masa adaptimi në sektorë të ndryshëm ekonomikë, duke marrë parasysh zhvillimin socio-ekonomik të vendit; të parashtrijë rekomandime për ruajtjen e energjisë dhe resurseve,

zgjerimin e ekosistemeve pyjore, diversifikimin e burimeve të energjisë, duke rritur pjesën e energjisë së ripërtërishme; të përmirësojë kornizën ligjore për ndryshimet klimatike.

Kosova nuk është anëtare e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike ("**UNFCCC**"), e për rrjedhojë nuk është as palë e Marrëveshjes së Parisit. Megjithatë, Kosova, si aspiruese për t'u bërë pjesë e BE-së dhe OKB-së, si dhe si palë aktive në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, do të vazhdojë të zhvillojë masa të ndryshimeve klimatike në baza vullnetare. Do të jetë më efikase dhe e suksesshme nëse veprimet e identifikuar për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përfshihen (dhe integrohen) qartësisht në dokumentet e PVQGJ-së së Prishtinës.

Analiza e plotë e politikave dhe strategjive të Qytetit është dhënë në Shtojcën B.

2.3 Gjendja bazë për Qytetin e Gjelbër

Për të kuptuar dhe për t'i dhënë prioritet sfidave me të cilat përballet Prishtina, krijuam gjendjen bazë të performancës mjedisore të qytetit tonë, me metodologjinë e procesit PVQGJ. Këtu përfshihen një sërë standardesh ndërkombëtare kundrejt të cilëve mund të krahasohet performanca mjedisore e qytetit, për të nxjerrë një vlerësim objektiv të gjendjes së qytetit.

Të dhënat u mbledhën për treguesit e Trysnisë, Gjendjes dhe Reagimit, duke populluar kështu veglën e Databazës së Treguesve. Për secilin tregues, jemi përpjekur të mbledhim të dhëna historike, ashtu që ta vlerësojmë performancën aktuale me ngjyrat Kuqe-Verdhë-Gjelbër, si dhe të shqyrtojmë trendet historikë.

U hartua edhe raporti i vlerësimit teknik, rezultatet e të cilit u ndanë dhe diskutuan me palët e interesit në një seri punëtorish të mbajtura për të konfirmuar këto konstatime.

Kapitulli i mëposhtëm përmbledh konstatimet e këtij procesi të vlerësimit teknik, si dhe nënvizon prioritetet mjedisore të theksuara gjatë diskutimeve me palët e interesit. Detajet e plota të performancës së secilit sektor, të matura me të dhënat e përfshira në databazën e Treguesve

PVQGGJ janë paraqitur në Shtojcën A (Të dhënat nga Databaza e treguesve).

2.3.1 Cila është gjendja aktuale e mjedisit?

Gjendja e mjedisit

Cilësia e ajrit

Analiza jonë tregoi që ka **sfida në aspektin e cilësisë së ajrit, ku treguesi bazë “Koncentrimi mesatar vjetor me PM2.5” ishte mbi pragun e standardit të “Kuq”** gjatë muajve të dimrit (nëntor - shkurt). Faktorët shtytës të kësaj performance të dobët në cilësinë e ajrit janë **trafiku dhe afërsia e termocentraleve** që sigurojnë furnizimin me ngrohje të qytetit. Ka mundësi të menaxhimit të cilësisë së ajrit në mënyrë më efektive në të ardhmen, duke përdorur **kontrollat rregullatore përmes Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Qytetit 2018-2030 (PMQU)**, për të menaxhuar qarkullimin e trafikut në zonat e qytetit ku cilësia e ajrit regjistrohet të jetë e dobët, si dhe duke inkurajuar burime alternative të energjisë për sistemin e ngrohjes qendrore të qytetit.



Cilësia dhe burimet e ujit

Ekzistojnë sfida për sa i përket cilësisë së ujit, sepse Qyteti **nuk ka sistem të mbledhjes së ujërave atmosferike**. Ka po ashtu nevojë të instalohen impiante për **trajtimin paraprak të mbetjeve industriale**, por edhe që të parandalohet ndotja e burimeve ujore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave. Kjo kërkon aktivitet më të fuqishëm në kuptimin e zbatimit të ligjit në mbrojtje të resurseve ujore, si dhe veprime për të siguruar menaxhimin më efektiv të **depozitimit të mbeturinave urbane, ndërtimore, mjekësore dhe atyre të rrezikshme**.



Cilësia e dheut

Nuk ka të dhëna në dispozicion në lidhje me treguesit e cilësisë së dheut. Hulumtimi i niveleve të ndotjes së tokës bujqësore, kryer më 2015, zbuloi që **nuk kishte tokë bujqësore të ndotur** brenda territorit të Komunës së Prishtinës, gjë që tregon se cilësia e dheut **me gjasë mund të mos jetë çështje aq domethënëse për Qytetin**. Secili rrezik që lidhet me kontaminimin e dheut ka të ngjarë të jetë pasojë e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave, ose afërsisë së pompave të karburanteve apo zonave të vjetra industriale.



Hapësirat e gjelbra

Numri i sipërfaqeve të gjelbra në Qytet është rritur ndjeshëm, ku ka më shumë zona që janë zhvilluar, së bashku me një numër më të madh të pemëve të mbjella dhe më shumë hapësira të lira publike që janë ndërtuar, transformuar apo rikonstruktuar.



Zonat e gjelbra tashmë përbëjnë **26% të zonave urbane**, përfshirë Parkun Natyror të Gërmisë që është hapësira më e rëndësishme e gjelbër në Qytet. Megjithatë, ekziston një **shpërndarje e pabarabartë e hapësirave të gjelbra në gjithë Qytetin**, ku pjesa më e madhe e hapësirave të gjelbra është më e largët nga zonat më të populluara të qytetit.

Ekziston sfida më e madhe në aspektin e zhvillimit të **një rrjeti të shtigjeve këmbësore dhe çikliste** që do të shërbente hapësirat e gjelbra, pasi që këto aktualisht nuk ekzistojnë, duke kufizuar kështu edhe qasjen për banorët vendorë dhe vizitorët. Ka gjithashtu një trysni të konsiderueshme mbi hapësirat e gjelbra dhe infrastrukturën e gjelbër nga **dendësimi urban dhe madje edhe për vendparkime** në qendër të qytetit.

Biodiversiteti

Aktualisht ka mungesë të të dhënave në dispozicion për biodiversitetin në Qytet. Biodiversiteti i Prishtinës konsiderohet i pasur falë afërsisë së Parkut të Gërmisë, në veri-lindje të qytetit, që ka një faunë të pasur me 64 specie zogjsh dhe 19 lloje kafshësh, si dhe një larmi prej afro 600 specieve të florës.



Nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e larmisë së specieve lokale të shpendëve. Ekziston [shqetësimi për nivelin e urbanizimit \(veçanërisht shtrirjen urbane\)](#) në qytet si dhe ndikimin e mundshëm të tij në diversitetin e specieve në të ardhmen.

Masat lehtësuese për ndryshimet klimatike

Kosova po zhvillon në mënyrë aktive reagimin e saj ndaj ndryshimeve klimatike, duke zbatuar [Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028, si dhe Planin e Veprimit 2019- -2021](#).

Çështjet kryesore lidhur me ndryshimet klimatike kanë të bëjnë me transportin, si dhe janë adresuar në detaje në Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) 2018-2030 të Qytetit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e mënyrave të qëndrueshme të transportit për të përmirësuar cilësinë e ajrit të qytetit.



Faktorë të tjerë kryesorë që ndikojnë në ndryshimet klimatike në Kosovë, e të cilat gjithashtu mund të konsiderohen si të rëndësishme për Qytetin, janë:

- Industri që punojnë me [teknologji të vjetëruara](#) (veçanërisht Termocentralet) edhe pse ndodhen jashtë territorit të Qytetit;
- Ndërtimi dhe [urbanizimi](#) i pakontrolluar që nga viti 1999;
- Ndërtimet pa leje dhe mosrespektimi i [kodeve dhe standardeve të ndërtimit](#);
- [Infrastruktura e vjetëruar](#) dhe e papërshtatshme e [sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve](#) për të përballuar tendencat aktuale të zhvillimit dhe rritjen e popullsisë; dhe

- [Menaxhimi i paqëndrueshëm i ujit](#).

Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike

Çështjet e identifikuara në [Strategjinë kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Planin e Veprimit 2019-2021](#) vlejnjë edhe për Prishtinën, për aq sa i përket pushtetit lokal. [Sfida kyçe është që sistemi i qeverisjes publike të bëhet më rezistent në aspektin klimatik në mënyrat vijuese:](#)

- Ballafaqimi me [paqartësitë në vendimmarrje](#) në lidhje me ndryshimet klimatike duke përfshirë analizat e skenarëve afatgjatë, vlerësimet e rrezikut dhe vlerësimet e cënueshmërisë;
- Përfshirja e [sektorit privat në menaxhimin e burimeve natyrore](#) (p.sh. përmes partneriteteve publike-private);
- Vendosja e [qasjeve të integruara, apo ndërsektoriale, si dhe koncepteve të menaxhimit adaptues](#).



Trysnitë dhe reagimet mjedisore

Sfidat për Prishtinën janë përmbledhur më poshtë:

Transporti

A është flota e automjeteve efikase? Derisa ka disa automjete të reja në rrugë, as flota e transportit publik dhe as flota e automjeteve private nuk konsiderohen efikase. Derisa ekzistojnë disa [autobusë të rinj](#) të futur në qarkullim nga Trafiku Urban, ka akoma [shumë automjete të vjetra që qarkullojnë në Qytet edhe përtej jetëgjatësisë së tyre funksionale](#).

Shumë banorë të Prishtinës blejnë [automjete shumë të vjetra, shpesh me motorë dizel](#), ndërsa moshja e vjetër e automjeteve, përveç dendësisë së madhe të trafikut në qendrën e qytetit, përbëjnë pjesën më të madhe të ndotjes së ajrit në Prishtinë. [Mbi 30% e automjeteve të Qytetit lëvizin me naftë për shkak të kostos së ulët](#).

Ligjet aktuale në Kosovë kanë kufizime të pakta për moshën e lejueshme të automjeteve, megjithëse ekzistojnë rregulla për automjetet me ndotje të madhe, që do të thotë se automjetet që janë më të vjetra se 10 vjet nuk mund të importohen. Mosha dhe përqindja e lartë e motorëve dizel në flotën e automjeteve të Qytetit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit dhe shëndetin publik në Prishtinë.



Cila është mënyra e preferuar e transportit? Prishtina po bëhet gjithnjë e më e varur nga udhëtimi me automjete, ku **përpjesëtimi i transportit privat** (automjete dhe motoçikleta) brenda qytetit është 50.9%. Vitet e fundit, në Prishtinë ka pasur një rritje të shpejtë të popullsisë, me migrim të madh nga zonat rurale drejt zonës urbane të Prishtinës.

Në përgjithësi, **pronësia e automjeteve** e cila, duke pasur parasysh përmirësimin e kushteve ekonomike dhe popullsisë në rritje në Prishtinë, **pritet të rritet në të gjithë Qytetin**. Në anën e kundërt, ekziston **nivel shumë i ulët i aktivitetit të çiklizmit** në Qytet, për shkak të mungesës së rrjetit të shtigjeve dhe elementeve për çiklizëm, por edhe çështje të tjera lidhur me sigurinë në rrjetin rrugor mjaft të ngjeshur.

Ekziston **një potencial i konsiderueshëm për të përmirësuar përpjesëtimin e mënyrave të transportit apo formave të transportit jo-motorik**, siç janë ecja dhe çiklizmi. Reagimet përfshijnë edhe futjen në funksion të një përparësie të këmbësorëve në qendrën e qytetit, ndërsa propozimet janë të përfshira në PMQU të qytetit, në kuptimin e zhvillimit të skemave të transportit publik, këmbësorëve dhe çiklizmit për të inkurajuar një lëvizje drejt mënyrave më të qëndrueshme të transportit.



A ka ngarkesa të konsiderueshme trafiku?

Mbingarkesa në qytet, veçanërisht në bërthamën urbane, po rritet, bashkë me automjete me shpejtësi të ulëta, si për automjete private ashtu edhe për autobusët e Qytetit. **Shpejtësia mesatare e automjeteve në rrjet gjatë orëve të pikut është shumë e ngadaltë**, gjë që ka efekt në transportin publik për shkak se ka pak infrastrukturë që i jep përparësi autobusëve brenda qytetit.



Shpejtësia mesatare e qarkullimit të autobusëve në Qytet është vërejtur të jetë 13 km/orë, si rezultat i ngarkesës së madhe, gjë që ndikon edhe në rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve. Zgjidhjet e propozuara në PMQU-në e qytetit, duke përfshirë implementimin e **një rrjeti të ri të autobusëve**, të mbështetur nga masat për përparësinë e autobusëve, si dhe vendosjen e masave të kontrollit të parkimit dhe menaxhimit të trafikut në qendër të qytetit.



Është rrjeti i transportit rezistent ndaj ndryshimeve klimatike? Aktualisht, nuk ka ndonjë urgjencë të konsiderueshme për të adresuar çënueshmërinë klimatike në nivel lokal në Prishtinë. Sidoqoftë, **është e kufizuar vetëdija për çënueshmërinë** me të cilën mund të përballet rrjeti i transportit, si dhe nuk ka evidenca të mjaftueshme mbi të cilat mund të bazohet një strategji adaptimi.

Ndërtesat

Sa eficiente janë ndërtesat në aspektin e energjisë elektrike? Qyteti menaxhon një fond prej 112 objektsh komunale, në të cilat shumica janë objekte arsimore dhe të kujdesit shëndetësor. Shumica e këtyre ndërtesave nuk i plotësojnë standardet aktuale evropiane dhe janë relativisht joefikase në energji. Problemet kryesore (në kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm) që karakterizojnë statusin aktual të fondit të ndërtesave në Prishtinë janë **konsumi i lartë i energjisë nga shtëpitë, financimi i**



pamjaftueshëm për banim dhe shërbime komunale, por edhe prania e azbestit në materialet ndërtimore të banimit.


Sa janë eficientë ndërtesat në aspektin termik? Nuk ka projekte me certifikatë të gjelbër të ndërtimit. Eficienca termike e ndërtesave të banimit në Prishtinë është e ulët. Sidoqoftë, Ligji Nr. 05 / L-101 Për Performancën Energjetike në ndërtesa jep përkufizimin e Ndërtimit me gati zero konsum të energjisë (Kapitulli V) si dhe krijon platformën për projektet e reja CPE (Certifikatat e Performancës së Energjisë) në këtë fushë.

Ngjashëm, fondi i ndërtesave jo-banesore paraqet sektor me **efiçencë të dobët termike**. Gjithsesi, konsumi i energjisë elektrike në objekte jo-banesore aktualisht është pak më i ulët në krahasim me konsumin në ndërtesat e banimit. Në veçanti, zbatimi i procesit të certifikimit paraqet një mundësi të rëndësishme për të rritur efiçencën.



Industria

Ka ndonjë industri në funksion apo hapësira industriale të braktisura në Qytet e që kanë ndikim negativ në mjedis? Qyteti ka trashëguar disa zona industriale, të cilat aktualisht nuk janë në funksion. Sidoqoftë, ekzistojnë lokacione me **industri minerare dhe prodhim energjie** (termocentrale qymyri), që gjenden **në afërsi të madhe me qytetin** (Komuna e Obiliqit), e të cilat përfaqësojnë një trysni domethënëse mjedisore mbi mjedisin e Prishtinës.



Energjia

Sa i "gjelbër" është burimi i energjisë për Prishtinën, si dhe a ka ndonjë implikim për gjendjen e aseteve të saj mjedisore? Dy termocentralet me linjit të Kosovës, që gjenden pak larg Prishtinës, paraqesin një pjesë të rëndësishme të prodhimit të energjisë në vend, por edhe një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Prishtinë.

Këto dy termocentralet kanë një kapacitet të instaluar të përbashkët prej 1,478 MW, edhe pse të dy centralet janë të vjetruara dhe operojnë me

kapacitet shumë më të ulët sesa ai i instaluar. Politikat e energjisë në Kosovë deri më tani janë përqendruar kryesisht në sigurimin e furnizimit me energji elektrike në shkallë të gjerë, si dhe kalimin në një treg të liberalizuar të energjisë.

A kanë njerëzit qasje adekuate në energji elektrike?

Sipas të dhënave të mbledhura, ekziston **elektrifikimi i plotë i popullsisë së Prishtinës**.




Kanë njerëzit qasje adekuate në sisteme të ngrohjes qendrore?

Qasja e popullatës së qytetit në ngrohje është e lartë, por **cilësia e shërbimit të ofruar ende nuk është e mjaftueshme**. Humbjet teknike në rrjetin shpërndarës të ngrohjes ishin 18% në vitin 2015, Plani i 3-të Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) përlogarit se mund të arrijë në 10-12% në të ardhmen e afërt.

Sa energji prodhohet nga burimet e ripërtërishme? Edhe pse nuk ka të dhëna saktësisht për Qytetin, mund të pritët që përpjesa e energjisë nga burimet e ripërtërishme të jetë e njëjtë me atë kombëtare, ku **energjia nga qymyri dhe nafta përfaqëson afro 86% të prodhimit të përgjithshëm**. Sidoqoftë, prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme ka qenë në rritje - kryesisht bazuar tek prodhimi nga hidrocentralet e vogla dhe të mesme, fermat e erës dhe instalimet fotovoltaike. Siç parashihet nga Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtërishme, **caku për hisen e energjisë nga burimet e ripërtërishme në konsumin e përgjithshëm bruto të energjisë është 25% në vitin 2020**.

Sa rezistent është rrjeti i energjisë elektrike ndaj fenomeneve ekstreme klimatike?

Nuk ka informacione ose të dhëna të disponueshme, të cilat mund të mundësojnë vlerësim më të thuktë të situatës. Sidoqoftë, mungesa e masave reaguese në lidhje me rezistencën e rrjeteve të energjisë elektrike në rast fatkeqësie tregon se **rrjeti i energjisë elektrike mund të mos jetë i përgatitur mirë për fenomenet ekstreme klimatike**.



Uji

Si ndikojnë furnizimi me ujë dhe sanitaria në mjedis në Prishtinë?

Kompania Rajonale e Ujësjellës-Ujërave të Zeza në Prishtinë (KRU Prishtinë) ofron shërbime të furnizimit me ujë dhe grumbullimit të ujërave të zeza për Qytetin, bashkë me gjashtë komunat fqinje. Aktualisht, shumica e klientëve të Prishtinës (98%) kanë furnizim të vazhdueshëm me ujë. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ), të gjitha ujërat e zeza të grumbulluara derdhen direkt në trupa uJORë, pa asnjë trajtim, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedis.

A është konsumi i ujit shumë i lartë? Sipas llogaritjeve të KRU Prishtina, konsumi për kokë banori është 128 litra në ditë, që është relativisht e ulët. Sidoqoftë, kjo shifër mund të rëndohet nga pasaktësitë në leximin e njehsorëve dhe shfrytëzimi i paautorizuar i ujit (veçanërisht ujitja ilegale gjatë verës).

KRU Prishtina tashmë ka miratuar strategjinë për humbjet e ujit, së bashku me planin përkatës të veprimit. Kompania gjithashtu përditëson çdo vit planin e biznesit, ku parashikohen nivelet e prodhimit dhe shitjes. Ekziston gjithashtu një mungesë e shërbimit të grumbullimit dhe furnizimit me ujëra atmosferikë.



A është sistemi i shpërndarjes së ujit efikas? Të dhënat e furnizuara nga Rregullatori i Ujit i Kosovës tregojnë se humbjet e pafaturuara në KRU Prishtinë qëndrojnë në 60%, që është shumë e lartë, si dhe nuk ka shfaqur përmirësime gjatë 5 viteve të fundit. Megjithatë në mungesë të auditimeve teknike, pjesa e humbjeve të ujit është e panjohur, mund të përlllogaritet që shumica e humbjeve janë rrjedhje të rrjetit me një pjesë të konsiderueshme të humbjeve komerciale. Sistemi i shpërndarjes së ujit funksionon në kushte hidraulike nën optimum, duke çuar kështu në nivel të lartë të çarjeve të gypave dhe efikasitet të dobët në energji.

Deri më tani, KRU Prishtina nuk ka model hidraulik dhe as sistem të centralizuar të Kontrollit Mbikëqyrës dhe Grumbullimit të të Dhënave (SCADA). Konfiguracioni gjeografik i qytetit karakterizohet me një përzierje të lartësive mbidetare të mëdha e të vogla. Kështu, pompimi mekanik është i domosdoshëm për të rritur presionin e ujit për disa pjesë të zonës së shërbyer. Sidoqoftë, ka situata të shumta kur një pjesë e ujit

të pompuar rrjedh drejt ultësirave të qytetit duke shkaktuar presione të tepërta dhe humbje të energjisë. Për shkak të luhatjeve në presion, ngathtësisë në rregullimin e elementeve të rrjetit (gjatë emergjencave) si dhe cilësisë së dobët të riparimeve, rritet edhe numri i incidenteve në rrjet. Zbulimi dhe riparimi i rrjedhjeve esencialisht janë reaguese, si dhe vihen në lëvizje kryesisht kur ndodhin ndërprerje të furnizimit. Kjo tregon një nivel të dobët të pjekurisë në aspektin e Menaxhimit të Aseteve në KRU Prishtina.

A trajtohen në mënyrë efektive ujërat e zeza? Nuk ka struktura për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë. KRU Prishtina tashmë operon me dy ITUZ të vogla, që grumbullojnë dhe trajtojnë rrjedhat e ujërave nga zonat lokale përreth tyre (fshatrat Sllatinë dhe Mramor).

Qeveria e Kosovës tashmë ka nënshkruar marrëveshje me Qeverinë Franceze për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza. Gjithashtu, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) do të financojë ndërtimin e sistemit të kolektorit të ujërave të zeza, i cili do të lidhet me impiantin e trajtimit të ujërave të zeza.



A është qyteti rezistent ndaj katastrofave natyrore? Në nivel kombëtar, ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike mbi burimet ujore janë shqetësim kritik. Për katër pellgjet lumore në Kosovë, strategjia e ujërave dhe planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, mes tjerash, adresojnë menaxhimin e rreziqeve, përfshirë mbrojtjen nga përmbytjet dhe identifikimin e zonave të prira të vërshohen. Për sistemet ujore në Prishtinë nuk ka informacion ose të dhëna të disponueshme për të mundësuar vlerësim më të thuktë të gjendjes në nivelin komunal. Sidoqoftë, mungesa e masave reaguese në lidhje me rezistencën e sistemit të ujësjellësit tregon se ky rrjet mund të mos jetë i përgatitur mirë për fenomenet ekstreme klimatike. Rritja e rezistencës do të kërkojë transformimin e rolit dhe qasjes së KRU Prishtina, investime të konsiderueshme në infrastrukturë, por edhe edukim dhe vetëdijësim të qytetarëve.

Mbeturinat inerte


Sa mbeturina prodhohet njerëzit? Prodhimi i mbeturinave në Prishtinë është 338 kg/vit/kokë banori, që paraqet një performancë mesatare.

A mblidhen mbeturinat në mënyrë efikase? Qyteti ka mbulueshmëri të plotë të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, që ofrohet nga Kompania Rajonale e Grumbullimit të Mbeturinave "Pastrimi". Qyteti përballet me menaxhim jo adekuat të rrjedhave të mbeturinave të tjera, sidomos mbetjeve ndërtimore dhe ato nga rrënimet, por edhe mbeturinave të rrezikshme. Gjithashtu, për shkak të mungesës së impianteve për mbeturina shtazore, si dhe menaxhimit jo adekuat të mbeturinave spitalore, por edhe rrjedhave të tjera të mbeturinave të rrezikshme, rezultati është që këto mbeturina hidhen në kontejnerë komunalë dhe përfundojnë në deponi sanitare.

Qyteti, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, nuk ka arritur të intensifikojë ndarjen e mbeturinave në burim, si dhe grumbullimin e riciklimin e ndarë të materialeve të riciklueshme. Kjo ka bërë që një sasi e madhe e mbeturinave që duhen grumbulluar e deponuar të prodhojë efekte negative mbi të gjitha palët e interesit që angazhohen në menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane.



A përfshin trajtimi i mbeturinave nivele të arsyeshme të klasifikimit dhe riciklimit? Ekziston një nivel tejet i ulët (rreth 1%) i klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave në kuadër të menaxhimit të mbeturinave të qytetit. Kjo kryesisht lidhet me materialet e riciklueshme që mblidhen nga vetë konsumatorët që kanë qasje në infrastrukturë për grumbullimin e posaçëm të mbeturinave. Kjo shifër nuk përfshin mbledhjen e mbeturinave nga vetë popullata, pasi që grumbullimi i tillë nuk regjistrohet në statistikat e Qytetit si "riciklim i mbeturinave", sepse vlerësohet si "transaksion shitblerjeje" dhe shumica e transaksioneve të tilla nuk llogariten. Operatori i grumbullimit dhe transportimit, si dhe operator i deponisë, nuk operojnë me impiante riciklimi. Të gjitha materiet e riciklueshme që mblidhen dërgohen në qendra private të grumbullimit, që tregtojnë me këto mbeturina, me një sasi të vogël që riciklohet.



A ka kapacitet të mjaftueshëm për deponi? Deponia e Mirashit, që merr mbeturinat nga Qyteti dhe komunat fqinje, nuk është në përputhje me normat mjedisore vendore dhe të BE-së për sa i përket infrastrukturës dhe menaxhimit. Deponia pritej të mbyllej në vitin 2020, ndërsa procesi i ndërtimit të deponisë së re nuk ka filluar ende. Është kontraktuar tashmë studimi i fizibilitetit për deponinë e re në Prishtinë, por me sa duket janë hasur probleme me gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për ndërtimin e deponisë së re.

Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës

A ka qyteti dendësi optimale të popullsisë? Analiza jonë tregon që Qyteti ka dendësi nën optimum sipas standardeve të PVQGJ-së, gjë që ka implikime të veçanta mbi rrjetet e transportit dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve komunale. Kjo tregon për mungesë të kapaciteteve të planifikimit urban dhe zbatim të papërshtatshëm ose të pamjaftueshëm të planeve dhe rregulloreve të zonimit.



Po "shkapërderdhet" qyteti? Bazuar në analizën e bërë me GIS (Sistem Informativ Gjeografik), me anë të hartave ortofoto dhe topografike deri në vitet 1970 - 2010, zona urbane është ndërtuar në vitin 1970 rreth 948 hektarë, ndërsa ishte rreth 1,693 hektarë (të zgjeruar) më 1999, por shënoi rritje rekord (zgjerimi i qytetit) në rreth 4,662 hektarë në vitin 2010. Gjatë dy dekadave të fundit, ka pasur rritje të vazhdueshme në nivelin e zonave të ndërtuara në gjithë qytetin, duke sjellë një shtrirje të zgjeruar të zonës urbane.



Janë të shfrytëzuara mirë zonat e zhvilluara ekzistuese? Disa pjesë të zonave urbane të Qytetit po transformohen përmes planeve rregulluese që mbulojnë zhvillime të ndryshme banesore, duke filluar nga shtëpitë private deri te objektet shumëkatëshe, me ndërtesa banesore të larta dhe destinime të përziera.

Sipas Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës, toka është në dispozicion për të akomoduar rritjen në pjesën jugore të qytetit. Zgjerimi i kufijve të qytetit drejt hapësirave të lira jashtë zonës së tanishme urbane ngre një shqetësim se në të ardhmen mund të ketë trysni të konsiderueshme që vjen nga përhapja urbane



Sfidat prioritare mjedisore - Përmbledhje

Bazuar në rezultatet e punës së vlerësimit teknik dhe diskutimet me palët e interesit, janë identifikuar prioritetet kryesore mjedisore për Prishtinën si vijon:

Gjendja mjedisore

Cilësia e ajrit:

- Nivel i lartë i emetimeve të grimcave (partikulat) në Qytet, veçanërisht gjatë muajve të dimrit
- Mungesë e monitorimit tërësor të cilësisë së ajrit në të gjithë Qytetin

Biodiversiteti:

- Qasshmëri e dobët e zonave të gjelbra për banorët e Qytetit
- Shtrirja e pabarabartë e hapësirave të gjelbra përgjatë territorit të Qytetit
- Mungesa e të dhënave të besueshme për biodiversitetin
- Nivelet e rritura të urbanizimit në të gjithë qytetin, përfshirë shkapërderdhjen urbane

Ndryshimet klimatike (Lehtësimi dhe adaptimi)

- Vendimmarrje e kufizuar lidhur me ndryshimet klimatike
- Mungesa e angazhimit të sektorit privat në çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike
- Mungesa aktuale e qasjeve të integruara dhe koncepteve të menaxhimit adaptues brenda Qytetit
- Mungesë e të dhënave lidhur me infrastrukturën publike dhe ekonominë familjare që kanë rrezikshmëri klimatike në Prishtinë

Trysnitë në infrastrukturë dhe shfrytëzim të tokës

Mobiliteti/Lëvizshmëria urbane:

- Problemet në lidhje me ngarkesat e mëdha të trafikut dhe përdorimin e automjeteve private në qendër të qytetit;
- Nivele të ulëta të udhëtarëve me transport publik dhe këmbësorëve për lëvizje brenda qytetit;
- Nivele të ulëta të çiklizmit në Prishtinë, si alternativë e vlefshme ndaj shfrytëzimit të transportit motorik privat;
- Kërkesë e lartë për parkim në qendër të qytetit;
- Mungesë e infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta dhe probleme të lëvizshmërisë;
- Shifra të mëdha të automjeteve dizel që qarkullojnë në Prishtinë;
- Dobësia e rrjetit të transportit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike;
- Problemet e ndikimeve mjedisore dhe të sigurisë nga automjetet e rënda transportuese në qytet;
- Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve që inkurajojnë përdorimin e automjeteve elektrike dhe hibride.

Ndërtesat:

- Nivele aktualisht të dobëta të efijencës së energjisë në ndërtesa në të gjithë Qytetin;
- Mungesë e efijencës në ngrohje termike në ndërtesa;
- Nivele të dobëta të respektimit të rregullave në gjithë sektorin, për kontrollimin e nivelit dhe llojeve të ndërtesave në të gjithë Qytetin, me projektim më të qëndrueshëm dhe pranim teknik të projektimit dhe konstruksionit të objekteve.

Sektori i industrisë:

- Afërsia me industrinë minerare dhe prodhimin e energjisë;

- Mungesa e standardeve dhe detyrimeve të gjelbra të industrisë për të kontribuar në komunitete; dhe
- Mungesë e inspektimit të fazave operative të aktiviteteve industriale.

Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës:

- Mungesë e zbatimit të masave të planifikuara tashmë.
- Problemet e shkaktuara nga dendësia e ulët e popullsisë dhe shpërndarja e saj në gjithë qytetin;
- Problemet e shkaktuara nga shtrirja e pakontrolluar urbane.

Sektori i Energjisë:

- Problemet lidhur me shfrytëzimin e qymyrit për prodhimin e energjisë dhe ngrohjen me afërsinë e termocentralit me qymyr me qytetin;
- Problemet lidhur me humbjet në ngrohje përgjatë gjithë rrjetit, me mungesën e efikasitetit të energjisë;
- Problemet me shtrirjen e rrjetit aktual të ngrohjes qendrore, si dhe mungesën e sistemeve inteligjente të matjes në Qytet;
- Mungesa e sistemeve të energjisë së ripërtërishme në Prishtinë, me investimet në teknologji dhe inovacione të reja në energji;
- Mungesë e vetëdijesimit dhe promovimit të shfrytëzimit të burimeve alternative të energjisë - përfshirë përdorimin e transportit elektrik dhe krijimin e stacioneve të mbushjes për automjetet elektrike, për të ndihmuar në përballjen me problemet e cilësisë së ajrit në Qytet;
- Monitorim dhe respektim i mangët, me nivele më të mëdha të inspektimit të prodhimit të energjisë.

Sektori i Ujërave:

- Problemet që lidhen me mungesën e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Qytet;
- Problemet që lindin nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe furnizimit të ujërave atmosferikë;
- Nevoja për të përmirësuar praktikatat e menaxhimit të burimeve ujore të qytetit;
- Mungesë e sistemit të grumbullimit të ujërave atmosferike në Prishtinë;
- Para-trajtim i mangët i ujërave të zeza industriale; dhe
- Problemet aktuale të ndotjes së burimeve ujore nga ndotja e përhapur për shkak të hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave.


Sektori i mbeturinave inerte:

- Nivele të ulëta të kapacitetit të deponive;
- Nivele të ulëta të aktivitetit të riciklimit në të gjithë Qytetin;
- Mungesë e menaxhimit të rrjedhave të ndryshme të mbeturinave, duke përfshirë mbeturinat e rrezikshme;
- Mungesë e të dhënave cilësore për mbeturinat, për të mundësuar planifikim më të mirë;
- Nivele të larta të aktivitetit të paligjshëm në lokacione të deponive;
- Krijimi i qendrave të reja të trajtimit të mbeturinave në të gjithë Qytetin; dhe
- Mungesa e standardeve të rrepta të mbrojtjes së mjedisit, kategorizimit dhe shfrytëzimit të tokës.

3 Vizioni i Qytetit të Gjelbër & Qëllimet Strategjike



Duke ndjekur përkufizimin e Gjendjes Bazë të Qytetit të Gjelbër, hapi vijues është të kuptojmë dhe t'i përcaktojmë prioritetin mundësive për të adresuar ato sfida. Formulimi i veprimeve të PVQGGJ-së ndjek këtë proces:



Vizioni i Qytetit të Gjelbër - 10 vjet

Ku duam të jemi pas 15 vitesh?

Qëllimet Strategjike 5 - 10 vjet

Cilat fusha specifike na duhet të adresojmë në gjithë sektorët?

Caqet Afatmesme - 5 vjet

Cilat caqe duam të synojmë të arrijmë përmes veprimeve tona?

Veprimet e Qytetit të Gjelbër 1 - 5 vjet

Veprimet që do të zbatohen në 1-5 vitet e ardhshme për të arritur caqet afatmesme



3.1 Cili është Vizioni ynë i Qytetit të Gjelbër për Prishtinën?

"Prishtina është qytet që e duam, me shoqëri aktive e të përgjegjshme, standarde të larta jetese dhe me përdorim efikas të resurseve e me mbrojtje të mjedisit"

Deklarata e vizionit u miratua nga përfaqësuesit e Qytetit në janar të vitit 2021. Kjo u definua nga Qyteti, duke u bazuar në:

- prioritetet mjedisore të identifikuara përmes angazhimit të palëve të interesit,
- aspiratat dhe mesazhet kryesore,
- shembuj të deklaratave të tjera të vizionit për Qytet të Gjelbër.

3.2 Qëllimet Strategjike të Qytetit të Gjelbër

Ka shumë mundësi për të përmirësuar performancën mjedisore në të gjithë qytetin. Si rezultat i analizës teknike të kryer nga ekipi ynë i konsulentëve dhe diskutimit me zyrtarë të qytetit, përfaqësues të ofruesve të shërbimeve, grupe të shoqërisë civile dhe grupeve të të rinjve, kemi identifikuar 11 Qëllime Strategjike që do të përmbushen gjatë 10-15 viteve të ardhshme, e të cilat janë përmbledhur më poshtë.

MOBILITETI URBAN

Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU)

NDËRTESTAT

Avancimi dhe ndërtimi, me efikasitet në energji dhe resurse, për të dekarbonizuar sektorin e ndërtimit të Qytetit

INDUSTRIA

Sigurimi i praktikave të mira mjedisore për të përmirësuar performancën e energjisë industriale

ENERGJIA

Vendosja e një kornizë të pastër, inteligjente dhe të integruar për furnizim të qëndrueshëm të energjisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe shtrirjes së rrjetit të ngrohjes qendrore

UJI

Vendosja e shërbimeve moderne, efikase dhe të qëndrueshme/ rezistente të ujit
Vendosja e trajtimit funksional të ujit & ujërave të ndotura dhe rigjenerimin e burimeve

MBETURINAT

Vendosja e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve

SHFRYTËZIMI I TOKËS

Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbërta me qasje të lehta, të ndërlidhura dhe të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje
Promovimi dhe zhvillimi i konceptit të lagjes së qëndrueshme në qytet për të zvogëluar zgjerimin e pakontrolluar urban

NDRYSHIMI I KLIMËS

Përmirësimi i reagimit ndaj Ndryshimeve Klimatike në një kontekst më të gjerë të qëndrueshmërisë
Sigurimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës së re të Prishtinës përballë trysnive kronike të klimës dhe ngjarjeve katastrofike.

SISTEMI MJEDISOR

Vendosja e një sistemi efektiv dhe efikas të koordinimit dhe menaxhimit të Qyteteve të Gjelbra
Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë

ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Vendosja e një marrëdhënie më efektive për angazhimin e palëve të interesuara për të përmirësuar planifikimin dhe vendimmarrjen

QYTETI INTELIGJENT

Aplikimi i Teknologjive Inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore


3.3 Zhvillimi i Veprimeve të Qytetit të Gjellbër

Duke u bazuar në vlerësimin e gjendjes bazë teknike për performancën mjedisore të qytetit, si dhe kontributet e ofruara nga palët e interesit gjatë seminareve, ekspertët tanë teknikë kanë hartuar listat fillestare të masave për shqyrtim brenda PVQGJ-së.

Këto lista preliminare të opsioneve u bazuan në idetë ekzistuese të projekteve të marra nga plane të tilla si Plani i Mobilitetit i Qytetit të Prishtinës etj. Veprimet e sugjeruara po ashtu u shtjelluan për të pasqyruar çështjet dhe sfidat e identifikuar dhe diskutuara me palët e interesit, por edhe konceptet e propozuara nga Ekipi i Ekspertëve të Konsulentit.

Procesi i plotë i ndërmarrë për zgjedhjen dhe elaborimin e listës së veprimeve të Qytetit të Gjellbër është përmbledhur më poshtë, duke pasqyruar procesin e strukturuar për të arritur në një listë përfundimtare të masave për PVQGJ.

Lista e opsioneve të mundshme do të strukturohet sipas sektorëve dhe përfshin fushat e mëposhtme kryesore:




- **Mobiliteti/Lëvizshmëria Urbane:** zvogëlimi i varësisë nga automjetet private dhe inkurajimi i përdorimit më të madh të mënyrave të transportit publik dhe aktiv, për të zvogëluar ndikimet në mjedisin e qytetit;
- **Ndërtesat:** projekte për të përmirësuar eficiencën termike dhe elektrike;
- **Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës:** Rritja e cilësisë së hapësirave të gjelbra në të gjithë qytetin dhe përdorimi i tokës në mënyrë më efikase;
- **Energjia:** krijimi i një përzierje më të qëndrueshme të burimeve të energjisë, zbatimi i strategjisë së klimës dhe asaj të energjisë, si dhe krijimi i qasjes së duhur në energji e ngrohje;
- **Industria:** inkurajimi i sektorit afarist që të angazhohet në krijimin e një qyteti të pastër dhe efikas;
- **Uji dhe ujërat e zeza:** zvogëlimi i konsumit të ujit dhe përmirësimi i kanalizimeve urbane dhe rreziqeve nga përmbytja;
- **Mbeturinat e ngurta:** zbatimi i një qasje të re menaxhuese për trajtimin e mbetjeve të ngurta, me theks më të madh tek riciklimi;
- **Mjedisi:** përmirësimi i ndikimeve në mjedis, veçanërisht në lidhje me cilësinë e ajrit të qytetit; dhe
- **Adaptimi klimatik:** përmirësimi i nivelit të të kuptuarit të dobësive të tij dhe adaptimi ndaj rreziqeve klimatike.

Është pranuar se disa veprime të identifikuar për përfshirje brenda PVQGJ do të ndihmojnë në arritjen e përmirësimit të barazisë gjinore dhe bashkë-përfitimet nga përfshirja.

3.3.1 Mobiliteti/Lëvizshmëria urbane

Miratimi i Planit të parë të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) më 2018 shënoi një hap të madh përpara në drejtim të ndikimit mbi trendet e qarkullimit për t'u orientuar kah mënyrat më të qëndrueshme të transportit, si dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedisin e qytetit. Korniza e politikave për PMQU-së si dhe plani i propozuar i veprimit parashtrojnë një gamë të gjerë të masave të lëvizshmërisë urbane, e që mbulojnë infrastrukturën, si dhe përmirësimet e shërbimeve dhe masat e menaxhimit.


Si pjesë e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit në PVQGJ, u pa një dëshirë e qartë për të siguruar përmirësime të mëdha në rrjetin e transportit publik të qytetit, veçanërisht në kuptimin e shtrirjes dhe cilësisë së shërbimeve, të mbështetur me infrastrukturë cilësore, për të tërhequr pasagjerë të rinj. Ngarkesa ekzistuese e trafikut aktualisht po krijon ambiente me cilësi të dobët për njerëzit që duan të ecin apo të ngasin biçikleta në qendër të qytetit, ndërsa ka mungesë të shtigjeve tërheqëse të cilat do të lidhnin zonat lokale të banimit me zonat kryesore tregtare,



vendet e punës dhe shkollat në qendër të qytetit, por edhe me hapësirat e gjelbra. Vështirësia në inkurajimin e qytetarëve që të përdorin më pak transportin motorik rëndohet edhe më shumë nga mungesa e parkimit të kontrolluar në qendër të qytetit, gjë që rrit problemet mjedisore në zemër të Prishtinës. Duke reflektuar Qëllimin Strategjik të Qytetit për Lëvizshmërinë Urban, janë zgjedhur fushat vijuese të veprimit për PVQGJ.

3.3.2 Ndërtesat

Derisa Prishtina vazhdon të përparojë si qendër kryesore ekonomike nacionale, ka kërkesë në rritje për më shumë zhvillim banesor dhe komercial, gjë që nga ana tjetër gjeneron një numër brengash mjedisore. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë të fondit të ndërtesave të qytetit vazhdon të mbetet prioritet kryesor, bashkë me miratimin dhe zbatimin e standardeve të reja të ndërtimit për të rritur sigurinë dhe për të zvogëluar




ndikimet në mjedis. Duke i marrë përsipër këto aspirata, janë identifikuar një numër veprimesh të rëndësishme për të rritur performancën mjedisore të sektorit të ndërtimit:

3.3.3 Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës

Rritja ekonomike në Prishtinë ka pasur ndikim të madh në shkallën e zhvillimit që ndodh në të gjithë qytetin, ndërsa mungesa e standardeve të rrepta të mbrojtjes së mjedisit dhe kontrollit të shfrytëzimit të tokës ka kontribuar në përkeqësimin e problemeve të përhapjes urbane dhe dendësisë së ulët të popullsisë. Lidhjet midis dhe brenda lagjeve lokale janë të dobëta, sidomos lidhjet me asetet natyrore të qytetit dhe zonat e hapësirave të gjelbra.


Duke i marrë përsipër këto aspirata, janë identifikuar një numër veprimesh të rëndësishme për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të ndërtesave, duke përfshirë si vijon:



3.3.4 Energjia

Sfidat kryesore në sektorin e energjisë lidhen me efikasitetin e Sistemit të Ngrohjes Qendrore, si dhe nivelin e humbjeve të ngrohjes, të cilat shënohen aktualisht. Ka probleme po ashtu me shtrirjen e sistemit, por edhe me mungesën e njehsorëve inteligjentë në të gjithë Qytetin. Zhvillimi i sistemeve të reja të energjisë së ripërtërishe në Prishtinë, bashkë me investimet në teknologji e inovacione të reja të energjisë, do të ndihmonin në mbulimin e kërkesës së ardhme të Qytetit për energji.

Duke i marrë përsipër këto aspirata, janë identifikuar një numër veprimesh të rëndësishme për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të energjisë, duke përfshirë si vijon:



3.3.5 Industria


Operimi i proceseve industriale shpesh sjell një sërë ndikimesh negative në mjedis, duke kontribuar drejt ndryshimeve klimatike, shterimit të resurseve natyrore, ndotjes së ajrit dhe ujit. Është me rëndësi që të ketë dialog të vazhdueshëm me përfaqësuesit e industrisë, për të nxitur partneritete bashkëpunuese, si dhe për të mundësuar menaxhim të mirë të pasurive, eficiencën e energjisë, si dhe rezistencën klimatike e praktikatat inteligjente të infrastrukturës në Prishtinë, për të nxitur tranzicionin e gjelbër në këtë sektor.



3.3.6 Uji

Problemet me sistemin e ujësjellësit të qytetit dhe përqindja e lartë e humbjeve të ujit kërkojnë investime shtesë për të përmirësuar efikasitetin dhe rregullsinë e shërbimit ndaj konsumatorëve. Për më tepër, ngritja e vetëdijes dhe fushatat publike për të inkurajuar konsum më të përgjegjshëm të ujit do të jenë po ashtu të dobishme si pjesë e një qasjeje të re për menaxhimin e kërkesës së ardhme për ujë në Prishtinë. Zhvillimi i një sistemi të ri të grumbullimit të ujërave atmosferikë që do të mbulonte tërë territorin e Prishtinës përbën element të rëndësishëm të planeve të ardhshme të zhvillimit dhe furnizimit me ujë të Qytetit.

Duke i marrë parasysh këto çështje, janë identifikuar veprime për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të ujërave, duke përfshirë:



3.3.7 Mbeturinat inerte

Mungesa e kapacitetit në deponi dhe niveli i lartë i hedhjes së paligjshme të mbeturinave, kombinuar me mungesën e klasifikimit të mbeturinave në burim dhe riciklimit, kërkojnë urgjentisht një përditësim të Planit të Qytetit për Menaxhimin e Mbeturinave. Vetëdijesimi i qytetarëve, ndërmarrjeve tregtare dhe industrisë për rëndësinë e menaxhimit të përgjegjshëm të mbeturinave është gjithashtu thelbësore në adresimin e mangësive në praktikatat e menaxhimit të mbeturinave.

Duke i marrë parasysh këto çështje, janë identifikuar një numër veprimesh të rëndësishme për të përmirësuar performancën mjedisore të sektorit të mbeturinave inerte, duke përfshirë si vijon:




3.3.8 Menaxhimi i sistemit mjedisor

Sistemi aktual i monitorimit të cilësisë së ajrit në Prishtinë ka nevojë për më shumë investime në pajisje/sisteme më solide, të cilat arrijnë më mirë të identifikojnë burimet e emetimeve, si dhe të mundësojnë analiza më të thukta të të dhënave dhe menaxhim të kontrolleve të cilësisë së ajrit, kur tejkalohen normat.

Mjetet e kufizuara në Komunë dhe nevoja për menaxhim të fuqishëm e koordinim të të gjitha përmirësimeve të propozuara mjedisore kërkojnë krijimin e një ekipi të dedikuar për të mbështetur zbatimin e suksesshëm të PVQGJ-së. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve është po ashtu i rëndësishëm për të siguruar që ata që janë përgjegjës për realizimin të kenë aftësitë dhe njohuritë e duhura për zbatimin e suksesshëm.

Për të përmirësuar menaxhimin e përgjithshëm mjedisor në Prishtinë, parashikohen veprimet e mëposhtme:




3.3.9 Ndryshimet klimatike

Çështjet e rezistencës klimatike duhet të adresohen në të gjitha fushat e planifikimit urban në Prishtinë. Kjo do të mundësonte që vetë infrastruktura e qytetit por edhe praktikatat e menaxhimit të qytetit të jenë më rezistente ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në të ardhmen, siç janë ngjarjet klimatike ekstreme dhe ndryshimet më graduale të motit.

Hartimi i një Plani Veprimi për Rreziqet Emergjente Klimatike do të ndihmojë të sigurojmë që Prishtina të jetë e gatshme të veprojë shpejt e e organizuar në raste të ndonjë emergjence klimatike. Ndërsa ndryshimet klimatike kanë gjasë të provokojnë raste më ekstreme të motit, me të reshura të mëdha dhe të zgjatura që rezultojnë me vërshime lumenjsh, siguria e sistemit të mbrojtjes nga vërshimet është qenësore.

Duke kuptuar këto çështje, janë identifikuar një numër veprimesh të rëndësishme për të avancuar qasjen në ballafaqimin me çështjet e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë sa vijon:

Kapitulli 4 ofron më shumë informata për prapavijën, kontekstin dhe fokusin tek Veprimet e Qytetit të Gjelbër, me skenarët e detajuar të projekteve, duke përshkruar elementet e secilit veprim, bashkë me detajet e përgjegjësisë për realizim, afatet kohore për zbatim, vlerësimet e kostove dhe një vlerësim të përfitimeve të përgjithshme.




4 Veprimet për Qytetin e Gjelbër të Prishtinës



4.1 Lëvizshmëria urbane

4.1.1 Hyrje

Si shumë qytete të mëdha, Prishtina përballlet me nivele të konsiderueshme të ngarkesës së trafikut, ku shumë kryqëzime e nje rrugore janë aktualisht tejet të ngarkuara e përtej kapacitetit, e sidomos gjatë periudhave të pikut në qarkullim. Ngarkesa me automjete motorike nuk është e vetmja çështje trafiku në Prishtinë, sepse numra të mëdhenj të këmbësorëve paraqesin probleme për trafikun e automjeteve, për shkak të mungesës së infrastrukturës së këmbësorëve në kryqëzime dhe rrugë kryesore. Këmbësorët shpesh detyrohen të kalojnë rrugët në mënyrë të pasigurt, duke rritur rrezikun e aksidenteve. Po ashtu, ka parkime të konsiderueshme që bëhen në trotuare, duke zvogëluar atraktivitetin e ecjes dhe çiklizmit.



Ky problem mbizotërues i trafikut në Prishtinën qendrore shkakton probleme të mëtejshme për shërbimet e transportit publik urban. Mbingarkesa e trafikut shkakton kohë të gjata udhëtimi në vijat e transportit publik, gjë që nga ana tjetër ka ndikim në numrat e pasagjerëve, si dhe dobëson rregullsinë e shërbimeve në aspektin e

zbatimit të rregullt të orareve operacionale. Stacioni i autobusëve funksionon si qendër e transportit publik që ndodhet brenda qytetit, me shërbime të transportit publik që shtrihen në të gjithë zonën urbane të qytetit dhe në periferi.

4.1.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Qyteti ka zbuluar këto sfidat kyçe të Trysnisë dhe/ose Reagimeve ndaj sektorit të transportit në Prishtinë, si rezultat i angazhimit të palëve të interesit dhe analizës së treguesve PVQGJ:

Cilësia e flotës së automjeteve private në Prishtinë është e dobët, përveç që janë të vjetëruara. Udhëtimet me automjete private janë mënyra dominuese e transportit në Qytet, duke kontribuar kështu në probleme të cilësisë së ajrit, veçanërisht gjatë periudhave të pikut në qarkullim. Tatimet e importit që rritin koston e automjeteve të përdorura, por relativisht më të reja, nga Evropa Perëndimore dhe Lindore sjellin tek fakti që njerëzit zgjedhin të mos ndërrojnë automjetet e vjetra, për shkak të koston të lartë.

- **Qarkullimi në periudhë piku është në nivele të padurueshme, duke krijuar ndotje të tmerrshme të ajrit.** Për shkak të rritjes së trafikut të madh me lëvizje të ngadaltë, me shpejtësi mesatare të udhëtimit në rrugët kryesore që është 13 km/orë gjatë orës së pikut. Shpejtësia mesatare ditore e udhëtimit për shërbimet e autobusëve ndikohet gjithashtu nga mbingarkesa, derisa këto linja udhëtojnë mesatarisht 18 km/orë. Moshë mesatare e flotës së automjeteve në Prishtinë është e vjetër, që do të thotë se bllokimi në trafik kontribuon në cilësinë e dobët të ajrit të qytetit. Duke pasur parasysh numrin e madh të këmbësorëve në Qendrën e Qytetit, afërsia me këtë trafik të bllokuar do të thotë që shumë të tillë i nënshtrohen rreziqeve shëndetësore nga emetimet e automjeteve.
- **Megjithëse shumë banorë të Prishtinës ecin në qendër, ka shumë pak infrastrukturë të favorshme për këmbësorët.** Ekziston një nivel relativisht i lartë i aktivitetit këmbësorik në Prishtinë, veçanërisht nga studentët, edhe pse ka pak zona të favorshme për këmbësorët jashtë Qendrës së Qytetit. Shoqëruar me faktin se shumica e kryqëzimeve kanë mungesë të vendkalimeve të sigurta, ose kanë edhe automjete

të parkuara në mënyrë të parregullt, 'përvoja e këmbësorit' në Prishtinë nuk është atraktive, si dhe potencialisht e rrezikshme.

Parkimi i parregulluar në Qytet çrregullon të gjitha mënyrat aktive të udhëtimit. Për shkak të mungesës së vendparkimeve zyrtare për automjete në Prishtinë, si dhe menaxhimit minimal të parkimit, banorët kryesisht parkojnë kudo që të mundën, shpesh në trotuare. Kjo shkakton shumë trafik rrethor në Qytet, ku shoferët humbin shumë kohë duke kërkuar vend për parkim, duke zgjatur kështu edhe kohën e qarkullimit. Kjo ka po ashtu ndikim negativ në shërbimet e transportit publik të qytetit, për sa i përket kohëzgjatjes së linjave të planifikuara. Kjo pengon edhe përvojën e atyre që dëshirojnë të ecin dhe ngasin biçikleta në qytet, sepse ka pengesa në lëvizje të cilat përballen në shtigjet kryesore të ecjes.

Mungesa e infrastrukturës dhe pajimeve të çiklizmit. Aktualisht, aktiviteti i çiklizmit shënon nivele të dobëta në Prishtinë, me vetëm 1% të udhëtimeve të bëra me biçikletë. (2019 SUMP). Vëllimet e mëdha të qarkullimit në rrugët e qytetit, bashkë me mungesën e lehtësirave dhe shtigjeve me përparësi për çiklistët, nuk ofrojnë kushte të sigurta e as atraktive për të tërhequr çiklistë të rinj.

Shumë autobusë publik nuk plotësojnë as standardet EURO-IV. Një pjesë e madhe e autobusëve nën operim publik janë të vjetër, me nivele të dobëta të emetimeve, duke kontribuar në problemet e cilësisë së ajrit, veçanërisht në qendër të qytetit. Përmirësimet gradualisht po bëhen në kuptimin e autobusëve të rinj, si dhe të avancimit të infrastrukturës së stacioneve, për të përmirësuar nivelin e shërbimit të ofruar për pasagjerët.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës dhe Stacioni kryesor Hekurudhor janë të shkëputur nga qendra. Nyjet kryesore të qarkullimit në Qytet aktualisht nuk janë të integruara siç duhet, përfshirë këtu Aeroportin Ndërkombëtar dhe Stacionin Hekurudhor, që mbeten të shkëputur nga Qendra e Qytetit. Aeroporti kryesisht shërbehet me udhëtime me automjete private dhe taksi, me shërbim autobusi publik në çdo orë, që lidh me stacionin qendror të autobusëve.

Nuk ka transport efektiv publik për masa. Rrjeti i autobusëve është mënyra e vetme e transportit publik brenda qytetit, me përjashtim të kompanive private të parregulluara të minibusëve në Qytet. Pjesa më e

madhe e këtij rrjeti të autobusëve nuk është miqësor ndaj mjedisit, e as në përputhje me standardet evropiane, për sa i përket qasshmërisë për personat me nevoja të veçanta, edhe pse në vitet e fundit, është filluar programi i ripërtërirjes së flotës.

4.1.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Në vitin 2019, Prishtina hartoi 'Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU), dokumenti i parë strategjik i Qytetit që trajtonte gamën e plotë të nevojave dhe çështjeve të lëvizshmërisë urbane të Prishtinës, duke marrë parasysh rritjen e popullatës dhe zhvillimin e ardhshëm. Plani përfshin një numër propozimesh madhore, duke përfshirë::

- **Zhvillimi i një linje të re të tranzitit të shpejtë:** Të rehabilitohet linja ekzistuese hekurudhore nga Fushë Kosova drejt Prishtinës, të zgjatet linja në veri të qytetit afër rrugëve Lidhja e Lezhës/Vëllezërit Fazliu/Illir Konushevci, ose edhe më tej në veri.



Përtërirja e Flotës së Autobusëve: Të vazhdohet fillimi i mirë i përtërirjes së autobusëve, të përtërihet e gjithë flota e Qytetit deri në standarde e tipare moderne. Kjo bazohet në programin e zëvendësimit të autobusëve,

që filloi në 2017, me futjen në funksion të automjeteve të reja në disa prej linjave kryesore të qytetit.

- **Implementimi i qendrave/pikave kryesore të këmbimit/transferit:** Të ofrohen zgjedhje më të mira udhëtimi për qytetarët udhëtarë, me qëllim koordinimin e orareve të autobusëve për të minimizuar kohën e pritjes ndërmjet tyre. Të ofrohet një ambient i sigurt, tërheqës dhe komod për pasagjerët në shfrytëzimin e shërbimeve të autobusëve dhe në transferimin e tyre drejt mënyrave të tjera të transportit, siç janë taksitë ose biçikletat, por edhe ecjet në këmbë.
- **Studimi i mundësive për krijimin e një sistemi të integruar të biletave për të gjithë zonën:** Të zbatohet një sistem inteligjent i biletave, që të lehtësohen shërbimet e shfrytëzuesve, por edhe uljen e kostove të udhëtimit për përdoruesit.
- **Infrastruktura hekurudhore ekziston afër aeroportit:** Të rindërtohet infrastruktura hekurudhore në linjën Podujevë-Prishtinë-Pejë-Fushë Kosovë; ky rindërtim ishte menduar të ishte mundësi për të krijuar një linjë transporti të qëndrueshme që i shërben aeroportit. Kjo linjë e shkurtër lidhëse mund të operojë duke zbatuar konceptin e trenit tranzit për distanca të shkurtra ndërmjet aeroportit, Fushë-Kosovës dhe Prishtinës.

Strategjia sektoriale dhe transportit multimodal 2015-2025 dhe Plani i veprimit 5-vjeçar po ashtu përcakton disa parime dhe rekomandime kryesore në lidhje me lëvizshmërinë urbane, përfshirë këtu:

- **Rritjen e cilësisë së shërbimeve të transportit multimodal:** Studime të fizibilitetit për modernizimin e terminaleve ekzistuese të pasagjerëve dhe ndërtimin e terminaleve të reja janë propozuar për transportin e pasagjerëve dhe modernizimin e terminalit multimodal për Prishtinën, përfshirë lidhjen e tij me aeroportin, Pejën, Prizrenin, Gjilanin, Ferizaj, Gjakovën dhe Mitrovicën;
- **Të lidhen stacionet hekurudhore lokale të Prishtinës me stacionin qendror të autobusëve në Prishtinë:** Të ofrohen shërbime të kombinuara multimodale në zonën e Prishtinës; të rivendosen lidhjet e besueshme dhe të mirë-koordinuara ndërmjet Prishtinës dhe Podujevës. Studime shtesë mbi mundësinë e krijimit të stacioneve të

reja dhe ndalesave në këtë linjë, në mënyrë që të mbulohen qendrat regjare, ndërtesat shkollore, spitalet etj.

Aktivitetet e tjera kryesore që janë duke vazhduar në sektorin e lëvizjes urbane janë sa vijon:

- **Themelimi i “Prishtina Parking”** si ndërmarrje e qytetit që menaxhon hapësirat publike për parkim automjeteve në qytet.
- **Zbatimi i Strategjisë së re të Biçikletave dhe rrjetit të shtigjeve:** Qyteti po ashtu po zhvillon shtigje të reja të biçikletave, si pjesë e Strategjisë së re të Biçikletave, që synon të inkurajojë përdorimin më të madh të mënyrave të pamotorizuara të udhëtimit. Një program i shtigjeve të reja çikliste dhe korsive të ndara të biçikletave është propozuar të fillojë zbatimin më 2021.

4.1.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Qëllimi i mëposhtëm strategjik është vendosur për Sektorin e Lëvizshmërisë Urbane. Arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak Afatmesëm mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 1.1 - Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit, përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU)

Në mbështetje të këtij qëllimi, është me rëndësi të merren parasysh objektivat strategjik të Planit të Mobilitetit, pasi këto mëtojnë arritjen e produkteve të qëndrueshme në kuptimin e realizimit të një numri të madh përmirësimesh mjedisore, sociale dhe ekonomike në të gjithë Prishtinën:

Të menaxhohet efektivisht rrjeti i transportit për të siguruar efikasitet të rrjetit, për të pakësuar vonesat e panevojshme dhe trafikun e rënduar;

Të menaxhohen më efektivisht sjellja në parkim, për të zvogëluar nivelin e transportit të motorizuar në Qendër të Qytetit, duke promovuar qarkullimin e qëndrueshëm, duke përfshirë transportin publik, ecjen dhe biçikletat;

Të mirëmbahet dhe të përmirësohet qasja në stabilimente e shërbime kryesore për të gjithë - përfshirë hapësirat e gjelbra të qytetit dhe pasuritë kulturore të tij;

Të inkurajohen njerëzit në Prishtinë që të ndjehen si në shtëpi - secili me përgjegjësinë që të ketë parasysh të gjitha nevojat për transport, për të gjithë.

Të reduktohen viktimat e aksidenteve rrugore, sidomos për pjesëmarrësit e cënueshëm në qarkullim, përfshirë këtu edhe përmirësimin e sigurisë dhe rendit të komunitetit;

Të përmirësohen kushtet mjedisore për komunitetet në Prishtinë, duke zbutur efektet negative të transportit mbi mjedisin e Qytetit, si dhe

Të promovohet jetesa e shëndoshë për njerëzit e Prishtinës, duke përfshirë edhe zbutjen e ndikimeve negative të ndotjes së ajrit dhe zhurmës.

Nivelet e ngarkesës në Qytet janë në rritje, që bën që shpejtësia e automjeteve, si për transportin privat ashtu edhe për transportin publik, të ulet, që në anën tjetër ndikon negativisht në cilësinë e ajrit në Prishtinë, veçanërisht në Qendrën e Qytetit. Investimet në transportin publik dhe mënyrat e transportit jo-motorik duhet të ndihmojnë në zbutjen e ngarkesave dhe trysnisë mjedisore, por edhe të rrisin atraktivitetin e Qendrës së Qytetit, për të inkurajuar më shumë aktivitete turistike dhe tregtare.

Çaqet mbështetëse

Shtimi i alternativave për udhëtim duke përmirësuar cilësinë dhe lidhshmërinë me transportin publik të qëndrueshëm dhe rrjetet aktive të udhëtimit duke çuar në nivele më të larta të kënaqshmërisë së udhëtimit nga qytetarët që përdorin këto mënyra.

Performanca e këtij qëllimi strategjik mund të matet kundrejt nivelit të kënaqshmërisë së publikut me shërbimet dhe infrastrukturën e transportit publik të qytetit, si dhe infrastrukturën për këmbësorë e biçiklistë, përmes një ankete sociale. Treguesi kryesor për këtë do të jetë zbatimi i anketave

⁷ Bazuar në një përlogaritje prej 106,050 automjete personale (75% benzinë, 25% naftë), me kilometrazhë mesatare vjetore prej 9,000 km, si dhe efikasitet prej 10 l/100 km për automjete me benzinë, si dhe 8 l/km për automjete me dizel). Emisionet e transportit publik supozohen të jenë të

të kënaqshmërisë publike nga Trafiku Urban, si dhe aftësia për të demonstruar përmirësimin e vazhdueshëm në vite, për sa i përket numrit të pasagjerëve gjatë pesë viteve të ardhshme.

Rritja e përqindjes së automjeteve me lëndë alternative (me emetimeve të ulëta) brenda flotës së automjeteve..

Përmes një kombinimi të masave të transportit të përshkruara, si dhe aktiviteteve të lidhura me shfrytëzimin e tokës (përshkruar në Kapitullin 4.3), zvogëlimet e GS-ve në Prishtinë përlogariten të jenë mbi 45,000 tCO₂eq/vit, për shkak të kalimit të llogaritur tek mënyrat e tjera të transportit, me afro 20 % të udhëtimeve nga automjetet private ose tek transporti publik ose tek mënyrat e tjera me zero emetime, si çiklizmi ose ecja.⁷

4.1.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (për t'u zbatuar në 3-5 vitet e ardhshme) në sektorin e lëvizshmërisë së qëndrueshme, për të mbështetur arritjen e synimeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4-1 që vijon, si dhe më pas përshkruhet më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4-1.- Përmbledhje e Veprimeve tek Mobiliteti/Lëvizshmëria Urbane

ID#	Veprimi	Përshkrimi
T1	Masa të avancuara për këmbësorë	<ul style="list-style-type: none"> Studimi i fizibilitetit/plani i veprimit për shtrirjen e rrjetit të transportit publik (autobusë), duke përfshirë implementimin e infrastrukturës mbështetëse, drejt zonave të reja të Qytetit, për të përmirësuar lidhshmërinë me rrjetin, por edhe për të tërhequr pasagjerë të rinj për vijat e gjithë qytetit.
T2	Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë	<ul style="list-style-type: none"> Angazhimi i vazhdueshëm, së bashku me ndërmarrjen publike në pronësi komunale Prishtina Parking, për të zhvilluar e implementuar zonën e re të parkimit të kontrolluar (punime ndërtimore) dhe

ngjashme me emisionet aktuale, edhe pse numri i automjeteve do të rritet - për shkak të efikasitetit më të madh të flotës.

		<p>vetë sistemin për qytetin. Ky veprim do të përmirësojë kontrollimin e kërkesës për trafik, si dhe do të ndihmojë në menaxhimin e parkingjeve në qendër të qytetit</p> <p>Zhvillimi i sistemit Parko-Ec ofron kapacitete parkimi në терминаlet e transportit publik, në rrugët kryesore unazore në qytet, si dhe motivon vozitësit të kalojnë tek shërbimet e shpejta, të shpeshta të transportit publik në qendër të qytetit. Ky do të sjellë prurje më të vogla trafiku në rrugët unazore dhe do të ndihmojë në uljen e nivelit të ngarkesave të trafikut në qendër.</p>
T3	Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elementë tjerë infrastrukturorë.	<ul style="list-style-type: none"> Studim Fizibiliteti (i gjithë rrjeti i vijave urbane do të përfshihet në studim), si dhe implementimi lidhur me zhvillimin e shiritave të dedikuara për autobusë si dhe infrastrukturën për autobusë apo masa tjera, për të përmirësuar kohëzgjatjen e udhëtimeve dhe rregullsinë e shërbimit të vijave të trafikut urban. Kjo përfshin edhe qasjen e autobusëve në ndalesa në qytet (p.sh. Ngritje/gurë trotuari për stacion/trotuarët Kassel etj.).
T4	Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve	<ul style="list-style-type: none"> Blerja e autobusëve të rinj, për të rritur cilësinë e flotës së automjeteve në Prishtinë, për të ofruar shërbime më cilësore për banorët e qytetit. Kjo përfshin futjen në funksion të automjeteve Euro VI dhe autobusëve elektrikë. <p>Implementimi i vijave të reja në të gjithë Qytetin, me funksionim me frekuencë më të lartë dhe realizimi i infrastrukturës së stacioneve të autobusëve dhe sistemit të ri të biletave.</p>
T5	Investime cikliste në gjithë qytetin	<ul style="list-style-type: none"> Studimi i fizibilitetit dhe zbatimi i shtigjeve të biçikletave dhe vendparkimeve në të gjithë qytetin. Zhvillimi i rrjetit të çiklizmit do të inkurajojë qarkullim më të qëndrueshëm, të zvogëlojë përdorimin e automjeteve dhe të mbështesë mënyra më të shëndetshme jetese. <p>Zhvillimi i Skemës së re Komunale të Huazimit të Biçikletave në të gjithë qytetin, për të inkurajuar përdorim më të madh të biçikletave si mënyrë e rregullt e transportit për udhëtime urbane si dhe qarkullimit rekreativ</p>

T6	Korridor i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme	<ul style="list-style-type: none"> Skema që synon të realizojë një korridor qarkor të transportit publik, për të zbutur tryshinën mbi Qendrën e Qytetit. Zhvillimi me orientim kah tranziti (TOD) do të përbëjë pjesë kryesore të integritimit më të mirë të shfrytëzimit të tokës dhe mënyrave të transportit, sidomos Transportin me Autobusë të Shpejtë (BRT), si dhe shërbimet Parko-Ec dhe Modalitetet Aktive të Udhëtimit (ecja dhe çiklizmi). Planifikimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës duhet të zbatohet në periferinë e qytetit, me zhvillim të integruar të banimit, tregtisë e objekteve afariste, që do të rriste qasjen në vijat urbane dhe rrjetet e transportit, si dhe minimizon nevojën për të udhëtuar.
-----------	---	--

T1: Masa për përmirësimin e kalimit të këmbësorëve

Qëllimi – Zhvillimi i një rrjeti të ri shtigjesh dhe lehtësira për këmbësorët në mbarë qytetin

Lloji i veprimit – Infrastrukturë / Rregullator

Përfitimet – Mbështetja e zhvendosjes modale drejt mënyrave aktive, që shoqërohet me përfitimet mjedisore dhe shëndetësore përkatëse, si dhe dizajnin gjithëpërfshirës

Kostoja – CAPEX: 3 milionë €; OPEX: Afro 300 mijë €/vit (10% e shifrës CAPEX)

2021			2022			2023			2025			2025 & Tutje	
Planifikimi			Planifikimi										

Përshkrimi

Zhvillimi i një rrjeti të ri të qytetit për lëvizjen e këmbësorëve, me hierarki të rrjetit të shtigjeve bazuar në Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban. Skema do të përfshijë modifikimin e sipërfaqeve të shtigjeve (përfshirë punimet ndërtimore dhe pajisjet e reja rrugore urbane), plus ndërtimin e sipërfaqeve/zonave prioritare për këmbësorët, të cilat ndërtohen në zonat ekzistuese të këmbësorëve të krijuara në zemër të qendrës së qytetit. Kjo skemë lidhet gjithashtu me propozimin për zhvillimin e gjelbërimit rrugor për të përmirësuar infrastrukturën rrugore në të gjithë qytetin.

Lloje të ndryshme të shtigjeve do të bazohen në standardet specifike të projektimit dhe në infrastrukturë për të siguruar konsistencë në zbatimin e skemave të reja. Ky rrjet do të përmbajë elemente cilësore, siç janë trotuarët e ulët, kalimet me prioritet, mungesat e rrëmujës në rrugë dhe shenjëzimi i mirë. Skema do të integrohet me zbatimin e rregullave të reja të trafikut dhe kufizimeve të hyrjes në qendër të qytetit, në mënyrë që të ofrojë prioritet më të lartë për pjesëmarrësit jo-motorikë të trafikut.

Përfitimet kryesore

Kjo masë do të krijojë mjedis të sigurt për këmbësorët, si dhe të motivojë njerëzit të përdorin mënyra të tjera transporti përveç automjeteve private. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimeve të shtigjeve këmbësorike për të ndihmuar lëvizjen e kufizuar. Potenciali për të mbështetur një mënyrë të sigurt dhe efikase të udhëtimit aktiv që është i pastër, pa gazra serrë, pa kosto për



përdoruesit, promovon shëndetin publik dhe nëse miratohet, dobi të konsiderueshme për reduktimin e mbingarkimit në qendër të qytetit.

Rrugët e këmbësorëve do të përfshijnë qasje të përmirësuar për përdorimin e karrigeve me rrota dhe mund të favorizojnë udhëtimet në distanca të shkurtra, siç janë ecja e fëmijëve për në shkollë, aktivitete të cilat me shumë gjasa do të ndërmerren nga gratë.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 7.1 – Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra me qasje të lehta, të ndërlidhura dhe të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje;
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë; dhe
- Qëllimi 10.1 – Vendosja e një marrëdhënie më efektive për angazhimin e palëve të interesit për të përmirësuar planifikimin dhe vendimmarrjen.

Qëllimi është që:

- Të ulen emetimet e karbonit nga qyteti. ;
- Të inkurajohet përdorimi më i madh i transportit publik dhe rrjeteve aktive të udhëtimit;
- Të inkurajohet përdorimi i Automjeteve me Emetime të Ulëta, si pjesë e një Plani Menaxhues të Cilësisë së Ajrit në Qendrën e Qytetit;
- Përmirësimi i rrugës me elementë shtesë (p.sh. shenjëzimi, ndriçimi, ulëset dhe peizazhi 'i gjelbër'; dhe
- Dizajni urban që minimizon ndikimin në mjedis dhe rrit përdorimin e pasurive natyrore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Shtimi i alternativave për udhëtim duke përmirësuar cilësinë dhe lidhshmërinë me transportin publik të qëndrueshëm dhe rrjetet aktive të udhëtimit duke çuar në nivele më të larta të kënaqshmërisë së udhëtimit nga qytetarët që përdorin këto mënyra; dhe
- Nivelet të rritura të udhëtimit të qëndrueshëm drejt gjitha destinimeve kyçe të arsimit, punësimit, rekreative, destinacionet komerciale në gjithë qytetin, matur me rritjen në përpjesëtimin modal të mënyrave të transportit publik dhe aktiv.

Konteksti aktual

Vitet e fundit kanë shënuar zhvillimin e një zone të madhe për këmbësorë në qendër të qytetit, ku Bulevardi “Nënë Tereza” që lidh rrugën “Xhorxh Bush” dhe rrugën “Agim Ramadani”. Zona ofron mjedis shumë të sigurt dhe komod, jo vetëm për këmbësorët, përfshirë banorët lokalë, fuqinë punëtore si dhe turistët (duke përfshirë edhe zhvillimin e ekonomisë 'së mbrëmjes'). Ka mundësi për të kapitalizuar nga kjo zonë e suksesshme qendrore për këmbësorë, si dhe për të zgjeruar zonën e mbulimit për të përfshirë rrugë të tjera në qendër të qytetit për

të krijuar rrjet të qasshëm rrugor që lidh me destinimet kryesore dhe stacionet e transportit publik.

Kostoja e investimit

Investimi total CAPEX – Zakonisht 300 €/metër të shtigjeve standarde këmbësore, duke përfshirë kalimet etj. Gjithsej 10km ndërtimi/rinovim i shtigjeve do të kërkojë 3 milionë €.

Gjithsej kosto OPEX – buxheti nominal prej 10% i CAPEX është lejuar – 300,000 €/vit. Shpenzimet për të mbuluar pastrimin e shtigjeve të ecjes dhe disa ridestime aty ku ka defekte.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

TM3 2021 – TM2 2022 Studimi i Fizibilitetit, pasuar nga faza implementuese TM3 2022 – TM4 2025.

Agjencitë zbatuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Prishtina Parking

Palët e interesit:

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik), Drejtorja e Parqeve, Drejtorja e Pronës, Ekipi teknik i PVQGJ-së – Sektori për Transport dhe Trafik, kompanitë e Transportit Publik që operojnë në Komunën e Prishtinës, OJQ-të.

Rreziqet kryesore në zbatim:

Rëndësia e kontributeve nga palët e interesit, duke përfshirë grupet e komunitetit lokal dhe bizneset, ndërsa skema zhvillohet dhe zbatohet. Zbatimi i rregullave të reja të trafikut do të jetë i rëndësishëm, por edhe të lehtësojë qasjen për automjetet e transportit publik, për të mbajtur qasshmërinë në zonat e dyqaneve dhe ato komerciale. Miratimi dhe zbatimi i standardeve të reja të shtigjeve për këmbësorë. Auditimet e shtigjeve për këmbësorë për të identifikuar përmirësimet. Vlerësimi i vëllimit dhe kërkesës për shtigje këmbësorësh. Mirëmbajtja e shtigjeve për këmbësorë.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Ka opsione për të zhvilluar instrumente virtuale për planifikimin e ecjes, të cilat ofrojnë qasje të lehtë në aplikacione që u mundësojnë njerëzve të planifikojnë ecjen e tyre për në punë/shkollë/destinacione rekreative, si dhe për të siguruar që mjetet ekzistuese (të tilla si google maps) të kenë qasje në ato të dhëna për ecjen. Kontrollat teknike të mbështetura me teknologji kamere për të menaxhuar qasjen e automjeteve në qendër të qytetit.

Mund të merren parasysh zgjidhje të ndryshme inteligjente për të mbështetur këtë veprim, në kuptimin e planifikimit të shtigjeve specifike të këmbësorëve, duke përdorur të dhëna nga telefonat, ose të dhëna të mbledhura nga regjistrimi i popullsisë, si dhe anketat kualitative të preferencave të këmbësorëve ('vijat e dëshirave'). Zgjidhjet inteligjente mund të shqyrtohen edhe për të rritur sigurinë dhe rehatinë e këmbësorëve, veçanërisht kur shtigjet e këmbësorëve ndërveprojnë me trafikun e rëndë të automjeteve (p.sh. Teknologji sinjalizuese dhe masat e zvogëlimit të shpejtësisë).

Sinergjia me veprimet tjera

- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.
- T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore.
- T4: Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve.
- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus tek zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive.

T2: Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë

Qëllimi – Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të reja për parkimin në qendër, për të kontrolluar kërkesën/qarkullimin në qendër të qytetit

Lloji i veprimit – Planifikim / Infrastrukturë / Rregullator

Përfitimet – Inkurajohet dhe mbështetet kalimi tek mënyra të tjera të lëvizjes, që shoqërohen me përfitimet lidhur me gazrat serrë dhe cilësinë e ajrit

Kostoja – CAPEX: studimi 250k €; 1.5 – 2 milionë € për fazën fillestare të skemës së parkimit, përfshirë pikat e mbushjes së AE-ve (PMQU - varet nga shtrirja dhe infrastruktura mbështetëse); ‘Parko & Udhëto’ rreth 2 milionë €; OPEX: mbulohet kryesisht nga të hyrat

2021		2022			2023			2025			2025 & Tutje		
		Planifikimi			Implementimi								

Përshkrimi

Duhet të punohet bazuar në Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) të Qytetit, për të hartuar politikën e re të parkimit në qendër, si dhe zbatimin e zonës së re të kontrollit të parkimit në qendër, që synon menaxhimin e kërkesës/qarkullimit në bërthamën urbane. Kjo përfshin shqyrtimin dhe azhurnimin e tarifave dhe rregulloreve të parkimit, që marrin parasysh nevojat e banorëve dhe bizneseve në zonën qendrore dhe zonat e banimit të qytetit. Duhet ofruar dhe hapësira të dedikuara të parkimit për transport mallrash (p.sh. zona e tregut të vjetër) por edhe për kërkesat e banorëve. Përfshirja e pajisjeve të mbushjes së Automjeteve Elektrike (AE) do të zhvillohet më shumë në përputhje me aspiratat e qytetit për të zhvilluar dhe promovuar AE-të në mënyrë më kuptimplotë. Masat e menaxhimit të kërkesës duhet poashtu të jene pjesë e rëndësishme e strategjisë për dekurajimin e qarkullimit të panevojshëm me automjete në qendër, si dhe për të promovuar mënyrat e transportit publik dhe aktiv. Është e rëndësishme që çdo reduktim i perceptuar i komoditetit të parkimit të shoqërohet me lehtësira më të mira të transportit publik dhe aktiv (siç promovohet në këtë dokument). Çdo rregullore e re do të kërkojë poashtu shqyrtimin e masave të duhura të ekzekutimit, për të siguruar efektivitetin e tyre.

Përfitimet kryesore

Është e ditur që zbatimi i kontrolleve dhe rregullimit të parkimit është element kryesor i strategjisë së parkimit. Propozohet që qasja aktuale e zbatimit të



rishikohet dhe ndryshohet, për të rritur resurset e dedikuara për zbatimin e masave të parkimit dhe menaxhimit të trafikut, të propozuara si pjesë e Planit. Suksesi në kontrollim e menaxhim të parkimit në të gjithë qytetin, veçanërisht në qendër të qytetit, varet shumë nga krijimi i një organi zbatues të suksesshëm. Përfitimet mjedisore rezultojnë nga këto pika:

- Zvogëlimi i parkimit afatgjatë në qendër dhe ndikime më të vogla mbi hapësirat e lira dhe mbi humbjet e biodiversitetit të shkaktuara nga ndërtimi i hapësirave të parkimit;
- Nivele më të ulëta të emetimeve të gazrave serë dhe ndotësve të ajrit nga automjetet në qendër për shkak të numrit më të vogël të automjeteve motorike gjatë periudhave të pikut.
- Sisteme parkimi të qasshme dhe të sigurta (masa (Dhuna dhe Ngacmimet mbi Bazë Gjinore (DNBG), ndriçimi, etj..).

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë;
- Qëllimi 10.1 – Vendosja e një marrëdhënie më efektive për angazhimin e palëve të interesit për të përmirësuar planifikimin dhe vendimmarrjen; dhe
- Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore.

Është e rëndësishme të krijohet një organizatë që mëton të zhvillojë dhe modernizojë pagesën e parkimit në qytet dhe e cila menaxhon dhe kontrollimin e parkimit. Operatori i tillë i parkimit mund të jetë në pronësi të komunës ose të operohet përmes një koncesionari privat.

Zona e kaltër, e shënuar me vijë të kaltër (shenja vertikale dhe horizontale) është e përcaktuar për banorët. Vetëm banorët me leje të vlefshme parkimi dhe abonuesit mund të parkojnë në zonën e kaltër. Të tjerët mund të përdorin zonën e kaltër për parkim vetëm pasi të paguajnë përmes aplikacionit virtual të parkimit, pasi nuk ka makina të biletave të parkimit të instaluar në zonën e kaltër. Operimi në zonën e kaltër mundëson parkim më së shumti për 3 orë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

Ekziston një angazhim i vazhdueshëm, së bashku me ndërmarrjen publike në pronësi komunale Prishtina Parking, për të ndërtuar zonën e re të parkimit të kontrolluar (punimet e ndërtimit) dhe vetë sistemin për qytetin. Ky veprim do të përmirësojë kontrollimin e kërkesës për qarkullim, si dhe do të ndihmojë në menaxhimin e nivelit të parkimit në qendër të qytetit. Do të ndërtohet një zonë e re parkimi dhe do të sigurohen hapësira parkimi të dedikuara për banorë, duke zvogëluar ndjeshëm pjesëmarrësit e tjerë në qarkullim që parkojnë në zonat e banuara lokale.

P&U (Parko & Udhëto) do të ofrojë kapacitete parkimi në терминаlet e transportit publik në rrugët kryesore unazore në qytet, si dhe të motivojë vozitësit të kalojnë tek shërbimet e shpejta e të shpeshta të transportit publik në qendër të qytetit. Do të sjellë prurje më të vogla qarkullimi në rrugët unazore dhe do të ndihmojë në uljen e nivelit të ngarkesave në trafik në qendër të qytetit.

Konteksti aktual

Kërkesa ditore për parkim në qendrën e qytetit është shpesh më e madhe se kapaciteti i ofruar, duke rezultuar me mbingarkesë të madhe, ndërsa parkimi i paligjshëm nuk përmbush nevojat e veçanta dhe kërkesën për parkim duke pasur parasysh llojet e ndryshme të pjesëmarrësve (banorët/udhëtarët/turistët). Komuna ka vendosur të miratojë organizimin dhe kompjuterizimin e parkimit si pjesë e projektit që fokusohet në *"Organizimin e pagesës dhe kontrollin e parkimit në qytetin e Prishtinës"*. Ky vendim është marrë në bazë të konceptit dhe zhvillimit të sistemit të pagesave dhe kontrollit të parkimit, duke përdorur masa të cilat nuk kërkojnë shkallë të lartë investimi, gjegjësisht, zbatimin e sistemit kompjuterik për pagesën dhe kontrollin e parkimit.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 250,000 € studimi, 1.5-2 milionë € investim fillestar – (përfshirë stacionet e karikimit për AE) – kostoja për njësi të mbushjes së AE-ve 1 mijë €. Të ardhurat e fituara nga faza fillestare e skemës së parkimit do të financojnë zgjerimin e zonës së parkimit të kontrolluar në të ardhmen. Zhvillimi i sistemit "Parko & Udhëto", afro 2 milionë € (përfshirë studimin dhe implementimin (madhësia dhe identifikimi i parcelave tokësore përcaktojnë koston përfundimtare).

Gjithsej kosto OPEX – ka nevojë të krijohet ekipi zbatues për parkim, për të menaxhuar dhe zbatuar skemën; Skema e Parkimit në Qendrën e Qytetit do të gjenerojë të ardhura për qytetin - që mund të mbulojë OPEX-in për skemat e tarifimit.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjërë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

TM3 2021 – TM2 2022 Studimi & Fizibiliteti, pasuar nga faza e implementimit
TM3 2022 – TM4 2025.

Agjencitë zbatuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Prishtina Parking, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Palët e interesit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori i Transportit dhe Trafikut), Drejtoria e Parqeve, Drejtoria e Pronës, Ekipi teknik PVQGJ - Sektori për Transport dhe Trafik, kompanitë e Transportit Publik që operojnë në Komunën e Prishtinës, kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Prishtinës për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës.

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Rregullimi i trafikut lidhur me linjat/kontratat e reja.
- Mbështetja nga bizneset dhe dyqanet e qytetit.
- Rezultati i kontaktit me publikun dhe reagimit të tyre ndaj vendosjes së tarifave dhe rregulloreve të parkimit.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Inovacioni teknologjik ka sjellë sisteme të reja informative e menaxhuese të parkimit brenda mjediseve urbane, duke ofruar dobi si për automjetet, ashtu edhe për transportuesit dhe operatorët e flotave. Opsionet e mundshme SMART që duhen shqyrtuar si pjesë e qasjes së ardhme, duke përfshirë monitorimin e parkingjeve, sistemet e numërimit të automjeteve në parkingje, leximin automatik të targave fiks dhe mobile (ANPR), sinjalistikën udhëzuese dhe automatet e pagesave (përfshirë lidhjen me aplikacione pagesash elektronike, si RingGo).

Opsionet SMART të menaxhimit të qarkullimit, për të kontrolluar dhe menaxhuar efektivisht qasjen në qendër të qytetit përfshijnë dhe barrierat/pengesat lëvizëse

SMART me lexim automatik të tabelave, aplikacionet mobile, sistemet me leje, sistemet e ndryshueshme të paralajmërimit të drejtuesve të mjeteve, etj.

Sinergjia me veprimet tjera

- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.
- T4: Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve.
- T5: Investime për ciklizëm në të gjithë qytetin.
- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus tek zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive.
- L2: Shqyrtimi i planeve aktuale urbane për të ndihmuar në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban.

T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore

Qëllimi – Masat e priorizimit të autobusëve kudo që është e mundur

Lloji i veprimit – Infrastrukturë / Rregullator

Përfitimet – Përmirësohet kohëzgjatja e udhëtimit dhe besueshmëria e shërbimit të autobusëve të qytetit

Kostoja – CAPEX: 100k € studimi; 0,5 - 1 milionë € infrastruktura (varësisht nga madhësia / prioriteti / elementet përbërëse të vendndaljeve); terminale autobusësh 'pika transferimi' - rreth 3 milionë €; OPEX: i pa aplikueshëm

2021		2022		2023		2024		2025 & Tutje	
		Planifikimi		Implementimi					

Përshkrimi

Bazuar në rrjetin e linjave të reja të autobusëve të propozuara për qytetin (Veprimi T4), do të ndërmerret studimi i fizibilitetit dhe zbatimit të korsive të dedikuara për autobusë si dhe lehtësirave e masave të tjera për autobusë, për të përmirësuar kohëzgjatjen e udhëtimeve dhe besueshmërinë e shërbimit të autobusëve urbanë. Kjo përfshin dhe qasjen e autobusëve në vendndaljet e tyre në qytet (p.sh. platforma të ngritura / trotuarë Kassel etj.). Parashihet vendosja e masave të prioritetit për autobusë ku është e mundur, kryesisht në rrugët kryesore që shkojnë në qendër, duke përfshirë ndarjen fizike të korsive të autobusëve në pjesë të zgjedhura të rrugëve. Në udhëkryqe, edhe minutazhi i semaforëve mund të rregullohet në favor të autobusëve, duke i dhënë atyre më shumë përparësi ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

Përveç krijimit të Stacionit të ri Qendror të Autobusëve në Prishtinë, Qyteti po ashtu po përpiqet të krijojë një numër pikash më të vogla terminale, apo siç quhen "hub", që mundësojnë transferim të lehtë e të thjeshtë midis linjave të ndryshme të autobusëve, por dhe me mënyra të tjera transporti, si biçikletat e taksitë. Një numër lokacionesh për stacione të tilla janë identifikuar tashmë në PQMU, por dhe lokacionet e mundshme për 'Parko & Udhëto' (shih Veprimin T2) që synojnë zvogëlimin e trafikut të automjeteve në drejtim të qendrës së qytetit.



Përfitimet kryesore

Përmirësimi i rrjeteve të transportit publik (përmes korsive të dedikuara, masave në kryqëzime dhe qasjes së lehtësuar në zonat qendrore) për t'i mundësuar

njerëzve të punojnë në kryeqytet, ndërsa vazhdojnë të jetojnë diku tjetër; Zhvillimi i linjave të rregullta dhe të besueshme të transportit publik dhe modernizimi i automjeteve të transportit publik; Arritja e një sistemi efikas të transportit publik, po ashtu duke rritur dendësinë urbane në të gjithë Prishtinën.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbatja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë; dhe
- Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

Një sërë propozimesh për prioritetin e autobusëve janë planifikuar brenda qendrës, me qëllim përmirësimin e rregullsisë së shërbimeve të autobusëve. Këto masa prioriteti të autobusëve ku është e mundur, do të vendosen kryesisht në linjat kryesore që shkojnë në qendër, duke përfshirë ndarjen fizike të korsive të autobusëve në pjesë të zgjedhura të rrugëve. Masat e prioritetit për transportin publik, si përparësia në dritë të gjelbër, ose konvertimi i hapësirave rrugore në korsitë të dedikuara për transport publik, mund të kontribuojnë në uljen e dallimit në kohëzgjatje të udhëtimit midis automjeteve private dhe transportit publik, si dhe ta bëjnë transportin publik më tërheqës dhe më efikas në energji, për shkak të rrjedhës më të mirë të trafikut. Shembuj të masave që janë të përshtatshme për Prishtinën janë:

- Prezantimi i korsive të dedikuara për autobusë në linjat apo seksionet kryesore unazore të rrjetit rrugor, ku ka ngarkesa;
- Rregullimi e racionalizimi/kontrolli më i mirë i parkimit (zbatimi);
- Përmirësimet në ndalesa, duke përfshirë rregullimet në vendndaljet e autobusëve (dizajni i duhur i vendndaljeve të autobusëve); dhe
- Përmirësimet në shenjëzim të trafiku, për të mundësuar kohëzgjatje më të madhe të “gjelbër” për autobusët, përmes përdorimit të sistemeve informative.

Konteksti aktual

Shpejtësia mesatare e automjeteve në trafik gjatë orëve të pikut është shumë e ngadaltë, gjë që ka efekt në transportin publik për shkak se ka pak infrastrukturë që i jep përparësi autobusëve brenda qytetit. Me ekonominë në rritje dhe rritjen

e shpejtë të numrit të automjeteve, trafiku mesatar ditor në rrugët kryesore që shpjen drejt Prishtinës është shumë i lartë. Linjat kryesore që lidhin veriun dhe jugun e vendit, si dhe rruga kryesore që lidh perëndimin e vendit, që të gjitha kalojnë nëpër qendrën e Prishtinës.

Ky problem mbizotëruet i trafikut në Prishtinën qendrore shkakton probleme të mëtejshme për shërbimet e transportit publik urban. Mbingarkesa shkakton kohëzgjatje të madhe udhëtimit në transport publik, që nga ana tjetër dobëson përdorimin e tij dhe shkakton probleme në rregullsi në aspektin e respektimit të orareve operative, edhe pse informatat për oraret janë po ashtu çështje diskutimi në qytet. Stacioni i autobusëve funksionon si qendër e transportit publik që ndodhet brenda qytetit, me shërbime të transportit publik që shtrihen në të gjithë zonën urbane të qytetit dhe në periferi.

Kostoja e investimit

Gjithsej investim CAPEX - 100.000 € studimi; 0,5 - 1 milionë € infrastruktura (varësisht nga madhësia / prioriteti / elementet përbërëse të vendndaljeve); terminale autobusësh ‘pika të transferimit’ - rreth 3 milionë € (të konfirmohet).

Kostoja totale e OPEX - të konfirmohet.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Spektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

Studimi i Fizibilitetit TM3 2021 – TM2 2022, pasuar nga faza e implementimit TM3 2022 – TM4 2025.

Agjencitë zbatuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Trafiku Urban, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Prishtina Parking

Palët e interesit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik), Drejtoria e Parqeve, Drejtoria e Pronës, Ekipi teknik i PVQGJ-sw – Sektori i Transportit dhe Trafikut, kompanitë e Transportit Publik që operojnë në Komunën e Prishtinës.

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Rregullimi i trafikut lidhur me linjat/kontratat e reja.
- Rezultati i kontaktit me publikun dhe reagimit të tyre ndaj ridefinimit të hapësirave rrugore dhe vonesave të krijuara për automjetet private.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Sistemi i ri i menaxhimit dhe monitorimit të trafikut është gjithashtu në proces, për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të transportit publik në Prishtinë, gjë që do t'i japë prioritet autobusëve në kryqëzime. Ekzistojnë plane për shtrirjen e sistemit të biletave elektronike, si dhe pajisjen e të gjitha vendndaljeve të autobusëve me ekrane që shfaqin informacione për oraret dhe linjat. Zgjidhjet SMART të krijuara për mbështetje të transportit publik do të marrin parasysh platformat e transferit/terminalët (p.sh. ofrimi i informatave për pasagjerë në kohë reale).

Sinergjia me veprimet tjera

- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.
- T4: Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve.

T4: Investime në Rrjetin e Autobusëve të Qytetit

Qëllimi – Shtrirja e shërbimit të trafikut urban drejt zonave të reja të qytetit dhe në терминаlet intermodale. Studimi i fizibilitetit, pasuar me investime.

Lloji i Veprimit – Planifikim / Infrastrukturë

Përfitimet – Përmirësimi i qasjes në shërbime, duke mbështetur kalimin në mënyra të tjera transporti dhe duke zvogëluar ndotjen (gazrat serrë dhe Cilësia e Ajrit), si dhe përfitimet sociale.

Kostoja – CAPEX: 9.3 milionë € (7.8 milionë € për autobusët; 0,5 milion € për infrastrukturën e mbushjes së VE-ve 0,5 - 1 milionë € për sistemin informativ dhe biletat e autobusit); OPEX: 0.98 milionë €


2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
			Planifikimi			Implementimi								

Përshkrimi

Studimi i fizibilitetit/plani i veprimit dhe zbatimi pasues për të zgjeruar rrjetin e transportit publik (autobusë), duke rritur flotën e automjeteve të reja dhe mbështetjen e zgjerimit të shërbimeve, për të përmirësuar cilësinë e tyre për udhëtarët në të gjithë qytetin. Aktualisht po punohet për krijimin e një rrjeti të ri të linjave të autobusëve, që maksimizon potencialin për të tërhequr pasagjerë të rinj, si dhe ka plane për përtërirjen e flotës së autobusëve me 24 automjete të reja Euro VI, si dhe gjashtë autobusë të rinj elektrikë 12 metra, së bashku me mbështetjen për infrastrukturën e mbushjes së baterive.⁸

Vendosja e sistemit të ri të integruar të biletave të transportit publik do t'u mundësojë përdoruesve të kalojnë lehtësisht nga njëri tek tjetri shërbim i operatorëve të ndryshëm të autobusëve, duke përmirësuar komoditetin dhe përvojën e udhëtimit për përdoruesit. Kjo masë do të rrisë komoditetin e përdoruesit të shërbimeve të transportit publik dhe do të tërheqë pasagjerë të rinj (duke krijuar ndërkohë më shumë të hyra). Veprimi do të përfshijë dhe sistemin e ri informativ të transportit publik (aplikacion për telefon + sistem në vendndalje). Sistemi i transportit publik do të funksionojë në mënyrë më efikase, me rregullsi më të madhe të shërbimit, duke rritur atraktivitetin krahasuar me përdorimin e automjeteve private. Duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm të elektrifikimit të punëtorët e transportit, do të ndërmerren masa sikurse rishkathësimi, për të

mbrojtur interesat e tyre dhe për të arritur një "tranzicion të drejtë" drejt lëvizshmërisë (mobilitetit) së qëndrueshme urbane.



⁸ Duhet theksuar që për shkak të faktorit të lartë të emetimeve në rrjet, automjetet elektrike në fakt do të rezultojnë me rritje të emetimeve të gazrave serrë (GS), pasi që faktori i emetimeve të dizelit për 100 km ende do të ishte më i ulët sesa emetimet që ndërliken me energjinë elektrike – ndërsa faktori i

emetimeve në rrjet zyrtarisht është i kalkuluar në 1.438 tCO₂eq/MWh, sipas Rregullores (MMPH) nr. 02/18 – Metodologjia nacionale e kalkulimit për performancën e integruar energjetike të ndërtesave

Në mbështetje të rrjetit dhe përmirësimeve të reja, qyteti do të përfitojë edhe nga ndërtimi i kapaciteteve në një numër fushash, duke përfshirë planifikimin e rrjetit, monitorimin operacional dhe kontrollin. Aktivitetet do të përfshijnë:

- Mbështetje për zbatimin e rrjetit të ri të transportit urban (përfshirë kontratat e tipit PSC (anglisht 'Public Service Contract' – shqip Kontrata për Shërbime Publike) për operatorët e sektorit privat);
- Planifikimi të trafikut të qytetit (përfshirë menaxhimin e trafikut/ITS, parkimin, lëvizshmërinë elektrike, planifikimin e qarkullimit aktiv, etj.).

Përfitimet kryesore

Vendosja dhe implementimi i linjave të reja të autobusëve në të gjithë qytetin janë një ndër qëllimet kryesore, për të siguruar një rrjet atraktiv të shërbimeve të transportit publik, të përshtatshëm, të shpejtë dhe të besueshëm. Qyteti do të mbulohet me linja të transportit publik, që i përgjigjen kërkesave të udhëtarëve, gjë që i tërheq njerëzit të përdorin këto shërbime në vend të automjeteve private. Sistemi i ri informativ i transportit publik, brenda në autobusë, në vendndaljet e autobusëve, por dhe në internet. Kjo masë do të rrisë komoditetin e përdoruesit të shërbimeve të transportit publik dhe do të tërheqë pasagjerë të rinj (duke krijuar ndërkohë më shumë të hyra). Avancimi i informimit dhe vetëdijesimit mbi linjat e shërbimeve të transportit publik ndihmon në tërheqjen e më shumë përdoruesve në sistem.

Aksioni do të shohë zhvillimin e sistemeve të transportit publik të sigurt dhe të arritshëm, masat për parandalim të Dhunës dhe Ngacimit mbi Bazë Gjinore (DNBG), ndriçimin, rampat, hapësirën për karriget me rrota, caktimin dhe drejtimin e autobusëve për të pasqyruar linjën dhe degëzimet e udhëtimeve, etj.).

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë; dhe
- Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të reduktohen emetimet e karbonit në qytet;
- Të inkurajohet shfrytëzimi më i madh i transportit publik dhe rrjeteve të qarkullimit aktiv;

- Të rritet kënaqshmëria e udhëtarëve me ofrimin e shërbimit të autobusëve; dhe
- Cilësi më e mirë e ajrit në qendër të qytetit.

Konteksti aktual

Përqindja e transportit privat në Prishtinë është më shumë se 50%, një nivel tejet i lartë sipas treguesve të PVQGJ-së. Pronësia gjithnjë në rritje e automjeteve private në Prishtinë, shoqëruar me rregullsinë dhe cilësinë e dobët të autobusëve publik, e bëjnë shfrytëzimin e transportit publik formal tejet të dobët. Për më tepër, operimi i kompanive të parregullta private të autobusëve që ofrojnë krahasimisht shërbime më të mira, konkurren drejtpërdrejtë me shërbimet zyrtare dhe ul më tej përdorimin e tyre. Për më tepër, përdorimi i mjeteve hekurudhore si shërbim publik është shumë i dobët, kryesisht për shkak të kostove dhe faktit që stacioni kryesor hekurudhor gjendet jashtë qytetit, në Fushë-Kosovë. Ka një numër të madh të njerëzve në Prishtinë që ecin, por për shkak të numrit të madh të ndotësve në ajër, kjo mund të ketë një efekt të dëmshëm në shëndetin e banorëve, në vend se të jetë e dobishme.

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX – 9.3 milionë € (7.8 milionë € për autobusët; 0,5 milionë € për infrastrukturën e mbushjes së AE-ve, 0,5 - 1 milionë € për sistemin informativ dhe biletat e autobusit).

Gjithsej Kosto OPEX – 930,000 € - që përfaqëson afërsisht 10% të investimit total.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët, potencialisht me modalitetin PPP / koncesion

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

Planifikimi TM3 2021 – TM1 2022; (Testimi i linjave dhe studimi i fizibilitetit), pasuar nga zbatimi TM2 2022 – TM2 2024 (plus investimet pasuese).

Agjencitë zbatuese: (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Trafiku Urban, operatorët privatë të autobusëve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Palët e interesit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik), Drejtoria e Parqeve, Drejtoria e Pronës, Ekipi teknik i PVQGJ-së – Sektori për Transport dhe Trafik, kompanitë e Transportit Publik që operojnë në Komunën e Prishtinës.

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Rregullimi i trafikut lidhur me linjat/kontratat e reja.
- Mundësia që operatorët e autobusëve të mbajnë dhe të zgjerojnë flotat e autobusëve për të ofruar një rrjet më të zgjeruar të autobusëve.
- Rezultati i kontaktit me publikun dhe reagimi për ndryshimin e linjave të autobusëve për t'i shërbyer zonave të reja.
- Ndikimi në trafikun e përgjithshëm nëpër qytet me prezantimin e linjave të reja të autobusëve, si dhe infrastrukturës përcjellëse.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Veçoritë kyçe inteligjente të rrjetit të ardhshëm të autobusëve në Prishtinë janë inkasimi automatik i biletave, informatat në kohë reale, platformat intermodale, sistemi i menaxhimit të asetëve, por dhe programet virtuale të linjave, bashkë me vendosjen e linjave/orareve të reja. Aspekte të tjera cilësore që përmirësojnë shërbimin për pasagjerë duhen hulumtuar, përfshirë dhe elementet si sistemi i ngrohjes dhe ftohjes, pajisjet Wi-Fi, sistemi i menaxhimit të qarkullimit, sistemi informativ audio-video për pasagjerë, sistemi i numërimit të pasagjerëve, sistemi i video-vëzhgimit, prizat USB për mbushjen e pajisjeve të ndryshme.

Sinergjia me veprimet tjera

- T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore.
- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.

T5: Investime për çiklizëm në të gjithë qytetin

Qëllimi – Krijimi i lehtësirave për të ofruar biçikletën si alternativë të dobishme kundrejt automjeteve private (sidomos për udhëtime të shkurtra), duke përfshirë Skemën e Huazimit të biçikletave

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë / Ndërtim Kapacitetesh

Përfitimet – Reduktimi i emetimeve dhe bllokimeve nga automjetet motorike, si dhe dobitë e shëndetit publik nga lëvizja aktive

Kostoja – CAPEX: 2 milionë € për implementimin e shiritave/shtigjeve për biçikleta; Skema e huazimit të biçikletave ('bike hire') - Studimi 50 - 100 mijë €, Zbatimi 0,5 - 1 milionë €; OPEX: 0,4 milionë € për skemën 'bike hire' (kryesisht nga tarifat e përdorimit)

2021	2022	2023	2025	2025 & Tutje
Planifikimi	Implementimi			

Përshkrimi

Qyteti ka nevojë për mbështetje në raport me kapacitetet për hartimin e projekteve të detajuara zbatuese për çiklizëm. Masa do të ofrojë infrastrukturë të re dhe të sigurt për përdorim nga publiku, si dhe do të motivojë njerëzit të përdorin mënyra aktive e miqësore për mjedisin, në vend të automjeteve private. Do të parashihen dhe lokacione me prioritet për parkim të biçikletave në ambiente të sigurta, duke pasur parasysh parimet si: qasshmëria, siguria, rrjeti dhe avancimi. Është i nevojshëm shqyrtimi i faktorëve fuqizues, për të identifikuar vendet e favorshme për investime, monitorim dhe alokim të fondeve. Zhvillimi i rrjetit të çiklizmit duhet të inkurajojë qarkullim më të qëndrueshëm, të zvogëlojë përdorimin e automjeteve dhe të mbështesë mënyra më të shëndetshme jetese. Ndërlidhur me PMQU-në, Komuna ka hartuar një dokument të ri si kornizë strategjike për Çiklizmin, duke përfshirë fazën 1 të shtigjeve të reja të biçikletave, që ka filluar zbatimin më 2021. Faza të mëtejshme të propozimeve për rrjet do të jepen gjatë gjithë kohëzgjatjes së Planit, së bashku me shqyrtimin e mëtejshëm të skemës së huazimit të biçikletave ('bike hire') në të gjithë qytetin.

Përfitimet kryesore

Potencial i konsiderueshëm për të mbështetur një mënyrë të sigurt dhe efikase të udhëtimit aktiv që është e pastër, pa gazra serrë, pa kosto për përdoruesit dhe promovon shëndetin publik, si dhe nëse miratohet, mund të ketë dobi të konsiderueshme në uljen e ngarkesës së trafikut në qendër. Kjo masë ndihmon



përmirësimin e modelit aktiv të qarkullimit, si dhe zvogëlimin e varësisë nga transporti motorik privat.

Shtigjet e këmbësorëve do të përfshijnë qasje më të mira për përdorimin e karrigeve me rrota dhe mund të favorizojnë udhëtimet në distanca të shkurtra, siç janë ecja e

fëmijëve për në shkollë, aktivitete të cilat me shumë gjasa do të ndërmerren nga gratë.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 7.1 – Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra me qasje të lehta, të ndërlydhura dhe të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Shtimi i alternativave për udhëtim duke përmirësuar cilësinë dhe lidhshmërinë me transportin publik të qëndrueshëm dhe rrjetet aktive të udhëtimit, duke çuar në nivele më të larta të kënaqshmërisë së udhëtimit nga qytetarët që përdorin këto mënyra; dhe
- Nivele të rritura të udhëtimit të qëndrueshëm drejt të gjitha destinimeve kyçe të arsimit, punësimit, rekreacionit, destinacionet komerciale në të gjithë qytetin, duke shënuar rritje në përqindjen e përdorimit të mënyrave të transportit publik dhe aktiv.

Konteksti aktual

Prishtina aktualisht ka afro 20 km shtigje çiklizmi (ekzistuese dhe të planifikuara) për 198.000 banorë (numri i banorëve bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2001), gjë që sipas treguesit të PVQGJ-së paraqet kategorinë e kuqe. Çiklizmi në baza të rregullta përdoret tejet pak në Prishtinë, për arsyen themelore të sigurisë. Ka mungesë të hapësirave për kalimin e këmbësorëve (nënkalime dhe mbikalime) që ofrojnë mekanizma të sigurt për kalim, si për këmbësorët ashtu dhe për çiklistët. Çështjet e sigurisë rrugore vazhdojnë të mbeten brengosëse, me cenueshmëri për çiklistët për shkak të shtigjeve të kufizuara përgjatë rrugëve dhe infrastrukturës së kufizuar për të inkurajuar njerëzit të përdorin biçikletë. Qyteti është orientuar drejt përmirësimit të infrastrukturës për këmbësorë/çiklistë, gjë që kërkohet për të tërhequr më shumë aktivitet këmbësor/çiklizëm, veçanërisht në zonën e qendrës.

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX – Implementimi i rrjetit dhe parkingjeve 2 milionë €.

Skema e huazimit të biçikletave – Studimi: 50,000 -100,000 € Investime: 0,75 milion € - 1,25 milionë - për shembull 30 stacione ankorimi me 25,000 € + 400 biçikleta me 600 € + depo me 250,000 €.

Gjithsej Kosto OPEX - 0,4 milionë € për skemën 'bike hire' - deri në 1,000 € për biçikletë/vit (kostot kryesisht kompensohen nga të hyrat nga tarifat për huazimin e biçikletës).

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët, sektori privat (Skema e huazimit të biçikletave)

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | **Përputhje e mundshme** | **Përputhje e dobët**

Implementimi

Afatet kohore:

Planifikimi TM3 - TM4 2021, pasuar nga TM1 2022 deri në TM4 2025 [10 km rrugë për biçikleta në vit].

Agjencitë zbatuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës

Palët e interesit:

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik), Drejtoria e Parqeve, Drejtoria e Pronës, Ekipi teknik i PVQGJ-së – Sektori për Transport dhe Trafik, Grupet e çiklistëve.

Reziqet kryesore në zbatim:

- Rregullimi i qarkullimit lidhur me shiritat/shtigjet e reja për biçikleta.
- Mundësia për krijimin e shtigjeve të sigurta, me ndarje nga trafiku motorik.
- Ndikimi në hapësirat dhe kapacitetet lokale të parkimit, aty ku propozohen shtigje të reja.
- Rezultati i kontaktit me publikun dhe reagimi për vendosjen e shtigjeve dhe parkingjeve të reja të biçikletave.

- Ndikimi në trafikun e përgjithshëm në të gjithë qytetin, me futjen e shiritave/shtigjeve të reja për biçikleta që potencialisht kërkon rindarjen e hapësirave rrugore në korridore kryesore dhe në kryqëzime.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Ka opsione të përdorimit të inteligjencës artificiale (AI) për planifikim e operim më të mirë të shtigjeve të reja të biçikletave në qytet, duke përdorur sensorë që mbledhin të dhënat për biçiklistët, këmbësorët, si dhe për mënyrat tjera të qarkullimit, për të kuptuar më mirë trendet e qarkullimit, si dhe për të përmirësuar kushtet për biçikletë. Kjo do të ndihmojë në vlerësimin e kërkesës për shtigje të reja për biçikleta, si dhe rritjen e numrit të njerëzve që përdorin biçikletë. Mund të ofrohen dhe aplikacione për planifikimin e itinerareve të çiklistëve. Të dhënat rreth tranzitit të çiklistëve mund të përdoren për të informuar planifikimin dhe vendimmarrjen përmes një sërë aplikacionesh të ndryshme për biçikleta.

Sinergjia me veprimet tjera

- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus tek zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive.
- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.
- T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore.

T6: Korridori i Udhëtimit të Qëndrueshëm i Unazës së Brendshme

Qëllimi – Ndërtimi i një korridori të udhëtimit të qëndrueshëm të Unazës së Brendshme, prej 26 km, për të ulur nivelin e trafikut tranzit dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit në qendër, si dhe për të ofruar transport publik orbital me cilësi të lartë që lidh zonat urbane.

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe shërbimeve të qytetit përreth Prishtinës, duke lehtësuar qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe duke ulur kostot e transportit. Cilësi më e mirë e ajrit në qendër të qytetit.

Kostoja – CAPEX: 97 milionë € (rrugë) + 130 milionë € (investime në sistemin e shpejtë tranzit për autobusë ('Bus Rapid Transit')); Zhvillimi i Orientuar drejt Tranzitit – të financohet nga sektori privat); OPEX: 5,23 milionë € për sistemin e shpejtë tranzit për autobusë ('BRT') + mirëmbajtjen e rrugëve

2021		2022		2023		2025		2025 & Përtej	
		Planifikimi		Implementimi					

Përshkrimi

Ndërtimi i një Korridori Orbital të Udhëtimit të Qëndrueshëm si pjesë e Unazës së Brendshme në Prishtinë, me gjatësi afro 26 km, që synon arritjen e objektivave kryesorë të mëposhtëm:

- Sigurimi i një korridori orbital me sistem/linja të shpejta tranzit për autobusë ('BRT') me cilësi të lartë që do të zhvillohet dhe zbatohet plotësisht duke përdorur parimet e Zhvillimit të Orientuar drejt Tranzitit (TOD);
- Përmirësimi i integritetit të qytetit në Korridoret Pan-evropiane, duke ofruar qasje dhe lidhje më të mira;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit në qendër, duke zbutur ngarkesën e trafikut; dhe
- Rritja e sigurisë dhe standardeve rrugore, duke devijuar qarkullimin e transportuesve të mallrave të rënda nga qendra e qytetit.

Një element thelbësor i skemës do të jetë sistemi/linjat e shpejta tranzit për autobusë ('Bus Rapid Transit – BRT') me cilësi të lartë që do të operojë rreth qytetit, duke lidhur zonat periferike të qytetit dhe duke siguruar një katalizator për zhvillime të integruara banimi, komerciale dhe tregtie, në nyjet kryesore të transportit. Planifikimi i integruar i tokës dhe transportit do të zvogëlojë nevojën për të udhëtuar, duke mundësuar afërsinë me zonat në zhvillim. Integrimi me



Burimi: Vegim Zhitija/CC BY-SA 2.0 (SEE News Shtator 2019)

përmirësimet e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë do të mëtojë të përmirësojë kushtet dhe sigurinë për këta përdorues të cenuar të rrugëve. Hartimi i skemës do të përpiqet të rrisë përdorimin e pasurive të gjelbra, duke u harmonizuar me

programin e planifikuar për mbjelljen e drunjëve në të gjithë qytetin. Zhvillimi i Orientuar drejt Tranzitit (TOD) përfshin planifikimin e zhvillimit multi-funksional rreth "nyjeve" të transportit, ose në këtë rast, të ndalesave kryesore të itinerarit të sistemit/linjave të shpejta tranzit për autobusë (BRT).

Ndalesat kryesore të 'BRT' mund të bëhen qendra komerciale dhe rezidenciale, duke ringjallur zonat që do të ishin thjesht hapësira kalimtare, në zona më aktive të qytetit.

Përfitimet kryesore

Projekti do të përmirësojë infrastrukturën rrugore dhe shërbimet përreth Prishtinës, duke lehtësuar qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe duke ulur kostot e transportit. Zbutja e ndotjes lokale të ajrit në Prishtinë përmes devijimit të qarkullimit drejt Unazës së Brendshme, duke çuar në përmirësime të cilësisë së ajrit në afërsi të zonës urbane të qendrës. Për më tepër, brenda projektit do të merret në konsideratë përfshirja e masave të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në dizajnin e detajuar të Korridorit.

Integrimi i korridoreve dhe infrastrukturës së përmirësuar, të kalimeve të cilësisë së lartë të këmbësorëve, çiklistëve dhe transportit publik, do të kontribuojë në uljen e nivelit të përdorimit të automjeteve private motorike duke ofruar përfitimet mjedisore dhe shëndetësore për banorët vendas.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 1.1 – Zbutja e ndikimeve negative të transportit në mjedisin e qytetit përmes zbatimit të suksesshëm të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- Qëllimi 8.2 – Sigurimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës së re të Prishtinës përballë trysnive kronike të klimës dhe ngjarjeve katastrofike; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

Projekti do të përmirësojë infrastrukturën e dedikuar për transport publik përmes sistemit/linjave cilësore të shpejta tranzit për autobusë ('Bus Rapid Transit – BRT') dhe përmes shërbimeve përreth Prishtinës, duke lehtësuar qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe duke i lidhur zonat periferike në zhvillim. Cilësia e ajrit do të përmirësohet ndjeshëm duke larguar qarkullimin tranzit, përfshirë dhe

transportuesit e mallrave të rënda që kontribuojnë në nivele të larta ndotjeje gjatë periudhave të pikut.

Konteksti aktual

Shpejtësia mesatare e automjeteve në rrjet gjatë orëve të pikut është shumë e ngadaltë, gjë që ka efekt në transportin publik për shkak se ka pak infrastrukturë që i jep përparësi autobusëve brenda qytetit. Me ekonominë në rritje dhe rritjen e shpejtë të numrit të automjeteve, trafiku mesatar ditor në rrugët kryesore që shpien drejt Prishtinës është shumë i lartë. Rrugët kryesore që lidhin veriun dhe jugun e vendit, si dhe linja kryesore që lidh perëndimin, të gjitha kalojnë përmes qendrës së Prishtinës, duke shkaktuar kështu nevojën për të larguar trafikun tranzit nga bërthama urbane për të lehtësuar mbingarkesën e trafikut dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Zhvillimi i Orientuar drejt Tranzitit do të jetë një katalizator kryesor për rritjen e dendësisë në zonat e reja të zhvillimit në periferi, për të parandaluar zgjerimin e pakontrolluar urban.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 97 milionë € + 130 milionë € për linjat e shpejta të tranzitit për autobusë ('BRT') - 5 milionë € për km për zhvillimin dhe implementimin e linjave të shpejta të tranzitit për autobusë. Kostoja e Zhvillimit të Orientuar drejt Tranzitit të mbulohet nga sektori privat.

Gjithsej Kosto OPEX – 5.23 milionë € për linjat e shpejta të tranzitit për autobusë ('BRT') OPEX⁹ + mirëmbajtja e rrugëve (nuk llogaritet).

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti komunal, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

⁹ Bazuar në 25 autobusë x 85,410 km / vit për autobus dhe 2,94 USD / km udhëtim - https://www.acea.auto/uploads/publications/20th_SAG_HR.pdf

Planifikimi (Studimi i fizibilitetit, projektimi dhe prokurimi) TM3 2021 – TM4 T2022;
Zbatimi TM1 2023 – TM4 2025.

Agjencitë zbatuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Huamarrësi është Republika e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Klienti dhe subjekti zbatues është Komuna, e cila është përgjegjëse për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor.

Palët e interesit:

Komuna, Policia e Qytetit, kompanitë transportuese dhe të logjistikës.

Rreziqet kryesore në zbatim:

Sigurimi i tokës në masë të konsiderueshme që kërkohet brenda mjedisëve urbane ka gjasa të shkaktojë edhe kërkesë për zhvendosje fizike dhe ekonomike. Ndikimet/rreziqet kryesore mjedisore dhe sociale për tu marrë parasysh janë: marrja e tokës që kërkohet për rrugë, rilokimi pasues dhe zhvendosja ekonomike që pritet në një mjedis urban, siguria rrugore, emetimet e zhurmës dhe ajrit, së bashku me ndikimet e fazës së ndërtimit në lidhje me qasjen gjatë punimeve dhe shqetësimet për biznesin dhe shërbimet, siguria në komunitet, shëndeti dhe siguria në punë, menaxhimi i mbeturinave.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Skema mund të përfitojë nga kontrolli SMART i qasjes në korsi dhe shpejtësisë, përfshirë sinjalizimin e integruar për të kontrolluar qasjen e automjetit gjatë orëve të mbingarkuara duke siguruar përparësi të qartë për automjetet e linjave të shpejta tranzit për autobusë (BRT).

Sinergjia me veprimet tjera

- T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore.
- T4: Investime në Rrjetin e Autobusëve të Qytetit.
- T5: Investimet në çiklizëm në të gjithë qytetin.
- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus tek zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive.
- EN1: Sistemi i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.

4.2 Ndërtesat

4.2.1 Hyrje

Në vitin 2018, Kosova miratoi një sërë rregullash që qeverisin efikasitetin energjetik të ndërtesave, të mbështetura nga Programi Rajonal i BERZH-it për Eficiencën e Energjisë (REEP). Këtu përfshihen standardet për cilësinë e performancës energjetike të mbështjellësit të objekteve (MMPH Nr. 04/18), si dhe përshkruhet procedura për çertifikimin e performancës energjetike të ndërtesave (MMPH Nr. 03/18). Aktet trajtojnë të gjitha llojet e konsumit të energjisë në ndërtesa dhe përcaktojnë obligimet për çertifikimin e performancës së energjisë, ku mbulohen lloje të ndryshme të ndërtesave (MMPH Nr. 02/18). Regjistri Kombëtar i Performancës së Energjisë në Ndërtesa ("RKPEN") është bazë qendrore e të dhënave lidhur me performancën energjetike të ndërtesave, e që përdoret nga institucionet përgjegjëse qeveritare, profesionistë të licencuar si dhe nga publiku i gjerë.

Sipas Rregullores MMPH Nr. 03/18, lëshimi i Çertifikatave të Performancës së Energjisë është i mundur vetëm me anë të RKPEN-së. Çertifikatat e Performancës së Energjisë përgatiten nga 'Vlerësuesit e Energjisë' të licencuar, si rezultat i procesit të vlerësimit të performancës energjetike, sipas Kodit të Praktikës së Vlerësuesve dhe Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes, të mbështetur nga programi i aprovuar për llogaritje iSBEMxk.

Rregullorja (MMPH) Nr. 01/2018 për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit përcakton rregullat e inspektimit të sistemeve të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar të instaluar në një ndërtesë. Qëllimi i saj është të identifikojë defektet, të raportojë mbi statusin e përgjithshëm të sistemit, efikasitetin dhe kapacitetin e instaluar kundrejt kritereve të ndërtimit, por dhe të rekomandojë përmirësime efektive në kosto.

Përveç këtyre, versioni aktual i PKVEE-së parasheh rritje të eficiencës së energjisë, si në objektet publike ashtu edhe në ato private. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes departamentit të saj të ndërtimit, ka hartuar tashmë Udhëzimin Administrativ për Etiketimin e Objekteve ekzistuese dhe të ndërtuara rishtas bazuar në performancën e tyre të energjisë.

4.2.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Pjesa më e madhe e fondit të ndërtesave të Qytetit tashmë kanë nevojë për rikonstruim të përgjithshëm për të plotësuar standardet aktuale evropiane. Problemet kryesore (në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm) që karakterizojnë statusin aktual të fondit të ndërtesave në Prishtinë janë:

- Konsumi i lartë i energjisë në shtëpi;
- Financimi i pamjaftueshëm i shërbimeve banesore dhe komunale; dhe
- Materialet me përmbajtje azbesti, sidomos në tjegulla [1].

Njohuritë nga pjesa tjetër e Evropës tregojnë se ndërtesat e tilla mund të rinovohen dhe përmirësohen ndjeshëm në drejtim të eficiencës së energjisë përmes masave si izolimi termik, përmirësimi i rrjeteve të ngrohjes dhe ndërrimi i dritareve, për të zvogëluar humbjet e energjisë.

Sfidat vijuese kyçe sa i përket trysnisë dhe/ose reagimeve në Sektorin e Ndërtesave në Prishtinë janë identifikuar si rezultat i angazhimit të palëve të interesit dhe analizës së treguesve të PVQGJ-së:

- Ndërtesat nuk janë efikase në konsum të energjisë, gjë që rezulton me konsum të lartë të energjisë elektrike në ndërtesa (sidomos ato banesore);
- Investime të pamjaftueshme publike dhe private në eficiencë të energjisë të ndërtesave;
- Materialet me përmbajtje azbesti, sidomos në tjegulla [1];
- Mungesa e certifikimit 50001/EMAS; dhe
- Mungesa e skemës së certifikimit të gjelbër të ndërtesave.

[1] Materialet me përmbajtje azbesti mund të gjenden edhe në gypa dhe materiale tjera izoluese, megjithatë tjegullat përbëjnë burimin kryesor.

4.2.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Qyteti aktualisht menaxhon me një fond prej 112 objektsh komunale, në të cilat shumica janë objekte arsimore dhe shëndetësore. Shumica e këtyre ndërtesave janë relativisht joefikase në energji, ku teknikat e ndërtimit të

janë përqendruar zakonisht në kosto të investimit, e jo në aspektet e cilësisë apo koston së ciklit jetësor.

BERZH-i miratoi Kornizën e Qytetit të Gjelbër – Ndërtesat Publike, në Prishtinë në dhjetor të vitit 2020, i cili ka një buxhet total prej 7.8 milionë EUR dhe do të bashkëfinancohet me një investim prej 1 milion EUR nga Programi Rajonal i Efiçencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor (REEP) financuar nga Bashkimi Evropian. Kredia pritët të nënshkruhet deri në fund të vitit 2021 dhe implementimi i projektit pritët të fillojë në vitin 2022. Objektivat e projektit përfshijnë:

- Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore të ndërtesave në pronësi të Komunës së Prishtinës duke zbatuar masat e EE-së që do të çojnë në kursimin e energjisë dhe uljen e emetimeve të CO₂; dhe
- Promovimi i përfshirjes së sektorit privat në hartimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë.

4.2.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Objektivat vijuese strategjike janë vendosur për sektorin e Ndërtesave, ndërkaq arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 2.1 - Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të Qytetit

Dekarbonizimi i sektorit të ndërtimit shihet si qëllim kritik për të zvogëluar ndikimet e ndryshimeve klimatike pasi ndërtesat janë kontribuesi i vetëm më i madh i emetimeve. Efiçenca termike e ndërtesave të banimit në Prishtinë është e ulët, ndërsa efiçenca energjetike në ndërtesa është larg përmbushjes së rregulloreve evropiane.

Fondi i ndërtesave jo-banesore paraqet sektor me efiçencë të ulët termike. Kombinimi i masave të efiçencës së energjisë dhe energjisë së ngrohjes shpesh shihet në kontekstin e arritjes së dekarbonizimit të thellë, në

mënyrën më efektive sa i përket koston. Me nivele të larta të kursimeve në kërkesën e energjisë me anë të rinovimit të ndërtesave, mund të ketë kosto më efektive zbatimi i opsioneve të furnizimit të qëndrueshëm të energjisë, si energjia e ngrohjes që bazohet në energji të ripërtërishme apo nxehtësi e shkarkuar, për pjesën tjetër të kërkesës për energji. Qasja e integruar në nivel rajoni do të mundësojë dekarbonizim më efektiv në kosto, por edhe më të shpejtë, të fondit të ndërtesave.

Në lidhje me "thjeshtë kalimin", dekarbonizimi i sektorit të ndërtesave do të sigurojë mundësi punësimi në industrinë e gjelbra në rritje, të tilla si izolimi termik, përmirësimi i rrjeteve të ngrohjes dhe instalimi i njehsorëve individualë të matjes. Qyteti do të identifikojë boshllëqet e mundshme të "shkathtësive të gjelbra" dhe do t'i ndihmojë punëtorët të kenë qasje në shërbimet e trajnimit dhe punësimit.

Caqet mbështetëse

Rritja e përqindjes së projekteve ndërtimore me certifikata të gjelbra të objekteve, si përpjesëtim i të gjitha projekteve që marrin leje ndërtimi brenda viti.

Ky cak reflekton kërkesën për të rritur nivelin e çertifikimit në të gjithë Prishtinën, ku gjendja bazë duhet të nxirret gjatë vitit 2021.

Përllogaritet që kombinimi i këtyre masave në sektorin e ndërtesave do të ulë emetimet e GS-ve (gazrave serrë) me mbi 64,000 tCO₂eq/vit deri në vitin 2030.

4.2.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra për t'u zbatuar në 3-5 vitet e ardhshme në sektorin e Ndërtesave, për të mbështetur arritjen e synimeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4.2 që vijon, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4-2 - Përmbledhje e Veprimeve tek Ndërtesat

ID#	Veprimi	Përshkrimi
B1	Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë:	<ul style="list-style-type: none"> Sipas legjisllacionit ekzistues, të gjitha ndërtesat e reja duhet të ndërtohen sipas standardit përkatës të energjisë. Si pjesë e procesit të lejes së ndërtimit për ndërtesat e reja dhe ndërtesat ekzistuese, ka nevojë të bëhen riparime për të marrë lejen e autoritetit lidhur me standardet minimale të konsumit të energjisë.
B2	Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale:	<ul style="list-style-type: none"> Dobitë nga rinovimi kompleks i fondit të ndërtesave komunale mund të përlllogariten në 40% të konsumit aktual të nxehtësisë, shoqëruar me përfitime të mëtejshme në konsumin e energjisë.
B3	Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale:	<ul style="list-style-type: none"> Qyteti administron një fond me 112 ndërtesa komunale. Auditimi dhe çertifikimi i energjisë është shumë i rëndësishëm për të përlllogaritur

ID#	Veprimi	Përshkrimi
		<p>kursimet e mundshme të energjisë përmes rinovimit të mbështjellësit të ndërtesave.</p> <ul style="list-style-type: none"> Masa do të identifikojë problemet kryesore të efijencës së energjisë në ndërtesat komunale - jo vetëm në fushën e ngrohjes/ftohjes. Pjesë e auditimit të energjisë është dhe vlerësimi i përdorimit të mundshëm të burimeve të ripërtërishme të energjisë për ngrohje dhe ngrohjes qendrore në ndërtesat komunale.
B4	Instalimi i njehsorëve të energjisë për konsumatorë individualë:	<ul style="list-style-type: none"> Matja dhe faturimi i energjisë sipas konsumit individual ndihmon në realizimin e kursimeve të energjisë. Përvojat nga vendet evropiane tregojnë rënie të konsumit të energjisë së ngrohjes prej rreth 10 - 11% pas instalimit të njehsorëve individualë. Është e përshtatshme që kjo masë të kombinohet me balancimin hidraulik (rregullimi i ndryshimit të presionit) të sistemeve të ngrohjes dhe instalimin e valvulave termostatike.

B1: Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë

Qëllimi – Të gjitha ndërtesat e reja dhe të rinovuara do të përmbushin kërkesat ligjore të Performancës Minimale të Energjisë

Lloji i Veprimit – Regullator

Përfitimet – Niveli i lartë i performancës energjetike të ndërtesave

Kostoja – CAPEX: – i pa aplikueshëm, OPEX: 20,000 € /vit

2021	2022	2023	2024	2025 & Tutje
Implementimi				

Përshkrimi

Standardet Minimale të Performancës së Energjisë (SMPE) specifikojnë nivelin minimal të performancës së energjisë që pajisjet shtëpiake, ndriçimi dhe pajisjet (produktet) elektrike duhet t'i përmbushin ose t'i tejkalojnë, për t'u ofruar për shitje ose për përdorim për qëllime tregtare.

Aktet nënligjore vendore përcaktojnë standardet për cilësinë e përbërësve të paketës së ndërtimit që ndikojnë në performancën e energjisë (MMPH Nr. 04/18). Të gjitha ndërtesat e reja duhet të ndërtohen sipas standardit përkatës të energjisë. Si pjesë e procesit të lejes së ndërtimit, për çdo objekt të ri dhe/ose rinovim i objektit ekzistues, është e nevojshme të plotësohen standardet minimale të performancës së energjisë.

Regjistri Kombëtar i Performancës së Energjisë në Ndërtesa ("RKPE") që është krijuar është bazë qendrore e të dhënave lidhur me performancën energjetike të



ndërtesave, e që përdoret nga institucionet përgjegjëse qeveritare, profesionistë të licencuar si dhe nga publiku i gjerë.

Përfitimet kryesore

Dobi kryesore e kësaj mase është arritja e performancës së mjaftueshme energjetike në të gjitha ndërtesat e reja dhe të rinovuara. Është vlerësuar se masa do të zvogëlojë emetimet deri mbi 52,000 tCO₂eq / vit në 2030¹⁰.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 2.1 – Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të Qytetit; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Zvogëlimi i konsumit total të energjisë;
- Rritja e numrit të ndërtesave me efikasitet të energjisë; dhe
- Vlera totale e projekteve me çertifikatë të ndërtesës së gjelbër si pjesë e vlerës totale të projekteve që marrin leje ndërtimi në vit.

Konteksti aktual

Rregullorja MMPH Nr. 04/18 për kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave përcakton kërkesat minimale të performancës energjetike për të gjitha ndërtesat e reja dhe njësitë e ndërtesave, si dhe për rinovimin e ndërtesave ekzistuese.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes departamentit të saj të ndërtimit, ka hartuar tashmë Udhëzimin Administrativ për Etikimin e Objekteve ekzistuese dhe të ndërtuara rishtas bazuar në performancën e tyre të energjisë.

Regjistri Kombëtar i Performancës së Energjisë në Ndërtesa ofron potencialin për të furnizuar me informata platformën e të dhënave të qytetit (p.sh. të dhëna mbi

efiçencën e energjisë). Këto informata mund të ndërlidhen edhe me të dhënat nga njehsorët individualë të energjisë (Veprimi B4).

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX – Masë administrative pa kosto.

Gjithsej Kosto OPEX – Masa administrative me kosto të ulët (kërkohen inspektime / kontrole të vazhdueshme). Pritet ndoshta një punëtor shtesë – 20,000 € në vit.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

Implementimi TM3 2021 deri TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna: Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave

Palët e interesit:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ndërmarrja Publike Banesore, investitorët e ndërtimit, ndërmarrjet e rehabilitimit të ndërtesave

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk ka

supozimi i një faktori emetimesh prej 0.189 tCO₂eq / MWh - faktori i emetimeve i llogaritur nga konsulentët për ngrohjen qendrore duke supozuar të kogjeneruar nga impiantet me bazë qymyri.

¹⁰ Bazuar në supozimet e niveleve të ndërtesave të reja nga 2000 - 2011 në Kosovë, prej 15,750,579 m², për një periudhë 12 vjeçare (bazuar në GIZ (2019) "Tipologjia dhe Performanca e Energjisë e Ndërtesave të Banuara në Republikën e Kosovës") - duke supozuar 30% në Prishtinë - dhe shumëzuar me 8 vjet implementim - zvogëlimi i konsumit për m² nga 218.9 kWh / m² me 40% dhe

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Nuk ka mundësi të parashikueshme

Sinergjia me veprimet tjera

- B3: Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale.
- B4: Instalimi i njehsorëve të energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorë individualë.

B2: Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale

Qëllimi – Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore të ndërtesave publike, në pronësi të komunës së Prishtinës, përmes rehabilitimit termik të mbështjellësit termik të ndërtesave, duke përfshirë ndërrimin e dritareve. Rinovimi i 10% të ndërtesave në pronësi komunale në baza vjetore.

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Ulja e konsumit të energjisë deri në 40% të konsumit aktual të ngrohjes në ndërtesat komunale deri në vitin 2030

Kostoja – CAPEX: 50 – 75 € për metër katror të sipërfaqes së ngrohur; OPEX: Nuk priten kosto operacionale

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
Planifikimi			Implementimi											

Përshkrimi

Qyteti i Prishtinës administron një fond prej 112 objektsh komunale të cilat janë ndërtuar kryesisht në periudhën e ish-Jugosllavisë, e si të tilla janë shumë joefikase në energji. Njohuritë nga pjesa tjetër e Evropës tregojnë se ndërtesat e tilla mund të rinovohen dhe përmirësohen ndjeshëm në aspektin e efikasitetit të energjisë përmes masave si izolimi termik, përmirësimi i rrjeteve të ngrohjes dhe ndërrimi i dritareve për të zvogëluar humbjet e energjisë.

Rehabilitimi i mbështjellësit termik të ndërtesave përmes izolimit termik të mureve të jashtme dhe çatisë, por edhe ndërrimi i dritareve, mund të sjellë kursime të konsiderueshme të energjisë (deri në 40% të konsumit aktual) të shoqëruar me uljen e ndotësve të ajrit.

Përfitimet kryesore

Përfitimet nga rinovimi kompleks i fondit të ndërtesave komunale mund të vlerësohen në 40% të konsumit aktual të nxehtësisë, shoqëruar me përfitime të mëtejshme në konsumin e energjisë. Kjo është masë që mund të ofrojë kontribut të madh në dekarbonizimin e sektorit të ndërtimit të Qytetit. Është vlerësuar se kjo masë nëse kombinohet me B3 do të zvogëlojë emetimet deri mbi 2,600 tCO₂eq / vit në 2030¹¹



Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 2.1 – Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të Qytetit; dhe

¹¹ Bazuar në supozimet e 195,000 m² sipërfaqe të përmirësuar - duke zvogëluar konsumin për m² 176 kWh / m² me 40% dhe duke supozuar një faktor të emetimeve prej 0.189 tCO₂eq / MWh - (faktor i

emetimeve i llogaritur nga konsulentët për ngrohjen qendrore duke supozuar të kogjeneruar nga impiantet me bazë qymyri)

- Qëllimi 9.2 - Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Synimet kryesore janë trajtimi i të gjitha ndërtesave komunale me këtë masë, si dhe ulja e kërkesës së energjisë në to deri në 40% deri më 2030;
- Të ulen nivelin e konsumit të ngrohjes;
- Të ulen nivelet e ndotjes së ajrit (përqendrimi mesatar vjetor i PM2.5); dhe
- Të rritet numri i ndërmarrjeve të qytetit me çertifikatë ISO50001/EMAS ose të ngjashme.

Konteksti aktual

Fondi i ndërtesave komunale është ndërtuar kryesisht disa dekada më parë, kur nuk kishte standarde të efikasitetit të energjisë, ndërsa shumë prej ndërtesave janë ndërtuar me materiale me veti izoluese termike shumë të dobëta.

Problemet kryesore (në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm) që karakterizojnë statusin aktual të fondit të ndërtesave në Prishtinë janë:

- Konsumi i lartë i energjisë në ambientet e banimit;
- Financimi i pamjaftueshëm i shërbimeve banesore dhe komunale; dhe
- Materialet me përmbajtje azbesti, sidomos në tjegulla.

Afro 67% e familjeve në Kosovë nuk kanë kullm të izoluar, 52% janë pa dritare me xham të dyfishtë dhe 69% pa mure të izoluar.

Komuna së fundmi ka siguruar një hua deri në 5 milionë EUR nga BERZH për të bashkëfinancuar masat e efikasitetit të energjisë në 47 ndërtesa në pronësi komunale duke përfshirë kopshtet, shkollat dhe qendrat e kujdesit shëndetësor primar. Përmirësimet do të çojnë në kursime të energjisë dhe një reduktim të emetimeve të CO₂ si dhe do të promovojnë përfshirjen e sektorit privat në hartimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë. Këto masa pritet të gjenerojnë rreth 60% kursime vjetore të energjisë dhe 83% emetime të shmangura vjetore të CO₂, ekuivalente me 7,000 tonë në vit.

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX - CAPEX të vlerësuara varen nga sipërfaqja e ngrohjes, me supozimin prej 50-75 € për metër katror

Gjithsej kosto OPEX - Nuk priten kosto operacionale

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti Komunal. Masa do të realizohet gradualisht, me anë të skemës së mbështetjes nga AKEE/FKEE, si dhe do të ishte me interes dhe për skemat

mbështetëse të BERZH-it, BB-së dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë. Kjo lloj mase është e mirëpritur për financim nga IFN-të dhe/ose AKEE/FKEE-ja. Mund të realizohet gjithashtu përmes një modeli PPP / Modeli i Kontratës së Performancës së Energjisë.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM2 2022; Zbatimi TM3 2022 – TM4 2025 (dhe më tej deri në 2030); 10 - 15 ndërtesa në vit në varësi të madhësisë.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës (Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave)

Palët e interesit:

Ndërmarrja publike e ngrohjes Termokos Sh.A., operatorët e njohur të rinovimit të ndërtesave

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Fitimprurja financiare e investimit - periudhë më e gjatë e kthimit të investimit.
- Kufizimi i buxhetit të qytetit dhe skemave të mbështetjes.
- Mund të ketë nevojë për kapacitete shtesë të kompanive të njohura të ndërtimit.

Potenciali i Qytetit Inteligent – Potenciali për përfitim

Rinovimi i ndërtesave publike ofron mundësi të mirë për instalimin e njehsorëve inteligjentë, si dhe Sistemit të Menaxhimit të Energjisë së Ndërtesave.

Sinergjia me veprimet tjera

- B1: Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale.
- B6: Instalimi i njehsorëve të energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorë individualë.
- Mbështet synimet e cilësisë së ajrit të qytetit përmes rritjes së konsumit të ngrohjes dhe uljes së emetimeve.

B3: Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale

Qëllimi – Të sigurohet kryerja e auditimit energjetik, apo çertifikatës për të gjitha ndërtesat e menaxhuara nga komuna

Lloji i Veprimit – Planifikim / Rregullator

Përfitimet – Bazë fillestare për rindërtimin gradual termik të ndërtesave komunale

Kostoja – CAPEX: 0,6 milion €; OPEX: i pa aplikueshëm

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
		Planifikimi	Implementimi											


Përshkrimi

Aktet nënligjore vendore përcaktojnë standardet për cilësinë e përbërësve të veshjes termike të objekteve që ndikojnë në performancën e energjisë (MMPH Nr. 04/18), si dhe përshkruajnë procedurën për **çertifikimin e performancës energjetike të ndërtesës** (MMPH Nr. 03/18), që merr parasysh të gjitha llojet e konsumit të energjisë në ndërtesa dhe vendos detyrimin për çertifikimin e performancës energjetike për disa lloje ndërtimesh (MMPH Nr. 02/18). Legjislacioni vendor (bazë dhe sekondar) për performancën energjetike në ndërtesa parasheh si vijon:

- Detyrimi për çertifikimin e performancës energjetike të ndërtesave;
- Kriteret minimale për performancën energjetike të ndërtesave;
- Procedurat e çertifikimit energjetik të ndërtesave; dhe
- Themelimi i Regjistrit Kombëtar të Kosovës për Performancën Energjetike në Ndërtesa.

Sipas Rregullores MMPH Nr. 03/18 për procedurat e çertifikimit të performancës energjetike të ndërtesave, lëshimi i Çertifikatave të Performancës së Energjisë është i mundur vetëm me anë të Regjistrit Komëtar të Performancës së Energjisë (RKPEN).

Çertifikatat e Performancës së Energjisë përgatiten nga 'Vlerësuesit e Energjisë' të liçencuar, si rezultat i procesit të vlerësimit të performancës energjetike, sipas Kodit të Praktikës së Vlerësuesve dhe Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes, të mbështetur nga programi i aprovuar për llogaritje iSBEMxk.



Përfitimet kryesore

Masa do të shfaqë problemet kryesore të efikasitetit të energjisë në ndërtesat komunale - jo vetëm në fushën e ngrohjes/ftohjes. Pjesë e auditimit të energjisë është dhe vlerësimi i përdorimit të mundshëm të burimeve të ripërtëritshme të energjisë për ngrohje dhe ngrohje qendrore në ndërtesat komunale.

Masa do të krijojë gjendjen bazë për përcaktimin e statusit aktual të performancës energjetike, si dhe të ndihmojë në krijimin e planeve për dekarbonizimin e sektorit të ndërtimit të Qytetit. Bazuar në rezultatet e nxjerra nga kryerja e auditimeve të energjisë dhe lëshimi i çertifikatave, do të jetë e mundur të krijohet një program i përmirësimit gradual të performancës energjetike për të gjithë fondin e ndërtesave të qytetit.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 2.1 – Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të Qytetit; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Rritja e numrit të ndërtesave me efikasitet të energjisë; dhe
- Rritja e numrit të ndërmarrjeve të qytetit me çertifikatë ISO50001/EMAS ose të ngjashme.

Konteksti aktual

Qyteti menaxhon një fond prej 112 objektesh komunale, ku shumica janë objekte arsimore dhe objekte të kujdesit shëndetësor. Shumica e këtyre ndërtesave janë ndërtuar në gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, e si të tilla prirjen të jenë relativisht joefikase në aspektin e energjisë. Fondi i ndërtesave komunale është ndërtuar kryesisht disa dekada më parë, kur nuk kishte standarde të efikasitetit të energjisë, ndërsa shumë prej ndërtesave janë ndërtuar me materiale me veti izoluese termike shumë të dobëta. Aktualisht ka nivel të ulët të efikasitetit të energjisë, gjë që përbën sfidë ndaj arritjes së zvogëlimeve të konsiderueshme të konsumit të energjisë përmes rinovimit termik të mbështjellësit të ndërtesave. Sidoqoftë, është e rëndësishme të ketë dëshmi të dokumentuara të standardeve dhe statusit të energjisë.

Projekti i zbatuar i efikasitetit të energjisë që shënjestron ndërtesat publike parashikon zbatimin e masave për Efikasitet të Energjisë (EE) në deri 47 ndërtesa publike në pronësi të Komunës, si kopshtet, shkollat dhe qendrat shëndetësore. Këto

masa EE përfshijnë instalimin e pompave me shpejtësi të ndryshueshme në sistemin e ngrohjes dhe ndërrimin e burimit të ngrohjes, izolimin termik të fasadës, izolimin termik të kulmeve dhe instalimin e dritareve dhe dyerve të reja të bëra nga profile PVC me pesë dhomëza, të përforcuara me profile dhe sisteme mbylljeje nga çeliku inox, me investim total deri në 7.8 milionë Euro.

Projekti parashihet angazhimin e një Konsulenti Mbështetës të Zbatimit të Projektit për të ndihmuar Klientin në të gjitha aspektet e zbatimit, përfshirë ofrimin e ndihmës në lidhje me auditimet e energjisë dhe përgatitjen dhe kompletimin e çertifikatave EE për të gjitha ndërtesat e rinovuara. Auditimi dhe çertifikimi i energjisë për ndërtesat e tjera komunale (nuk përfshihen në projektin aktual) është fokusi i kësaj mase të PVQGJ-së.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 560,000 € (112 ndërtesa x afro 5.000 €).

Gjithsej Kosto OPEX – nuk ka.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti Komunal. Masa mund të zbatohet me financim gradual nga buxheti i Qytetit, si dhe nga skemat e mbështetjes ndërkombëtare. Kjo masë mund të jetë e mirëpritur për donatorët. FKEE po ashtu kërkon të investojë në masa të tilla.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Korniza kohore:

Planifikimi TM3 – TM4 2021; Zbatimi TM1 2022 – TM 2025 (dhe më tutje).

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës

Palët e interesit:

Auditorët e autorizuar të energjisë

Rreziqet kryesore në zbatim:

Një rrezik i vogël mund të jetë mungesa e auditorëve të autorizuar të energjisë. Megjithatë Agjensioni Kosovar për Eficiencë të Energjisë është duke trajnuar dhe çertifikuar auditorë të licensuar të energjisë.

Masa mund të zbatohet shumë shpejt, por mund të kërkojë mjete financiare shtesë dhe numër të mjaftueshëm të auditorëve të kualifikuar të energjisë.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Nuk ka mundësi të parashikueshme. Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes mbështetet nga programi i aprovuar i llogaritjes iSBEMxk.

Sinergjia me veprimet tjera

- B2: Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale.
- Mbështet synimet e cilësisë së ajrit të qytetit përmes rritjes së konsumit të ngrohjes dhe uljes së emetimeve

B4: Instalimi i njehsorëve të energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorë individualë

Qëllimi – Instalimi i njehsorëve të energjisë termike dhe faturimi sipas konsumit real të energjisë për afro 25,000 ekonomi familjare individuale

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Njehsorët individualë të konsumit të energjisë termike do të kenë ndikim (zvogëlim) të dukshëm dhe të matshëm në nivelin e energjisë së konsumuar

Kostoja – CAPEX: 17.5 milionë €; OPEX: E papërfillshme

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
Planifikimi			Implementimi											


Përshkrimi

Ngrohja qendrore me matje individuale kombinon shumë nga përfitimet e ngrohjes qendrore duke përfshirë efikasitetin më të madh me fleksibilitetin e ngrohjes individuale - përmes instalimit të njehsorëve individualë që regjistrojnë konsumin nga secili banor, ku faturat llogariten bazuar në atë konsum. Pagesa fikse mujore bëhet për mirëmbajtjen e sistemit të ngrohjes qendrore, ndërsa kostot e mbetura mbeten në nivel të ndryshueshëm sipas konsumit. Instalimi i shpërndarësve rrit motivimin për të rregulluar temperaturat në brendësi të banesave, duke zvogëluar kështu konsumin e energjisë.

Matja dhe faturimi individual për ngrohje është një nga zgjidhjet më efektive për të ndikuar në sjelljen e konsumatorit. Instalimi i njehsorëve individualë të ngrohjes nuk është në vetvete përmirësim i efikasitetit të energjisë, por është masë që promovon kursimin e energjisë për shkak të mënyrës së menaxhimit të sistemit të ngrohjes, duke mundësuar përdorim më efikas të sistemit.

Përfitimet kryesore

Matja dhe faturimi i energjisë sipas konsumit individual ndihmon në arritjen e kursimit të energjisë. Përvojat nga vendet evropiane tregojnë rënie 10-11% të konsumit të



energjisë së ngrohjes pas instalimit të njehsorëve individualë. Është vlerësuar se kjo masë do të zvogëlojë emetimet deri mbi 9,200 tCO₂eq / vit në 2030¹².

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 2.1 - Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të Qytetit;
- Qëllimi 9.2 - Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë; dhe
- Qëllimi 11.1 - Zbatimi i teknologjive inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike që shoqërohet me zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë;
- Rritja e kursimeve të energjisë termike; dhe
- Rregullimi më i madh i matjes dhe faturimit për përdorimin individual të energjisë.

Konteksti aktual

Sistemi i ngrohjes qendrore në Prishtinë furnizon afro 25 mijë familje, ndërtesa publike dhe objekte tregtare. Konsumi i energjisë llogaritet dhe buxhetohet sipas sipërfaqes me ngrohje, pa marrë parasysh konsumin real nga konsumatorët individualë. Njehsorët dhe faturimi individual i konsumit të ngrohjes sipas niveleve aktuale të konsumit ushtron presion mbi të gjithë konsumatorët për të kursyer energjinë dhe faturat e ngrohjes. Masa do të shfaqë problemet kryesore të efikasitetit të energjisë në ndërtesat komunale - jo vetëm në fushën e ngrohjes/ftohjes. Është e përshtatshme të kombinohet me balancimin hidraulik (rregullimi i diferencës së presionit) të sistemeve të ngrohjes dhe instalimin e valvulave termostatike. Njehsorët individualë të konsumit të energjisë do të kenë ndikim të dukshëm dhe të matshëm në nivelin e përgjithshëm të energjisë së konsumuar.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 17.5 milionë €.

Llogaritja e CAPEX – 25,000 konsumatorë x 700 €.

Gjithsej kosto OPEX - kostot operacionale të papërfillshme.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Ky veprim ka nevojë për një kombinim të burimeve financiare - buxhetin e qytetit për ndërtesat komunale dhe financimin privat për ndërtesat e banimit. Ekzistojnë mundësi për mobilizimin e granteve të BE-së dhe/ose investimeve nga IFN-të, ekonomitë familjare/ndërmarrjet e NQ-së.

Në tetor 2020 është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi midis Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovë (MFK) dhe Termokos-it për instalimin e njehsorëve termik për më shumë se 12,000 konsumatorë të ngrohjes qendrore, me vlerë 10 milion USD.

Buxheti Komunal, Termokos Sh.A., pronarët e ndërtesave.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Sektori privat - pronarë të ndërtesave	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Korniza kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025 (dhe më tutje). Shtrirja në faza sipas shumës së mjeteve në dispozicion.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Termokos Sh.A. - Ndërmarrja publike e ngrohjes qendrore në Prishtinë, Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Blerësit e ngrohjes, furnizuesit e njehsorëve të ngrohjes.

Rreziqet kryesore në zbatim:

Gatishmëria e pronarëve të ndërtesave për të investuar.

Potenciali i Qytetit Inteligent – Potenciali për përfitim

Zgjerim i mundshëm drejt menaxhimit inteligjent të ndërtesave

Sinergjia me veprimet tjera

- B1: Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë.
- B2: Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale.

¹² Bazuar në supozimet e energjisë NQ të dorëzuar aktualisht rritet me 2 herë për shkak të zgjerimit të sistemit NQ dhe më pas zvogëlimit të konsumit me 10% dhe supozimit të një faktori emetimesh prej 0.189

4.3 Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i tokës

4.3.1 Hyrje

Strategjia për zhvillimin aktual të Qytetit është vendosur me Planin Strategjik të Prishtinës 2002, i cili kurrë nuk u miratua zyrtarisht nga Kuvendi Komunal. Këto politika zhvillimi mëtonin të rrisnin ndjeshëm shtrirjen e Qytetit, duke shtrirë zonën urbane drejt lindjes dhe jugut, drejt tokave bujqësore dhe zonave joformale.

Më 2012, Qyteti hartoi Planin Zhvillimor Komunal - PZHK (2012 - 2022), plan multi-sektorial që përcaktonte qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor të Prishtinës. Në të njëjtin vit, u hartua edhe Plani Zhvillimor Urban (2012-2022), bazuar në objektivat që rrjedhin nga Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, si dhe nga PZHK-ja. PZHK dhe PZHU janë ende në fuqi, e bashkë me Planet Rregulluese Urbane, kanë qenë deri tash instrumentet kryesore të planifikimit, sipas ligjeve që ishin në fuqi në atë kohë - Ligji Nr. 2003/14 dhe Ligji Nr. 03/L-106.



Procesi i transformimit urban po vazhdon përmes dendësimit në disa zona, ndërsa zgjerimi i qytetit drejt hapësirave të lira jashtë zonës së tanishme të ndërtuar ngre shqetësimin se në të ardhmen, mund të ketë trysni të konsiderueshme që vjen nga zgjerimi i pakontrolluar urban.

Disa pjesë të bërthamës së qytetit po transformohen përmes planeve rregullatore që mbulojnë zhvillime të ndryshme banesore, duke filluar nga shtëpitë private deri te objektet shumëkatëshe, me ndërtesa banesore të larta dhe destinime të përziera. Shtëpitë familjare, që mbulojnë më pak se 40%, gjenden kryesisht në veri, veri-perëndim, veri-lindje dhe në pjesën qendrore të qytetit. Ka shtëpi private kryesisht në zonat periferike. Mbi 60% e zonës së qytetit është e mbuluar me objekte kolektive banimi, objekte afaristo-banesore në bërthamën urbane, si dhe përgjatë korridoreve kryesore në periferi. Pjesa jugore u mbulua me shtëpi private të ndërtuara pas luftës, të cilat tashmë në vitet e fundit po kthehen shpejt në ndërtesa shumëkatëshe.

Pjesa qendrore e qytetit - lagjet Arbëria 1, Kodra e Trimave, Vreshtat, Taslixhe, Velania dhe Sofalia - janë zona banimi kryesisht me shtëpi private, ndërsa zonat tjera - Ulpiana, Bregu i Diellit, Dardania, Arbëria 3, Kalabria, Prishtina e Re - janë kryesisht zona banimi kolektiv me destinime të përziera.

Shtojca A (baza e të dhënave kryesore të treguesve) ofron një përmbledhje të Treguesve të Trysnisë dhe Reagimeve të PVQGJ-së, që kanë të bëjnë me sektorin e shfrytëzimit të tokës në Prishtinë.

4.3.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Qyteti ka zbuluar sfidat kyçe vijuese që rezultojnë nga analiza e çështjeve të planifikimit urban dhe ato të shfrytëzimit të tokës, si dhe çështjeve që janë ngritur gjatë angazhimit të palëve të interesit:

Biodiversiteti

Ka mungesë të të dhënave të disponueshme për speciet dhe habitatet, por palët e interesit kanë shprehur shqetësimin se modelet aktuale të shfrytëzimit të tokës ushtrojnë trysni të konsiderueshme mbi biodiversitetin në Prishtinë. Megjithatë, është e evidente që niveli i larmisë së specieve rritet duke u larguar nga qendra e qytetit drejt periferisë, e kështu, është e rëndësishme që Komuna të kontrollojë shtrirjen e zhvillimit urban drejt Parkut Natyror të Gërmisë për aq sa është e mundur.

Korridoret e Gjelbra dhe Hapësirat e Gjelbra

Ka shqetësime që shprehen nga palët e interesit në qytet lidhur me cenimin e hapësirave të gjelbra në të gjithë qytetin, ku dhe është sugjeruar që ekziston nevoja që biodiversiteti dhe zonat e gjelbra të mbrohen dhe zhvillohen sistematikisht në Prishtinë. Ka mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, përfshirë hapësirat publike dhe të gjelbra, veçanërisht në zonat joformale dhe zonat në zhvillim e sipër. Hapësirat e gjelbra janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në territorin e qytetit, ku zonat më të mëdha të gjelbra gjenden në pjesët më të largëta veri-lindore dhe lindore të kufirit urban. Përqindja e zonave të gjelbra në Qytet, sipas të dhënave nga profili i ri komunal, është 26.3%, nëse përfshihet Parku Natyror i Gërmisë, ose 1.2% nëse përjashtohet Parku Natyror i Gërmisë.

Zhvillimi i zonave gjysëm të zhvilluara (Brownfield)

Peizazhi industrial që po ndryshon në Prishtinë, e në veçanti dhe prirja e konsiderueshme kah sektori i shërbimeve, po shpie drejt rritjes së numrit të zonave të braktitura industriale. Ka një numër hapësirash gjysmë të zhvilluara/ish-industriale që mund të rigjenerohen brenda qytetit. Strategjia e mundshme për nxitjen e destinimeve të përziera do të zbuste trysinë e ndërtimit mbi hapësirat e gjelbra, si dhe do të ndihmonte kompaktësinë e Qytetit.

4.3.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Bazuar në Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, publikuar më 2013, Prishtina obligohet të hartonte një tërësi të re të instrumenteve të planifikimit: Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës, si dhe Planet Rregulluese të Hollësishme. Kështu, Qyteti ka filluar punimet për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe përgatitjet e nevojshme për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK). Kjo paraqet një moment të rëndësishëm në kuptimin e harmonizimit të planeve të zhvillimit urban dhe harmonizimin e rregulloreve të planifikimit, për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm, rezistent e kompakt të qytetit.

Numri i sipërfaqeve të gjelbra në qytet është rritur ndjeshëm, me më shumë drunjë që janë mbjellur e më shumë hapësira të lira publike që janë ndërtuar, transformuar apo rikonstruktuar. Sidoqoftë, ka nevojë për

një shpërndarje më të baraspeshuar të hapësirave të gjelbra në të gjithë qytetin, si dhe për shtigje të qasshme e pa pengesa për këmbësorë, që do të lidhnin këto hapësira të gjelbra dhe të krijonin sistem gjithëpërfshirës dhe të balancuar të hapësirave që lidhin lagjet së bashku.

4.3.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Objektivat vijuese strategjike janë vendosur për sektorin Planifikimi Urban dhe Shfrytëzimi i Tokës, ndërkaq, arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 7.1 – Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra me qasje të lehta, të ndërlidhura dhe të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje

Caqet mbështetëse

Të rritet qasja në hapësira të gjelbra ashtu që të gjithë banorët e qytetit të kenë qasje në hapësira të gjelbra cilësore (të mëdha apo të vogla) brenda 300 metrash nga shtëpia e tyre.

Derisa Prishtina ka nivele mjaft të larta të hapësirave të gjelbra brenda kufijve të komunës, pjesë të mëdha të këtyre janë toka bujqësore, që gjenden në skaj të qytetit, e që nuk janë lehtësisht të qasshme. Qasja në hapësira të gjelbra është e mirë për shëndetin fizik dhe mendor, si dhe ka qenë veçanërisht e rëndësishme gjatë Pandemisë COVID-19.

Qëllimi 7.2 – Promovimi dhe zhvillimi i konceptit të lagjes së qëndrueshme në qytet për të zvogëluar zgjerimin e pakontrolluar urban

Caqet mbështetëse

Hartimi dhe miratimi i një strategjie të re për zhvillimin e qytetit që përfshin dhe promovon zhvillimin dhe lidhshmërinë e linjave të trafikut urban dhe linjave të qarkullimit aktiv (ecje/çiklizëm) brenda zonave të lagjeve.

Rritja e dendësisë së ndërtimit dhe afërsisë me shërbimet e qytetit dhe rrjetet e transportit mund të luajnë rol të rëndësishëm jo vetëm në ballafaqimin me përhapjen urbane, por dhe në ruajtjen e hapësirave të gjelbra në të gjithë qytetin. Kjo do të zbuste edhe varësinë nga udhëtimet me automjete private, si dhe të promovonte efikasitetin dhe besueshmërinë e rrjeteve dhe shërbimeve të autobusëve në të gjithë qytetin, si dhe afërsinë e tyre, për të mbështetur qarkullimin jo-motorik.

4.3.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (për t'u zbatuar në pesë vitet e ardhshme) në sektorin e planifikimit urban dhe shfrytëzimit të tokës, për të mbështetur arritjen e caqeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4.3 që vijon dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4-3 - Përmbledhje e veprimeve në Planifikimin Urban dhe Shfrytëzimin e Tokës

ID#	Veprimi	Përshkrimi
L1	Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive:	<ul style="list-style-type: none"> Të ridefinohen hapësirat publike brenda lagjeve, duke u dhënë përparësi këmbësorëve, çiklistëve dhe gjelbërimit. Fokus më i madh në lagjen si njësi e tërësisë (Qyteti), ashtu që të sigurohet një ndërlidhje rrjetesh, sidomos atyre të këmbësorëve dhe hapësirave të gjelbra, ndërsa këto të fundit plotësohen me infrastrukturë të sporteve e rekreacionit në hapësira të jashtme, por dhe me parqe rekreative dhe mobilie/aksesorë të lojës. Integrimi i "fermave urbane" brenda lagjeve.

		<ul style="list-style-type: none"> Largimi i pengesave në lëvizje, duke përfshirë largimin e gardheve përreth objekteve, për të mundësuar lidhje më atraktive. Masa mund të zbatohet nëse punohet ngushtë me sektorin privat dhe komunitetet lokale.
L2	Të shqyrtohen planet aktuale urbane për të ndihmuar në zbutjen e zgjerimit të pakontrolluar urban:	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të re të qytetit për zhvillim, që fokusohet në qëndrueshmëri, rezistencë, planifikim racional urban dhe zhvillimin me orientim kah tranziti, ashtu që të zvogëlohet zgjerimi i pakontrolluar urban me potencial rritjeje, si dhe të sigurohet zhvillimi i nevojshëm i infrastrukturës përkatëse komunale. Planet Rregulluese ekzistuese janë aktualisht duke u rishikuar dhe do të përfshihen brenda Planit të ri Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe në Hartën Zonale të Komunës (HZK). Është qenësore të revidohen instrumentet e planifikimit për të krijuar më shumë hapësira publike brenda zonave të ndërtuara të qytetit, duke promovuar mundësi të qëndrueshme të qarkullimit, për të minimizuar qarkullimin motorik, por edhe përfshirjen e hapësirave/zonave të gjelbra.
L3	Zhvillimi i Inventarit gjithëpërfshirës të aseteve të gjelbra dhe sistemit të financimit të granteve:	<ul style="list-style-type: none"> Masë për të zgjeruar inventarin aktual digjital të drunjëve në qytet për të përfshirë të gjitha hapësirat e gjelbra, si parqet, oazat e gjelbra në rrugë, kulmet e gjelbra, muret e gjelbra, kopshtet (përfshirë ato private), etj. Kjo skemë do të përfshinte dhe ofrimin e granteve të vogla për grupet lokale komunitare të qytetit, për të ndihmuar në ofrimin e hapësirave të reja të gjelbra, aty ku është e mundur.

L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive

Qëllimi – Rigjenerimi dhe ringjallja e mjedisit të ndërtuar brenda Qytetit të Prishtinës

Lloji i Veprimit – Planifikim / Infrastrukturë

Përfitimet – Lagje më të jetueshme, me më shumë zona të gjelbra dhe aktivitete rekreative e sportive

Kostoja – CAPEX :6 milionë € (që mbulon zonat e lagjeve bazuar në 24 Këshilla Lokale në zonën urbane brenda Prishtinës); OPEX: e ulët, pjesë e mirëmbajtjes së vazhdueshme

2021		2022			2023			2024		2025 & Tutje	
		Planifikimi			Implementimi						

Përshkrimi

Lagjja merret si element i rigjenerimit urban, për të ripërcaktuar hapësirat publike të qytetit, duke u dhënë përparësi këmbësorëve, çiklistëve dhe hapësirave të gjelbra. Lagjja si 'një bllok i një tërësie' (i qytetit) do të siguronte ndërlidhjen e rrjeteve, veçanërisht për këmbësorët dhe lidhjen e hapësirave të gjelbra. Kufizimet e shpejtësisë së automjeteve do të ulëshin brenda rrugëve/lagjeve, duke mundësuar mjedis më të sigurt dhe rritje të mundshme të përdorimit të mënyrave të qëndrueshme të transportit.

Qëllimi është të krijohet një vazhdimësi e hapësirave të gjelbra që lidhin lagjet dhe që plotësohen me elemente për sporte dhe palestër në natyrë, si dhe parqe rekreative me kënde lojërash dhe mobiluarë të përshtatshëm urban. Korridoret e gjelbra nuk do të përfshijnë vetëm gjelbërimin në nivel horizontal, por edhe drunjët dhe gjelbërimin vertikal (si muret e gjelbra dhe urat e gjelbra). Këto hapësira do të identifikohen përmes procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës.

Ky veprim mundëson integrimin dhe zhvillimin më të mirë të projekteve të bujqësisë dhe kopshtarisë urbane në qytet ('urban farming') të ndërmarrura nga komuniteti, duke përfshirë mundësinë e instalimit të sistemeve aeroponike/hidroponike, apo formave tjera të ujitjes/rritjes, brenda lagjeve ku ka hapësirë të mjaftueshme. Do të ketë rëndësi inkurajimi i grupeve të komunitetit, si dhe i Këshillave Lokale, për bashkëpunim sa më të mirë në menaxhimin e zonave të gjelbra, përfshirë rregulla të reja të mirëmbajtjes dhe monitorim të përbashkët të zonave të komunitetit në lagje.



Mëtohet të largohen barrierat që vështirësojnë lëvizjen, duke përfshirë gjithashtu dhe largimin e rrethojave përreth ndërtesave, për të mundësuar lidhje më atraktive për këmbësorët.

Përfitimet kryesore

Ky veprim kontribuon në rritjen e zonave të gjelbra në të gjithë Prishtinën, duke krijuar mikroklimë më të mirë në lagje dhe duke ofruar dobi në mirëqenie përmes krijimit të zonave më të shumta të lojës dhe rekreacionit në natyrë, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën e shërbimeve publike. Për më tepër, kjo masë do të rrisë sigurinë dhe rendin në lagje, duke mundësuar krijimin e vendeve tërheqëse dhe ndërtimin e kapitalit social të lagjes.

Gjithashtu, vlera e pronave rritet në lagjet që ndërmarrin këtë veprim rigjenerimi. Do të ketë gjithashtu përfitime të fituara përmes sigurisë urbane dhe masave të DNBG-së (Dhuna dhe Ngacmimet me Bazë Gjinore), planifikimit urban të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe parimeve universale të projektimit.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 7.1 - Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra lehtësisht të qasshme e të ndërlidhura, të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje; dhe
- Qëllimi 7.2 - Promovimi dhe zhvillimi i konceptit të lagjeve të qëndrueshme në qytet, për të zvogëluar zgjerimin e pakontrolluar urban.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të përmirësohet niveli i jetesës brenda lagjeve (dmth. brenda qytetit); dhe
- Të rritet dhe dokumentohet niveli i raportit të hapësirave të lira të gjelbra kundrejt 100.000 banorëve.

Konteksti aktual

Hapësirat publike brenda qytetit, sidomos ato brenda lagjeve, nuk janë të përdorura në kapacitetin që e kanë, ju mungon inventari për aktivitete të ndryshme dhe shfrytëzohen kryesisht për parkim. Gjithashtu, shtigjet e ecjes kanë nevojë për përmirësim, ndërsa shpejtësia e automjeteve e bën të pasigurt përdorimin e biçikletave në rrugët e lagjeve.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 6 milionë €; 900,000 €/vit

Gjithsej Kosto OPEX – me gjasë e ulët, si pjesë e mirëmbatjes së vazhdueshme.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të – mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat / PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikim TM2 2021 – TM1 2022; Implementimi TM2 2022 – TM4 2025.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Komunitetet e Lagjeve, Këshillat Lokale, OJQ-të, Sektori Privat, Asociacioni i Arkitektëve, Komuniteti i Planerëve, Sociologëve, Ambientalistëve.

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Duke pasur parasysh kapacitetin aktual të Komunës, hartimi i projekteve rigjeneruese për secilën lagje mund të kontraktohet/tenderohet.
- Masa mund të zbatohet nëse zhvillohet në bashkëpunim me sektorin privat dhe komunitetet lokale.
- Sfidat lidhur me proceset e prokurimit publik dhe implementimin e kontratave midis Komunës dhe kompanive private.

Potenciali i Qytetit Inteligent – Potenciali për përfitim

Ekziston potenciali për angazhim online për të krijuar rrjetë komunikimi dhe bashkëveprimi me palët e interesit (qytetarët) përmes qendrës së të dhënave inteligjente ('City smart data hub') dhe faqes së internetit. Gjithashtu, identifikimi i zonave të gjelbra dhe atyre rekreative mund të bëhet përmes mjeteve dixhitale të tilla si binjakët dixhitalë ('digital twins') ose hartat GIS.

Sinergjia me veprimet tjera

- L3: Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të Pasurive të Gjelbra.
- T1: Masa të avancuara për Këmbësorë.
- T2: Masa Kontrolli për Parkimin në Prishtinë.
- T5: Investime për çiklizëm në të gjithë qytetin.
- CC1: Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent.

L2: Shqyrtimi i planeve aktuale urbane për të ndihmuar në uljen e zgjerimit të pakontrolluar urban

Qëllimi – Planifikim dhe zhvillim i qëndrueshëm i qytetit me fokus në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët

Lloji i Veprimit – Planifikim

Përfitimet – Plane të harmonizuara të shfrytëzimit të tokës dhe zbatim i zhvillimit urban kompakt; Performancë e përmirësuar mjedisore

Kostoja – CAPEX: 150,000 €; OPEX: E papërfillshme – pjesë e procesit të planifikimit të vazhdueshëm

2021		2022			2023			2024			Përtej	
	Planifikimi	Implementimi										

Përshkrimi

Të shtyhet përpara strategjia për zhvillim të qytetit, që fokusohet në qëndrueshmëri, adaptueshmëri ('resilience'), planifikim racional urban dhe zhvillim të orientuar drejt tranzitit, ashtu që të zvogëlohet zgjerimi i pakontrolluar urban që është në rritje e sipër, si dhe të sigurohet zhvillimi i nevojshëm i infrastrukturës përkatëse komunale. Është duke u punuar Plani i Ri Zhvillimor Komunal (PZHK), në kuadër të cilit do të shqyrtohen të gjitha planet në fuqi (Plani aktual Zhvillimor Komunal – PZHK, Plani Zhvillimor Urban – PZHU dhe Planet Rregulluese). Paralelisht kanë filluar dhe përgatitjet për punimin e Hartës Zonale Komunale (HZK). Ky veprim do të adresojë rritjen dhe zhvillimin e ardhshëm të qytetit në mënyrë më të qëndrueshme, me synim shfrytëzimin e hapësirës dhe mundësinë e qasjes në të gjitha shërbimet e qytetit.

Është qenësore që të ketë rishikim të harmonizuar dhe të plotë të dispozitave të planifikimit, që do të pasqyrohen në PZHK-në e Re dhe HZK-në, dispozita të cilat do të mundësojnë zona të ndërtuara me hapësira adekuate publike, distancë të duhur ndërmjet ndërtesave dhe respektim të kërkesave për lëvizje duke marrë parasysh trendet e udhëtimit. Është gjithashtu e rëndësishme të synohet deri në 50% të hapësirave të lira publike në lagje të reja, për të mundësuar më shumë hapësira publike të gjelbra, si dhe më shumë hapësira rekreative dhe shërbime të tjera urbane.

Masa përfshin zhvillimin dhe prezantimin e një instrumenti për të vlerësuar nivelin aktual të fondit banesor dhe kërkesës, ashtu që të menaxhohet në mënyrë efektive programi i ndërtimeve në vazhdim në të gjithë qytetin. Kjo do të përfshijë përcaktimin dhe shqyrtimin e dendësisë së popullsisë në tokë urbane, banorë/km². Qëllimi është të mundësohet një zhvillim sa më i qëndrueshëm



urban dhe zbatimi i planeve për zhvillim dhe ndërtim, për të reduktuar përhapjen e pakontrolluar urbane në të gjithë qytetin dhe për të rritur densitetin e banimit/zhvillimit, duke përmirësuar performancën mjedisore, qasjen në shërbime dhe resurse, duke ofruar rrjete të qëndrueshme të transportit. Mund të përfshihet një proces i auditimit të tokës të përdorur më herët për qëllim industrial

ose komercial ('Brownfield') ose një proces i identifikimit të "zonave të mundësive".

Përfitimet kryesore

Përmes zbatimit të këtij veprimi do të siguroheshin hapësira urbane kompakte dhe me destinim të shumëllojshëm. Ky veprim mbështet zhvillim dhe përdorim më intensiv të strukturave ekzistuese urbane, duke rritur kompaktesinë, përmes transformimit të hapësirave të braktisura ose më pak të përdorura, si dhe përmes ridestinitimit të tokës urbane. Nga ana tjetër, kjo do të kontribuojë në përmirësim të performancës mjedisore dhe zbatim të parimeve dhe praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, do të ketë ndikim në përforsim të politikave/rregulloreve dhe dispozitave të planifikimit, përmes menaxhimit të të dhënave, si dhe mbështetjes së projekteve të infrastrukturës së gjelbër. Do të ketë gjithashtu përfitim të fituara përmes sigurisë urbane dhe masave të DNBG-së (Dhuna dhe Ngacmimet me Bazë Gjinore), planifikimit urban të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe parimeve universale të projektimit.

Qëllimet e synuara Strategjike

- Qëllimi 7.1 - Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra lehtësisht të qasshme e të ndërlidhura, të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje; dhe
- Qëllimi 7.2 - Promovimi dhe zhvillimi i konceptit të lagjeve të qëndrueshme në qytet, për të zvogëluar zgjerimin e pakontrolluar urban.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të rritet implementimi dhe fuqizimi i politikave të zhvillimit dhe planifikimit;
- Të rritet ndërveprimi dhe mirëqenia sociale brenda komuniteteve në të gjithë Prishtinën; dhe
- Të bëhet harmonizimi i planeve të qytetit për menaxhim të rritjes urbane dhe zhvillimit të ardhshëm të Prishtinës.

Konteksti aktual

Prishtina ka pasur nivel të ndërtimeve pa leje duke shënuar 46,000 deri më 2018. Duke marrë parasysh që Prishtina është kryeqendër e mundësive administrative, edukative dhe kulturore, ka pasur kërkesa të konsiderueshme për shfrytëzim të tokës nga rritja e popullsisë, veçanërisht nga migrimi urban në 20+ vitet e fundit. Mëtohet që Plani i Ri i Zhvillimit Komunal dhe Harta Zonale Komunale do të sjellin kontrolle të reja për të rritur dendësinë në qytet duke respektuar parimet strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm kompakt, ku zhvillimi lidhet ngushtë me rrjetet e transportit të qëndrueshëm, si dhe iniciativat tjera që synojnë reduktimin

e ndikimeve mjedisore, të tilla si zhvillimi dhe promovimi i teknologjisë së automjeteve elektrike për të minimizuar rritjen e ndotjes së ajrit në qytet.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 150,000 € - për të mbuluar analizën dhe prezantimin e një instrumenti/mjeti për të ndihmuar në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban.

Gjithsej Kosto OPEX – E papërfillshme (pjesë e procesit të planifikimit të vazhdueshëm)

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës, Buxheti Kombëtar dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afate kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Komuna e Prishtinës, Instituti i Planifikimit Hapësinor, Asociacioni i Arkitektëve, Institucionet e Larta Arsimore, Komuniteti i Planifikuesve Urban & Arkitektëve

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Ankesa të mundshme ndaj zhvillimit/zonimit dhe planeve rregulluese nga pronarët dhe investitorët e tokave private.
- Vështirësi në integrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të planit në zonat tashmë të ndërtuara.
- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të tkurrjes së zonave të gjelbra brenda blloqeve të reja dhe ekzistuese urbane, ku ndërkohë synohet krijimi i një strategjie dhe plani zhvillimi për "qytet më kompakt".

Potenciali i Qytetit Inteligjent - Ka mundësi të përfitojë

Ka mundësi potenciale si databaza kadastrale e hapur e më e detajuar, si dhe lejet digjitale për destinim të tokës dhe ato të ndërtimit. Një shpërndarës digjital binjak ose inteligjent i të dhënave me hartë GIS mund të përdoret si platformë bazë e të dhënave për databazën kadastrale dhe për planifikimin e shfrytëzimit të tokës dhe lejeve të ndërtimit.

Sinergjia me veprimet tjera

- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive.
- L3: Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të Pasurive të Gjelbra dhe Sistemi i Financimit të Granteve.
- CC1: Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent.
- T1: Masa të avancuara për Këmbësorë.
- T2: Masa Kontrolli për Parkimin në Prishtinë.

L3: Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të Pasurive të Gjelbra dhe Sistemit të Financimit të Granteve

Qëllimi – Nxitja e zhvillimit të hapësirave të gjelbra përmes angazhimit të komunitetit

Lloji i Veprimit – Planifikim / Financë

Përfitimet – Ndikime pozitive në shëndet publik, biodiversitet dhe rezistencë klimatike

Kostoja – CAPEX: 500,000 €; OPEX: 10,000 €/vit

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
		Planifikimi												

Përshkrimi

Qëllimi është të krijohet një inventar gjithëpërfshirës digjital ku përfshihet i gjithë gjelbërimin në qytet: drunjë, parqe, gjelbërim horizontal në rrugë, kulme të gjelbra, mure të gjelbra, kopshte publike dhe private, etj. Databaza duhet të përfshijë informata të hollësishme për llojin e gjelbërimit, llojet e drunjëve dhe të gjitha llojet e kategorive të shfrytëzimit të tokës në qytet, duke identifikuar pikat kritike ('hot spots') brenda zonave me biodiversitet të zhvilluar dhe duke kontribuar në rigjenerim urban përmes zonave të reja të gjelbra.

Qëllimi është të përmirësohen hapësirat e gjelbra ekzistuese, si dhe të hulumtohet potenciali dhe nevoja për gjelbërim të mëtejshëm në zona specifike të Prishtinës.

Platforma do të zgjerohet më tej për të ofruar grante të vogla për komunitetin që shfaq interes për rritjen e nivelit të hapësirës së gjelbër, duke respektuar udhëzimet dhe dizajnet për peizazhin, të cilat do të ofrohen nga komuna. Kjo do të çojë në rritjen e përfshirjes dhe angazhimit të banorëve dhe bizneseve lokale për të përmirësuar mjedisin lokal, gjë që nga ana tjetër do të ofrojë ndikime pozitive në mirëqenien e përgjithshme dhe shëndetin publik.

Mundësitë për kontributet e komunitetit dhe investitorëve do të rregulloheshin nga administrata e qytetit.



Përfitimet kryesore

Zonat e gjelbra ndihmojnë në përthithjen e karbonit, duke kontribuar në adaptueshmërinë ('resilience') klimatike brenda qytetit dhe duke kufizuar ndikimet negative në mjedis.

Inventari mund të ketë rol në vlerësimin e ndikimeve të politikave të shfrytëzimit të tokës në biodiversitetin urban në të gjithë qytetin.

Krijimi i hapësirave të gjelbra që përdoren nga të gjithë, qofshin ato zona publike apo private. Rritja e jetueshmërisë në qytet përmes menaxhimit të mirë të zonave të gjelbra dhe ndërthurjes së tyre me shtigjet e ecjes dhe të ciklizmit.

Qëllimet e synuara Strategjike

- Qëllimi 7.1 – Sigurimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra lehtësisht të qasshme e të ndërlidhura, të shpërndara njëtrajtësisht nëpër lagje;
- Qëllimi 8.1 – Përmirësimi i reagimit ndaj Ndryshimeve Klimatike në një kontekst më të gjerë të qëndrueshmërisë (përsëmbull: përfshirë pandemitë);
- Qëllimi 9.1 – Vendosja e një sistemi efektiv dhe efikas të koordinimit dhe menaxhimit të Qyteteve të Gjelbra; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe Treguesit kryesorë

- Shtimi i hapësirave të gjelbra dhe ndërtimi i marrëdhënieve sociale brenda komunitetit në Prishtinë.

Konteksti aktual

Puna tashmë ka filluar nga OJQ "Architecture for Humans" në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, përmes platformës online 'Prishtina Tree and Public Space Map' (Harta e Drunjëve dhe Hapësirave Publike në Prishtinë) ku janë dokumentuar drunjët dhe mobiliari urban në disa zona të qytetit. Sidoqoftë, është e rëndësishme që kjo databazë të zgjerohet më tej për sa i përket funksionit dhe fushëveprimit, ashtu që të shërbejë dhe si mjet që ndërlidhet me planet zhvillimore, të zonimit dhe ato rregulluese.

Ka shumë hapësira të neglizhuara në qytet që kanë potencial të kthehen në zona të gjelbra të mirëmbajtura dhe që do të kontribuonin në rigjenerim urban.

Aktualisht, nuk ka platformë të qytetit që mbështet iniciativat e komunitetit dhe pjesëmarrjen në mbjelljen dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra pavarësisht interesit të treguar, mirëpo Komuna e Prishtinës ka përkrahur iniciativat individuale deri më tani, prandaj bashkëpunimi i ndërsjellë në këtë drejtim do të sjellë përfitime të rëndësishme mjedisore dhe sociale.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 500,000 €.

Gjithsej Kosto OPEX – 10,000 €/vit.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti Komunal, si dhe donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM 2022; Implementimi TM2 2022 – TM4 2025..

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Komuna, Këshillat Lokale, Komuniteti, OJQ-të, Shkollat, Shoqatat e pronarëve të banesave në bashkëpronësi, MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues).

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Proceset e prokurimit publik brenda qytetit.
- Angazhimi i duhur dhe stimujt financiarë për palët e interesit privat.
- Rezistenca nga zhvilluesit privatë.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Përdorimi i mundshëm i të dhënave për të krijuar hartën e biodiversitetit, si dhe statusin e gjelbërimit ekzistues, por dhe zgjerimin e tij. Te jetë i qasshëm për publikun. Integrimi potencial i të dhënave në Hartën Zonale Komunale dhe/ose planet tjera relevante të qytetit për të ndihmuar zhvillimin e infrastrukturës së gjelbër.

Sinergjia me veprimet tjera

- W1: Instalimi i Sistemit të Trajtit të Ujërave të Reshjes.
- CC1: Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent.
- L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive.
- T1: Masa të avancuara për Këmbësorë.
- T5: Investime për ciklizëm në të gjithë qytetin .

4.4 Energjia


4.4.1 Hyrje

Qymyri tradicionalisht ka qenë burimi kryesor i energjisë në Kosovë, me dy termocentrale me linjit, Kosova A dhe Kosova B, të ndërtuara në Komunën e Obiliqit, në veri-perëndim të Prishtinës. Këto dy termocentrale kanë kapacitet të instaluar të përbashkët prej 1,478 MW, edhe pse të dy centralet janë të vjetruara dhe operojnë me kapacitet shumë më të ulët sesa ai i instaluar (ndërmjet 645 dhe 710 MW). Politika e energjisë në Kosovë deri më sot është përqendruar kryesisht në sigurimin e gjenerimit në shkallë të gjerë të energjisë elektrike dhe kalimin në një treg të liberalizuar të energjisë elektrike.




Qeveria ka në plan të ndërtojë një termocentral të ri të madh me qymyr (Kosova C) si pjesë e një programi për të reformuar sektorin e energjisë së Kosovës. Banka Botërore ka qenë sponsori kryesor që ka financuar reformat e energjisë, duke përfshirë TC Kosova C, por ajo revokoi mbështetjen e saj për projektin në tetor të vitit 2019. Që nga ajo kohë, ka pasur negociata me kompaninë energjetike amerikane ContourGlobal, në lidhje me kontributin e mundshëm financiar në skemë, ndërsa diskutimet janë duke vazhduar.

Furnizimi total me energji primare sipas burimeve në Kosovë në ktoe



Burimi: IEA. Statistikat kryesore të energjisë, 2018

Përbërja aktuale e energjisë e Kosovës



Burimi: IEA. Statistikat kryesore të energjisë, 2018

4.4.2 Sfidat kryesore tek Trysnia dhe/ose Reagimi

Duke qenë se Kosova është vend me rezerva të konsiderueshme të linjtit, strategjia kombëtare e energjisë bazohet në sigurinë e furnizimit me energji elektrike nga termocentralet me linjit. Ka plane për të rehabilituar termocentralet ekzistuese për të siguruar pajtueshmërinë me Direktivën e Centraleve të Mëdha me Djegie ("LCPD"), ndërsa centralet e reja obligohen të jenë në pajtim me Direktivën për Emetimet Industriale ("IED").

Strategjia nacionale e energjisë parashikon gjithashtu diversifikimin e burimeve të energjisë, përfshirë Burimet e Ripërtërishme të Energjisë ("BRE"), ndërsa Kosova tashmë ka përbushur të gjitha kërkesat e parapara me Pakon e Tretë të Energjisë së BE-së, ku janë përbushur të gjitha dispozitat rregullative, legjislative e infrastrukturore, për të mundësuar diversifikimin e energjisë së prodhuar nga BRE.

Brenda Prishtinës, sfida kyçe është rritja e efijencës së energjisë në fondin e ndërtesave që menaxhohen nga Komuna. Investimet janë siguruar tashmë për rinovimin e ndërtesave dhe realizimin e masave të efijencës së energjisë.

4.4.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Fondi i Efijencës së Energjisë, që është themeluar së voni, përqendrohet tek ofrimi i stimuljeve për sektorin privat dhe atë publik, përfshirë edhe ekonomitë familjare, që synojnë zbatimin e masave investuese për efijencë të energjisë.

Qyteti ka siguruar investimet për një projekt të rinovimeve dhe realizimit të masave të efijencës së energjisë në ndërtesa në gjithë Prishtinën. Masat e tilla do të ndihmojnë në arritjen e kursimeve të energjisë, reduktimin e emetimeve të dioksid-karbonit, si dhe në realizimin e rritjes së efijencës së energjisë në të gjithë qytetin. Gjithsej 47 objekte komunale do të përfitojnë nga masat e renovimit për EE, përfshirë çerdhet, shkollat dhe qendrat e kujdesit primar shëndetësor.

Projekti për EE përfshin masa që janë relativisht të lehta për tu realizuar, si dhe me periudha të arsyeshme të shpagimit të investimit, duke përfshirë instalimin e pompave me shpejtësi të ndryshueshme në sistemin e ngrohjes dhe ndërrimin e burimit të ngrohjes, izolimin termik të fasadës, izolimin

termik të kulmeve dhe instalimin e dritareve dhe dyerve të reja të bëra nga profile PVC me pesë dhomëza, të përforcuara me profile dhe sistem mbylljeje nga çeliku inox. Për sa i përket kostove të përgjithshme të projektit, shuma prej 7.1 milionë EUR duhet të vihet në dispozicion, financuar nga fonde të kombinuara, ku përfshihet kredia prej 5 milionë Euro dhe 1 milion nga BERZH-i, së bashku me 1.1 milionë EUR nga Komuna e Prishtinës.

4.4.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Objektivat vijues strategjikë janë vendosur për sektorin e Energjisë, ndërkaq arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 4.1 - Vendosja e një kuadri të pastër, inteligjent dhe të integruar për furnizim të qëndrueshëm të energjisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe shtrirjes së rrjetit të ngrohjes qendrore

Diskutimet me palët e interesit kanë zbuluar një numër temash kryesore strategjike, si dhe aspiratat për sektorin e energjisë në Prishtinë, duke përfshirë si vijon:

- Identifikimi i alternativave miqësore ndaj mjedisit, për të siguruar ngrohje qendrore për banorë, ku synohet ndalimi i përherëshëm i përdorimit të qymyrit;
- Rëndësia e promovimit të përdorimit të energjisë së ripërtërishme, paralelisht me zvogëlimin e përdorimit të qymyrit nga familjet, në mënyrë që të shkohet drejt energjisë më të pastër në të ardhmen; dhe
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore nga Termokos-i.

Qëllimi është të zhvillohen dhe të vihen në treg zgjidhje teknologjike të përbalueshme, me kosto të efektshme dhe efektivitet në burime, për të dekarbonizuar sistemin e energjisë në mënyrë të qëndrueshme. Është po ashtu e rëndësishme të sigurohet furnizimi me energji që mund të plotësojë kërkesën në të ardhmen.

Qyteti po zhvillon burime të qëndrueshme të ripërtëritshme të energjisë si një mundësi e rëndësishme dhe miqësore me mjedisin për prodhimin e energjisë në të ardhmen. Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të arritshme kërkon shumë më pak investime në sektorin e energjisë, gjë që ndihmon në uljen e çmimeve të energjisë elektrike, duke mbështetur kështu edhe rritjen ekonomike. Njëkohësisht, përdorimi i BRE-ve ndihmon në furnizim të energjisë elektrike pa shkaktuar emetime të dioksidit të karbonit.

Komuna aktualisht po punon për të shtyrë përpara zhvillimin e një sistemi modern të energjisë së ngrohjes, në mënyra të ndryshme - përfshirë planifikimin, rregullimin dhe financimin. Kombinimi i qasjeve në eficiencë të energjisë në sektorin e ndërtesave, si dhe në sistemin e ngrohjes në nivel të sistemit, efektivisht do të sjellë përputhje midis ofertës dhe kërkesës, si dhe të ofrojë një sërë dobish edhe në eficiencë. Implementimi i suksesshëm i rrjetit modern të energjisë së ngrohjes, rrjetit të energjisë dhe sistemit të shpërndarjes, që janë eficientë në energji, rezistentë në aspektin klimatik, si dhe të përballeshëm në kosto, është një prej zgjidhjeve me koston më të ulët dhe me efektivitetin më të lartë për zvogëlimin e emetimeve dhe kërkesës primare për energji.

Ndërkohë, planifikimi i hershëm dhe përfshirja e gjerë e punonjësve dhe komuniteteve të prekura do të konsiderohen për të siguruar një "tranzicion të thjeshtë". Trajnimi dhe zhvendosja e vendeve të punës mund të vendosen për të ndihmuar punëtorët të lëvizin në sektorët modern të ngrohjes qendrore dhe energjisë.

Është me rëndësi të theksohet se zgjerimi i sistemit të ngrohjes qendrore aktualisht varet nga energjia plotësuese dhe shkarkimet e prodhuara nga dyfishimi i propozuar i kapaciteteve të prodhimit të energjisë termike, gjë që duhet të rrjedhë nga skema që po zhvillohet në TC "Kosova B" - kjo pritet të shtojë kapacitetin e prodhimit të energjisë nga 140MW në 280MW.

Caqet mbështetëse

Të rritet niveli i energjisë së prodhuar nga energjia diellore dhe të zvogëlohet varësia nga termocentralet me qymyr.

Përlllogaritet që kombinimi i këtyre masave në sektorin e ndërtesave do të ulë emetimet e GS-ve me mbi 66,000 tCO₂eq/vit deri në vitin 2030.

4.4.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (për t'u zbatuar në 3-5 vitet e ardhshme) në sektorin e energjisë, për të mbështetur arritjen e synimeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në tabelën 4.4, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4.4 - Përmbledhje e veprimeve në Energji

ID#	Veprimi	Përshkrimi
E1	Rehabilitimi i Ndriçimit Publik - Zëvendësimi i Poçave Ekzistues me Poça Eficientë në Energji:	<ul style="list-style-type: none"> Zëvendësimi i poçave ekzistues të vjetër, joefikasë, me teknologji LED që është më efikasë. [Raporti në kuptimin e konsumit të energjisë elektrike midis teknologjisë LED dhe poçave ekzistues është 1:6.] Ky veprim do të sjellë ulje të konsiderueshme të emetimeve, dhe është i përshtatshëm për implementim, me fonde nga buxheti i Komunës, por edhe nga një projekt i mundshëm i Partneritetit Publiko-Privat si dhe Kompanisë së Furnizimit të Energjisë.
E2	Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit:	<ul style="list-style-type: none"> Ky veprim i propozuar përfshin implementimin e pajisjeve telekomanduese në kutitë e distribucionit të ndriçimit publik. Ndërprerësit foto-elektronikë mund të zvogëlojnë konsumin e energjisë në ndriçimin publik, duke zvogëluar orët e shpenzimit gjatë natës (ndezje e vonuar dhe fikje e hershme).
E3	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore:	<ul style="list-style-type: none"> Veprimi do të realizohet në dy faza - e para që aktualisht është në vazhdim, financuar nga programi ekzistues IPA 2015, si dhe një program i dytë, i ri, që do të financohet nga KfW, Faza e dytë ndahet në dy Lote: <ul style="list-style-type: none"> Loti 2 - Rehabilitimi dhe zgjerimi i Rrjetit - (projekti ka filluar zbatimin në maj të vitit 2021) Loti 1 - Ndërtimi i nënstacioneve të reja termike (200 nënstacione termike).
E4	Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore:	<ul style="list-style-type: none"> Studimi i para-fizibilitetit është kryer nga KfW, ku është shqyrtuar arritshmëria e prodhimit të energjisë termike në Prishtinë përmes përdorimit të paneleve diellore.

E1: Rehabilitimi i Ndrëçimit Publik - Zëvendësimi i Llambave Ekzistuese me Llamba Efiçiente në Energji

Qëllimi – Zëvendësimi gradual i të gjithë poçave joefikasë në sistemin e ndriçimit publik me poçat LED më efikasë

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Sipas llogaritjeve, raporti i konsumit të energjisë elektrike midis teknologjisë LED dhe poçave ekzistues është 1:6. Kjo masë ofron kursime të konsiderueshme të energjisë, por edhe ulë emetimin e gazrave me efekt serrë

Kostoja – CAPEX: 0,4 milionë €; OPEX: Kostoja OPEX neto zvogëlohet për shkak të kursimit të energjisë elektrike dhe jetëgjatësisë së poçave LED

2021		2022			2023			2024			2025 & Tutje		
	Planifikimi	Implementimi											

Përshkrimi

Ndrëçimi në rrugë dhe zona publike është shërbim kyç që ofrohet nga Komuna. Sektori i ndriçimit publik luan një rol të rëndësishëm në rritjen e sigurisë dhe rendit, promovimin e zhvillimit ekonomik, krijimin e mjediseve sociale/miqësore, si dhe rritjen e efektit estetik të përnavave përreth.

Konsumi i energjisë në sektorin e ndriçimit të rrugëve, qoftë në ndriçim publik apo tek përdoruesit privatë, përbën përqindje të lartë të energjisë së përgjithshme të përdorur. Kushtet e ndriçimit në rrugët e Prishtinës aktualisht janë në një nivel i cili në shumë raste nuk i plotëson kërkesat e paracaktuara me legjislacion dhe standarde.

Kjo masë përqendrohet tek zëvendësimi gradual i poçave joefikase/llambave me shpenzim të lartë, që përdoren gjerësisht në sektorin e ndriçimit publik të Komunës, me drita efikase LED, duke rritur kështu efiçencën e energjisë. Avancimet teknologjike të industrisë së ndriçimit dhe zvogëlimi i kostos së pajimeve LED e bëjnë rinovimin e ndriçimit publik të Qytetit me LED investim të përballueshëm.

Përfitimet kryesore

Rinovimi në të gjithë qytetin do të sjellë kursime të konsiderueshme të kostos së energjisë në sistemin e ndriçimit publik deri në 80% të konsumit aktual, si dhe reduktim edhe më të madh të emetimeve të gazrave serë.

Për më tepër, jetëgjatësia e madhe e pajimeve LED do të sjellë zbritje të kostos së mirëmbajtjes dhe riparimit. Poçat LED në ndriçim mund të qëndrojnë me



dekada deri sa të ketë nevojë për ndërrimin e tyre. Vlerësohet se nëse ky veprim kombinohet me veprimin E2 do të ulte emetimet me mbi 39,000 tCO₂eq / vit deri në vitin 2030¹³.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 4.1 – Krijimi i një kornize të pastër, inteligjente e të integruar për furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmes rritjes së eficiencës dhe adaptueshmërisë ('resilience') së rrjetit të ngrohjes qendrore; dhe
- Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për të përmirësuar performancën mjedisore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike;
- Ulja e numrit të aksidenteve dhe kriminalitetit; dhe
- Mbështetje për sektorin mjedisor në përgjithësi.

Konteksti aktual

Komuna e Prishtinës ofron shërbime në përmirësimin/avancimin e rrjetit të sistemit të ndriçimit publik, duke investuar 300 mijë € çdo vit. Teknologjia e qëndrueshme e ndriçimit duhet të plotësojë të paktën tri kritere: 1) eficiencë e lartë ose kursim i energjisë, 2) jetëgjatësi të madhe të produktit dhe 3) riciklueshmëri. Llamba është përbërës kryesor i sistemit të ndriçimit, që do të thotë se zgjedhja e llojit të duhur të llambës është e rëndësishme. Parametrat e intensitetit të dritës në sistemet e ndriçimit e përcaktojnë të gjithë sistemin e ndriçimit nga pikëpamja e ndriçimit dhe teknikës, aspektet operacionale dhe ekonomike, si dhe nga ana e mirëmbajtjes operacionale. Shkalla e eficiencës së sistemit të ndriçimit varet gjithashtu nga zgjedhja e duhur e llambës. Ndërrimi i llambave është masë me potencial të konsiderueshëm të kursimit të energjisë.

Kostoja e investimit

Gjithsej investim CAPEX – varet nga numri i përgjithshëm i llambave - afro 200 € për llambë inteligjente kur infrastruktura e rrjetit është në rregull.

Afërsisht. 5 000 drita x 200 = 1,000,000 €.

¹³ Bazuar në supozimet e 5000 pajisjeve të ndriçimit që zvogëlojnë konsumin e energjisë nga 1500 W në 300 W dhe orët e funksionimit nga 4380 orë në 3504 orë në vit - me një faktor emetimesh prej

Gjithsej kosto OPEX – Shpenzimi operacional neto (OPEX) ulet për shkak të kursimit të energjisë dhe jetëgjatësisë së poçave LED.

Sigurimi i burimeve të financimit

Buxheti Komunal, Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE), Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), IFN-të, PPP-të. Masa mund të zbatohet gradualisht brenda burimeve ekzistuese dhe do të ishte interesante për burime të tjera financimi - kontratat EPC dhe PPP-të. Mobilizimi i fondeve për këtë është relativisht i lehtë.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Korniza kohore:

Program me faza deri në vitin 2030. Planifikimi: TM3 – TM4 2021, Implementimi: TM1 2022 me një program vjetor të vazhdueshëm deri në TM2 2025.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës, Kompanitë furnizuese të energjisë (ESCO)

Palët e interesit:

Furnizuesit e njohur të dritave LED, furnizuesi i energjisë elektrike

Rreziqet kryesore në zbatim:

Ekziston kriteri i kapacitetit të mjaftueshëm të palëve të përfshira në arritjen e këtij veprimi.

Potenciali i Qytetit Inteligjent - Mundësia për Përfitime

Një sistem i telekomandës është propozuar si pjesë e veprimit E2 dhe është planifikuar me instalimin e pajisjeve telekomanduese në kabinetet e distribucionit

1.438 tCO₂ / MWh bazuar në Rregulloren (MMPH) # 02/18 - Metodologjia Kombëtare e llogaritjes për performancën e energjisë së integruar të ndërtesave.

– kjo zgjidhje siguron kontroll në largësi të të gjitha llambave të nevojshme nga një kuti (qark lokal) dhe është më e lirë se instalimi i pajisjeve në çdo llambë.

Sinergjia me veprimet tjera

- E2: Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit.
- Ekziston lidhja shumë e qartë midis E1 dhe E2, pasi të dyja kanë të bëjnë me rritjen e efiçencës së sistemit të ndriçimit publik të qytetit.

E2: Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit

Qëllimi – Instalimi i ndërprerësve foto-elektronikë në sistemin e ndriçimit publik

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Energjia elektrike mesatare e konsumuar si input është 75.6% në krahasim me sistemin e ndriçimit pa foto-ndërprerës apo ndërprerës në largësi.

Kostoja – CAPEX: 3,9 milionë €; OPEX: për ndërprerësit inteligjentë është gati zero

2021		2022			2023			2024			2025 & Tutje	
	Planifikimi	Implementimi										

Përshkrimi

Ndërprerësit foto-elektronikë mund të zvogëlojnë konsumin e energjisë në ndriçimin publik duke zvogëluar orët e shpenzimit natën (ndejeje e vonuar dhe fikje e hershme). Sistemi i tele-menaxhimit mundëson që sistemi i ndriçimit të reagojë automatikisht ndaj parametrave të jashtëm siç janë dendësia e trafikut, koha e mbetur e ditës, punimet në rrugë, aksidentet apo kushtet e motit. Propozimi përfshin pajisjen telekomanduese në kutitë e shpërndarjes së ndriçimit publik.

Ndriçimi inteligjent mbledh, monitoron dhe dërgon të dhëna të përdorimit në kohë reale, ashtu që autoritetet civile dhe planifikuesit e qytetit të mund të përdorin më mirë të dhënat e tilla për të përmirësuar infrastrukturën e ndriçimit.

Ky investim do të kishte rëndësi të madhe dhe është investim shumë më i vogël se instalimi i ndërprerësve inteligjentë në llamba. Sidoqoftë, duhet të instalohet edhe rrjeti me fibër optike për kontrollimin e kabineteve.

Përfitimet kryesore

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë në sistemin e ndriçimit publik.
- Përmirësimi i sigurisë.
- Zvogëlimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes.



Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 4.1 – Vendosja e një kornize të pastër, inteligjente dhe të integruar për furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmes rritjes së efikasitetit dhe adaptueshmërisë ('resilience') së rrjetit të ngrohjes qendrore; dhe

- Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për përmirësim të performancës mjedisore

Caqet dhe treguesit kryesorë

Zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike që shoqërohet me zvogëlimin të emetimeve të gazeve serrë.

Konteksti aktual

Për vitin 2021, ka plane për instalimin e sistemit Dali-Dimming për kontrollimin e intensitetit të dritës në pjesët tashmë të rinovuara të sistemit të ndriçimit publik.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX - 3.9 milionë €

CAPEX rrjedh nga llogaritja: 270 kabine të furnizimi x 14,500 €

Gjithsej kosto OPEX - OPEX lidhur me ndërprerësit inteligjentë është gati zero (vetëm konsum i vogël i ndërprerësve).

Sigurimi i burimeve të financimit

Buxheti Komunal, AKEE, FKEE, PPP-të

Komuna e Prishtinës ka aplikuar në Agjensionin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE) për bashkëpunim në financimin e përmirësimit të rrjetit të ndriçimit publik të Prishtinës, ku skema/raporti i financimit është Komuna e Prishtinës 30% dhe AKEE 70%.

Buxheti i qytetit	FKEE	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

Program në faza, deri në vitin 2030. Planifikimi: TM3 – TM4 2021, Implementimi: TM1 2022 me një program vjetor deri në TM4 2025.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës

Palët e interesit:

Furnizuesit e njohur të sistemeve inteligjente të ndriçimit

Rreziqet kryesore në zbatim:

Rrezik i vogël me mobilizimin e burimeve të financimit.

Potenciali i Qytetit Inteligent

Krejtësisht inteligjent

Sinergjia me veprimet tjera

- E1: Rehabilitimi i Ndrëçimit Publik - Zëvendësimi i Poçave Ekzistues me Poça Eficientë në Energji.
- Ekziston lidhje shumë e qartë midis veprimeve E1 dhe E2, pasi të dyja kanë të bëjnë me rritjen e eficiencës së sistemit të ndriçimit publik.

E3: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore

Qëllimi – Modernizimi dhe zgjerimi i Sistemit të Ngrohjes Qendrore në Prishtinë

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Reduktimi i ndotësve dhe emetimeve të gazrave serrë, duke zvogëluar humbjen e nxehtësisë dhe ujit dhe duke rritur eficiencën e energjisë në sistemin e ngrohjes qendrore, me rritjen e numrit të ekonomive familjare me ngrohje qendrore (NQ)

Kostoja – CAPEX: 17,7 milionë €; OPEX: të konfirmohet

2021		2022		2023		2024		2025 & Tutje		
		Implementimi								

Përshkrimi

Masa do të realizohet në dy faza. Faza e parë në vazhdim përfshin projektin ekzistues në kuadër të programit IPA 2015 për ndërrimin e 121 nënstacioneve ekzistuese me nënstacione të reja në lokacionet si më poshtë:

- Gjithsej 82 nënstacione në sektorin e banimit:
 - 40 në zonën Dardania;
 - 25 në qendrën e qytetit (Qendra);
 - 32 në zonën e Ulpianës; dhe
 - 20 në zonën Kodra e Diellit.
- Gjithsej 39 nënstacione në Objektet Institucionale Publike kryesisht në lagjet e Qendrës së Qytetit dhe Dardania.
- Kycja e klientëve të rinj me 50 nënstacione - shtrirja e rrjetit prej të cilëve:
 - Gjithsej 16 nënstacione për konsumatorë të rinj që do të kyçen në rrjetin ekzistues në Qendër, lagjet Dardania, Ulpiana dhe Kodra e Diellit, si dhe;
 - Gjithsej 34 nënstacione të reja për konsumatorë të rinj si pjesë e zgjerimit të rrjetit, duke përfshirë 30 në Kalabri dhe 4 në zonat e Matit.
- Furnizimi dhe instalimi i valvulave të reja të kontrollit të ndryshimit të presionit (PDCV) në 50 nënstacione.
- Furnizimi dhe instalimi i rreth 7.73 km gypave me izolim të gatshëm.
- Ndërrimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes - Furnizimi dhe instalimi i rrjetit me 6 km gypa të rinj me izolim të gatshëm.
- Valvulat e mbylljes (130 njësi) që do të furnizohen dhe instalohen në 65 lokacione në gypat me izolim të gatshëm.



- Sigurimi i një pajisjeje testuese të cilësisë së ujit për trajtimin e ujit në Termokos dhe furnizimi dhe zëvendësimi i njehsorit të ngrohjes të anës primare (DN350) në stacionin e pompimit Bregu i Diellit.

Faza e dytë (që ka filluar), financuar nga KfW, është ndarë në dy Lote:

- Loti 1 – Ndërtimi i nënstacioneve të reja termike (200 nënstacione termike)

- Ndërrimi/modernizimi i nënstacioneve termike ekzistuese (200 nënstacione termike).
- Ndërtimi i dy rezervuarëve për depozitim të ngrohjes (400 m³ + 400 m³) në oborrin e Termokos-it.
- Dy pompa qarkulluese (një në sistemin e kogjenerimit dhe një në sistemin e shpërndarjes).
- Loti 2 – Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrjetit - (projekti ka filluar zbatimin në maj 2021)

Përfitimet kryesore

- Rritja e efikasitetit të energjisë në sistemin e ngrohjes qendrore; dhe
- Zvogëlim i ndjeshëm i humbjeve të energjisë dhe ngrohjes së ujit.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 4.1 – Vendosja e një kuadri të pastër, inteligjent e të integruar për furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmes rritjes së efikasitetit dhe rezistencës së rrjetit të ngrohjes qendrore; dhe
- Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Reduktimi i humbjeve teknike në sistemin e shpërndarjes në 6% nga niveli aktual prej 10.2%.

Vlerësohet se kjo masë do të ulte emetimet me mbi 12,900 tCO₂eq / vit në 2030¹⁴.

Konteksti aktual

Sistemi ekzistues i ngrohjes duhet të rinovohet dhe të zgjerohet me konsumatorë të rinj nga sektori i banimit dhe ai institucional.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX - 17.7 milionë € - rezultatet nga buxheti i projektit:

5,6 milion € IPA 2015 + 12,1 m KfW

Kostoja totale e OPEX - totali i OPEX do të zvogëlohet me uljen e humbjeve të nxehtësisë në shpërndarje nga 10.2% ekzistuese në 6% të pritshme.

Sigurimi i burimeve të financimit

Programi IPA 2015 + financimi i KfW – përmes Termokos-it

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjërë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: TM3 2021 – TM4 2025. Faza e parë është në vazhdim, sistemi SCADA (telekomanda) mbetet për t'u finalizuar. Faza e dytë është në fillim.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Termokos Sh.A.

Palët e interesit: Komuna e Prishtinës, Termokosi, Furnizuesit e pjesëve të reja dhe të riparuar të sistemit të ngrohjes

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Rreziqet në zbatim përfshijnë afatet kohore për implementim dhe kapacitetin e furnitorëve.

Potenciali i Qytetit Inteligjent

Potencial i madh përmes sistemit SCADA - kontroll nga largësia i Rrjetit të Ngrohjes Qendrore.

Sinergjia me veprimet tjera

- E4: Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore.

¹⁴ Bazuar në supozimet e energjisë NQ të dorëzuar aktualisht rritet me 2 herë për shkak të zgjerimit të sistemit NQ dhe më pas uljen e humbjeve nga 18% në 10% dhe supozimin e një faktori emetimesh prej 0.189 tCO₂eq / MWh, të llogaritur nga konsulentët për NQ bazuar në kogjenerim.


E4: Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore

Qëllimi – Rritja e shfrytëzimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) nga rrjeti i furnizimit të ngrohjes, duke reduktuar shfrytëzimin e lëndëve djegëse të ngurta

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Rritja e kapaciteteve të ndërmarrjes Termokos duke zgjeruar rrjetin e ngrohjes qendrore në lagjet me njësi individuale banimi.

Kostoja – CAPEX: e përafërt rreth 33.69 milionë €



Përshkrimi


Energjia termike diellore është e mirënjohur si teknologji e vlefshme për përgatitjen e ujit të nxehtë dhe ngrohjen e hapësirave në njësitë e banimit. Studimi i para-fizibilitetit për Projektin Termik Diellor "Solar4Kosovo/Big Solar Pristine" është organizuar nga Ndërmarrja Publike "Termokos" Sh.A. në Prishtinë, si partner implementues.

Studimi i para-fizibilitetit "Solar 4 Kosovo/Big Solar Pristine" është financuar bashkarisht nga Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Kosovës, përmes KFW-së dhe Programit të Energjisë së Ripërtërishme Zhvillimore në Ballkanin Perëndimor (ReDEWeB), përmes BERZH-it. Projekti tani kërkon studim dhe vlerësim të mëtejshëm të fizibilitetit dhe po punohet për të siguruar tokën (parcelën) e nevojshme, që arrin në afro 30 hektarë. Implementimi i projektit synon të ofrojë ngrohje dhe furnizim me ujë sanitar, pjesërisht për lagjet Arbëri dhe Tophane.

Impianti, që përbëhet nga fusha e kolektorëve solarë, akumulimi i nxehtësisë sezonale, si dhe pompa absorbuese e nxehtësisë dhe pajisjet ndihmëse, është planifikuar për instalim në tokë publike 3 km në veri-perëndim nga Tophanja në Prishtinë, në territorin e Komunës së Obiliqit.

Impianti do të depozitojë nxehtësinë diellore gjatë kohës së verës dhe do të ofrojë nxehtësi në rrjetin e ngrohjes qendrore gjatë dimrit. Pompa absorbuese e nxehtësisë mundëson përdorimin e temperaturës së ulët nga depozitat dhe rrit ndjeshëm efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

Diagrami i projektimit të sistemit të madh diellor, me përbërësit kryesorë dhe shkëmbyesit e nxehtësisë



Burimi: 'Report Kosovo', Termokos - Projekti i Energjisë Termike, studimi i para-fizibilitetit. fg. 20, fq. 36

Ky projekt është në përputhje me projektet e tjera në vazhdim dhe të planifikuara të investimeve në ngrohje qendrore, si dhe kontribuon në plotësimin e kërkesës në rritje për ngrohje në të gjithë qytetin.

Projekti po ashtu ka kuptim në kombinim me impiantin aktual të ko-gjenerimit, edhe nëse kapaciteti ngrohës i tij do të dyfishohet. Depozitimi mund të përdoret për të zvogëluar ngarkesat e pikut, duke barazuar dhe optimizuar funksionimin e

TC-ve, si dhe duke shërbyer si kapacitet rezervë ngrohje me investime të ulëta shtesë.

Përfitimet kryesore

- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore, duke shfrytëzuar BRE-të në vend të lëndëve djegëse të ngurta në familje individuale, përmes kyçjes së konsumatorëve të rinj; dhe
- Kapaciteti i parashikuar për impiantin diellor është të paktën 35 GWh / vit. Duke supozuar që kjo zëvendëson karburantin e ngurtë (linjitin), atëherë ulja e emetimeve do të jenë mbi 13,500 tCO₂eq në vit.

Projekti do të mund të kontribuonte në zëvendësimin e ngrohjes elektrike dhe emetimet përkatëse indirekte nga TC-ja me linjit. Ndërrimi i sistemeve të tjera individuale joefikase të ngrohjes ose stufave mund të përmirësojë gjithashtu situatën e emetimeve jo vetëm të lidhura me CO₂ por edhe me reduktimin e emetimeve lokale ndotëse e të dëmshme. Rreth 4.000 banesa me 18.000 njerëz mund të furnizohen me nxehtësi diellore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

Reduktimi i emetimeve, rritja e numrit të ekonomive familjare të kyçura në Sistemin e Ngrohjes Qendrore (SNQ); dhe

Zëvendësimi i përdorimit të pajisjeve elektrike dhe lëndëve djegëse fosile për ngrohje, duke rritur përdorimin e BRE-ve.

Konteksti aktual

Projekti tani është në fazën e studimit të fizibilitetit dhe po punohet për të siguruar tokën (parcelën) për implementim, që kërkon një sipërfaqe prej rreth 30 hektarësh.

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX - Vlerësuar (me para-fizibilitet) në 33.69 milionë €.

Gjithsej kosto OPEX - Duhet të nxirret nga konstatimet e studimit të fizibilitetit.

Sigurimi i burimeve të financimit

Buxheti Komunal, Buxheti shtetëror dhe donatorët - KfW, me pjesëmarrjen financiare të Termokos-it

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Korniza kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM2 2022; Implementimi TM3 2022 – TM4 2025. Studimi i fizibilitetit është duke u zhvilluar, dhe përparimi i projektit varet nga sigurimi i tokës së nevojshme për zbatim.

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Termokos (duhet ofruar mbështetje edhe nga niveli i qeverisë qendrore)

Palët e interesit:

KfW, Termokos, furnizuesit e teknologjisë së ngrohjes diellore.

Rreziqet kryesore në zbatim:

Projekti është në fazën e studimit të fizibilitetit, ku rreziqet në zbatim lidhen me realizueshmërinë e skemës që rrjedh nga kjo punë.

Potenciali i Qytetit Inteligent – I lartë

Burimi diellor i ngrohjes do të kontrollohet përmes një sistemi elektronik inteligjent. Sistemi i ngrohjes diellore është planifikuar të integrohet me sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore që aktualisht është duke u modernizuar (Veprimi E3), përfshirë implementimin e sistemit SCADA.

Sinergjia me veprimet tjera

- E3: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore.

4.5 Industria

4.5.1 Hyrje

Siç përcaktohet në Planin Zhvillimor Urban (PZHU), Prishtina ka planifikuar zhvillimin e zonave industriale, veçanërisht në periferi të pjesës perëndimore të qytetit në të ashtuquajturën Zonë Ekonomike e Kaltër. Zhvillimi i një zone të tillë është paraparë të përfshijë aktivitete të industrisë së lehtë, e jo të rëndë, siç mund të jenë aktivitetet logjistike. Puna po vazhdon për rehabilitimin e ish vendeve industriale që nuk janë më aktive. Aktivitetet e energjisë dhe minierave në afërsi të Prishtinës po modernizohen vazhdimisht përmes investimeve të huaja direkte, të cilat do të shohin një përmirësim të nivelit të emetimeve dhe cilësisë së ujit.

4.5.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Nuk ka sfida të perceptuara të industrive në qytet për mjedisin e saj dhe burimet natyrore.

4.5.3 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Qëllimi i mëposhtëm strategjik është vendosur për Sektorin e Industrisë, ndërkaq arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak afatmesëm mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 3.1 - Të sigurohet zbatimi i praktikave të mira mjedisore për përmirësimin e performancës energjetike të industrisë

Diskutimet me palët e interesit kanë zbuluar një numër temash dhe aspiratash kyçe strategjike për sektorin e industrisë në Prishtinë, duke kuptuar që derisa industrializimi ka potencial për të ndihmuar në përmbushjen e një sërë synimesh shoqërore, njëkohësisht, proceset e tilla industriale kanë ndikime negative, duke shkaktuar ndryshime klimatike, humbjen e burimeve natyrore, ndotjen e ajrit dhe ujit, të cilat kërcënojnë mjedisin e qytetit, si dhe mirëqenien ekonomike dhe sociale. Si rezultat,

është e rëndësishme të sigurohet që praktikave të mira mjedisore të inkorporohen fuqimisht në menaxhimin e kompanive industriale, bashkë me përmirësimin e performancës së energjisë.

Caqet afatmesme mbështetëse

Të rritet niveli i dialogut me kompanitë industriale për sa i përket efijencës së konsumit të energjisë, si dhe zbatimit të praktikave të mira mjedisore.

Qëllimi është krijimi dhe implementimi i praktikave të mira mjedisore në lidhje me para-trajtimin e ujërave të zeza industriale para shkarkimit të tyre në trupat ujorë të qytetit. Subjekti që shkakton çfarëdo niveli të ndotjes duhet të mbulojë shpenzimet e secilit ndikimi negativ. Parimi 'ndotësi paguan' është parim i politikës mjedisore, që kërkon që shpenzimet e parandalimit, kontrollit dhe masave të zvogëlimit të ndotjes të barten nga ndotësi, për të parandaluar dëmtimin e mjedisit.

4.5.4 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Kemi propozuar një veprim afatshkurtër për t'u zbatuar në 5 vitet e ardhshme në sektorin e Industrisë, për të mbështetur arritjen e caqeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4.5 që vijon, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4.5 - Përmbledhje e veprimeve tek Industria

ID#	Veprimi	Përshkrimi
I1	Strategjia e Angazhimit dhe Plani i Veprimit për Promovimin e Efiçencës së Energjisë:	<ul style="list-style-type: none"> Të organizohet dialogu me subjektet industriale për konsumin efikas të energjisë dhe shfrytëzimin e mundshëm të nxehtësisë nga mbetjet e proceseve industriale për kyçe në rrjetin e ngrohjes. Komunikimi proaktiv me subjektet industriale do të sigurojë zbatimin e praktikave të mira mjedisore për performancën energjetike të industrisë, trajtimin e ndotjes së ajrit, përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave, si dhe para-trajtimin e ujërave të ndotura industriale në përputhje me parimin "ndotësi paguan".

I1: Strategjia e Angazhimit dhe Plani i Veprimit për Promovimin e Efiçencës së Energjisë

Qëllimi – Të krijohet një partneritet midis Komunës dhe subjekteve industriale për përfshirjen e të dy palëve në aktivitetet e Qytetit të Gjelbër

Lloji i Veprimit – Angazhim i Publikut / Informacion

Përfitimet – Mbështetje për sektorin mjedisor në përgjithësi

Kostoja – Masë administrative pa kosto

2021			2,022			2023			2024			2025 & Tutje		
		Planifikimi	Implementimi											

Përshkrimi

Të organizohet dialogu me subjektet industriale për konsumin efikas të energjisë dhe shfrytëzimin e mundshëm të nxehtësisë, nga mbeturinat nga proceset industriale, për kyçjen në rrjetin e ngrohjes. Komunikimi aktiv me subjektet industriale do të sigurojë zbatimin e praktikave të mira mjedisore për performancën energjetike të industrisë, trajtimin e ndotjes së ajrit, mbështetjen e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave, si dhe para-trajtimin e ujërave të ndotura industriale në përputhje me parimin "*ndotësi paguan*".

Përfitimet kryesore

Krijimi i gjendjes bazë të informatave mbi ndikimet aktuale industriale në çështjet mjedisore, si dhe zhvillimi i dialogut dhe bashkëpunimit efektiv për mbështetje drejt arritjes së përmirësimit të performancës mjedisore nga subjektet industriale.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 3.1 – Sigurimi i praktikave të mira mjedisore për të përmirësuar performancën e energjisë industriale.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Zvogëlimi i nivelit të konsumit të energjisë në industri, për njësi të PBB-së industriale.



Konteksti aktual

Qyteti ka trashëguar disa zona industriale nga koha e ish-Jugosllavisë të cilat nuk janë më aktive. Shumica e tyre janë privatizuar duke mos pasur më aktivitetet e mëparshme, e duke u përqendruar më shumë në aktivitete të lehta industriale, siç janë logjistika dhe depotë. Përjashtimi i vetëm i madh është tek aktivitetet minerare dhe energjetike të vendosura në komunën fqinje të Obiliqit, gjë që paraqet sfida madhore mjedisore edhe për Prishtinën.

Kostoja e investimit

Gjithsej investimi CAPEX - Masë administrative pa kosto.

Gjithsej Kosto OPEX - Masë administrative pa kosto.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti Komunal.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore:

Planifikimi TM3 – TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025..

Agjencitë implementuese (kryesoret me të zeza):

Komuna e Prishtinës

Palët e interesit:

Komuna, ndërmarrjet industriale

Rreziqet kryesore në zbatim:

Gatishmëria e subjekteve industriale për angazhim e bashkëpunim.

Potenciali i Qytetit Inteligent

Mundësia e përdorimit të mjeteve digjitale për të promovuar EE-në (p.sh. fushata vetëdijesimi, kalkulatorët e kursimeve të energjisë, raste studimore, etj.). Platforma dhe partneriteti i tillë ofrojnë po ashtu mundësi për të ndarë dhe mbledhur të dhënat.

Sinergjia me veprimet tjera

- Mbështetje për sektorin mjedisor në përgjithësi.
- EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit.
- WA1: Përditësimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në Prishtinë.

4.6 Sektori i Ujërave

4.6.1 Hyrje

Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Prishtinë (KRU Prishtina) ofron shërbime të furnizimit me ujë dhe grumbullimit të ujërave të zeza për Qytetin, bashkë me gjashtë komunat fqinje. Aktualisht, shumica e konsumatorëve të Prishtinës kanë qasje të pandërprerë në ujë cilësor që raportohet të jetë brenda parametrave të pranueshëm. Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit në Prishtinë është mjaft kompleks dhe përbëhet nga gypa transmisioni prej 1,200 km gjatësi, rrjeti sekondar i shpërndarjes, si dhe tubacionet e shërbimit me gjatësi 700 km, por edhe rezervuarë me vëllim maksimal prej 70.000 m³. Çështjet kryesore të ujit për KRU Prishtina janë humbjet e mëdha teknike dhe komerciale të ujit (60% më 2018), kombinuar me kostot e larta të shërbimit.

Aktualisht, nuk ka trajtim të ujërave të zeza as trajtim të llucës/zgjyrës në Prishtinë. Si pasojë, lumenjtë përdoren si pranues të kanalizimeve, ku shumë prej tyre transportojnë ndotjen në vendet fqinje - lumi Drini i Bardhë derdhet në Shqipëri, lumi Ibri dhe Morava e Binçës në Serbi, ndërsa lumi Lepenc në Maqedoninë e Veriut.

4.6.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Qyteti ka identifikuar sfidat vijuese kyçe të sektorit të ujërave në Prishtinë, si rezultat i angazhimit të palëve të interesit dhe analizës së treguesve PVQGJ:

- **Adresimi i problemeve të ndotjes së ujit dhe rritja e cilësisë së ujit të lumenjve:** Për shkak të dekadave të shkarkimeve të rrjedhjeve të patrajtuara si dhe ndotjes me mbeturina, gjendja e lumenjve dhe trupave të tjerë ujqorë është përkeqësuar me shpejtësi. Lumi Sitnica, që rrjedh përreth Prishtinës, ka pësuar ndotje të madhe mjedisore nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara, ujërave industriale të Korporatës Energjetike të Kosovës – KEK, dhe depërtimit të kullimeve nga deponia e Mirashit. Parandalimi i ndotjes nuk do të mjaftojë për rivendosjen e cilësisë së ujit, si dhe ka nevojë për veprime të tjera plotësuese për ta arritur këtë.
- **Zbutja e efekteve negative dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike:** Trajtimi i kësaj sfide globale kërkon transformimin e rolit dhe qasjes së KRU Prishtina, investime substanciale në infrastrukturë të re, por edhe ndërmarrje të zhvillimit të kapaciteteve si dhe programe të vetëdijësimit të qytetarëve. Për shumë vite, niveli i kërkesës nuk është kontrolluar, ndërsa në nivel kombëtar, është tashmë e ditur që ka resurse të kufizuara ujore, ndërsa furnizimi ndikohet nga streset e ndryshimeve klimatike. Si rezultat, çështja e kontrollit të kërkesës pëe ujë luan rol qendror si pjesë e çfarëdo strategjie të re të menaxhimit të ujit të qytetit.
- **Ulja e nivelit të humbjeve të ujit dhe përmirësimi i performancës komerciale:** Në vitet e fundit, KRU Prishtina nuk ka arritur të zvogëlojë nivelin e humbjeve të ujit, ku ndërmarrja pëson kosto të larta dhe humbje komerciale. Për ta kthyer mbrapsht këtë trend, është e nevojshme të investohet në teknologji, zhvillim të kapaciteteve dhe të transformohet kompania, duke përqafuar një qasje komerciale që përqendrohet në praktikat efektive të menaxhimit të aseteve, mbështetur me përdorimin e teknologjive të reja.
- **Të përmirësohet efektiviteti energjetik i pajisjeve dhe stabilimenteve që përdoren në sektorin e ujit:** Kjo është posaçërisht e rëndësishme për eficiencën e energjisë që përdoret për prodhimin dhe pompimin e ujit. Masat e propozuara mund të jenë zhvillimi i modelit hidraulik, optimizimi i operimit të rrjetit, rehabilitimi i stacioneve të pompimit etj. Diagnostikimi bazë i rrjetit, me modele hidraulike, master-plan të rrjetit, do të jenë të nevojshme për kalimin nga qasja reaktive në atë proaktive për menaxhimin e furnizimit me ujë.
- **Zbatimi i standardeve të shkarkimit të ujërave të zeza:** Standardet e rrjedhave që duhen arritur para shkarkimit në trupa ujqorë pranues janë mjaft të rrepta. Për të arritur këto standarde, kërkohet jo vetëm infrastrukturë cilësore, por edhe menaxhim dhe operim efektiv i saj, që do të kenë nevojë për staf shtesë të kualifikuar dhe të shkakthtë.
- **Mbrojtja nga efektet e dëmshme të ujërave, përfshirë përmbytjet, prurjet e forta dhe erozioni:** Prishtina aktualisht nuk ka mbrojtje adekuate nga ndikimet e përmbytjeve. Sistemi aktual i kanalizimeve është i papërgatitur për grumbullimin e ujërave të të rreshurave dhe

dukurive të tjera të ngjashme. Kjo rezulton në ngjarje të shpeshta të përmytjeve, të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin publik, dëmtimin e pronës, etj., ndërsa si rezultat të fundit, ndotjen e ujit. Trajtimi i ndikimeve negative nga rastet potenciale të ujërave nga vërshimet kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturën e re, potencialisht duke përfshirë dhe infrastrukturën e ujërave atmosferike, por edhe infrastrukturën e gjelbër, psh. zgjidhjet e bazuara në natyrë (NBS – Nature Based Solutions).

4.6.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Furnizimi me ujë

Me funksionalizimin e Fabrikës së re në Shkabaj me 700 l/s më 2017, KRU Prishtina ka siguruar kapacitete plotësuese, duke mundësuar furnizim të mjaftueshëm të ujit të pijshëm për të gjithë zonën e Qytetit. Janë të pakta ndërtesat e reja që nuk kanë shtypjen e nevojshme të ujit (vetëm 0,02%). KRU Prishtina është tejet e interesuar të ruajë stabilitetin e furnizimit të ujit, e së bashku me KfW-në, kanë implementuar një program për mbrojtjen e burimeve ujore për liqenin artificial të Badocit, si dhe pusët tokësore në fushëburimin e Kuzminit. Kjo do të kontribuojë në projeksionet më afatgjate për sektorin e ujërave në Prishtinë.

KRU Prishtina aktualisht po rehabiliton rrjetin e ri të shpërndarjes në Qendër të Qytetit dhe lagjen "Medresa". Një pjesë e këtij programi është edhe rehabilitimi i stacioneve pompuese shtytëse, pra me ndërrimin e pompave konvencionale të vjetra në stacionet e Parkut dhe Mirditës me pompa të reja, që kanë motorë me shpejtësi të ndryshueshme/konvertues frekuencorë. Kompania ka pajisur të gjitha pikat e prodhimit me matës të prurjeve, për të matur, regjistruar dhe ruajtur vëllimin e saktë të ujit të furnizuar në sistem¹⁵. Rëndësia e gatishmërisë për të përgatitur bilancin kuptimplotë të ujërave nuk mund të nënvlerësohet.

Menaxhimi i kërkesës dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit

¹⁵ Së voni, SECO ka nisur një program të rezistencës mjedisore, që do të financojë propozimet e suksesshme nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit në Kosovë, përfshirë

KRU "Prishtina" aktualisht po përpiqet të përforcojë 'strategjinë e menaxhimit të kërkesës', ndërsa kompania po ashtu promovon gjerësisht vetëdijësimin e publikut për programet e tyre të kursimit të ujit. Kompania obligon të gjithë konsumatorët amvisnorë të instalojnë ujëmatës në amvisnitë e tyre, si dhe është duke punuar në një numër masash të reja, për të promovuar përdorimin racional të burimeve ujore, si dhe për të zvogëluar nivelin e humbjeve të ujit. Aktualisht po punohet në hartimin e një strategjie për humbjet e ujit dhe planit përkatës të veprimit. Po punohet gjithashtu në përcaktimin e zonave me shtypje të rregulluar dhe me njëhisor në dalje, por edhe në ndërrimin e pjesëve të vjetra të rrjetit të shpërndarjes në Qytet.

Trajtimi i ujërave të zeza

Prishtina aktualisht nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ) për trajtimin e ujërave të zeza të komunës. Qeveria ka nënshkruar një marrëveshje me Qeverinë e Francës për ndërtimin e një ITUZ-je, investimet kapitale të të cilit llogariten në 86 milionë EUR në total. Gjithsej 20 milionë EUR do të sigurohen nga Qeveria, ndërsa pjesa tjetër e fondeve "të buta" sigurohet nga Qeveria Franceze.

Paralelisht, KfW do të financojë ndërtimin e kolektorit kryesor të ujërave të zeza, i cili do të transferojë ujërat e zeza deri tek ITUZ-ja, ndërsa investimi kapital për këtë llogaritet të jetë 40 milionë Euro.

4.6.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Qëllimet vijuese strategjike janë vendosur për Sektorin e Ujërave, ndërkaq arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi 5.1 Të ofrohen shërbime moderne, efikase dhe rezistente të ujit

KRU Prishtina, për të adresuar efektet negative të ndryshimeve klimatike në furnizimin me ujë, me zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe rritjen e efijencës së energjisë.

Në reflektim të nevojës për të përmirësuar strategjinë e përgjithshme të kërkesës për ujësjellësin e Prishtinës, është e rëndësishme të investohet në rinovimin e plotë të sistemit ekzistues të gypave e pompave, të përmirësohet trajtimi i ujit dhe të reduktohet niveli i humbjeve që shënohen në Prishtinë. Realisht, kjo mund të marrë shumë kohë deri në realizim.

Është po ashtu kritike që të zbatohet një Plan i Menaxhimit të Aseteve të KRU-së, i cili do të përfshinte një numër detyrash prioritare: (i) kryerjen e punëve/shërbimeve të riparimit, në rastet e nevojshme; (ii) ndërrimin e sistemeve të gypave kur riparimi nuk është i mundshëm, si dhe (iii) ndërrimin e gypave të vjetër dhe gypave azbest-çimento.

Është po ashtu e rëndësishme të vazhdohet përdorimi i burimeve ujore nëntokësore për ujitje, por dhe vetëdijesimi i publikut për rëndësinë e furnizimit me ujë në Prishtinë, për të ulur nivelin e humbjeve.

Qëllimi 5.2– Të krijohen resurse funksionale të trajtimit të ujit dhe të ujërave të zeza, si dhe të ripërdorimit të tyre

Qëllimi është të investohet në teknologjinë më të fundit për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza, si dhe që ky investim të bëhet i vetë-qëndrueshëm, duke planifikuar dhe azhurnuar me kujdes strukturën tarifore. Për të përmirësuar menaxhimin dhe kontrollin e burimeve ujore, është e rëndësishme të kemi prani të shtuar të inspektorëve dhe shqiptimin e gjobave mandatore për kundërvajtësit. Krijimi i një sistemi kolektorësh për ujërat atmosferikë në qytet do të përmirësonte furnizimin me ujë të qytetit.

Caqet mbështetëse

Të rritet vetëdija për çështjet e efikasitetit të ujit, përmes nismave të e fushatave të vetëdijesimit.

Derisa cilësia e ujit në Prishtinë konsiderohet e pranueshme, ndërsa konsumi për kokë banori është relativisht i ulët, me 128 litra/ditë, ka akoma dobi që të inkurajohen banorët të ulin konsumin e tyre, përmes

masave të menaxhimit të kërkesës (si fushata vetëdijesimi dhe inkurajimi i praktikave dhe teknologjive të kursimit të ujit në anën e konsumatorit).

Ulja e humbjeve fizike të ujit në qytet me 20%, krahasuar me gjendjen e vitit 2021, përmes një sërë programesh të infrastrukturës dhe operimit e mirëmbajtjes (OeM).

Aktualisht, ka nivele të larta të humbjeve të ujit dhe joefikasitetit në rrjetin ujqor të qytetit, kryesisht për shkak të kombinimit të mangësive si infrastruktura e vjetërsuar (përfshirë rrjetin e shpërndarjes), si dhe çështjeve të operimit e mirëmbajtjes. Për të adresuar këto probleme, kërkohen investime në infrastrukturë dhe praktika të reja të menaxhimit, për të ulur nivelin e humbjeve të ujit në të gjithë Prishtinën.

4.6.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (për t'u zbatuar në pesë vitet e ardhshme) në sektorin e Ujërave, për të mbështetur arritjen e caqeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4.6 që vijon, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4.6 - Përmbledhje e Veprimeve në sektorin e Ujërave

ID#	Veprimi	Përshkrimi
W1	Investimet në sistemin e ujësjellësit (sistemi i gypave):	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat tregojnë se ka nevojë për ndërhyrje emergjente në pjesën e mbetur të gypave të vjetër, që janë prodhuar kryesisht me materiale potencialisht të dëmshme, si çimento dhe azbesti. Ky problem vërehet edhe më shumë tek nivelet e larta të rrjedhjeve dhe humbjeve të ujit në gjithë qytetin. Ky veprim përfshin rinovimin dhe riparimet e rrjeteve ekzistuese të ujësjellësit të Qytetit, në dy faza: (i) vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe ndërmarrjen e Analizës së Kostos - Përfitimit (CBA); (ii) projektin teknik, pasuar me nga punimet në implementim.
W2	Sistemi i ripërdorimit të ujërave atmosferikë:	<ul style="list-style-type: none"> Ky veprim llogaritet të jetë kritik në kuptimin e kursimeve të ujit, por edhe për praktikata e mbrojtjes nga vërshimet. Megjithatë, është e rëndësishme të jetë realist, në kuptimin e sasive që praktikisht mund të kursehen në aspektin volumetrik. Ky synon të zvogëlojë nevojën e përdorimit të ujit nga ujësjellësi komunal, duke vënë në dispozicion ujë të ripërdorur për lagjet lokale, si nga ripërdorimi i ujërave atmosferikë, ujërat nga proceset industriale, si dhe

ID#	Veprimi	Përshkrimi
		<p>ripërdorimi i ujërave nga kanalizimet atmosferike, si dhe kudo që është e mundur, edhe rikuperimi i ujërave kondenzate.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ujërat e ripërdorur mund të përdoren si ujë sanitar për ekonomi familjare, apo edhe për qëllime të tjera.
W3	Rritja e efikasitetit në shfrytëzim të ujit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ky veprim synon të vetëdijesojë shoqërinë në Prishtinë rreth çështjeve të mungesës së ujit. Fushata gjithëpërfshirëse e vetëdijesimit publik planifikohet të informojë e edukojë publikun e gjerë, duke u përqendruar tek veprimet miqësore për konsumatorin e ujit, që nga burimi i ujit deri tek përdoruesi fundor, duke zbatuar praktika të ndryshme të kursimit të ujit në baza ditore. ▪ Njehsimi dhe tarifat me matje të stimuluar plotësojnë masat e sjelljes së konsumatorëve, me kushtin që të mbrohen edhe grupet e cenueshme.
W4	Iniciativa për zvogëlimin e humbjeve të ujit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ekziston nevoja që të zvogëlohet joefikasiteti në sektorin e shërbimeve të ujit, ku mund të bëhen përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë dhe menaxhim të furnizimit. ▪ Elementet kryesore të kësaj qasjeje janë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Zbatimi i "strategjisë së menaxhimit të rrjedhjeve", për tkurrjen e mundshme të humbjeve fizike; ○ Aplikimi i "praktikave efektive të menaxhimit", për reduktimin e humbjeve; dhe ○ Përmirësimi i faturimit.

W1: Investimet në Sistemin E Ujësjesit (Sistemi i Gypave)

Qëllimi – Riparimi dhe rinovimi i rrjeteve ekzistuese.

Lloji i veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Kursimi i ujit dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së sistemit të ujësjesit me ujë 24 orë.

Kostoja – CAPEX: 7 milionë €; OPEX: i pa aplikueshëm – mbulohet nga kursimet

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
		Planifikimi												

Përshkrimi

Sistemi publik i ujësjesit operohet nga KRU Prishtina. Përkundër shumë përpjekjeve, shërbimet e furnizimit me ujë nuk janë ende duke i përmbushur qëllimet e synuara. Kjo pjesërisht është për shkak të faktit se pjesë të mëdha të rrjeteve të ujësjesit janë me gypa të instaluar më se 30 vjet më parë, që kanë nevojë për zëvendësim.

Të dhënat tregojnë se ka ndërhyrje emergjente në pjesën e mbetur të tubacioneve të vjetra, që janë ndërtuar kryesisht me materiale potencialisht të dëmshme për shëndetin, siç janë çimentot dhe azbesti. Ky problem përkeqësohet më tej nga nivelet e larta të ujit që nuk faturohet (rrjedhjet dhe humbjet) nga sistemet e ujit të pijshëm, përfaqësohet 56%. Rrjedhimisht, kjo masë mundëson riparimin dhe rinovimin e rrjeteve ekzistuese. Përveç arritjes së një prej objektivave kryesore që kërkon shërbime moderne, efikase dhe të adaptueshme ('resilient') të ujit, kjo masë është po ashtu e rëndësishme për arritjen e qëllimeve të tjera, si përmirësimi i besueshmërisë së sistemeve të furnizimit, ashtu që furnizimi 24 orësh të vazhdojë, si dhe të ulet niveli i humbjeve. Masa parashikohet të zbatohet në dy faza:

Faza e parë - Një studim i hollësishëm i fizibilitetit, që analizon sa vijon:

- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese, pasi ka një numër të projekteve të ngjashme në vazhdim ose të planifikuar, ndërsa nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me fazën e implementimit; dhe

- Analiza e hollësishme kosto/përfitim, për ndikimet e mundshme financiare dhe aspektet kohore, për shkak të infrastrukturës urbane të qytetit, topografisë dhe popullsisë.



Faza e dytë - Projektimi teknik, pasuar me fazën zbatuese - punimet ndërtimore.

Përfitimet kryesore

- Studimi i fizibilitetit - kryerja e analizës për vlerësimin e gypave ekzistues (p.sh. gypat, pompat, valvolat, depozitat, rezervuarët, elementet dhe pajimet tjera hidraulike); aplikimi i kontrollit në kohë reale përmes sistemeve SCADA, etj.
- Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Aseteve në KRU, me prioritet tek detyrat vijuese: planifikim i detajuar për ndërmarrjen e masave/shërbimeve të riparimit kudo që është e nevojshme; ndërrimi i gypave ekzistues kur riparimi nuk është i mundshëm; si dhe ndërrimi i gypave të vjetër dhe gypave me azbest-çimento.

Qëllimet e synuara strategjike

SG 5.1: Vendorsja e shërbimeve moderne, efikase dhe të qëndrueshme/ të adaptueshme të ujit.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Numri i njësive të riparuar;
- Numri i njësive të instaluar rishtaz (p.sh. sensorë);
- Cilësia e ujit të pijshëm;
- Përqindja e humbjeve fizike; dhe
- Mbulimi dhe efikasiteti i rrjeteve të ujësjellësit përmirësohen përmes planeve dhe investimeve.

Konteksti aktual

Problemet me sistemin e ujësjellësit adresohen gjerësisht nga të gjitha palët relevante, si dhe palët e prekura. Bllokimet në sistemin e gypave të ujësjellësit, kapaciteti joadekuat i rregullimit të presionit, rrjedhjet në sistemin e vjetër dhe të tejkualuar të gypave, bashkë me rritjen e rreziqeve shëndetësore për publikun për shkak të azbestit, kanë rezultuar tashmë me disa veprime të ngjashme, kryesisht të financuara nga donatorët. Sipas Planit të Biznesit të KRU-së (2021-2023) janë planifikuar / janë në vazhdim veprimet e mëposhtme:

- Rehabilitimi i 4,000 metrave të rrjetit të ujësjellësit (2019-2020);
- Rehabilitimi/ndërrimi i 15,000 metra gypa të shpërndarjes së ujit, që mbulojnë tetë komuna të shërbyera nga KRU-ja (2021-2023); dhe
- Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për të përmirësuar furnizimin dhe zvogëluar humbjet në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Drenas) me buxhet të përgjithshëm 730,000 Euro (2021-2023).

Nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me fazën aktuale të implementimit dhe projektet tjera të ngjashme potenciale në vazhdim. Siç mund të vërehet, projektet e planifikuara/në vazhdim mbulojnë vetëm disa vendbanime të caktuara suburbane, si dhe nuk trajtojnë të gjithë qytetin. Kështu, masat e propozuara mëtojnë të mbulojnë të gjithë qytetin e Prishtinës.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 7 milionë € (Punët ndërtimore/instaluese p.sh. gypat, rezervuarët e depozitave, prokurimi i pompave, valvolat, elementet dhe pajimet tjera hidraulike, përafërsisht 665,000 €; dhe kostot e studimit të fizibilitetit përafërsisht 350,000 €).

Gjithsej kosto OPEX – Mbulohet nga kursimet

Përputhshmëria me burimet e financimit

Komuna, Qeveria – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, KRU, Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Dobitë e kombinuara sociale e ekonomike

Kursimi i ujit dhe përmirësimi i rregullsisë së sistemit të ujësjellësit dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijes.

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 2021 - TM2 2022; Implementimi TM3 2022 - TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

KRU Prishtina

Palët e interesit:

KRU Prishtina, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komuna e Prishtinës

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Instalimi i sensorëve për zbulimin e rrjedhjeve, si dhe aplikimi i kontrollit në kohë reale përmes sistemeve SCADA, mund të jenë vlerë e shtuar për kontrollimin dhe menaxhimin efektiv.

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet performancën e përgjithshme mjedisore, duke zbutur presionin mbi burimet ujore, me përmirësimin e cilësisë së ujit dhe efikasitetin e sistemit të furnizimit.

W2: Sistemi i Ripërdorimit të Ujërave Atmosferikë

Qëllimi – Zbutja e presionit mbi ujësjellësin komunal, me shfrytëzimin e burimeve alternative të ujit, si ripërdorimi i ujërave atmosferikë, ripërdorimi i ujërave industrialë dhe ujërave të zeza, si dhe kudo që është e mundur, edhe ripërdorimi i kondenzateve (të ujit). Uji i ripërdorur mund të përdoret si ujë sanitar për ekonomi familjare, apo edhe për qëllime të tjera.

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Kursimi i ujit, më shumë ujë në dispozicion për komunitetin, si dhe zvogëlimi i rrezikut nga vërshimet.

Kostoja – CAPEX: 8 milionë €; OPEX: 320,000 €/vit

2021		2022		2023		2024		2025 & Tutje		
		Planifikimi		Implementimi						

Përshkrimi

Projeksionet aktuale të popullsisë tregojnë për rritje të popullsisë me afro 6% deri më 2060. Megjithatë, Prishtina është një nga komunat me mungesat më të mëdha të ujit në vend, që edhe ashtu është kategorizuar si rajon me stres ujor. Disponueshmëria e burimeve ujore për kokë banori është në parametra kritikë. Zbatimi i praktikave të kursimit dhe ripërdorimit të ujërave kanë rëndësi të jashtëzakonshme. Për të zbutur presionin mbi ujësjellësin komunal, qyteti mund të përdorë burime alternative të ujit, si ripërdorimi i ujërave atmosferikë, ripërdorimi i ujërave industrialë dhe ujërave të zeza, si dhe kudo që është e mundur, edhe ripërdorimi i kondenzateve (të ujit).

Veprimet në këtë masë parashohin që ujërat si: ujërat e zeza amvisnore; ripërdorimi i ujërave atmosferikë; ujërat industrialë, si dhe ripërdorimi i kondenzatit nga kondicionerët e ajrit; që fillimisht duhen filtruar, pastaj të kalojnë trajtimin biologjik, në p.sh. bioreaktor me membrana, pasuar me osmozë reverse për të larguar ndotësit mikrobikë dhe biokimikë.

Përfundimisht, ujërat e ripërdorur mund të përdoren si ujë sanitar për ekonomi familjare, apo edhe për qëllime të tjera. Një skemë e thjeshtuar e mundshme e procesit është paraqitur në figurën 1 më poshtë.




Fig. 1. Diagrami i procesit. Burimi: Nxjerrë nga (ARUP, 2018)


Përfitimet kryesore

- Ripërdorimi i ujërave atmosferikë nga kulmet (kulme banesash, komerciale, industriale, etj.)

- Ripërdorimi i ujërave atmosferikë nga dushet dhe pajisjet e tjera sanitare, si dhe ujërat industrialë (nëse ka)
- Sistem i ndarë i kanalizimeve për ujërat e grumbulluara drejt impiantit të trajtimit të ujërave, i cili duhet të pajiset teknologjikisht me trajtim biologjik (nëse nuk ka të tillë) dhe osmozë reverse.
- Ndërtimi i depozitës për mbajtjen e ujit

Qëllimet e synuara strategjike

- SG 5.1 – Vendosja e shërbimeve moderne, efikase dhe të qëndrueshme/rezistente të ujit;
- SG 5.2 – Vendosja e trajtimit funksional të ujit & ujërave të ndotura dhe rigjenerimin e burimeve; dhe
- SG 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për përmirësim të performancës mjedisore.



Caqet dhe treguesit kryesorë

- Përqindja e përdorimit të ujit për kokë banori; dhe
- Zbutja e rrezikut për incidente të rrjedhjes së ujërave atmosferikë (p.sh. Rastet e përmytjeve).

Konteksti aktual

Ka mangësi në kuptimin e stresit në ujëra, si ndërprerjet e shpeshtë të ujit dhe rastet e vërshimeve. Përkundër rëndësisë së kuptuar të këtyre veprimeve, nuk ka as iniciativa të tilla dhe as plane të ndërmarra nga qyteti, gjithashtu, nuk ka sisteme të trajtimit të ujërave atmosferikë dhe ujërave të zeza. Rritja e mbulimit të sipërfaqeve të shtruara që lidhen me urbanizimin ka çuar në një rritje të fluksit maksimal të rrjedhjeve nga reshjet, të cilat rezultojnë me vërshime, kur kanalet e vjetëruara në rrjedhë të poshtme nuk kanë kapacitet për të absorbuar rrjedhat e reshjeve të mëdha dhe afatgjate, siç parashihen të ndodhin për shkak të ndryshimeve klimatike, si dhe projeksioneve të rritjes së popullsisë; kjo kontribuon edhe në rritje të rasteve të vërshimeve, ashtu edhe në përkeqësimin e cilësisë së ujit.

Ka po ashtu hapësirë të konsiderueshme për përmirësim të praktikave të kursimit dhe ripërdorimit të ujërave, duke zbatuar masat e propozuara. Këto masa parashihen të jenë kritike në kursimin e ujërave, si dhe praktikave të mbrojtjes nga vërshimet. Këto synojnë të zvogëlojnë në masë të madhe nevojën për shfrytëzim të ujërave nga ujësjellësi komunal, duke vënë në dispozicion ujëra shtesë të ripërdorur për komunitetin lokal, ndërsa zvogëlojnë edhe rastet e vërshimeve.

Kostoja e investimit

Gjithsej investim CAPEX – 8 milionë € (€ 500,000 për depozita mbajtjeje; € 6M ndarja e sistemeve të kanalizimit; € 1.5M avancimi i impiantit të trajtimit të ujërave).

Gjithsej Kosto OPEX – afro € 320,000/vit. (Operimi i osmozës reverse dhe kostot e mirëmbajtjes në baza vjetore; është e mundur të mbulohen me kurse të ujit).

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Qytetit / KRU – Prishtinë bashkë-financuar nga Qeveria - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe donatorët mjedisorë, ekonomitë familjare dhe akterët tjerë privat¹⁸

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjërë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Dobitë e kombinuara sociale dhe ekonomike

Ripërdorimi i ujit të shiut dhe shfrytëzimi i burimeve të tjera jo-tradicionale, siç është uji nga pajisjet sanitare, uji i procesit industrial (aty ku është në dispozicion) dhe i ujërave të tjerë, do të jetë i dobishëm për një përdorim të qëndrueshëm të ujit në qytet. Për më tepër, kjo do të kontribuojë në rritjen e ujit në dispozicion për komunitetin lokal, ndërsa rreziku i përmytjes nga reshjet e shiut do të zvogëlohet.

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 2021 - TM2 2022; Implementimi TM3 2022 - TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

KRU Prishtina

Palët e interesit:

KRU Prishtina, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Këshilli Ndërmintor i Ujërave

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme. Sidoqoftë, mund të kërkohet një studim paraprak i fizibilitetit, si dhe ndoshta vlerësim i ndikimit në mjedis.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Instalimi i sensorëve për shkarkimin e depozitave dhe rezervuarëve të ujit do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit në aspektin kohor dhe atë të menaxhimit – duke mundësuar kontroll të lokalizuar të sistemeve.

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet performancën e përgjithshme të sektorit mjedisor, me aplikimin e pjesëve të teknologjisë inteligjente. Kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore; zvogëlimin e mbeturinave dhe rritjen e përdorimit të resurseve të ripërtërishme.

W3: Rritja e Efikasitetit në Shfrytëzim të Ujit

Qëllimi – Fushatë gjithëpërfshirëse vetëdijesimi publik mbi mungesën e ujit dhe kursimet, me qëllim që të krijohen praktika ditore miqësore për mjedisin tek konsumatorët.

Lloji i Veprimit – Angazhim i Publikut / Informacion

Përfitimet – Ngritja e vetëdijes për mungesën e ujit. Ulje e konsumit të ujit për kokë banori.

Kostoja – CAPEX: 50,000 €; OPEX: 50,000 €

2021		2022		2023		2024		2025 & Tutje	
		Planifikimi		Implementimi					

Përshkrimi

Kjo masë synon të paralajmërojë shoqërinë për brengën e mungesës së ujit. Planifikohet të zbatohet si fushatë e madhe dhe gjithëpërfshirëse e vetëdijesimit publik, që synon të informojë dhe edukojë publikun e gjerë dhe audiencat e caktuara të shënjestruara, p.sh. fëmijët parashkollorë, bizneset, industrinë, etj. Promovimi i veglave digjitale të krijuara enkas, p.sh. informimi për shkyçjet nga ujësjellësi, etj., do të jenë pjesë përbërëse e procesit. Fushata do të përqendrohet në instalimin e praktikave miqësore tek konsumatorët e ujit, nga burimi i ujit tek përdoruesi fundor, me zbatimin e praktikave të kursimit të ujit në sjelljen e përditshme të qytetarëve.

Përfitimet kryesore

- Promovimi i efikasitetit të shfrytëzimit të ujit, përmes fushatave mediale nacionale e lokale, si dhe mënyrave të tjera të promovimit publik;
- Procesi i shpërndarjes përmes reklamimit, njoftimit, etj.; dhe
- Materiale informuese dhe edukative si: broshura, pamflete, etj.

Qëllimet e synuara strategjike

- SG 5.1 – Vendosja e shërbimeve moderne, efikase dhe të qëndrueshme/ të adaptueshme ('resilient') të ujit; dhe
- SG 5.2 – Vendosja e trajtimit funksional të ujit & ujërave të ndotura dhe rigjenerimin e burimeve



Caqet dhe treguesit kryesorë

- Konsumi i ujit për kokë banori; dhe
- Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit.

Konteksti aktual

Uji është burim i çmuar. Vendi i mungonjë burimet e ujit të ëmbël, e kështu klasifikohet si vend me stres ujor. Vendi ka ndër nivelet më të ulta të zhvillimit dhe depozitimit të burimeve ujore për kokë banori, afro 41% të mesatares rajonale. Projektioni aktual i popullsisë tregon për rritje të popullsisë me rreth 6%

deri më 2060, ndërsa ndryshimet klimatike parashihen të sjellin më raste më të shpeshta të periudhave të thatësisirës. Përveç stresit fizik të ujërave që shkaktohet nga ndryshimet klimatike, menaxhimi dhe shfrytëzimi i mangët i burimeve në dispozicion i bën ujërat e Kosovës të pasigurta. Praktikrat e kursimit të ujit duhet të bëhen pjesë e zakoneve të përditshme të qytetarëve.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 50,000 €.

Gjithsej Kosto OPEX – 50,000 €.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Komuna, Donatorët dhe KRU

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | **Përputhje e mundshme** | **Përputhje e dobët**

Implementimi

Afatet kohore: TM4 2021 - TM1 2025

Agjencitë implementuese (kryesoret me të zeza):

KRU Prishtina, me përkrahje (mbikëqyrje) të Komunës së Prishtinës

Palët e interesit:

KRU Prishtina, Komuna e Prishtinës, Akademia, Universitetet

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk parashihen rreziqe të konsiderueshme, por komuna duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që mesazhi në të gjithë fushatën të përçohet saktësisht për të gjitha komunitetet e ndryshme.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Kjo masë është fushatë vetëdijesimi, prandaj përdorimi i teknologjive inteligjente nuk parashikohet aktualisht. Sidoqoftë, gjatë zbatimit të masës, qytetarëve mund t'u ofrohen aplikacione speciale në telefonat e tyre inteligjentë, për të ofruar lexim

krahasues të konsumit të ujit, si dhe për qëllime raportimi, p.sh. aktivitetet e keqpërdorimit të ujit që hasen, nivelin e konsumit ditor të ujit të ekonomisë familjare, etj.

Një numër qytetesh evropiane kanë zhvilluar aplikacione që i mundësojnë qytetarëve të alarminojnë probleme që kërkojnë përgjigje nga shërbimet komunale (përfshirë edhe çështje më të gjera të Komunës, jo vetëm ato që lidhen me ujin).

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet sektorin e përgjithshëm mjedisor, duke zbutur presionin mbi burimet ujore.

W4: Iniciativa për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit

Qëllimi – Zbatimi i kontratave të shërbimit të bazuara në performancë, përmes subjektit privat

Lloji i Veprimit – Planifikim / Infratrakturë

Përfitimet – Zvogëlimi i humbjeve të ujit, që ndikon pozitivisht në përdorimin e burimeve (ujë, energji dhe resurse të tjera) si dhe përfitimet në kosto për operatorin


Kostoja – CAPEX: 250,000 €; OPEX: 400,000 €

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
		Planifikimi	Implementimi											

Përshkrimi

Duke pasur parasysh mungesën e ujit, qyteti i Prishtinës synon të zbusë mungesën e efikasitetit në sektorin e shërbimeve të ujit. Me gjithë përmirësimet e qëndrueshme në vitet e fundit, ka ende hapësirë për përmirësim të efikasitetit. Për shembull, shkalla e humbjeve të ujit në vitin 2017 arrinte në afro 56 përqind, që ndikon negativisht në kostot dhe nivelin e shërbimit. Ky nivel i lartë i humbjeve i atribuohet një tërësie faktorësh, që përfshijnë infrastrukturën e vjetërsuar, pajisjet e vjetëruara të matjes, gabimet në përpunim të të dhënave dhe keqpërdorimin e ujit. Ngjashëm, edhe produktiviteti i stafit vlerësohet të jetë i ulët.

Nevojiten veprime të prekshme nga KRU-ja për të rregulluar këtë gjendje. Përfundimisht, dështimi në trajtimin e kësaj çështjeje do të sjellë përkeqësim të shërbimit dhe rritje të nivelit të mospagimit (për shkak të pakënaqësisë me standardin e shërbimit). Rrjedhimisht, këtu kërkohet ndërhyrje e menjëhershme, si në infrastrukturë ashtu edhe në nivelin e menaxhimit. Në kuadër të kësaj, propozojmë zbatimin e kontratave të shërbimit, të bazuara në performancë, përmes një subjekti privat. Këto lloje të shërbimeve kontraktuale janë dëshmuar si të suksesshme dhe efikase, pasi që gjithsesi përmirësojnë performancën e përgjithshme menaxheriale dhe teknike. Përfitimet kryesore të masës janë zvogëlimi i humbjeve të ujit, që ndikon pozitivisht në përdorimin e burimeve (ujë, energji dhe resurse të tjera) si dhe përfitimet në kosto për operatorin, pasi që ka më pak humbje financiare për ujin e prodhuar.



Përfitimet kryesore

- Zbatimi i një "strategjie të menaxhimit të rrjedhjeve" për rikuperimin potencial të humbjeve teknike (p.sh. në gypa e menaxhim të aseteve, si përzgjedhja,

instalimi, mirëmbajtja, rehabilitimi dhe zëvendësimi; shpejtësia dhe cilësia e riparimeve; kontrolli aktiv i rrjedhjeve, etj.).

- Zbatimi i “praktikave të menaxhimit efektiv” për rikuperimin e humbjeve financiare (p.sh. gabimet në llogaritje të shpenzimit, njehsorët e pasaktë, keqpërdorimi i ujit).
- Përmirësimi i shërbimeve të faturimit.

Qëllimet e synuara strategjike

- SG 5.1 – Vendosja e shërbimeve moderne, efikase dhe të qëndrueshme/rezistente të ujit; dhe
- SG 5.2 – Vendosja e trajtimit funksional të ujit & ujërave të ndotura dhe rigjenerimin e burimeve.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Përqindja e humbjeve të ujit;
- Të ardhurat e KRU-së nga pagesat e faturave;
- Matjet dhe faturimi për përdorimin e ujit janë të rregulluara;
- Konsumi i ujit për kokë banori; dhe
- Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit.

Konteksti aktual

Humbjet e ujit mbeten një ndër problemet kritike që lidhen me të. Humbjet e ujit në kontekst rajonal janë në shkallën prej afro 56%. Norma e inkasimit ishte diku rreth 71%, që shfaq mosefikasitet të shërbimeve të ndërmarrjes, si dhe çështje të pazgjidhura me klientët rreth përballimit të borxheve. Sistemi i ujësjellësit është i vjetër dhe i dobësuar, humbjet teknike dhe rrjedhjet e ujit janë të dukshme, sistemi i matjes edhe pse ekziston (afro 97% e konsumit të ujit raportohet të jetë matur), ende nuk ka saktësi, duke ndikuar kështu në sistemin e faturimit dhe gjenerimin e të ardhurave, ndërsa aktivitetet e paligjshme të ujit vazhdojnë të rriten. Sidoqoftë, përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe financiare të KRU-së mbetet prioritet për sektorin e ujit të pijshëm, veçanërisht përmes zvogëlimit të humbjeve të ujit.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investimet CAPEX – 250,000 € (shpenzimet në lidhje me konfigurimin e zonave të matura të ujit dhe infrastrukturat mbështetëse (p.sh. sistemi inteligjent i matjes së ujit – ‘IoT’ etj.).

Gjithsej Kosto OPEX – 400,000 € (riparime shtesë të rrjetit dhe detyrime tjera kontraktuale; detajet e mëtejshme financiare të specifikohen në kushtet e kontratës).

Përputhshmëria me burimet e financimit

Subjektet private, KRU Prishtina

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | **Përputhje e mundshme** | **Përputhje e dobët**

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 - TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

KRU Prishtina dhe subjektet private

Palët e interesit: KRU Prishtina, Komuna e Prishtinës (mbështetje dhe mbikëqyrje)

Rreziqet kryesore në zbatim: Ka gjasa për implikime në lidhje me dispozitat ligjore të operatorit, që do të duheshin ndryshuar e miratuar nga Komuna.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Përdorimi i teknologjive inteligjente të matjes së ujit, si dhe i pajisjeve të tjera të automatizuara për monitorim, funksionim të rrjetit të ujit, prurjeve të ujit dhe kontroll aktiv të rrjedhjeve.

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet sektorin e përgjithshëm mjedisor, duke zbutur presionin mbi burimet ujore.

4.7 Mbeturinat inerte

4.7.1 Hyrje

Prishtina ndan sfidat e menaxhimit të mbeturinave inerte komunale (MIK) me qytetet dhe qytezat tjera në të gjithë vendin. Qyteti ka përgjegjësi të menaxhojë këto mbeturina, por edhe të menaxhojë mbeturinat komerciale dhe mbeturinat ndërtimore si dhe ato nga rrënimet. Menaxhimi i mbeturinave mjekësore është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme, siç janë pajisjet elektrike dhe elektronike, akumulatorët, vajrat, gomat, etj., është përgjegjësi e MMPHI-së.

Menaxhimi i mbeturinave shtazore, si kufomat, eshtrat, etj., që prodhohen nga thertoret dhe mishtoret, është përgjegjësi e Agjencisë Kosovare të Ushqimit dhe Veterinës. Mbeturinat shtazore mbliidhen, transportohen dhe depozitohen ndaras nga mbeturinat komunale. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së një impianti për përpunim të mbeturinave shtazore, si dhe aktiviteteve të mangëta në zbatim të ligjit, disa nga këto mbeturina hidhen në kontejnerë publikë dhe në fund përfundojnë në deponinë e Mirashit.



Prishtina ka mbulim të plotë me shërbime të grumbullimit të mbeturinave komunale që ofrohet nga Kompania Rajonale e Grumbullimit të Mbeturinave "Pastrimi", ndërsa mbeturinat depozitohen në deponinë e Mirashit, me tarifë hyrëse prej 6 euro/ton, që i paguhet operatorit të deponisë KLMC. Deponia e Mirashit pranon mbeturinat komunale nga lokacionet e të gjithë Komunës së Prishtinës, por dhe nga komunat fqinje.

Prishtinës i mungon infrastruktura kritike për deponi sanitare, siç është reparti i trajtimit të kullimeve, sistemi aktiv i kaplimit të gazrave, si dhe sistemi i transportit. Deponia e Mirashit aktualisht vepron si deponi e kontrolluar, me nevojë urgjente për përmirësim të infrastrukturës, mirëmbajtjes operacionale dhe sigurim të respektimit të standardeve mjedisore. Operimi i vazhdueshëm i deponisë paraqet rrezik të vazhdueshëm të ndotjes si të tokës ashtu edhe të burimeve ujore.

Prishtinës aktualisht i mungon menaxhimi efektiv i rrjedhave tjera të mbeturinave, sidomos mbeturinave ndërtimore dhe atyre nga rrënimet, por edhe mbeturinave të rrezikshme. Sipas ligjit, Komuna duhet të caktojë lokacionin për deponi të mbeturinave ndërtimore e të rrënimet, të marrë pëlqimin mjedisor, të ndërtojë deponinë dhe të kontraktojë operatorin e deponisë, ndërsa ata që prodhojnë mbeturinat e tilla duhet të dërgojnë mbeturinat e tyre në këtë deponi. Ne kemi ndarë buxhetin dhe kemi caktuar lokacionin për ndërtimin e deponisë së re për mbeturina ndërtimore. Sidoqoftë, ky impiant ende nuk është ndërtuar, ndërsa ndërkohë, prodhuesit e mbeturinave ndërtimore po i hedhin mbeturinat e tyre në vende të parregullta, duke kontribuar kështu në rritjen e deponive të egra në të gjithë qytetin.

4.7.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Qyteti ka zbuluar sfidat vijuese kyçe të sektorit të Mbeturinave inerte në Prishtinë, si rezultat i angazhimit të palëve të interesit dhe analizës.

- **Përzgjedhja e lokacionit të duhur, si dhe ndërtimi i deponisë së re sanitare:** Kjo është një nga sfidat më të mëdha, pasi banorët lokalë shprehin shqetësimin kur deponia duhet të ndërtohet në afërsi me ta. Menaxhimi i dobët i deponisë ekzistuese Mirash nuk ka ndihmuar ngritjen e përshtypjes publike për sa i përket pranueshmërisë së deponisë së re.

- **Përzgjedhja e lokacionit të përshtatshëm dhe ndërtimi i deponisë së re dhe impiantit të përpunimit të materialeve nga mbeturinat ndërtimore dhe të rrënimt:** Qyteti ka sektor të fuqishëm ndërtimtarie, që prodhon vëllime të mëdha mbeturinash, që aktualisht hidhen në mënyrë të paorganizuar dhe të pakontrolluar, si dhe në vende të papërshtatshme në të gjithë qytetin. Kjo deponi (që do të financohet nga buxheti i komunës) do të shërbejë edhe për ndarjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave ndërtimore, duke përfshirë edhe largimin e mbeturinave të rrezikshme.
- **Ndarja në burim, grumbullimi i ndarë dhe riciklimi i kategorive specifike të mbeturinave, si letra, plastika, metali, qelqi, tekstili, mbetjet organike, si dhe materiet tjera të riciklueshme të pranishme në mbeturinat aktualisht të përziera:** Pjesa më e madhe e këtij materiali përfundon në deponinë e Mirashit, në vend që të ripërdoret apo riciklohet. Kjo praktikë rrit koston e shërbimit të operatorëve për grumbullimin e mbeturinave, mbingarkon kamionët e mbeturinave, humb kapacitete të çmuara të deponisë, si dhe prodhon ndikime negative mjedisore.
- **Mungesa e impianteve trajtuese për materiale të riciklueshme dhe mbeturina organike nga mbeturinat e përziera, si dhe për mbeturinat reziduale:** Disa ndërmarrje grumbullojnë sasi të konsiderueshme mbeturinash (qelqi, letre, metali, plastike, vajra e të tjera) të prodhuara nga sektori komercial, ose që mblidhen nga vetë banorët e qytetit. Deponimi dhe grumbullimi i mbeturinave i ndarë në burim aktualisht sigurohet vetëm për 1% të familjeve në Prishtinë. Pjesa më e madhe e grumbullimit të mbeturinave të riciklueshme, të tilla si plastika dhe metali, bëhet në mënyrë joformale. Çfarëdo rritje e konsiderueshme e trajtimit të ndarë të rrjedhave të mbeturinave nga mbeturinat aktualisht të përziera apo të përgjithshme do të kërkojë ndërtimin e impianteve për trajtim të mbeturinave.
- **Krijimi i instrumenteve financiarë dhe ekonomikë për të forcuar sektorin dhe për të arritur pajtueshmërinë mjedisore:** Ka sfida financiare me trysni nga operatori i deponisë (KRU Pastrimi) dhe Qeveria për të rritur tarifat e deponisë për të mbuluar kostot e

shërbimit, veçanërisht për të arritur respektimin e standardeve mjedisore, si dhe mirëmbajtjen pas mbylljes.

- **Sigurimi i pjesëmarrjes së publikut në shërbimet e ardhshme të sistemit të mbeturinave të ngurta:** Zhvillimi i infrastrukturës është vetëm një pjesë e sfidës. Një pjesë e rëndësishme është edhe gatishmëria e publikut të gjerë për të bashkëpunuar në shfrytëzim të shërbimeve të mbeturinave, bashkë me vetëdijesimin lidhur me infrastrukturën që ekziston, gjë që do të sillte dobi për Prishtinën.
- **Tregje të dobëta për shitje të produkteve të prodhuara nga materialet e riciklueshme, e të grumbulluara ndaras:** Aktualisht ka mungesë të tregjeve të riciklimit, të cilat do të siguronin kërkesën për produkte të ricikluara në të gjithë qytetin.

4.7.3 Çfarë jemi duke bërë aktualisht?

Ne jemi munduar të identifikojmë një vend të përshtatshëm për ndërtimin e deponisë së mbeturinave, por fatkeqësisht ende nuk e kemi zgjidhur këtë çështje. Si rezultat fundor, shpesh ka hedhje të parregullta të mbeturinave ndërtimore në të gjithë qytetin. Në veçanti, mbeturinat e Ndërtimit dhe Rrënimt (C&D) krijohen kryesisht nga ndërmarrjet e ndërtimit, ndërsa ata janë të detyruar të dërgojnë mbeturinat e tyre në deponinë për këto mbeturina. Për shkak të mungesës së impianteve për mbeturina shtazore, si dhe menaxhimit jo adekuat të mbeturinave spitalore, por edhe rrjedhave të tjera të mbeturinave të rrezikshme, rezultati është që këto mbeturina hidhen në kontejnerë komunalë që shpesh përfundojnë në deponinë e Mirashit.

Përkundër përpjekjeve tona të vazhdueshme, ende nuk kemi arritur të intensifikojmë aktivitetin e ndarjes së mbeturinave në burim, si dhe grumbullimin dhe riciklimin e materialeve të riciklueshme ndaras. Kjo ka sjellë sasi të mëdha të mbeturinave që duhen grumbulluar e depozituar, por edhe probleme mjedisore që shkaktohen nga kjo. Tarifa aktuale për mbeturina është vendosur në shumën prej 4.7 EUR për muaj/familje, me shumë fikse. Tarifat e deponisë janë 6.08 EUR për ton, që paguhet nga operatori i grumbullimit, si dhe përfshihen në kostot e shërbimit. Që nga viti 2018, Komuna ka marrë përsipër procesin e faturimit të shërbimeve

të grumbullimit të mbeturinave për ekonomitë familjare, përmes taksave komunale, ndërsa kontraktin operatorin publik ashtu siç kërkohet me ligj.

4.7.4 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Qëllimi i mëposhtëm strategjik është vendosur për Sektorin e Mbeturinave inerte.

Qëllimi 6.1– Të vendoset një sistem modern dhe i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave

Synim kryesor është krijimi i një hierarkie moderne të menaxhimit të mbeturinave, ku do të bënin pjesë të gjitha elementet e konceptit të menaxhimit të mbeturinave, me menaxhim më të mirë të deponive dhe marrjen e masave për minimizimin dhe parandalimin e mbeturinave. Masa e prodhimit të mbeturinave do të ulet me anë të inicimit të ndërmarrjes së fushatave sensibilizuese dhe prezantimin e sistemit të pagesave për mbeturinat, bazuar në sasinë e prodhuar të mbeturinave, e jo me shumë paushalle.

Kjo mund të arrihet duke përdorur mbeturinat organike të kompostuara për zonat e gjelbra të qytetit, si dhe për qëllime komerciale, duke përdorur mbetjet e ndërtimit dhe rrënimin si material i dobishëm për nivelizimin e rrugëve. Mund të ofrohen edhe stimulime fiskale për riciklimin e shisheve të plastikës e qelqit. Është me rëndësi të vendosen pika të grumbullimit të mbeturinave të rrezikshme në të gjithë qytetin, si dhe të ngriten vetëdija për ndikimet e mbeturinave të rrezikshme përmes fushatave publike.

Arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak mbështetës është dhënë më poshtë.

Caqet mbështetëse

Gjithsej 25% të mbeturinave urbane të riciklohen brenda Prishtinës deri në vitin 2030.

Një prej sfidave kryesore për Prishtinën është të përmirësojë ndjeshëm nivelin e aktivitetit të riciklimit, si dhe të sigurojë përpunimin dhe trajtimin efektiv të mbeturinave komunale.

4.7.5 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra për t'u zbatuar në pesë vitet e ardhshme në sektorin e mbeturinave inerte, për të mbështetur arritjen e caqeve afatmesme të përcaktuara më sipër.

Tabela 4.7 - Përmbledhje e Veprimeve në sektorin e Mbeturinave

ID#	Veprimi	Përshkrimi
WA1	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave në Prishtinë:	<ul style="list-style-type: none"> Ky veprim do të krijojë një plan të ri për menaxhimin e mbeturinave, që do të përfshin elemente të rëndësishme siç janë çmimet dhe financimi efektiv; strategjitë e informimit; përmirësimi i grumbullimit të mbeturinave; inkurajimi më i madh i riciklimit dhe prodhimit të energjisë, si dhe zbatimi i konceptit '3R'. Për të përmbushur këtë plan do të merren parasysh dy qasje - fillimi i një procedure për vendosjen e rregulloreve adekuate ligjore dhe ekonomike; si dhe fillimi i një fushate vetëdijesimi publik (në media qendrore dhe lokale), duke u përqëndruar tek parimet kryesore të menaxhimit efektiv dhe të qëndrueshëm të mbeturinave urbane.
WA2	Koncepti 3R- Reduktim, Ripërdorim, Riciklim i mbeturinave:	<ul style="list-style-type: none"> Kjo nismë do të mbështesë reduktimin e mbeturinave përmes zbatimit të konceptit '3R', që obligon të gjithë qytetarët, ndërmarrjet tregtare etj., të jenë të përgjegjshëm dhe t'i përmbahen detyrimeve ligjore për ndarjen e mbeturinave në burim dhe dërgimin e tyre në pikat e caktuara të grumbullimit. Do të krijohen impiante qendrore të përpunimit/grumbullimit të mbeturinave për mbledhjen dhe riciklimin/depozitimin përfundimtar tek impiantet e riciklimit. Veprimi do të mbështetet me shtrirjen e fushatave të gjera edukative në të gjithë qytetin, për të ngritur vetëdijen publike mbi dobritë e praktikave të mira të menaxhimit të mbeturinave.

WA1: Plani i Menaxhimit të Mbeturive në Prishtinë

Qëllimi – Hartimi i planit të menaxhimit të mbeturinave

Lloji i Veprimit – Planifikim / Rregullator / Financë

Përfitimet – Kapacitete administrative të qëndrueshme në menaxhim të mbeturinave

Kostoja – CAPEX: 50,000 €; OPEX: 150,000 €

2021		2022			2023		2024		2025 & Tutje	
	Planifikimi	Implementimi								

Përshkrimi

Qëllimi i kësaj mase është të hartohet plani i menaxhimit të integruar të mbeturinave, si dhe zhvillimi i kapacitetëve administrative sipas nevojave të qytetit. Plani duhet të përmbajë komponente thelbësore si stimujt efektivë të çmimeve dhe financimi; strategjitë e informacionit dhe financimi; përmirësimi i mbledhjes së mbeturinave; trajtimi i mbeturinave për të inkurajuar riciklimin dhe rigjenerimin e energjisë dhe zbatimin e konceptit 3R. Plani do të përfshijë dy qasje: ligjore dhe ekonomike.

Qasjet ligjore përfshijnë për shembull miratimin e udhëzimeve administrative dhe/ose dokumenteve të tjerë përkatës mbështetës; ndërsa qasjet ekonomike përfshijnë instrumentet e mëposhtëm:

- Sistemet e rimbursimit të depozitimit, të cilat mund të projektohen për të mbështetur riciklimin e ambalazheve njëpërdorimëshe të pijeve;
- Zbatimi i tarifave për shkelje;
- Vendosja e taksave për deponi e incineratorë;
- Skemat “pagesë për hedhje” mbeturinash janë skema që synojnë të stimulojnë riciklimin dhe parandalimin e mbeturinave, përmes tarifave të mbeturinave në bazë të asaj që familjet hedhin si mbeturinë;
- Tatimet në produkte, si ato për qeset plastike, apo gotat njëpërdorimëshe (me qëllim të trajtimit edhe të problemit të mbeturinave nëpër rrugë) ose për ambalazhim, mund të zbatohen për të mbështetur parandalimin e mbeturinave dhe për të gjeneruar të ardhura për masa plotësuese mjedisore; dhe



- Përdorimi i prokurimit “të gjelbër” publik për të zvogëluar prodhimin e mbeturinave, ose për të përmirësuar performancën mjedisore të produkteve të blera.

Masa përfshin edhe një fushatë informimi dhe vetëdijësimi. Kjo masë ka rol të rëndësishëm në formësimin e konsumit dhe të sjelljeve në menaxhim të mbeturinave të qytetarëve dhe bizneseve. Kjo do të ketë sidomos rëndësi nëse

ka shërbime të reja që ofrohen në qytet, si dhe në kontekstin e përpjekjeve për të zvogëluar prodhimin e mbeturinave.

Përfitimet kryesore

- Fillimi i procedurës për të vendosur rregullore të mirëfillta ligjore dhe ekonomike p.sh., me efekt të menjëhershëm; dhe
- Inicimi i fushatës së vetëdijesimit publik (media nacionale e lokale).

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 6.1 – Vendosja e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Përmirësimi i progresit të bërë drejt forcimit të kapacitetit institucional dhe organizativ të strukturave të menaxhimit të mbeturinave;
- Rritja e numrit të planeve/udhëzimeve administrative të dakorduara; dhe
- Rritja e numrit të aktiviteteve vetëdijesuese të realizuara.

Konteksti aktual

Rolet dhe përgjegjësitë për qeverinë qendrore dhe lokale janë përcaktuar në ligj, por, për arsye historike, nuk janë realizuar qartë në praktikë. Ligji për Mbeturinat përcakton qartë përgjegjësitë për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën se si ato duhet të ndahen midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale. Çështja kryesore është se historikisht, përgjegjësia për menaxhimin e mbeturinave ka qenë tek qeveria qendrore, ndërsa kompetencat nuk janë transferuar ende mirë tek pushteti lokal. Bartja e përgjegjësive tek pushteti lokal pengohet kryesisht nga fakti që pushteti lokal shpesh ka burime të pamjaftueshme teknike dhe financiare për të ofruar shërbimet e kërkuara. Prandaj, është e nevojshme që planet komunale për menaxhimin e mbeturinave të hartohen sipas nevojave dhe kapaciteteve specifike të komunës, ashtu që konceptet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Kostoja e investimit

Gjithsej CAPEX - afro 50,000 € (miratimi i politikës; VSM afro 20,000 Euro dhe 30,000 Euro për fushatën e vetëdijesimit publik).

Gjithsej Kosto OPEX - afro 150,000.00 € (zbatimi i politikave mbulohet nga rimbursimi i tarifave).

Përputhshmëria me burimet e financimit

Komuna e Prishtinës, Qeveria – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë
Përputhje e mirë Përputhje e mundshme Përputhje e dobët		

Dobitë e kombinuara sociale e ekonomike

Modernizimi i planit të menaxhimit të mbetjeve me përfitimet ekonomike në drejtim të zvogëlimit të mbeturinave dhe / zvogëlimit të ndotjes. Futja e skemës së rimbursimit të depozitave mund të shërbejë gjithashtu si një burim i të ardhurave për njerëzit e angazhuar në riciklim (profesionalisht dhe për familjet më të varfra).

Implementimi

Afatet kohore: Planifikim TM3 - TM4 2021; Implementim TM2 2022 - TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komuna e Prishtinës, KRM Pastrimi

Rreziqet kryesore në zbatim: Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme, pasi masa përputhet qartë me zotimet ekzistuese politike në fushën e strategjive lokale dhe nacionale të mbeturinave.

Potenciali i Qytetit Inteligent – Potenciali për përfitim

Masa nuk parashihet të përfshijë ndonjë komponent inteligjent të drejtpërdrejtë, megjithatë ekziston një potencial i konsiderueshëm i monitorimit dhe kontrollit digjital të aseteve.

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet menaxhimin efektiv të sektorit të mbeturinave, me ndikim pozitiv në mjedis dhe ndikime socio-ekonomike.

WA2: '3R - REDUKTİM, RIPËRDORIM, RICIKLIM' – KONCEPTI I MBETURINAVE

Qëllimi – Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave përmes praktikave të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave, duke mbështetur kështu zhvillimin ekonomik të Qytetit.

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë / Rregullator

Përfitimet – Sasi më e vogël e mbeturinave, si dhe praktika më të mira të menaxhimit të mbeturinave

Kostoja – CAPEX: 5 milionë €; OPEX: 60,000 €/vit

2021		2022			2023			2024			Përtej		
	Planifikimi	Implementimi											

Përshkrimi

Kjo iniciativë do të mbështesë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave, derisa mbështet dhe zhvillimin ekonomik të qytetit. Masa do t'i ndajë palëve të prekura (qytetarë, ndërmarrje komerciale, industrinë, etj.) përgjegjësi dhe detyrime ligjore për klasifikimin e mbeturinave në burim, si dhe dërgimin e tyre në pikat e caktuara të grumbullimit. Qyteti/operatori do të vendosë tarifën, me masa ligjore, të grumbullimit të kategorive të ndryshme të mbeturinave, ku secila vendoset në qese mbeturinash transparente për identifikim më të lehtë nga grumbulluesit.

Masa mëton të mbështesë qasjen pjesëmarrëse të bizneseve dhe komuniteteve të ndryshme, përmes një numri skemash mbështetëse. Për shembull, qyteti mund të bashkëpunojë me prodhuesit për të krijuar produkte që shkaktojnë më pak mbeturina dhe për të zbatuar skemat e "kompensimit" për rinovimin ose riciklimin e produkteve që kanë arritur fundin e ciklit të tyre të jetës, ndërsa ekonomitë familjare mund të paguajnë sipas sasisë së mbeturinave që prodhojnë, p.sh. tarifa e vendosur në qeset e mbeturinave (Flandri, rasti i Belgjikës). Përveç kësaj, sektori joformal do të mund të përfshihej si pjesë formale e sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave inerte. Implementimi i masës do të kërkojë hartimin e dokumenteve të planifikimit, si "Strategjia e Parandalimit të Riciklimit të Mbeturinave", pasuar nga "Plani i Veprimit" përkatës. Dokumentet mëtojnë të shqyrtojnë edhe opsionin e ndarjes në burim të mbeturinave të riciklueshme, si dhe të mbetjeve të tjera. Skenari optimal do të identifikohet, bashkë me infrastrukturën relevante (shportat/kontejnerët, automjetet, qendrat e riciklimit, impiantet e rikuperimit, etj.), sipas vendbanimeve specifike urbane të qytetit. Plani i ri duhet të mbështetet me fushata të gjera edukative, për të rritur vetëdijen publike për dobinë e menaxhimit efektiv të mbeturinave.



Përfitimet kryesore

- Përcaktimi i kategorive të mbeturinave dhe pikave të grumbullimit;
- Kontejnerët dhe/ose qeset e mbeturinave me shenja të caktuara;
- Qendrat e riciklimit dhe infrastruktura përcjellëse, p.sh kamionë të specializuar për grumbullim; dhe

- Inicimi i fushatave të gjera edukative.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 6.1 – Vendosja e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Numri i pikave të caktuara për grumbullimin e mbeturinave të ndara;
- Masa e mbeturinave që klasifikohet dhe riciklohet, gjithsej, si dhe sipas llojit të mbeturinave p.sh. Letër, qelq, bateri, PVC, shishe, metale, etj.;
- Numri i objekteve mbështetëse të realizuara me etiketimin e kategorive të mbeturinave;
- Sasia e mbeturinave të prodhuara për kokë banori; dhe
- Numri i aktiviteteve të realizuara të vetëdijesimit.

Konteksti aktual

Rëndësia e konceptit "3R" është gjerësisht e pranuar si pjesë e planeve dhe strategjive të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave, por nuk praktikohet. Në nivel bazë, për të arritur objektivat e legjisllacionit të mbeturinave, duhen vendosur synimet e riciklimit, rikuperimit e ripërdorimit me masa e instrumente ligjore, për të siguruar që janë të përshtatshme për zbatim.

Ekzistojnë disa instrumente administrative që janë miratuar, por ka masa të papërshtatshme për arritjen e synimeve përkatëse të parimit të përgjegjësisë së prodhuesit. Kjo është e dukshme, për shembull, tek niveli i zhvillimit të infrastrukturës për reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave, që mbetet i kufizuar. Shkalla e riciklimit është e ulët, pothuajse inekzistente, ndërsa shumica e mbeturinave shkojnë direkt në deponi. Janë ndërmarrë pak iniciativa nga organizatat lokale mjedisore, të mbështetura nga donatorët; megjithatë, koncepti nuk zbatohet si pjesë e konceptit institucional të menaxhimit të mbeturinave.

Kostoja e investimit

Gjithsej Kosto CAPEX – 5,000,000 €; përfshirë 3,400,000 € për qendrat e riciklimit (numri i qendrave të riciklimit varësisht nga kategoritë e përcaktuara të mbeturinave, p.sh., 1,500,000 € për kamionë grumbullues; 50,000 € hartimi i dokumenteve të planifikimit; fushata e vetëdijesimit 50,000 €).

Gjithsej Kosto OPEX – afro 60,000 € për qendër riciklimi dhe infrastrukturë mbështetëse; në baza vjetore.

Përputhshmëria me burimet e financimit.

Ka të ngjarë të implementohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi - potencialisht me mbështetjen e bashkisë / kombëtar / donatorëve. Përfshirja e IFN-ve dhe / ose PPP (koncesioni) mund të jenë të përshtatshme.

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Dobitë e kombinuara sociale e ekonomike

Përfitimi kryesor është arritja e niveleve më të larta të ndarjes primare dhe riciklimit gjatë gjithë investimeve në mbledhjen e mbeturinave dhe infrastrukturën e ndarjes. Koncepti 3R do të promovohet gjatë fushatave të gjera edukuese.

Implementimi

Afatet kohore: Planifikim TM3 2021 – TM2 2022, Implementim TM2 2022 – TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi, Komuna e Prishtinës

Palët e interesit: Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi, Komuna, Odat Ekonomike

Rreziqet kryesore në zbatim: Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Masa mund të kontribuojë në konceptin e qytetit inteligjent, përmes modaliteteve të ndryshme, për shembull monitorimi i digjitalizuar. Zgjidhje të avancuara inteligjente mund të jenë edhe sensorët për koshat (ose pikat e riciklimit) për të ndihmuar në optimizimin e vijave të qarkullimit, por edhe analizat e sjelljes së konsumatorëve.

Sinergjia me veprimet tjera

- Mbështet përmirësimin e mjedisit të ujit, tokës dhe ajrit duke zvogëluar ndotjen e shkarkimeve të padëshiruara të mbetjeve.
- Mbështet sektorin ekonomik me krijim të të ardhurave dhe ulje të shkallës së papunësisë.

4.8 Ndryshimet klimatike

4.8.1 Hyrje

Përderisa ka angazhim të qartë kombëtar për të ulur emetimet e gazrave serrë të paktën 35% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990, ende nuk është zhvilluar ndonjë plan specifik për Ndryshimet Klimatike, ku do të trajtoheshin veprimet zbutëse. Planet zhvillimore të qytetit trajtojnë temën e ndryshimeve klimatike, duke parashikuar një tranzicion të madh drejt sektorit të shërbimeve, gjë mund të ndihmojë në uljen e emetimeve nga sektori industrial. Programi i Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Qytetit të Prishtinës për periudhën 2016-2020 ka identifikuar një numër prioritetesh lidhur me adresimin e 'ekonomisë së gjelbër', përfshirë uljen e emetimeve të ajrit nga burimet mobile me të paktën 1% krahasuar me nivelet e vitit 2015.



Një sërë nismash ndër-sektoriale janë duke u zhvilluar, duke përfshirë si vijon:

- **Transporti:** ulja e emetimeve dhe ndotjes nga automjetet, Sistemet Inteligjente të Transportit, zgjerimi i rrjetit të biçikletave;
- **Ndërtesat:** Përmirësimi i fondit banesor, duke përfshirë investimet në ndërtime të reja me efikasitet të energjisë;
- **Energjia:** Modernizimi i sistemeve të ngrohjes qendrore dhe trajtimi i teknologjive si pompat e ngrohjes dhe kolektorët diellorë;
- **Industria:** Modernizimi i objekteve industriale dhe optimizimi i komplekseve industriale;
- **Ujërat:** Krijimi i rezistencës përmes furnizimeve alternative, përmirësimi i impianteve të trajtimit (shërbimet e ujës-jellësit dhe ujërave të zeza) dhe përmirësimi i kanalizimit atmosferik komunal;
- **Mbeturinat:** Përfshihen investimet në stabilimente riciklimi e kompostimi, si dhe tek masat në anën e kërkesës, siç janë skemat e depozitimit dhe investimet në vetëdijesim publik.

Ne vazhdojmë të adresojmë prioritetet kombëtare përmes "Programit Shtetëror të Kursimeve të Energjisë për periudhën 2016-2020", duke përcaktuar drejtësit kryesore të politikave që identifikojnë reduktimin e konsumit të energjisë; janë përcaktuar treguesit për caqet e qytetit, të cilët do të përmbushen deri në fund të periudhës raportuese. Në nivel kombëtar, si dhe pas kërkesës nga Zyra e Presidencës së Kosovës, BERZH-i është pajtuar të mbështesë Qeverinë e Kosovës në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë.

Programi Kombëtar i Komisionit Shtetëror për Masat e Zbutjes së Ndikimit nga Ndryshimet Klimatike 2013-2020 gjithashtu rendit objektivat për tkurrjen e emetimeve të GS-ve për Zbutjen e Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike, duke rritur furnizimin e energjisë së ripërtërishme, si dhe duke përmirësuar efikasitetin e energjisë.

Adaptimi

Sa i përket zbutjes së ndikimit të ndryshimeve klimatike, Prishtina ende nuk ka hartuar plan specifik për ndryshimet klimatike, që do të trajtonte veprimet lidhur me adaptimin dhe rezistencën. Komunikata e Gjashtë Shtetërore e Republikës së Kosovës dhe Programi Kombëtar i Komisionit

Shtetëror për Masat e Zbutjes së Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike 2013 - 2020, theksojnë që sektorët më të ndjeshëm ndaj Ndryshimeve Klimatike janë bujqësia, pylltaria, menaxhimi i ujërave, energjia, ndërtimi dhe sfera sociale.

Vlerësimi Kombëtar i Cënueshmërisë Klimatike përcakton masat e adaptimit që lidhen posaçërisht me sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë, si dhe ndikimet mbi shëndetin njerëzor, ku përfshihen veprime në sektorin e ujërave (vërshimet dhe cilësia e ujit). Në veçanti, ky rekomandon:

- Përmirësimin e legjislacionit mjedisor, posaçërisht, hartimin e një dokumenti të vetëm mbi adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, që do të koordinonte punën e agjencive të ndryshme në këtë fushë;
- Angazhim i rritur me OSHC-të;
- Përmirësimi i ndërveprimit të organeve shtetërore për Ndryshime Klimatike dhe përfshirja e OSHC-ve; dhe
- Rritja e kapaciteteve, pra zhvillimi i kapaciteteve dhe vetëdijësimi i organizatave të ndryshme që kanë përgjegjësi në planifikim e zbatim të çështjeve të ndryshimeve klimatike.

Dokumenti "Tërësia rajonale e aktiviteteve për Programin Shtetëror të mbrojtjes së mjedisit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore për periudhën 2016-2020 në Qytetin e Prishtinës" përcakton aktivitetet dhe masat e orientuara kah mbrojtja e mjedisit, ndërtimi i parqeve dhe zonave të gjelbra, biodiversiteti, menaxhimi i mbeturinave dhe ujit, monitorimi i burimeve natyrore. Të gjitha këto rekomandime kanë gjasë të barten tek niveli i qytetit, këtu në Prishtinë.

4.8.2 Cilat janë sfidat dhe përparësitë kryesore?

Qyteti ka identifikuar sfidat vijuese të lidhura me Ndryshimet Klimatike në Prishtinë, si rezultat i analizës së treguesve të PVQGJ-së, si dhe përmes angazhimit të palëve të interesit.

Politika ndaj ndryshimeve klimatike: Së voni, Qeveria ka shpallur përkushtimin e saj shtetëror për të ulur ndjeshëm emetimet, në një deklaratë dërguar Sekretariatit të OKB-së¹⁶. Ka po ashtu synime për të

marrë përsipër zotimin e pakushtëzuar për uljen e emetimeve të gazrave serrë të paktën 35% deri në 2030, krahasuar me nivelet e regjistruara në vitin 1990. Komisioni Shtetëror për Ndryshimet Klimatike është përgjegjës për politikën për Ndryshimet Klimatike, megjithëse natyrisht, pothuajse çdo subjekt në Prishtinë parimisht do të duhej të merrte përsipër një lloj përgjegjësie për Rezistencën dhe Zbutjen e ndikimit të Ndryshimeve Klimatike në sektorin përkatës të tyre.

Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike nga projektet investive:

Proceset aktuale të kontrollit të zhvillimit/ndërtimit nuk përmbajnë pika lidhur me çështjet e Ndryshimeve Klimatike në Prishtinë. Për shembull, nuk ka ndonjë mekanizëm për të siguruar që të gjitha investimet e reja janë rezistente ndaj Ndryshimeve Klimatike, si dhe janë të mbrojtura, në të ardhmen, nga ndikimet e mundshme të Ndryshimeve Klimatike. Derisa rastet e motit ekstrem po bëhen më të shpeshta, dështimi në zbatimin e masave të tilla mund të dobësojë dobinë e investimeve të reja. Në korrik të vitit 2018, reshjet ekstreme të shiut shkaktuan çorientim në Prishtinë, me ndikim të posaçëm mbi sistemet e transportit. Aktualisht, kjo prek sektorin e transportit dhe atë të ujërave të zeza, si dhe është e qartë që ka nevojë për planifikim më të mirë, ashtu që të rritet rezistenca e kanalizimeve atmosferike.

Ka po ashtu nevojë të sigurohet që investimet të mund të kontribuojnë në zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike, duke shmangur çdo rritje të emetimeve të GS-ve, gjë që do ta ndihmonte Prishtinën të demonstrojë kontributin e saj në angazhimet shtetërore lidhur me ndryshimet klimatike.

¹⁶ Shih https://atom.belta.by/en/news_en/view/Kosovo-announces-commitment-to-significantly-reduce-emissions-10400/.

4.8.3 Çfarë qëllimesh e caqesh strategjike janë vendosur, si dhe pse?

Qëllimet vijuese strategjike janë vendosur sa i përket Ndryshimeve Klimatike, ndërkaq arsyeshmëria e përmbledhur për secilin Cak Afatmesëm mbështetës është dhënë më poshtë.

Qëllimi Strategjik 8.1 - Qytet që kupton dhe menaxhon mirë cenueshmërinë e tij ndaj ndryshimeve klimatike

Mungesa aktuale e të dhënave rreth kostove të mundshme të që lidhen me rastet e motit ekstrem duhet të trajtohet, ashtu që të ketë njohuri e konsensus lidhur me dobësitë e Qytetit, si dhe nevojën për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike.

Caqet mbështetëse

Të rritet niveli i njohurive lidhur me dobësitë në fushën e ndryshimeve klimatike, të cilat kërkojnë planifikim aktiv për adaptim (planifikimi urban që merr parasysh edhe rreziqet e fatkeqësive të tilla).

Aktualisht, ka mungesë të njohurisë se Prishtina mund të ballafaqohet me sfida nga ndryshimet e kushteve klimatike, përderisa ekziston gjithashtu nevoja për njohuri më të mira lidhur me rreziqet specifike ndaj të cilave duhet të adaptohemi ne në qytet.

Qëllimi Strategjik 8.2 - Të menaxhohet cenueshmëria/ndjeshmëria ndaj ndryshimeve klimatike në kontekstin e gjerë të qëndrueshmërisë (pra, të sigurohet rezistenca dhe adaptueshmëria e infrastrukturës së re të Prishtinës kundrejt streseve klimatike dhe rasteve tronditëse, përfshirë pandemitë)

Ka nevojë që çështjet e rezistencës klimatike të bëhen pjesë e të gjitha fushave të planifikimit urban, si dhe që fokusi të jetë tek planifikimi i hapësirave të gjelbra, zgjidhjet infrastrukturore, kriteret e projektimit të

ndërtesave, si dhe planifikimi i sistemit të transportit. Këtu duhen trajtuar edhe çështjet e efikasitetit të energjisë për infrastrukturën, ndërtimin por dhe zgjidhjet e transportit.

4.8.4 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Ne kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (për t'u zbatuar në pesë vitet e ardhshme) në Sektorin e Ndryshimeve klimatike, për të mbështetur arritjen e caqeve afatmesme të përcaktuara më sipër. Këto janë përmbledhur si vijon në Tabelën 4.8, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4.8 - Përmbledhje e Veprimeve në sektorin e Ndryshimeve Klimatike

ID#	Veprimi	Përshkrimi
CC1	Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i rezistencës klimatike të infrastrukturës së qytetit, për identifikimin e komponentëve infrastrukturorë dhe identifikimin e zonave të rrezikuara të banimit që kërkojnë vëmendje, duke mundësuar hartimin e planeve për adresimin e tyre.
CC2	Përgatitja e Planit të Veprimit për Rreziqet Emergjente Klimatike:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ky veprim përqendrohet në përgatitjen e një plani emergjence, i cili do të identifikojë aktivitetet ekonomike që mund të ndikohen nga ngjarjet e pafavorshme klimatike dhe pikat e nxehta të cenueshme në qytet. ▪ Do të përgatiten dhe veprime specifike për palët publike e private, që të ndihmojnë në zbutjen dhe parandalimin e rreziqeve, si dhe të udhëzohen si të veprojnë në raste emergjente. ▪ Masa përfshin: <ul style="list-style-type: none"> ○ Aktivitete vetëdijesimi të shëndetit publik rreth Ndryshimeve Klimatike dhe Sjelljeve Përshtatëse; ○ Shpërndarja e informatave mbi veprimet gjatë ngjarjeve ekstreme klimatike (p.sh. valët e të nxehtit); dhe ○ Shpërndarja e informatave mbi veprimet në rast të epidemive që shfaqen si pasojë e ndryshimeve klimatike.
CC3	Vlerësimi i Rrezikut të Përmytjeve:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitja e një sërë studimesh, të cilat më pas do të orientojnë përzgjedhjen e masave të planifikimit dhe ndërtimit, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Vlerësimin e rreziqeve ndaj mbrojtjes ekzistuese nga përmytja; ○ Masat për zbutjen e rreziqeve nga përmytjet; dhe ○ Studimin e korridoreve të kaltër-gjelbër.

CC1: Planifikimi Urban Inteligjent dhe i Adaptueshëm ('Resilient')

Qëllimi – Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent (të adaptueshëm) për të zvogëluar cënueshmërinë e infrastrukturës së qytetit

Lloji i Veprimit – Planifikim

Përfitimet – Rritja e rezistencës dhe adaptueshmërisë së infrastrukturës së qytetit dhe ulja e kostove të trajtimit të ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe rasteve ekstreme të motit

Kostoja – CAPEX: 150,000 €; OPEX: i pa aplikueshëm

2021		2022		2023		2024		Përtej	
		Planifikimi		Implementimi					


Përshkrimi

Qëllimi i planifikimit urban inteligjent dhe të adaptueshëm ('resilient') është të përfshijë aspektet e adaptueshmërisë në të gjitha fushat e planifikimit urban, me qëllim që infrastruktura dhe plani i qytetit të Prishtinës të jenë të adaptueshme / qëndrueshme ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në të ardhmen, siç janë rastet ekstreme të motit dhe ndryshimet graduale të tij. Kjo masë do të kërkojë fokus të posaçëm në planifikim të hapësirave të gjelbra, zgjidhje të infrastrukturës, standarde të projektimit, si dhe planifikim të sistemit të transportit. Ajo duhet të adresojë edhe çështjet e efijencës së energjisë për infrastrukturën, ndërtimin dhe zgjidhjet e transportit.

Kjo masë duhet të prodhojë një udhëzues për planifikimin urban inteligjent dhe të adaptueshëm për Prishtinën dhe mund të bëhet në dy faza: planifikimi dhe implementimi. Brenda fazës së parë (planifikimit), do të konfirmohen objektivat e udhëzimeve, fushëveprimi i tyre dhe do të caktohet një ekspert/ekip përgjegjës për këtë projekt brenda Komunës së Prishtinës.

Pasi të konfirmohen këto elemente, eksperti/ekipi përgjegjës do të përgatisë vetë ose me ndihmën e konsulentëve të jashtëm, udhëzimet (faza e zbatimit). Kjo masë do të përfshijë veprime për të vlerësuar adaptueshmërinë ('resilience') klimatike të infrastrukturës së qytetit, për të identifikuar komponentet e riskut në

infrastrukturë dhe për të identifikuar zonat e banuara që kërkojnë vëmendje në të ardhmen e afërt, por edhe për të mbështetur planifikimin në të ardhmen.



Aspektet bazë të planifikimit urban të adaptueshëm ('resilient') do të duhej të formulohen si udhëzues, e të zbatohen në drejtorinë e Komunës që është përgjegjëse për planifikimin urban. Qasjet inovative për planifikimin e qytetit, të

tilla si për shembull zhvillimi i një binjaku dixhital ('digital twin') të qytetit për të ndihmuar në planifikim, mund të shihen si mundësi në këtë fazë.

Pasi të përfundojnë, udhëzuesit do të duhet t'u komunikohen të gjitha palëve të interesit. Ka shumë gjasë të ketë nevojë për zhvillim të kapaciteteve brenda drejtorive përkatëse. Udhëzuesit duhen rishikuar dhe përditësuar në baza të rregullta.

Përfitimet kryesore

- Rritja e adaptueshmërisë së infrastrukturës së qytetit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike;
- Kosto më të pakta gjatë ballafaqimit me rastet ekstreme të motit dhe tendencat klimatike në ngritje; dhe
- Shqetësime më të pakta për bizneset lokale lidhur me ndryshimet klimatike.

Cilësi më e mirë e jetesës për banorët e qytetit, për shkak të zgjidhjeve më inteligjente në qytete (p.sh. më shumë hapësira të gjelbra, rrjete inteligjente të transportit).

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 2.1. – Përmirësimi dhe ndërtimi i një mënyrë efikase të përdorimit të energjisë dhe burimeve të saj, me qëllim dekarbonizimin gradual të sektorit të ndërtimit të qytetit; dhe
- Qëllimi 8.2. – Adaptueshmëri/qëndrueshmëri e infrastrukturës së re të Prishtinës përballë trysnive kronike të klimës dhe ngjarjeve katastrofike.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të ulet përqindja e infrastrukturës publike në rrezik; dhe
- Të ulet përqindja e ekonomive familjare në rrezik.

Konteksti aktual

Ekzistojnë hapa të caktuar që mbështesin këtë masë, të cilët përfshihen në Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike në Kosovë (p.sh. promovimi i ndërtimit ekologjik). Sidoqoftë, deri më sot, dispozitat e caktuara që përfshijnë

adaptueshmërinë/qëndrueshmërinë në planifikimin e qytetit nuk janë zbatuar ende.

Do të ketë nevojë për hartimin e udhëzuesve të qartë për zbatimin e aspekteve të adaptueshmërisë ('resilence'), bashkë me zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 150.000€

Gjithsej Kosto OPEX – N/A

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Spektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 2021 – TM2 2022; Implementimi TM3 2022 - TM2 2024

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Komuna e Prishtinës (Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm)

Palët e interesit:

Drejtoritë e ndryshme të Komunës me përgjegjësi në planifikim dhe zbatim të planeve të qytetit, infrastrukturë, ndërtesa dhe zgjidhje të transportit; Ofruesit e shërbimeve të zhvillimit dhe zbatimit të zgjidhjeve si më sipër

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Mungesa e të dhënave në dispozicion për të mbështetur vlerësimin mund të ketë ndikime negative në rezultatet dhe përfundimet e tij. Ky rrezik mund të lehtësohet përmes rishikimit dhe përmirësimit të proceseve të mbledhjes së të dhënave për treguesit kryesorë të përdorur në këtë vlerësim.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Potenciali për implementim të infrastrukturës inteligjente të matjes së energjisë, si njehsorët inteligjentë (p.sh. energji elektrike/ujësjellës), që do të mundësonte mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave dhe menaxhim më të mirë-informuar të energjisë. Potencial për të ofruar shërbime për banorët dhe bizneset, për të monitoruar dhe menaxhuar konsumin e tyre të energjisë përmes aplikacioneve në telefona mobil.

Po ashtu ka potencial për krijimin e një Platforme Digjitale të Qytetit për të ndihmuar në përmirësimin e vendim-marrjes në planifikim urban.

Sinergjia me veprimet tjera

Ka lidhje të qarta me Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU), i cili synon të përmirësojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit të transportit të qytetit, duke zhvilluar dhe promovuar zgjidhje me më pak karbon.

CC2: Përgatitja e Planit të Veprimit për Rreziqe Emergjente Klimatike

Qëllimi – Të sigurohet që qyteti të jetë i përgatitur të veprojë shpejt dhe i organizuar në rast të emergjencave të lidhura me klimën

Lloji i Veprimit – Planifikim/Politikë

Përfitimet – Zbutja e ndikimit të emergjencave të lidhura me klimën

Kostoja – CAPEX: 300,000 €, OPEX: i pa aplikueshëm

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje		
			Planifikimi			Implementimi								

Përshkrimi

Duke pasur parasysh që me rritje e ndikimit të ndryshimeve klimatike, shpeshtësia dhe ashpërsia e emergjencave të lidhura me klimën do të rriten, si rrjedhojë është i rëndësishëm ekzistimi i një plani cilësor veprimi për rreziqet emergjente klimatike. Prandaj, kjo masë sugjeron përgatitjen e një plani emergjence i cili do të identifikojë aktivitetet ekonomike të cilat mund të ndikohen nga ngjarjet e pafavorshme të motit dhe pikat e dobëta / të cenueshme në qytet.

Si hap i parë (planifikimi), do të ishte e nevojshme të identifikohet qëllimi i këtij plani, fushëveprimi i tij, aktorët kryesorë, ekipi përgjegjës për zbatimin e tij dhe detajet operacionale, siç është buxheti për zhvillimin e planit të veprimit. Pasi të konfirmohen këto detaje, ekipi përgjegjës do të vazhdojë me zhvillimin e planit (faza e zbatimit). Mund të kërkohet ndihmë nga konsulentët e jashtëm nëse është e nevojshme. Zhvillimi i planit të veprimit do të përfshijë analizën e pikave të dobëta ndaj klimës dhe mund të mbështesë shumë masa të tjera të lidhura me adaptueshmërinë ('resilience'), të cilat propozohen në këtë plan. Planit gjithashtu mund të mbështetet në rezultatet e masave të tjera si përdorimi potencial i një binjaku dixhital ('digital twin') të qytetit, nëse është rënë dakord për një gjë të tillë në veprimin e planifikimit urban inteligjent dhe të adaptueshëm (CC1).

Pjesa e dytë e zhvillimit të planit të veprimit duhet të identifikojë pjesët më të cenueshme të qytetit dhe (ii) përgatitjen e veprimeve për aktorët publikë dhe privatë për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet e identifikuar, si dhe (iii) veprimet në raste emergjente. Kjo do të informojë sektorin privat mbi ekspozimin ndaj rrezikut dhe do të ndihmojë në koordinimin e zvogëlimin të rreziqeve dhe



sjelljes në emergjencë. Ky proces do të kërkojë angazhimin e palëve të interesit dhe ndërtimin e kapaciteteve në bashkëpunim me bizneset lokale dhe komunitetet.

Masa gjithashtu përfshin një fushatë ndërgjegjësuese që duhet të përqendrohet në vetëdijesimin për shëndet publik në raport me ndryshimet klimatike dhe sjelljet adaptuese, duke përfshirë:

- Informatat mbi rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe ndryshimin e trendeve të motit;
- Informatat mbi sjelljen/veprimet gjatë rasteve ekstreme të motit (p.sh. si të sillemi në një valë nxehtësie); dhe
- Informatat mbi sjelljet/veprimet në rast të epidemive që shfaqen si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Kjo do t'i informonte më shumë njerëzit për reagimet e tyre ndaj ndryshimit të trendeve të motit dhe ngjarjeve ekstreme të motit, duke zbutur kështu ndikimin në shëndetin e tyre.

Pasi të përfundojë, plani do të duhet t'u komunikohet të gjitha palëve relevante të interesit. Do të duhet të rishikohet dhe përditësohet rregullisht.

Përfitimet kryesore

- Zbutja e ndikimit ekonomik të emergjencave të lidhura me klimën;
- Harta e pikave të nxehta ('hot spots') klimatike mbështet strategjinë e gjerë të adaptueshmërisë ('resilience') së qytetit;
- Angazhim më i lartë i sektorit privat në mbështetje të zbatimit të masave adaptuese;
- Informim më i mirë, si dhe komunitete më të adaptueshme;
- Përmirësim i cilësisë së jetës dhe gjendjes shëndetësore në kuadër të ndryshimit të trendeve të motit;
- Zvogëlim i kostove të sistemit të shëndetit publik për shkak se njerëzit ndikohen më pak nga ndryshimet e motit dhe ngjarjet tjera të shkaktuara nga klima, të tilla si epidemitë; dhe
- Zvogëlim i ndikimit në biznese, si dhe potencialisht mundësi të reja biznesi në reagim ndaj ndryshimeve klimatike.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 8.1 – Menaxhimi i pikave të cënueshme në kuptimin e ndryshimeve klimatike në kontekst më të gjerë të qëndrueshmërisë (duke përfshirë pandemitë); dhe
- Qëllimi 10.1 – Vendosja e një marrëdhënie më efektive për angazhimin e palëve të interesit për të përmirësuar planifikimin dhe vendimmarrjen.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të zvogëlohet potenciali për dëme ekonomike, të përllogaritura si fraksion i PBB-së, nga fatkeqësitë natyrore (vërshimet, thatësit, tërmetet, etj.);
- Të rritet përqindja e popullatës së informuar me sjelljet që lidhen me përshtatshmërinë; dhe
- Të rritet përqindja e bizneseve të rrezikuara që janë të informuara për ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike.

Konteksti aktual

Qyteti i Prishtinës aktualisht nuk ka plan adekuat emergjent që mund të përfshijë emergjencat e lidhura me ndryshimet klimatike. Pasi të identifikohen dhe vendosen në hartë, rreziqet specifike klimatike duhet të përfshihen në planet ekzistuese emergjente. Do të ketë nevojë për angazhim të madh nga drejtoritë që kanë përgjegjësi për reagimin ndaj emergjencave. Ekzistojnë hapa të caktuar që mbështesin këtë masë, e të cilët përfshihen në Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike në Kosovë (p.sh. Vlerësimi i rreziqeve dhe trajnimi për menaxhim). Sidoqoftë, deri më sot, nuk është ndërmarrë ndonjë fushatë ndërgjegjësuese për publikun ose për bizneset. Ekspertët e qytetit mund të kenë nevojë për mbështetje nga ekspertët të jashtëm për të ndihmuar në konceptimin dhe përgatitjen e fushatës.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 300,000 €

Gjithsej Kosto OPEX – i pa aplikueshëm

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës, Buxheti Qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimburohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikim TM3 2021 – TM2 2022; Implementim TM3 2022 – TM2 2024

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza):

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm (Komuna)

Palët e interesit:

Ekipet Reaguese Emergjente, Komunitetet lokale, Bizneset lokale, OJQ-të, institucionet arsimore

Rreziqet kryesore në zbatim:

- Zbatimi i kësaj mase do të mbështetet në të dhënat në dispozicion dhe në bashkëpunimin ndërmjet palëve të ndryshme në të gjithë qytetin.
- Për të zbutur rreziqet që lidhen me këtë varësi, është e rëndësishme të fillohen veprimet në angazhim të palëve të interesit që në fillim të procesit, për të rritur bashkëpunimin dhe të dhënat në dispozicion për këtë masë.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Me zhvillimin e një harte të pikave të nxehta ('hot spots') klimatike, kjo masë ka potencialin të prodhojë informata të vlefshme që mbështesin analizën dhe reagimin inteligjent të qytetit dhe optimizimin e ofrimit të shërbimeve emergjente. Teknologjitë digjitale në dispozicion mund të merren parasysh për të parë se si mund të mbështesin krijimin e hartës së pikave të nxehta klimatike.

Fushata vetëdijesuese – ky element mund të përfshijë komunikimin përmes një aplikacioni i cili do t'u dërgonte qytetarëve njoftime, përkujtesa dhe këshilla se si të sillen gjatë ngjarjeve ekstreme të motit. Përderisa ka pak gjasa që një aplikacion i tillë të zhvillohet si i veçantë, ai mund të përfshihet si modul në një aplikacion më të madh të mbështetur nga qyteti, që informon qytetarët për zhvillimet në qytet.

Sinergjia me veprimet tjera

- Sinergji me masat në sektorin e ndërtimit, me identifikimin e objekteve të cenueshme.
- Sinergji me masat në sektorin e ndërtimit, me stimulimin e zbatimit të masave adaptuese në ndërtesa.
- Sinergji me sektorin e industrisë, me zvogëlimin e cënueshmërisë së ndërmarrjeve.

CC3: Adaptueshmëria ('resilience'): Vlerësimi i mbrojtjes nga përmbytja

Qëllimi – të kuptohen pikat e dobëta në sistemin ekzistues të mbrojtjes nga përmbytja, për të informuar zgjidhjet për zbutjen e rreziqeve të vërshimeve

Lloji i Veprimit – Planifikimi

Përfitimet – mbështetje e mëtejshme për sistemin e mbrojtjes nga vërshimet, në mënyrën më relevante dhe me efektive sa i përket kostos

Kostoja – CAPEX 50,000 € (Studim); OPEX – i pa aplikueshëm

2021			2022			2023			2024			2025 & Tutje	
		Planifikimi			Implementimi								

Pë

rshkrimi

Përderisa ndryshimet klimatike kanë gjasë të provokojnë raste më ekstreme të motit, me shira të mëdha dhe të zgjatura që rezultojnë me vërshime lumenjsh, siguria e sistemit të mbrojtjes nga vërshimet është qenësore. Ky veprim kërkon përgatitjen e një sërë studimesh, të cilat më pas do të informojnë përzgjedhjen e masave të planifikimit dhe ndërtimit, duke përfshirë:

- Vlerësimin e rrezikut nga vërshimet, me identifikimin e zonave të qytetit që preken më shumë nga rreziqet e vërshimeve;
- Vlerësimin e rreziqeve të sistemit ekzistues të vërshimeve, me identifikimin e nivelit të mbrojtjes që ofrohet nga sistemi ekzistues, si dhe ndërlidhja e gjetjeve të këtij studimi me rreziqet e vërshimeve të identifikuara në hapin e mëparshëm; dhe
- Studimin e korridoreve të kaltra-gjelbra (ujë-gjelbërim), për të kuptuar se si mund të ndërlidhen zonat e gjelbra brenda qytetit, cili është potenciali i tyre për të lehtësuar rreziqet e vërshimit dhe si projektet e reja të mbrojtjes nga vërshimet mund t'i inkorporojnë ato.

Përfitimet kryesore

- Identifikimi i zonave me rrezik të lartë nga vërshimet, si dhe informatat për planifikimin e mbrojtjes nga vërshimet në atë mënyrë që mund të parandalohen ndikimet e dëmshme të vërshimeve;



- Sigurimi i efikasitetit të investimeve në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet; dhe
- Reduktimi i kostove të menaxhimit të rrezikut nga vërshimi përmes përfshirjes së zgjidhjeve që e respektojnë natyrën, aty ku është e mundur.

Qëllimet e synuara strategjike

- Qëllimi 8.2 – Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe adaptueshmërisë së infrastrukturës së re të Prishtinës përballë trysnive kronike të klimës dhe ngjarjeve katastrofike.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Të rritet përqindja/numri i strukturave mbrojtëse ndaj vërshimeve të inspektuara;
- Të sigurohet që objektet e drenazhimit zhvillohen përmes planeve dhe investimeve;
- Të ulet përqindja e infrastrukturës publike në rrezik; dhe
- Të ulet përqindja e ekonomive familjare që rrezikohen nga vërshimet.

Konteksti aktual

Ekzistojnë hapa të caktuar që e mbështesin këtë masë, të cilët përfshihen në Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike në Kosovë (p.sh. Vlerësimi i rreziqeve dhe trajnimi për menaxhim). Ka dispozita relevante që janë përfshirë, edhe pse në nivel më të lartë, në Strategjinë e Kosovës për ndryshimet klimatike 2019-2028, si dhe Planin e Veprimit 2019-2021.

Qyteti i Prishtinës ka përvojë me inspektime të mbrojtjes nga vërshimet dhe ka ekspertizë relevante; megjithatë, një vlerësim gjithëpërfshirës i kësaj natyre nuk është ndërmarrë deri më sot. Për më tepër, vlerësimi i korridoreve të kaltra-gjelbra dhe zgjidhjeve që e respektojnë natyrën nuk janë kryer deri më sot.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investim CAPEX – 50.000€

Gjithsej Kosto OPEX – i pa aplikueshëm

Përputhshmëria me burimet e financimit

Buxheti i Komunës, Buxheti qendror dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: TM3 2021 – TM1 2022; Implementimi TM1 2022 – TM2 2023

Agjencitë implementuese (drejtuesi me të zeza): Komuna dhe Qeveria e Kosovës

Palët e interesit: Komuna e Prishtinës (Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave), KRU Prishtina

Rreziqet kryesore në zbatim: Njohuritë e ekspertëve të komunës mund të mos mbulojnë plotësisht teknologjitë e fundit në sektorin e mbrojtjes nga vërshimet, si dhe mundësitë që lidhen me korridoret e kaltra-gjelbra. Për të adresuar këtë rrezik, mund të ketë nevojë për angazhim të ekspertëve të jashtëm, përfshirë ekspertët ndërkombëtarë.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Pasi ky hap do të mbështesë përmirësimet e mëtejshme në sistemin e mbrojtjes nga vërshimet në Prishtinë, ai mund të identifikojë mundësitë që ato sisteme të pajisen me sensorë që ofrojnë informata në kohë reale për nivelet e ujit. Kjo, nga ana tjetër, ndihmon në monitorimin dhe parashikimin më të mirë të rasteve të vërshimeve. Sensorët mund të ndihmojnë në krijimin e vizualizimeve gjeografike për t'i dhënë qytetit informacione në kohë reale, të cilat së bashku me parashikimin e motit, mund të ndihmojnë në zhvillimin / përsosjen e sistemeve të paralajmërimit të hershëm. Një pjesë e sistemit të mbrojtjes nga vërshimet mund të përfshijë dhe reagimin emergjent në rastet e vërshimeve, që do të mbështetej në konceptin e "njerëzve inteligjentë". Kjo sugjeron që qytetarët mund të pajisen me aplikacione telefonike, që mundëson koordinimin më të mirë të reagimit të tyre, bazuar në lokacionin e tyre në GPS.

Sinergjia me veprimet tjera

- Sinergji me masat në sektorin e ujërave, përmes menaxhimit më të mirë të burimeve ujore të qytetit, si pjesë e qasjes së integruar për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet.
- Nëse përdorimi i sensorëve të ujit dhe qasjeve të tjera të automatizuara teknologjike janë dakorduar si pjesë e planit të veprimit urban inteligjent dhe rezistent, ose planit të veprimit të ndryshimit të klimës, ato mund të mbështesin zbatimin e kësaj mase. Zgjidhje më inovative të tilla si një "binjak dixhital i qytetit" gjithashtu mund të mbështesin këtë veprim.

4.9 Çështje të tjera të ndërthurura

4.9.1 Cilat janë mundësitë kyçe në Prishtinë?

Ekzistojnë një numër fushash ndër-sektoriale të cilat i kemi adresuar në lidhje me PVQGJ-në, duke përfshirë elementët e mëposhtëm:

- **Angazhimi Publik** – Efekti pozitiv i organizimit të angazhimit të mirëfilltë të palëve të interesit lidhet jo vetëm me të kuptuarit e pikëpamjeve të banorëve, grupeve të komunitetit lokal dhe biznesit, mbi planet dhe projektet e propozuara të qytetit, por edhe me mënyrën se si iniciativat e ndryshme potencialisht ndikojnë në sjellje ndryshe, veçanërisht ato që gjenerojnë aktivitete më të qëndrueshme dhe të gjelbra. Vetëdijesimi për çështjet mjedisore dhe të performancës, që mbulojnë sektorë të ndryshëm mjedisorë, është gjithashtu i rëndësishëm për matjen e reagimit dhe këndvështrimeve të publikut për to, si dhe për të krijuar mbështetjen publike për veprimet e ardhshme, kur është e nevojshme.
- **Teknologjitë e "Qyteteve Inteligjente"** – Në zhvillimin e veprimeve mjedisore të përcaktuara në këtë Plan, është ndërmarrë një vlerësim i nivelit të lartë mbi potencialin e shqyrtimit apo zbatimit të 'teknologjive inteligjente'. Opsionet janë të gjera, duke përfshirë shfrytëzimin e qasjeve më moderne të menaxhimit dhe kontrollimit të trafikut, planifikimit dhe operimit të transportit publik (veçanërisht sistemet informative, sistemet e biletave dhe prioriteti i autobusëve). Këto iniciativa kanë evoluar përmes iniciativës së drejtorive e projekteve specifike, e jo përmes një strategjie të koordinuar e të centralizuar.
- **Sistemi mjedisor dhe i gjelbër i qytetit** – Cilësia e ajrit në qytet është identifikua si fushë që kërkon përmirësim si në vlerësimin objektiv të treguesve gjatë vlerësimit të gjendjes bazë, ashtu edhe përmes diskutimit me palët e interesit. Janë të nevojshme ndërhyrjet si ulja e varësisë nga lëndët djegëse të ngurta për ngrohje, përmirësimi i cilësisë së flotës së automjeteve, si dhe promovimi i mundësisë së udhëtimit jo-të-motorizuar për të përmirësuar cilësinë e ajrit në qendrën e qytetit (duke përfshirë pajisjet e reja moderne të monitorimit të cilësisë së ajrit).

Janë vendosur objektivat vijuese strategjike, që janë shtruar në vijim bashkë me arsyetimet përmbledhëse për secilin nga caqet afatmesme mbështetëse.

Qëllimi 9.1 - Të vendoset një sistem efektiv dhe efikas i koordinimit dhe menaxhimit të Qyteteve të Gjelbra

Gjatë angazhimit të palëve të interesit për zhvillimin e PVQGJ-së, janë diskutuar një varg temash dhe aspiratash kyçe strategjike lidhur me zhvillimin e një sistemi më të mirë të monitorimit dhe menaxhimit të mjedisit në Prishtinë, duke përfshirë aspektet e mëposhtme:

- Shqyrtimi i praktikave të mira ndërkombëtare në proceset e menaxhimit mjedisor (duke marrë shembullin e bashkëpunimit të suksesshëm midis BERZH-it dhe Trafikut Urban në lidhje me përpunimin/riciklimin e lëndëve djegëse);
- Krijimi i një Qendre të Monitorimit Mjedor (QMM) për prodhimin dhe menaxhimin e të dhënave të besueshme mjedisore në nivel lokal;
- Shqiptimi i masave ndëshkuese ndaj ndotësve të mjedisit, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të inspektorëve mjedisorë të qytetit;
- Zhvillimi i politikave të qytetit për të ndihmuar në zbutjen e efekteve negative të veprimtarisë njerëzore në mjedis;
- Rritja e kapacitetit të qytetit për të mbështetur përgatitjen dhe zbatimin e masave dhe veprimeve; dhe
- Rëndësia e krijimit të një sistemi për klasifikimin e llojeve të ndotjes, sipas rreziqeve dhe kërcënimeve.

Është kritike që të vendoset një strukturë e fuqishme institucionale, me stafin e trajnuar dhe të motivuar për të menaxhuar zbatimin e PVQGJ-së në baza të vazhdueshme, ndihmuar me aktivitete përkrahëse të mirëfillta e të mjaftueshme në zhvillim të kapaciteteve.

Qëllimi 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë

Ngritja e nivelit dhe cilësisë së të dhënave mjedisore të mbledhura dhe të përdorura për vendimet e ardhshme të planifikimit do të përmirësonin shumë ndikimin e iniciativave në PVQGJ, si dhe të mundësojnë kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit korrekt. Kuptohet që ka fusha që kërkojnë të dhëna më të mira, përfshirë nevojën për monitorim më gjithëpërfshirës të cilësisë së ajrit, duke pasur parasysh shkallën e problemeve me të cilat përballlet qyteti, sidomos në qendër.

Strukturat aktuale të monitorimit të cilësisë së ajrit mund të përmirësohen përmes investimeve në sisteme më solide të monitorimit të cilësisë së ajrit, analizës së të dhënave dhe menaxhimit, si dhe identifikimit më të madh të burimeve të emetimeve. Do të blihen sensorë të tjerë, bashkë me avancimin e monitorimit dhe operimit të tetë sensorëve aktual për matjen e cilësisë së ajrit në të gjithë qytetin.

Caqet mbështetëse

Matja e përmirësuar e cilësisë së ajrit, vlerësimi në lokacione dhe projeksionet, duke përfshirë dhe zvogëlimin e ndotësve vijues: koncentrimi mesatar vjetor i PM2.5 & PM10 dhe koncentrimi mesatar ditor me SO2 dhe NOx.

Qëllimi 10.1 – Vendosja e një marrëdhënie më efektive për angazhimin e palëve të interesit për të përmirësuar planifikimin dhe vendimarrjen

Është qenësore që angazhimi efektiv i palëve të interesit të vazhdojë të sigurohet gjatë zhvillimit të PVQGJ-së, për të ruajtur dialogun të gjallë me grupe dhe shoqata të ndryshme të palëve të interesit kur Plani kalon në fazën e zbatimit. Kjo do të ndihmojë që perspektivat dhe pikëpamjet mbi cilësinë e mjedisit, planifikimin urban dhe zhvillimin e infrastrukturës të vazhdojnë të formësojnë veprimet dhe iniciativat e zhvilluara si pjesë e Planit.

Caqet mbështetëse

Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile të Qytetit ndjehen të angazhuar në çështjet mjedisore në Prishtinë.

Me nisjen e strategjisë së angazhimit të palëve të interesit për të mbështetur hartimin dhe miratimin e PVQGJ-së së parë të qytetit, ka dobi të qarta të ruajtjes së dialogut të vazhdueshëm me palët e interesit në qytet kur Plani hyn në fazën e zbatimit. Përfshirja më e madhe në planifikim e zbatim të projekteve të Qytetit të Gjellbër do të ndihmojë në krijimin e përkrahjes dhe vetëdijesimit për këto veprime, si dhe t'i mundësojë Komunës të marrë shënim kritikave konstruktive për përparimin që arrihet.

Qëllimi 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për përmirësim të performancës mjedisore

Qëllimi përfundimtar i teknologjisë "Qytetet Inteligjente" është që informatat të vihen në dispozicion të operatorëve dhe përdoruesve, për të informuar e përmirësuar vendimarrjen. Në rastin e PVQGJ-së, kjo ka të bëjë me përmirësimin e qasjes dhe përdorimit të të dhënave mjedisore për të përmirësuar kushtet në të gjithë qytetin. Zhvillimi i aplikacioneve inteligjente të dobishme në infrastrukturën e qytetit mund të bëhet në mënyra të ndryshme:

- **Aplikacione ad-hoc:** komponentë të projekteve që i ofrojnë dobi qytetit dhe/ose shfrytëzuesve fundorë, pavarësisht nga fakti nëse Departamenti i Prokurimit apo qyteti ka apo jo strategji aktuale për zhvillimin inteligjent.
- **Oportuniste:** përmes qasjes së hapur në të dhëna, lindin aplikacione të reja inteligjente që sigurojnë dobi publike për sa i përket njohurive apo aktiviteteve mjedisore; dhe
- **Strategjike:** zhvillimi i një strategjie për mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave, ose përfshirjen inteligjente, brenda një projekti të infrastrukturës së qytetit.



Caqet mbështetëse

Rritja e % e veprimeve të PVQGJ-së që përfshijnë me sukses brenda tyre aplikacione SMART.

4.9.2 Çfarë veprimesh propozojmë të ndërmerren?

Kemi propozuar një sërë veprimesh afatshkurtra (që do të zbatohen në 3-5 vitet e ardhshme) për aspektet ndër-sektoriale të PVQGJ-së. Këto janë përmbledhur në Tabelën 4.9 që vijon, si dhe janë përshkruar më hollësisht në faqet vijuese.

Tabela 4.9 - Përmbledhje e Veprimeve Ndërsektoriale

ID#	Veprimi	Përshkrimi
C1	Krijimi i Ekipit / Zyrtarit/es për Zbatimin e PVQGJ-së:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i Ekipit të ri për Zbatimin e PVQGJ-së në kuadër të komunës, i cili mban përgjegjësi për detyrat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> ○ Zhvillimi i kapaciteteve të stafit përkatës komunal: për ballafaqimin me mangësitë në shkathtësi e kapacitete të nevojshme për zbatimin e PVQGJ-së. ○ Organizimi i aktiviteteve për zhvillim të kapaciteteve, me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm. ○ Të sigurohet që mjetet e monitorimit e vlerësimit të mirëfilltë të jenë në dispozicion dhe të zbatohen gjatë periudhës së implementimit.
EN1	Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Strukturat aktuale të monitorimit të cilësisë së ajrit mund të përmirësohen përmes investimeve në sisteme më solide të monitorimit të cilësisë së ajrit, analizës së të dhënave dhe menaxhimit, identifikimit më të madh të burimeve të emetimeve. ▪ Duhet të blihen sensorë të tjera (2), por dhe të ketë monitorim e operim më të mirë të 8 sensorëve për matjet e cilësisë së ajrit në të gjithë qytetin. ▪ Kjo skemë do të përfshijë edhe hulumtimin dhe zhvillimin teknik të një doracaku të ri për përdorues, që flet për gjendjen e ndotjes së ajrit në Prishtinë, ashtu që të përforcohen shkathtësitë dhe kapacitetet e ekipit mjedisor të Komunës.

C1: Krijimi i Ekipit / Zyrtarit/es Zbatues të PVQGJ-së

Qëllimi – Sigurimi i zbatimit dhe monitorimit të mirëfilltë të PVQGJ-së

Lloji i Masës – Institucional (personeli)

Përfitimet – Planifikim i mirëfilltë, përgjegjësi të qarta dhe të përcaktuara për dhe gjatë zbatimit të PVQGJ-së

Kostoja – CAPEX: i pa aplikueshëm; OPEX: 20,000 €/vit

2021		2022			2023			2024			2025 & Tutje	
	Planning	Implementimi										

Përshkrimi

Pasi të miratohet, PVQGJ-ja do të jetë dokument kyç strategjik për Prishtinën, që përcakton qëllimet e ardhshme për zhvillimin e gjelbër të qytetit. Është qenësore të vendosen masa efektive të zbatimit për të siguruar realizimin e suksesshëm të Planit dhe për të siguruar realizim me kohë të veprimeve në sektorë të ndryshëm. Pasi zyrtarët komunalë që aktualisht punojnë në administratën e qytetit janë të ngarkuar me detyrat e tyre ditore, Ekipi i Zbatimit të Projektit duhet të krijohet për të koordinuar zbatimin e veprimeve, si dhe për të mbajtur përgjegjësinë për monitorim e raportim. Kjo duhet të sigurojë zbatimin e suksesshëm të PVQGJ-së dhe veprimeve të tij. Monitorimi i rregullt i planit të veprimit të PVQGJ-së duhet të ndihmojë në vlerësimin nëse sfidat mjedisore të identifikuar në Plan janë duke u tejkaluar, apo nëse po shfaqen probleme të reja.

Përfitimet kryesore

- Krijimi i stafit si resurs, i cili fokusohet tek menaxhimi dhe bashkërendimi i zbatimit të veprimeve sektoriale të PVQGJ-së, duhet të ndihmojë në sigurimin e zbatimit të plotë të Planit, sipas planifikimit; dhe
- Ekzistimi i një ekipi ekspertësh që mbulojnë secilën fushë të PVQGJ-së dhe që nuk merren me detyrat të tjera ditore të komunës do të jetë garanci për zbatimin e suksesshëm të PVQGJ-së në mënyrë të koordinuar me aktivitetet e tjera të komunës.

Project Management



- Ekipi i zbatimit të PVQGJ-së në Prishtinë do të ketë qasje në mënyra të zhvillimit të kapaciteteve në internet, si dhe përvoja të shkëmbimit të njohurive që Programi i Qyteteve të Gjelbra është duke zhvilluar tashmë.

Qëllimet e synuara strategjike

- SG 9.1 dhe SG11.1 – Krijimi i një ekipi do të vendosë përgjegjësi dhe llogaridhënie të qartë për zbatimin e PVQGJ-së.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Siguria që veprimet e PVQGJ-së zbatohen mirëfilli në përputhje me qëllimet/synimet;
- Efikasiteti në mbikëqyrje dhe zhvillim, realizimi i veprimeve gjatë periudhës së Planit; dhe
- Veprimet e PVQGJ-së zbatohen në përputhje me planin e punës, pa vonesa të mëdha.

Konteksti aktual

Komunës aktualisht i mungojnë burimet njerëzore dhe kapaciteti teknik për të menaxhuar realizimin e të gjitha veprimeve sektoriale, si dhe monitorimin/raportimin efektiv. Ekipi Zbatues i PVQGJ-së do të jetë përgjegjës për dy detyra kryesore:

- Udhëheqjen e zhvillimit të kapaciteteve të stafit përkatës komunal për të adresuar mangësitë në aftësi e kapacitete. Ekipi do të vlerësojë llojet e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme për të zbatuar veprimet e PVQGJ-së. Nevojat për trajnime dhe zhvillim të domosdoshëm të individëve kryesorë do të identifikohen dhe programohen për të përmirësuar njohuritë teknike dhe kapacitetin, përmes seancave për zhvillim të kapaciteteve me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm. Organizimet e tilla për zhvillim të kapaciteteve do të konceptohen bazuar në kërkesat dhe prioritetet e sektorit.
- Menaxhimi i detyrave raportuese për PVQGJ-në: Kjo do të sigurojë që mjetet për monitorimin e duhur të progresit të PVQGJ-së të vihen në dispozicion, duke u mbështetur në instrumente si mostrat e raportimit dhe një softuer që ndihmon në ekzekutimin e tyre.

Kostoja e investimit

Gjithsej Investimet CAPEX – i pa aplikueshëm

Gjithsej Kosto OPEX – 20,000€/vit.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Komuna e Prishtinës

Implementimi

Afatet kohore: TM3 – TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025

Agjencitë implementuese (kryesoret me të zeza):

Komuna e Prishtinës

Palët e interesit:

Kompania Rajonale e Ujësjetës – Prishtina, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Personeli i komunës (të gjitha drejtoritë).

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Zbatimi i këtij veprimi ndër-sektorial është i lidhur ngushtë me zhvillimin e mjeteve të mundshme digjitale për planifikimin urban (p.sh. data-hub, binjakëzimi digjital i qytetit). Ndërsa Komuna e Prishtinës vazhdon të krijojë sisteme të reja të dhënave për të mbështetur funksionet e komunës, kjo do të ndihmojë në përmirësimin e vendimmarrjes, priorizimit, monitorimit e veprimeve, si dhe ndihmon në uljen e kostove.

Sinergjia me veprimet tjera

Masa do të mbështesë zbatimin efektiv të të gjitha veprimeve sektoriale të identifikuar brenda Planit, mbështetur nga monitorimi dhe raportimi i rregullt në baza vjetore.

EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit

Qëllimi – Prodhimi i të dhënave cilësore dhe të besueshme për Ndotjen e Ajrit brenda qytetit

Lloji i Veprimit – Infrastrukturë

Përfitimet – Sistemet e paralajmërimit të hershëm për qytetarët e ndjeshëm (me sëmundje të frymëmarrjes), të cilët njoftohen për cilësinë aktuale të ajrit

Kostoja – CAPEX: 75,000 € për të gjithë sensorët në 5 lokacione të qytetit; OPEX: 10,000 €/vit

2021	2022	2023	2024	2025 & Tutje
Planifikimi	Implementimi			

Përshkrimi

Shumë qytete në Kosovë, përfshirë Prishtinën, vuajnë nga cilësia e dobët e ajrit, me koncentrimet ambientale të thërmijave me diametër prej 2.5 mikrometra ose më pak (PM2.5) që tejkalojnë në masë të madhe standardet vendore dhe ato të Bashkimit Evropian (BE) dhe udhëzimet globale të cilësisë së ajrit për PM2.5, të vendosura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Ndotja e ajrit në kryeqytet i bën konkurrencë ndotjes në qytetet e mëdha si Pekini, Mumbai apo New Delhi. Sidomos në dimër, zonat urbane përballen me episode të mëdha smogu, shkaktuar nga rritja e kërkesës për ngrohje nga sektori i banimit dhe ai komercial, sektor i cili ngrohet kryesisht me djegien e lëndëve të ngurta. Nivelet e tilla të ndotjes së ajrit janë shqetësuese për popullsinë e Kosovës prej 1.9 milion banorësh, si dhe shkaktojnë ndikime të konsiderueshme të dëmshme në shëndet¹⁷.

Masa përfshin zhvillimin e një Doracaku për Cilësinë e Ajrit (DCA) për Prishtinën, i cili kontribuon në rritjen e njohurive teknike dhe praktike të stafit të komunës që kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e cilësisë së ajrit dhe përpunimin e të dhënave.



Përfitimet kryesore

- Vlerësim më i mirë i cilësisë së ajrit, duke përfshirë vlerësimin në terren dhe parashikimet.
- Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së banorëve të qytetit.

¹⁷ Monitorimi i Cilësisë Rajonale të Ajrit në Ballkanin Perëndimor - Raporti i Ballkanit Perëndimor - MCA (AQM) në Kosovë-Banka Botërore, 2019

Qëllimet e synuara strategjike

- SG 9.2 – Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë; dhe
- SG 11.1 – Zbatimi i teknologjive inteligjente për përmirësim të performancës mjedisore.

Caqet dhe treguesit kryesorë

- Vlerësim më i mirë i cilësisë së ajrit, duke përfshirë vlerësimin në terren dhe parashikimet;
- Zvogëlimi i koncentrimit mesatar vjetor me PM2.5;
- Zvogëlimi i koncentrimit mesatar vjetor me PM10;
- Zvogëlimi i koncentrimit mesatar ditor të SO2; dhe
- Zvogëlimi i koncentrimit mesatar ditor të Nox.

Konteksti aktual

Analiza e kushteve mjedisore ka zbuluar se ka sfida në cilësinë e ajrit në lidhje me treguesin themelor (koncentrimi mesatar vjetor i PM2.5 dhe PM10) që është mbi normën referente "të kuqe" gjatë muajve të dimrit (nëntor - shkurt), veçanërisht gjatë dimrave të ftohtë dhe me borë. Faktorët e mundshëm për cilësi të dobët të ajrit janë trafiku, ngrohja lokale dhe afërsia e termocentralit që ofron furnizimin me ngrohje. Pavarësisht nga serioziteti i kësaj çështje, ekzistojnë vetëm dy stacione monitorimi në territorin e qytetit, të cilat nuk mundësojnë monitorim të mjaftueshëm ashtu që të vlerësohen normat e cilësisë së ajrit në lokacione specifike dhe pikat e nxehta ('hot spots') të pritshme, në baza më të rregullta.

Rregullimet aktuale të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit duhen përmirësuar me investime në pajisje/sisteme më të mira, të cilat arrijnë më mirë të identifikojnë burimet e emetimeve, si dhe të mundësojnë analiza më të thella të të dhënave dhe menaxhim të kontrolleve të cilësisë së ajrit, atëherë kur tejkalohe normat. Ka gjasë të ketë nevojë për një studim për të përcaktuar lokacionet apo vendet më të mira për të instaluar sensorë të rinj të cilësisë së ajrit. Do të blihen sensorë të tjerë (3 statik dhe 2 mobil) për të rritur monitorimin dhe operimin për matjet e cilësisë së ajrit në të gjithë komunën.

Kostoja e investimit

Gjithsej investim CAPEX – 75,000 €; 15,000 €/sensor matës; 3 statik dhe 2 mobilë në 5 lokacione të ndryshme në qytet.

Gjithsej kosto OPEX – afro € 10,000 €/vit.

Përputhshmëria me burimet e financimit

Komuna e Prishtinës dhe Donatorët

Buxheti i qytetit	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - mund të rimbursohet
Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë

Përputhje e mirë | Përputhje e mundshme | Përputhje e dobët

Implementimi

Afatet kohore: Planifikimi TM3 – TM4 2021; Implementimi TM1 2022 – TM4 2025

Agjencitë implementuese (drejtuesit me të zeza):

Komuna e Prishtinës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Palët e interesit:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Rreziqet kryesore në zbatim:

Nuk parashikohen rreziqe të konsiderueshme.

Potenciali i Qytetit Inteligjent – Potenciali për përfitim

Skema do të përfshijë të dhëna në kohë reale për cilësinë e ajrit dhe ofron potencialin për t'u lidhur me monitorimin e ndotjes në të gjithë qytetin, për të menaxhuar dhe kontrolluar ndotësit kur nivelet e cilësisë së ajrit bien nën nivelet e pranueshme. Të dhënat e grumbulluara (përfshirë monitorimin e trafikut) ofrojnë potencialin për t'u integruar në një qendër të dhënash për gjithë qytetin, ashtu që proceset e vendimmarrjes të jenë më efikase.

Sinergjia me veprimet tjera

Mbështet performancën e përgjithshme të sektorit mjedisor, me aplikimin e pjesëve të teknologjisë inteligjente. Kontribuon dukshëm në përmirësimin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave

5 Opsionet e Financimit të PVQGJ-së



5.1 Përmbledhje e gjendjes financiare të Qytetit

Buxheti është akti më i rëndësishëm komunal që rishikohet dhe aprovohet çdo vit nga Asambleja përkatëse komunale, bazuar në parashikimin tre-vjeçar afatmesëm. Zakonisht, Prishtina i merr ndërmjet 60 - 70% të të ardhurave buxhetore nga Qeveria në formën e tre granteve: (1) Granti i Përgjithshëm, (2) Granti për Arsim dhe (3) Granti për Shëndetin Publik dhe Shërbimet Sociale. Pjesa e mbetur vjen nga burime të tjera të ardhurash siç janë taksat lokale. Për vitin 2020, shumat e Grantit të Përgjithshëm dhe Grantit të Shëndetit & Shërbimit Social kanë qenë më të larta se në vitin 2019, por për vitin 2021 ato kanë rënë lehtësisht, me shumë mundësi si pasojë e shkurtimeve të buxhetit qeveritar për shkak të COVID-19.

Tabela 5.1: Të ardhurat buxhetore të qytetit për periudhën 2014 - 2020 (në milionë EUR)

Burimi i të ardhurave	2019	2020	2021
Granti i Përgjithshëm	24.92	31.70	29.46
Granti për Shëndetin Publik dhe Shërbimet Sociale	7.44	7.53	6.95
Granti për Arsim	23.15	23.09	21.11
Të ardhura vetanake	31.73	29.26	28.27
Totali	87.25	91.58	85.79

Burimi: Komuna e Prishtinës

Shpenzimet e qytetit në vitet e fundit kanë qenë mjaft të qëndrueshme, por ka një ndryshim të dukshëm në shpenzimet e buxhetit për vitin 2021, me një ulje më shumë se 20% të buxhetit për pagat dhe shpenzimet kapitale.

Tabela 5.2: Shpenzimet e buxhetit të qytetit për 2019 - 2021 (në milionë EUR)

Shpenzimet	2019	2020	2021
Pagat	6.20	6.80	4.83
Mallrat dhe Shërbimet	12.41	13.41	14.14
Shpenzime komunale (faturat e shërbimeve)	0.93	0.93	1.04
Shpenzime kapitale	27.70	28.09	22.46
Subvencionet dhe transfertat	3.49	3.41	3.55
Buxheti Sektorial për Shëndetësinë	9.70	10.17	11.31
Buxheti Sektorial për Arsimin	27.31	28.77	28.46
Totali	87.73	91.58	85.79

Burimi: Komuna e Prishtinës

Vlen të përmendet që huazimi për komunat në Kosovë nuk është diçka e zakonshme – me marrëveshjen e parë të borxhit komunal të nënshkruar në 2018 në vlerën prej 2.5 milionë EUR. Instrumente të tjerë të borxhit janë kanalizuar përmes qeverisë vendore.

Shifrat e paraqitura më sipër nuk përfshijnë të hyrat dhe shpenzimet nga ndërmarrjet në pronësi të komunës – të cilat janë shumë më të larta por nuk janë përfshirë në këtë raport. Mund të shihet se të ardhurat përputhen gjerësisht me shpenzimet – që do të thotë se shumat fleksibile për investime ka të ngjarë të mbështeten në (a) kontributet e Qeverisë, (b) investimet nga ndërmarrjet në pronësi të komunave, ose (c) PPP-të. Mund të ketë një hapësirë për alokimin e buxhetit të shpenzimeve kapitale dhe të shpenzimeve komunale (fatura e shërbimeve) për masat e gjelbra.

5.2 Burimet e mundshme të financimit

Ka një numër burimesh të mundshme për financimin e Veprimeve të PVQGJ-së, të cilat janë shtjelluar në tabelën që vijon. Në kuadër të procesit të hartimit të PVQGJ-së, secili veprim është vlerësuar në aspektin e gjasave për të siguruar financimin përkatës, ose nga qyteti ose nga burime të tjera.

Mekanizmi i financimit	Përshkrimi
Financimi nga Qyteti	Ky është financim i drejtpërdrejtë, përmes mekanizmave si buxhetet komunale (përfshirë buxhetet e ardhshme për projekte kapitale, si dhe kontributet në natyrë të artikujve si toka ose koha e personelit ekzistues). Burime të tjera financimi mund të sigurohen edhe nga burime si lëshimi i letrave me vlerë - megjithëse kjo me gjasë është e vështirë në rrethanat e Prishtinës.
Fondet shtetërore ose rajonale	Këto përfshijnë financimin (zakonisht të pakthyeshëm) në formën e transfereve direkte fiskale. Ky mund të jetë dhe mekanizëm për shpërndarjen e mekanizmave të tjerë të financimit (të tilla si ato që vijnë).
Institucionet financiare ndërkombëtare (IFN-të) – të kthyeshme	Këta janë për shembull BERZH, BIE, etj. Financimi përmes këtij mekanizmi zakonisht bëhet përmes instrumenteve të kredisë, ku bankat ofrojnë financim për qytetet ose përmes qeverive qendrore me kredi sovraane, ose duke i dhënë kredi drejtpërdrejt qytetit. Banka të ndryshme zhvillimore kanë politika të ndryshme të praktikave të kreditimit. Në disa raste, financimi i kapitalit është gjithashtu i mundur. Në këtë lloj mekanizmi, ekziston pritja/kriteri për shlyerjen e investimit. Ky mund të përfshijë edhe, për shembull, krijimin e mekanizmave të garancive.
Fondet e donatorëve - të pakthyeshme	Këto përfshijnë, si shembull, fondet strukturore të BE-së dhe burime të tjera të donatorëve që nuk rimburohen (zakonisht grante). Financimi përmes këtyre burimeve shpesh përdoret si mënyrë për të mbyllur hendeqet, ashtu që kreditë dhe investimet tjera të jenë rentabile. Këto mund të përfshijnë dhe asistencën teknike. Mund të përfshijnë edhe fonde të donatorëve të mobilizuara nga IFN-të.
Financimi nga sektori privat/Partneritetet Publiko-Private (PPP)	Disa veprime përfshijnë politika apo investime të qytetit që pastaj nxisin financimin nga sektori privat (të tilla si inkurajimi i formave të reja të prodhimit të energjisë), ndërsa të tjerët mund të ndërlidhen me sipërmarrje të përbashkëta apo partneritete publiko-private, me investitorë të sektorit privat ose palë të tjera të treta – si në rastin e menaxhimit të mbeturinave, ngrohjes qendrore, e madje edhe eficiencës

Mekanizmi i financimit

Përshkrimi

së energjisë në ndërtesat në pronësi publike. Angazhimi i investimeve të sektorit privat do të ndihmojë në zvogëlimin e barrës financiare për qytetin, si dhe do të mundësonte ndarjen e barrës së rrezikut midis qytetit dhe investitorit privat, duke i mundësuar qytetit të ruajë një masë kontrolli dhe ndikimi mbi aktivitetet investive.

Disa projekte kapitale mund të financohen, ndërtohen, kontrollohen dhe operohen nga organizata private. Këto mund të jenë kompani private që punojnë me kontrata shërbimi me qytetin, si koncesionet e shërbimeve që operojnë për periudha kohe të caktuara (p.sh. 25 vjet).

Publiku i gjerë dhe burime të tjera

Këtu përfshihen financimet nga publiku i gjerë (për shembull, në rinovimet e sektorit të banimit) ose modele të tjera të decentralizuara të mbledhjes së fondeve, përfshirë pagesat nga përdoruesit e shërbimeve dhe financimet grupore (crowd-funding).

Siç është bërë në PVQGJ-të e tjerë, është përdorur sistemi i pikëve, me ngjyra (kuq, verdhë, gjelbër), për të vlerësuar përshtatshmërinë e mekanizmave dhe burimeve të financimit për secilin veprim, si vijon:

- **Gjelbër - Përputhje e mirë:** të ketë prioritet në hulumtimet e mëtejshme. Kjo mund të jetë sepse burimi i financimit përputhet mirë me shkallën e ndërhyrjes dhe/ose ky lloj aktiviteti është i zakonshëm për këtë lloj mekanizmi/burimi.
- **Verdhë - Përputhshmëri e mundshme:** të hulumtohet, por jo detyrimisht të jetë përputhje e plotë. Kjo notë tregon që shkalla e financimit të nevojshëm është e papërshtatshme për këtë mekanizëm financimi (në një farë mase ose shumë e madhe ose shumë e vogël), ose ky veprim nuk financohet zakonisht përmes këtij mekanizmi – me disa përjashtime.
- **Kuqe - Përputhshmëri e dobët:** Kjo mund të jetë sepse shkalla e projektit është përtej kufijve, në aspektin e shkallës për atë lloj financimi, ose është e pazbatueshme (p.sh. financimi është për investime kapitale).

5.3 Vlerësimi i Veprimeve kundrejt Opsioneve të financimit

Tabela vijuese përshkruan përputhshmërinë e mundshme të opsioneve të mundshme të financimit (mekanizmat dhe burimet) për veprime të caktuara brenda PVQGJ-së. Në praktikë, ka elemente të financimit për disa veprime të cilat nuk kanë nevojë të sigurohen, sepse fondet janë tashmë në vend, tek një organ publik apo subjekt privat. Këto janë ofruar edhe për masat specifike në Kapitullin 4.

Investimi total që nevojitet për implementimin e PVQGJ-së është afërsisht 378 milionë €, e nga kjo shumë, pjesa më e madhe me gjasë do të rrjedhë nga qyteti, ose në formën e investimeve direkte ose përmes ndërmarrjeve në pronësi të komunës (dhe me gjasë nga investimet nga Qeveria). Mund të ketë edhe mundësi të tjera për angazhimin e PPP-ve / sektorit privat – gjë që paraqitet në tabelën më poshtë. Kjo do të ishte një shumë e konsiderueshme investimesh në krahasim me të ardhurat e qytetit.

Rritja e shpenzimeve OPEX nga PVQGJ-ja përlogaritet të jetë rreth 7.99 milionë € – një pjesë e konsiderueshme e të cilave llogaritet të jetë nga rritja e kostove të vazhdueshme për zhvillimin e sistemit të autobusëve (përfshirë 'BRT'), zhvillimi i skemave të huazimit së biçikletave, masat infrastrukturore këmbësorike (T1), sistemi i shfrytëzimit të ujërave atmosferikë (W2), sistemi i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit (EN1). Të gjitha këto veprime kanë gjasë të kursejnë para në terma ekonomikë (në terma të ngarkesave në trafik, përmirësimit të shëndetit, kursimeve të ujit etj.), por mund të ketë rritje të kostove të vazhdueshme. Në anën tjetër, shumë prej investimeve të mëdha në qytet (si B2, B4, E1, E2 ose WA2) do të sillnin ulje të shpenzimeve operative (OPEX), njëkohësisht duke përmirësuar dhe mjedisin.

Përderisa nuk është kryer analiza e plotë kosto-përfitim për PVQGJ-në, ne presim që shumë prej këtyre investimeve do të jenë gjithsesi financiarisht fitimprurëse, mjaftueshëm për të arsyetuar investimet. Përgjithësisht, vlerësimi tregon se të gjitha ndërhyrjet kanë të paktën një metodë alternative të mundshme të financimit. Mund të pritët që shumë prej veprimeve që kërkojnë investime më të mëdha do të kërkojnë të paktën një burim shtesë financimi (përveç qytetit). Investimet nga Qeveria qendrore (përfshirë përdorimin e fondeve BE-IPA), angazhimi i

donatorëve, investimet e IFN-ve dhe përfshirja e sektorit privat do të jenë kritike për zbatimin e plotë të veprimeve të PVQGJ-së – në veçanti për investimet më të mëdha. Mbështetja e vazhdueshme e donatorëve për hartimin e politikave dhe për studime, për të shtjelluar plotësisht investimet, do të jetë po ashtu e rëndësishme. Hapi tjetër në zbatimin e PVQGJ-së do të jetë konfirmimi i burimeve financiare, kudo që është e mundur, si dhe kontaktimi i burimeve të mundshme të financimit, aty ku këto nuk janë konfirmuar ende. Këto do të bëhen për secilin veprim, nga organizatat/drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e masave specifike.

Tabela 5.3: Financimi i nevojshëm për Veprimet (në milionë EUR) dhe opsionet e mundshme të financimit

#	Veprimi	Gjithsej investime (m EUR)	OPEX (EUR)	Tipi i financimit nga qyteti	Financimi nga Qyteti	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - rimbursohen	Donatorët	Sektori privat/PPP-të	Publiku i gjerë/Tjerë:
T1	Masa të avancuara për këmbësorë	3.00	300,000	Investim Komunal						
T2	Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë	4.00	Mbulohen me të ardhurat	Investim Komunal						
T3	Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore	4.00	N/A - mbulohet nga tarifat e përdoruesve/OeM ekzistuese në vazhdim	Investim Komunal / PPP						
T4	Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve	9.30	930,000	Investim Komunal / PPP						
T5	Investimet për ciklizëm në të gjithë qytetin	3.24	400,000	Investim Komunal / PPP						
T6	Korridor i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme	227.00	5,231,000	Investime Komunal						
B1	Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë	0.00	20,000	Stafi i angazhuar						
B2	Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale	15.90	N/A - kursime neto	Investim Komunal / PPP						
B3	Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale	0.56	N/A	Studim						
B4	Instalimi i njehsorëve të energjisë për konsumatorë individualë	17.50	E papërfillshme	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
I1	Strategjia e Angazhimit dhe Plani i Veprimit për Promovimin e Efiçencës së energjisë	0.00	N/A	Stafi i angazhuar						
E1	Rehabilitimi i Ndrçimit Publik - Zëvendësimi i Poçave Ekzistues me Poça Efiçientë në Energji	0.40	N/A - kursime neto	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës / PPP						

#	Veprimi	Gjithsej investime (m EUR)	OPEX (EUR)	Tipi i financimit nga qyteti	Financimi nga Qyteti	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - rimbursohen	Donatorët	Sektori privat/PP P-të	Publiku i gjerë/Tjerë:
E2	Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit	3.90	N/A - kursime neto	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës / PPP						
E3	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore	17.70	N/A - të paguhet nga konsumatorët, me zvogëlim neto të koston për njësi të energjisë	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
E4	Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore	33.69	N/A - paguhet nga konsumatorët	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
L1	Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive	6.00	Të konfirmohet - me gjasë të vogla, si pjesë e mirëmbajtjes së vazhdueshme	Investim i Komunës						
L2	Shqyrtimi i planeve aktuale urbane për të ndihmuar në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban	0.15	N/A	Studim / zhvillim i veglave/mjeteve						
L3	Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të Pasurive të Gjelbra dhe Sistemit të Financimit të Granteve	0.50	10,000	Studim / zhvillim i veglave/mjeteve						
WA1	Azhurnimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në Prishtinë	0.05	150,000	Studim						
WA2	"3R-Reduktim, Ripërdorim, Riciklim"- Koncepti i menaxhimit të mbeturinave	5.00	60,000	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
W1	Investime në sistemin e ujësjellësit (sistemi i gypave)	7.00	N/A - kursime neto	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
W2	Sistemi i shfrytëzimit të ujërave atmosferikë	8.00	320,000	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës						
W3	Rritja e efikasitetit në shfrytëzim të ujit	0.05	50,000	Stafi i angazhuar						
W4	Iniciativa për zvogëlimin e humbjeve të ujit	0.25	400,000	Investim nga ndërmarrja në pronësi të komunës / PPP						
CC1	Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent	0.15	N/A	Studim						
CC2	Përgatitja e Planit të Veprimit për Rrezeqe Emergjente Klimatike	0.30	N/A	Studim						

#	Veprimi	Gjithsej investime (m EUR)	OPEX (EUR)	Tipi i financimit nga qyteti	Financimi nga Qyteti	Fondet shtetërore ose rajonale	IFN-të - rimbursohen	Donatorët	Sektori privat/PP P-të	Publiku i gjerë/Tjerë:
CC3	Vlerësimi i Rrezikut të Përmblytjeve	0.05	N/A	Studim						
EN1	Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit	0.75	100,000	Studim / përkrahje e vazhdueshme						
C1	Krijimi i Ekipit / Zyrtarit/es për Zbatimin e PVQGJ-së	0.00	20,000	Stafi i angazhuar						
	Gjithsej	368.44	7,991,000							

6 Përmbledhje e dobive



6.1 Hyrje

Ky Plan Veprimi për Qytet të Gjelbër synon të shtyjë përpara përmirësimin e performancës mjedisore të qytetit tonë. Dobitë e secilit prej veprimeve janë vlerësuar kundrejt tërësisë së përfitimeve të definuara në Metodologjinë e BERZH-it për Qytetet e Gjelbra. Këtu pasqyrohen jo vetëm dobitë mjedisore, por dhe dobitë shoqërore dhe ekonomike të cilat do të duheshin arritur me zbatimin e planit të veprimit, së bashku me përfitimet gjinore dhe përfshirëse.

Secili veprim ka potencial për të sjellë dobi në disa fusha të identifikuar brenda kësaj kornize, ndërsa qasja e matricës është përdorur për të identifikuar se cilat veprime mbështesin cilat fusha të dobisë apo përfitimit. Dobitë e tilla kategorizohen në tre nivele:

3 Dobi e konsiderueshme: Ka dobi potencialisht të konsiderueshme nga veprimi.

- **2 Dobi sekondare:** Ka gjasa të ketë dobi, gjë që është substanciale për përzgjedhjen e opsionit, por nuk është faktori kryesor.
- **1 Dobi periferike:** Mund të ketë përfitime periferike, por nuk janë faktorë që kanë qenë substanciale për zgjedhjen e opsionit.

Analiza e dobisë për secilin projekt është paraqitur në **Tabelën 6-1** si më poshtë.

Për shkak të natyrës strategjike të këtij plani, këto dobi janë vlerësuar kryesisht në aspektin kualitativ, si dhe duhen parë si indikative. Sidoqoftë, ato ofrojnë udhëzime për agjencitë zbatuese mbi gamën e dobive që mund të nxirren nga secili veprim.

Një përmbledhje e shkurtër narrative e dobive është pasqyruar brenda secilit prej përshkrimeve të hollësishme të Veprimeve në pjesën kryesore të këtij raporti. Kjo bazohet në vlerësimin vijues:

Tabela 6-1: Vlerësimi i dobive – PVQGJ e Prishtinës

#	Veprimi	Cilësia e ajrit	Cilësia e Ujit	Cilësia e dheut	Biodiversiteti	Përdorimi i ujit	Përdorimi i energjisë	Shfrytëzimi i tokës	Përdorimi i materialeve	Masat lehtësuese për ndryshimet klimatike	Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Shkalla e kthimit për investitorin	Rritja ekonomike	Punësimi / Krijimi i vendeve të punës	Përfshirja ekonomike	Shëndeti publik	Qasja në shërbime themelore	Siguria	Barazia gjinore	Veprimtaria dhe vetëdija e " gjelbër"	Përfshirja e komunitetit
T1	Masa të avancuara për këmbësorë	3	0	0	0	0	2	2	0	3	1	1	1	1	3	3	2	3	2	3	2
T2	Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë	2	0	0	0	0	1	2	0	2	1	2	2	1	2	1	2	2	1	2	0
T3	Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore	3	0	0	0	0	2	2	0	2	2	0	1	1	1	2	2	3	3	0	0
T4	Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve	3	0	0	0	0	2	2	0	3	2	2	2	2	2	2	2	3	3	2	2
T5	Investimet për ciklizëm në të gjithë qytetin	3	0	0	0	0	2	2	0	3	1	1	1	1	3	3	2	3	2	3	2
T6	Korridori i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme	3	0	0	0	0	1	2	0	2	1	2	2	2	2	1	2	3	1	1	1
B1	Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë	3	0	0	0	0	3	0	2	2	2	2	2	2	1	2	1	1	0	2	2

6.2 Dobitë kryesore mjedisore

Kapitulli vijues ofron një pasqyrë të dobive kryesore mjedisore që ka gjasa të arrihen përmes zbatimit të PVQGJ-së së Prishtinës.

6.2.1 Cilësia e ajrit

Aktualisht, qyteti ka një Plan të Cilësisë së Ajrit, i cili ka karakterizuar fushat kryesore sfiduese, si dhe mbetet vegla kryesore e planifikimit për trajtimin e çështjeve të cilësisë së ajrit në qytet, ndërsa zbatimi i tij është qenësor për sigurimin e përmirësimeve në cilësinë e ajrit në qytet. Sidoqoftë, ka një numër veprimesh komplementare brenda këtij plani, të cilat janë kritike për suksesin e Planit të Cilësisë së Ajrit. Përmirësimet në efikasitetin termike të ndërtesave në qytet dhe implementimi i energjisë së ripërtërishme (ngrohje solare) brenda qytetit do të zvogëlojë kërkesën për shërbime të ngrohjes, si dhe do të zvogëlojë në masë kritike barrën mbi cilësinë e ajrit nga djegia e lëndëve fosile edhe nga centralët me lëndë të tilla, edhe nga ngrohja e qytetit.

PVQGJ po ashtu përmban një sërë masash të cilat do të inkurajojnë zbutjen e varësisë nga përdorimi i automjeteve private në favor të transportit publik, me shërbime të përmirësuara të autobusëve urbanë, si dhe me fokus më të madh në promovimin dhe inkurajimin e aktiviteteve këmbësore dhe çikliste në të gjithë qytetin – me propozime për përmirësimin e shtigjeve të dedikuara për ecje dhe çiklizëm, si dhe zhvillimin e skemës për huazimin e biçikletave në të gjithë qytetin, që do të kontribuonin drejt një përmirësimi të dukshëm në cilësinë e ajrit lokal, veçanërisht në qendër të qytetit.

Përfundimisht, për të rritur njohuritë tona për cilësinë e ajrit në qytet, si dhe për t'u dhënë mundësi njerëzve të marrin vendime më të mira për të zvogëluar kontributin e tyre në sfidat e cilësisë së ajrit, ose për të mbrojtur më mirë shëndetin e tyre, është planifikuar dhe skema e avancuar e monitorimit të cilësisë së ajrit.

6.2.2 Biodiversiteti

Veprimet L2 dhe L3 synojnë të implementohen mbështetur mbi punën e mirë që Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë në lidhje me zhvillimin dhe

promovimin e hapësirës së gjelbër në të gjithë qytetin. Qëllimi është të krijohet një vazhdimësi të hapësirave të gjelbra që lidhin lagjet, me korridore të gjelbra që sigurojnë më shumë drunjë dhe bimësi që do të shtohen aseteve të gjelbra të qytetit. Zhvillimi i inventarit të pasurisë së gjelbër do të luajë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e ndikimeve të politikave të përdorimit të tokës në biodiversitetin e të gjithë Qytetit.

6.2.3 Shfrytëzimi i ujit

Derisa disponueshmëria dhe cilësia e ujit në Prishtinë konsiderohet të jetë përgjithësisht e mirë, ka mundësi për të zvogëluar vëllimet e ujit të konsumuar nga konsumatorët me përmes vetëdijesimit për ujin, duke inkurajuar sjellje më të përgjegjshme dhe duke mbrojtur furnizimet dhe përdorimin e ujit. Ekziston gjithashtu një propozim për të zvogëluar më tej harxhimin e ujit përmes zëvendësimit të infrastrukturës së degraduar, dhe kursimeve prej efikasitetit në menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit të qytetit.

6.2.4 Shfrytëzimi i energjisë

Fusha kryesore e mundësive për zvogëlimin e shfrytëzimit të energjisë është përmes përmirësimit të efikasitetit të energjisë (kryesisht efikasitetit termike) në ndërtesa, nga të cilat, pjesa më e madhe e dobisë ka gjasë të gjendet në sektorin e banimit. Një fushë tjetër me mundësi të konsiderueshme është rehabilitimi i sistemit të ngrohjes qendrore. Çdo rehabilitim i rrjetit ka gjasë të përfshijë edhe uljen e ndjeshme të joefikasitetit në sistem (për shembull nga përmirësimet në rrjetin shpërndarës për të zvogëluar humbjet) dhe implementimin e një faturimi më të mirë të konsumit të klientëve individualë. Të dy këta faktorë mund të përmirësojnë ndjeshëm performancën e energjisë në rrjet. Përmirësimi dhe zgjerimi i Rrjetit të Ngrohjes Qendrore pritet të sjellë kursime të realizuara që përlogariten deri në 12,981 tonë CO₂eq/vit deri në vitin 2030. Një reduktim prej mbi 13,500 ton CO₂eq / vit mund të pritet nga përdorimi i energjisë diellore për ngrohje.

6.2.5 Shfrytëzimi i tokës

Veprimet e Shfrytëzimit të Tokës (L1-3) të përcaktuara në këtë PVQGJ do të përmirësojnë lidhjen ndërmjet lagjeve dhe hapësirave të gjelbra të qytetit, duke siguruar lidhje për rrjetet aktive të udhëtimit dhe duke zvogëluar nevojën për udhëtime të motorizuara. Investimet në transportin publik (T4 dhe T5), lehtësirat për këmbësorët (T1), investimet në çiklizëm (T5) së bashku me kontrollat e parkimit (T2), synojnë të gjitha të ulin nivelin e trafikut të motorizuar dhe të inkurajojnë përdorimin e mënyrave të udhëtimit të qëndrueshëm, veçanërisht në zonën qendrore urbane. Zvogëlimi i nivelit të trafikut të automjeteve private do të sigurojë më shumë hapësirë e cila mund të përdoret për qëllime të veprimtarive të kohës së lirë, duke kontribuar në rritjen ekonomike si dhe në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së banorëve të qytetit.

Inkurajimi i Zhvillimit të Orientuar drejt Tranzitit si pjesë e veprimit T6 do të lehtësojë shfrytëzimin më të integruar të tokës dhe zhvillimin e transportit, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban dhe rritjen e dendësisë së zhvillimit në të gjithë Prishtinën.

6.2.6 Masat lehtësuese për ndryshimet klimatike

Fushat kryesore të mundësive për zvogëlimin e emisioneve të Gazrave Serrë (GS) janë eficientia e energjisë në ndërtesa (dhe veçanërisht ndërtesat e banimit), përmirësimet në rrjetin e ngrohjes qendrore dhe zvogëlimi i emetimeve nga transporti, kryesisht duke inkurajuar kalimin nga automjetet private në mënyra transporti më pak ndotëse.

Mundësitë për Ndërtesa

Fusha më e madhe e mundësive për zvogëlimin e emetimeve GS është të sigurohet që ndërtesat e reja të plotësojnë standardet minimale të performancës së energjisë, pasuar me rehabilitimin termik të fondit të ndërtesave, e veçanërisht rehabilitimin e ndërtesave të banimit.

PVQGJ-ja propozon një program të integruar të izolimit termik, të cilin e kemi llogaritur se mund të sjellë afro 2,605 tonë CO₂eq/vit kurse deri në vitin 2030, ku shumica dërrmuese e kësaj dobie fitohet me përmirësimet termike.

Mundësitë për Mobilitet të Qëndrueshëm

Ekzistojnë një sërë masash të propozuara në sektorin e transportit, të cilat kolektivisht inkurajojnë kalimin nga përdorimi i automjeteve private tek përdorimi më i madh i mënyrave alternative e të qëndrueshme të transportit. Modeli i detajuar i emetimeve nga transporti nuk është zhvilluar për këtë studim, por një llogaritje bazë, me reduktim prej 20% të përdorimit të automjeteve private (ku ata përdorues kalojnë tek ecja dhe çiklizimi, si dhe me ruajtjen e pjesës aktuale të përdoruesve të transportit publik) do të arrihej kursimi prej rreth 45,867 tCO₂eq/vit.

Ka mundësi të tjera për të zvogëluar emetimet nga flota e autobusëve, me zëvendësimin e autobusëve të vjetër dizel me autobusë modernë elektrikë, si dhe automjete Euro VI.

Tabela 1-2: Kursimet e përlllogaritura të emisioneve GS nga Veprimet e PVQGJ-së

Masa	Kursimet e përlllogaritura në GS në vitin 2030 (tonë CO ₂ eq/vit)
B1: Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë	52.235
B2: Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale	2.605
B3: Auditimi Energjetik dhe Certifikimi i Ndërtesave Komunale	
B4: Instalimi i njehsorëve të energjisë për konsumatorë individualë	9.235
E1: Rehabilitimi i Ndrçimit Publik - Zëvendësimi i Poçave Ekzistues me Poça Efiçientë në Energji	39.680
E2: Ndërprerësit inteligjentë të ndrçimit	12.981
E3: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore	
E4: Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore	13,578
T1: Masa të avancuara për këmbësorë	45.867
T2: Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë	

T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore	
T4: Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve	
T5: Investimet për çiklizëm në të gjithë qytetin	
T6: Korridori i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme	
Gjithsej	176,181

6.3 Dobitë kyçe të kombinuara ekonomike dhe sociale

Procesi PVQGJ është përqendruar posaçërisht në zhvillimin e masave për të arritur dobitë mjedisore, megjithëse është e rëndësishme të kuptohen dhe dobitë e kombinuara ekonomike e sociale, të cilat mund të realizohen si pasojë e zbatimit të veprimeve të PVQGJ-së.

6.3.1 Përfitimet financiare për investitorët e mundshëm

Shumë nga veprimet e përfshira në PVQGJ kanë potencial për të sjellë dobi për investitorët, përfshirë Komunën e Prishtinës dhe investitorët e sektorit privat. Këto arrihen përmes përmirësimeve të efikasitetit, si zvogëlimi i kostove operative ose rritja e të ardhurave nga rritja e shfrytëzimit të shërbimeve. Kjo vlen për masat e efikasitetit të energjisë (në ndërtesa dhe sistemin e ngrohjes qendrore), rrjetin e transportit që është më i qëndrueshëm me më shumë shtrirje e rrjedhimisht edhe me më shumë klientë, rrjedhat e mundshme të të ardhurave që vijnë nga veprime të tilla si zbatimi i skemës së huazimit të biçikletave (Citywide Bike Hire), si pjesë e masave të investimeve për çiklizmin në qytetin e Prishtinës.

6.3.2 Punësimi

Investimet mund të krijojnë mundësi punësimi afatshkurtra (për shembull në realizimin e projekteve të infrastrukturës), por ato krijojnë dhe vende pune "të gjelbra" e më afatgjata, siç janë instalimi, shërbimi dhe mirëmbajtja e teknologjive të ripërtëritshme në nivel të ulët, ose në produkte izoluese për ndërtesa, vende të tjera pune në transportin publik për të mbuluar linja të reja shërbimi, si dhe në menaxhimin e skemës së huazimit të biçikletave.

6.3.3 Përfshirja ekonomike

Qytetarët me të ardhura të ulëta kanë gjasë të përfitojnë nga infrastruktura e qasshme e transportit, veçanërisht nga zgjerimi i rrjetit të linjave të transportit publik në zonat periferike të qytetit, si dhe zhvillimi i rrjeteve të sigurta të ecjes dhe çiklizmit, që mund të ofrojnë mundësi efektive të udhëtimit, përfshirë lidhjet me stacionet dhe terminalët e transportit publik, me kosto marginale të ulët për përdoruesit. Kursimet financiare në faturat e energjisë që duhet të rezultojnë nga investimet në efikasitet të energjisë dhe teknologjitë e ripërtëritshme në ndërtesat e banimit do të duhej të ofronin dobi edhe për familjet me të ardhura më të ulta.

6.3.4 Shëndeti publik

Janë tri fusha të gjëra të dobisë në aspektin e shëndetit publik që janë identifikuar të rrjedhin nga plani i veprimit i Qytetit të Gjelbër. Këto janë:

- Zbutja e varësisë nga përdorimi i automjeteve private, e sidomos qasja në infrastrukturë këmbësore e çikliste që jo vetëm ofron mundësi të lira, të qëndrueshme të qarkullimit, por edhe ka dobi të prekshme në kuptimin e përmirësimit të shëndetit fizik dhe mirëqenies mendore.
- Hapësirat e gjelbra urbane mund të promovojnë shëndetin fizik dhe mendor, si dhe mund të zvogëlojnë rrezikun ndaj sëmundjeve dhe vdekshmërinë tek banorët, duke ofruar relaksim fizik dhe zbutje të stresit, mund të nxisin kohezionin shoqëror, të mbështesin aktivitetet fizike dhe të zvogëlojnë ekspozimin ndaj zhurmës, ajrit të ndotur dhe nxehtësisë së tepërt. Përmirësimet në hapësira e infrastrukturë të gjelbër në qytet do të mbështesin synimet e shëndetit publik, si dhe kanë pasur shumë rëndësi sidomos gjatë pandemisë aktuale COVID-19.

6.3.5 Siguria

Instalimi i infrastrukturës së re (si në lagje, rrjetet e transportit, si dhe respektimi i standardeve të ndërtimit dhe standardeve të automjeteve të transportit publik dhe infrastrukturës përkatëse në vendndalje) ka potencial të rrisë sigurinë e përdoruesve përmes zbatimit të standardeve

të mira të projektimit e të funksionimit. Sigurimi i infrastrukturës për ecje dhe çiklizëm ka mundësi e dobi të posaçme në aspektin e sigurisë rrugore. Skemat e projektuara mirë ofrojnë dhe mbrojtje më të mirë në kuptimin e kryqëzimeve me qarkullim motorik, por ofrojnë edhe mjedis më të sigurtë e më të rregullt, duke tkurrur rreziqet e kriminalitetit tek shtigjet këmbësore dhe çikliste, që vendosen në lokacione me dukshmëri të mirë, mbulim me kamera vëzhguese, si dhe ndriçim përkatës.

6.3.6 Barazia gjinore

Çështjeve gjinore duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur gjatë zhvillimit të secilit veprim, për të siguruar që dobitë dhe mangësitë e skemave të marrin parasysh nevojat e burrave dhe grave, të cilat mund të jenë të ndryshme. Janë theksuar Mundësitë ose dobitë vijuese.

- Infrastruktura e re e transportit publik ka gjasë të projektohet për të akomoduar një gamë më të gjerë të nevojave të qasshmërisë, siç është qasja më e mirë për karroca fëmijësh.
- Shtigjet e këmbësorëve dhe biçikletave do të ofrojnë qasshmëri më të mirë edhe për karrocën e fëmijëve, si dhe mund të favorizohen për udhëtime të shkurtra, si përcjellja e fëmijëve në shkollë, gjë që ka më shumë gjasa të bëhet nga gratë.
- Gratë janë posaçërisht të cenueshme ndaj sulmeve ose ngacmimeve seksuale në vende si vendndaljet e autobusëve, ose shtigjet e ecjes/çiklizmit që nuk gjenden përgjatë rrugëve kryesore. Standardet moderne të dizajnit të ndalesave për autobusë duhet të kenë parasysh veçoritë e sigurisë, si ndriçimi dhe dukshmëria e rritur, por dhe vëzhgimi natyror, për të rritur sigurinë e grave, si dhe për të zvogëluar frikën e sulmeve.
- Gratë e vjetra që ofrojnë kujdes për fëmijë do të përfitonin po ashtu nga shfrytëzimi i bankinave përgjatë shtigjeve të ecjes si dhe në parqe e zona të gjelbra.
- Familjet me gra kryefamiljare kanë më shumë gjasë të jenë ekonomikisht të marginalizuara sesa ekonomitë tjera familjare, e

kështu dobitë e diskutuara tek pika **Error! Reference source not found.** (përfshirja ekonomike) kanë relevancë të mundshme për këtë grup. Gratë në përgjithësi kanë po ashtu gjasë të kenë më pak qasje në automjete private, si dhe më shumë gjasa të ecin dhe të përdorin transportin publik sesa meshkujt.

7 Implementimi dhe Monitorimi i PVQGJ-së



7.1 Hyrje

Monitorimi i rregullt i masave dhe projekteve të PVQGJ-së përbën një pjesë thelbësore të procesit të zbatimit, pasi kjo do të ndihmojë Komunën e Prishtinës të përcaktojë nëse progresi është duke u arritur sipas planit, si dhe nëse po realizohen qëllimet strategjike. Është krijuar korniza e monitorimit të PVQGJ-së, që do të shërbejë për qëllimet e mëposhtme:

- Për të mbështetur planifikimin, procesin e përcaktimit se ku dëshiron të shkojë qyteti dhe si mund të arrijë atje;
- Për të përmirësuar vendimmarrjen, duke i dhënë kuptim më të qartë gjendjes dhe tendencave aktuale;
- Për të mundësuar krahasimin e kushteve dhe performancës në sektorë të ndryshëm të mjedisit; dhe
- Për të siguruar llogaridhënie për veprimet dhe rezultatet e përcaktuara në PVQGJ.

Monitorimi i rregullt i planit të veprimit të PVQGJ-së duhet të ndihmojë në vlerësimin nëse sfidat mjedisore të identifikuara në Plan janë duke u tejkaluar, apo nëse janë parë të shfaqen probleme të reja.

Korniza e monitorimit për PVQGJ-në e Prishtinës bazohet në treguesit e dakorduar të performancës (duke e përdorur si bazë strukturën e treguesve të PVQGJ-së: Trysnia - Gjendja - Reagimi) të cilët mund të maten dhe të interpretohen lehtësisht në krahasim me standardet që janë vendosur. Ne kemi modifikuar disa nga treguesit për të pasqyruar kushtet lokale dhe disponueshmërinë e të dhënave.

7.2 Struktura e qeverisjes dhe ajo institucionale për PVQGJ-në e Prishtinës

Është qenësore që të vendosen rregullimet efektive të implementimit për të siguruar realizim të suksesshëm të PVQGJ-së. Është krijuar enkas një strukturë qeverisëse për të bashkërenduar, menaxhuar dhe mbikëqyrur zbatimin e suksesshëm të PVQGJ-së. Kjo strukturë pasqyron rëndësinë e vendimmarrjes politike dhe të dhënave hyrëse teknike, për të siguruar progres të mirë në zhvillimin e skemës dhe zbatimin pasues, si dhe vlerësimin e ndikimit të veprimeve dhe vlerësimin e progresit në arritjen

e caqeve të PVQGJ-së dhe realizimit të qëllimeve strategjike. Rolet dhe përgjegjësitë e propozuara janë dhënë më poshtë.

Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës (Prijësit Politikë)

Emërimi i një prijësi politik është thelbësor për suksesin e udhëheqjes së zhvillimit dhe zbatimit të suksesshëm të PVQGJ-së, si dhe planit të veprimit të miratuar. Prijësi politik aktualisht kryeson Komitetin Drejtues të PVQGJ-së dhe do të jetë prijësi i detyrave përkatëse administrative për të siguruar arritjen e progresit në zhvillimin dhe zbatimin e veprimeve të identifikuara brenda PVQGJ-së.

Komiteti Drejtues i PVQGJ-së

Komiteti Drejtues i PVQGJ-së do të mbikëqyrë zhvillimin e PVQGJ-së së qytetit gjatë fazës së implementimit, për të siguruar qasje të gjithëpërfshirëse në realizimin e PVQGJ-së, si dhe shqyrtimin e performancës mjedisore në qytet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Planit. Ky Komitet Drejtues do të kryesohet nga Nënkryetari i Komunës, si Prijësi Politik i PVQGJ-së, mbështetur nga Koordinatorin e Qytetit të Gjelbër që është caktuar, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Komunës së Prishtinës që udhëheqin drejtoritë kryesore. Këto përfshijnë Drejtoritë që kanë të bëjnë me Shërbimet Publike, Mbrojtjen dhe Shpëtimin, Investimet Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave, Planifikimin Strategjik dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm, Financat, Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Këshilltarin Ligjor të Komunës. Komiteti Drejtues mbledhet dy herë në vit, në interval gjashtë-mujor, për të trajtuar elementët kyçë si vijon:

- Konfirmimi i projekteve për zhvillim të mëtejshëm (varësisht nga miratimet përkatëse nga Asambleja Komunale);
- Monitorimi i progresit të projekteve;
- Shqyrtimi i të dhënave nga monitorimi i performancës mjedisore;
- Konfirmimi dhe miratimi i raporteve për PVQGJ-në (përfshirë çdo veprim të propozuar korrigjues); dhe
- Inicimi i raundeve të mëtejshme të planifikimit PVQGJ, kurdo që të ketë nevojë.

Koordinatori/ja për Qytetin e Gjelbër

Koordinatori/ja e Qytetit të Gjelbër mban përgjegjësi për koordinimin e përgjithshëm të programit të zbatimit dhe monitorimin pasues të tij, për të vlerësuar performancën e përgjithshme kundrejt qëllimeve dhe caqeve të përcaktuara me PVQGJ. Këtu përfshihen autorizimet për bashkëpunim dhe veprime të ndërmarra ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse të komunës, për të siguruar realizim të suksesshëm të të gjitha veprimeve të PVQGJ-së. Koordinatori/ja e Qytetit të Gjelbër do të harmonizojë po ashtu proceset e monitorimit dhe vlerësimit, të nevojshme si pjesë e programit të raportimit PVQGJ, me proceset e tjera të qytetit dhe veprimtarinë e planifikimit strategjik në të gjithë Komunën e Prishtinës. Kjo do të bëhet përmes komunikimit të rregullt me Udhëheqësit Sektorialë të PVQGJ-së të caktuar, derisa përparohet me zbatimin e skemës, si dhe derisa informatat mbi ndikimin e kësaj skeme implementimi të fillojnë të mblidhen e shqyrtohen. Koordinatori/ja e Qytetit të Gjelbër luan rol kritik në mbështetjen e procesit të zbatimit të PVQGJ-së, si dhe mundësimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit efektiv mes Projektit PVQGJ dhe Udhëheqësve të Sektorëve.

Udhëheqësit e Projektit PVQGJ

Brenda Komunës, duhen emëruar menaxherë të projekteve të caktuara, për të menaxhuar në mënyrë aktive zhvillimin dhe zbatimin e skemave dhe iniciativave të ndryshme në PVQGJ. Zyrtarët e emëruar do të mbikëqyrin zbatimin e veprimeve specifike, përfshirë raportimin mbi progresin e aktivitetit në zbatim, si dhe do të ndihmojnë në grumbullimin e të dhënave të nevojshme rreth ndikimeve të rezultateve pas implementimit. Komuna do të përcaktojë buxhetet dhe afatet kohore për realizimin e veprimeve të përcaktuara në baza vjetore. Raportimi tremujor i progresit, me shpenzimet dhe progresin e projekteve, duhet të ndihmojë në vlerësim, si dhe t'i dorëzohet Komitetit Drejtues të PVQGJ-së së qytetit duke raportuar mbi statusin e implementimit. Rezultatet e këtij procesi do të informojnë planifikimin e fazave pasuese të secilit veprim, duke përfshirë konfirmimin e çfarëdo ndryshimi në afatet kohore, resurset e buxhetin, që mund të jenë të nevojshme.

Udhëheqësit Sektorialë të PVQGJ-së

Udhëheqësit e sektorëve do të veprojnë në nivel operacional, duke punuar ngushtë me Koordinatorin/en e Qytetit të Gjelbër të Prishtinës për të mbledhur informacion mbi treguesit e performancës së sektorit, i cili mblidhet e vlerësohet vazhdimisht për të matur performancën e përgjithshme dhe kontributin drejt caqeve e standardeve të vendosura. Rezultatet e kësaj pune do të shtjellohen në një raport vjetor, i cili po ashtu merr parasysh investimet në qytet dhe progresin në zbatim. Koordinatori/ja e Qytetit të Gjelbër do të punojë në bashkëpunim me Udhëheqësit e Sektorëve për të analizuar të dhënat sektoriale të PVQGJ-së, si dhe të hartojë raportet. Struktura e plotë e drejtimit që do të krijohet për të koordinuar, menaxhuar e mbikëqyrur zbatimin e suksesshëm të programit PVQGJ-së është shfaqur në Figurën 7.1 më poshtë.

Veprimet individuale mund të ndërmerren nga secili subjekt që miratohet nga Komiteti Drejtues i PVQGJ-së, e që mund të jetë ndonjë drejtori e qytetit, ndërmarrje apo ndonjë palë e jashtme (përfshirë subjektet e sektorit privat). Agjencia që ndërmerr një veprim nga PVQGJ-ja obligohet të koordinohet me Ekipin Koordinues të PVQGJ-së, përmes ndërlidhjes me Koordinatorin e PVQGJ-së. Për të ndihmuar udhëheqësit e projekteve që të mblidhin e shqyrtojnë të dhënat siç duhet, Koordinatori/ja e Qytetit të Gjelbër do të punojë ngushtë me Udhëheqësit e Sektorëve për të siguruar që të dhënat përkatëse të mblidhen e analizohen për të vlerësuar ndikimin e skemave individuale, por dhe për të vlerësuar treguesit kundrejt caqeve të vendosura. Kur ka nevojë për përcaktimin e gjendjes bazë, të dhënat plotësuese do të sigurohen për të ushqyer më vonë raportet vjetore të ardhshme, që të maten ndryshimet e përgjithshme në performancë në drejtim të përmbushjes së qëllimeve dhe caqeve strategjike. Trajektoret e performancës ndihmojnë në të identifikuarit nëse caqet afatmesme janë të mundshme të realizohen, me monitorim në faza vjetore, për të theksuar nëse ka ndonjë veprim korigjues që mund të jetë i domosdoshëm.

7.3 Implementimi dhe Monitorimi i PVQGJ-së

Programi në vija të trasha që shtjellon implementimin e projekteve dhe iniciativave të PVQGJ-së është hartuar, si dhe është paraqitur në faqen vijuese, Tabelën 7.1. Ky identifikon kornizat kohore të propozuara për

zbatimin e projekteve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj periudhe të PVQGJ-së (deri në pesë vjet), ku ndahet më tutje në fazën përgatitore (që përfshin përgatitjen e studimeve, angazhimin me partnerët në realizim, aplikimet për financa, etj.), pasuar nga faza e realizimit, e cila mund të jetë me faza të vazhdueshme vjetore (ku programi i vazhdueshëm i realizimit në faza të elementeve të veprimit planifikohet në baza vjetore). Këto periudha kohore bazohen në përllogaritjet paraprake nga Ekipi i Konsulentëve, bazuar në shtrirjen dhe ndërlikueshmërinë e perceptuar të projekteve individuale. Do të ketë nevojë për planifikim më të detajuar gjatë periudhës fillestare të zbatimit, pas miratimit të PVQGJ-së, për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve më të detajuara lidhur me alokimin e mjeteve, kërkesat buxhetore, fazat paraprake të projekteve, si dhe proceset e aprovimeve që duhen siguruar, por dhe kontributet nga partnerët e jashtëm të realizimit.




Figura 7.1 Struktura qeverisëse e PVQGJ-së në Prishtinë

Tabela 7.1: Korniza kohore e implementimit

<i>Data e fillimit të implementimit të PVQGJ-së</i>	2021 <i>Viti 1</i>	2022 <i>Viti 2</i>	2023 <i>Viti 3</i>	2024 <i>Viti 4</i>	2025 & <i>5 & Tutje</i>
Monitorimi					
Raportimi					
T1: Masa të avancuara për këmbësorë					
T2: Masat e Kontrollit të Parkimit në Prishtinë					
T3: Korsi të dedikuara me prioritet për Autobusët në Qendrën e Qytetit dhe elemente tjera infrastrukturore					
T4: Investime gjithëpërfshirëse komunale në Rrjetin e Autobusëve					
T5: Investimet për çiklizëm në të gjithë qytetin					
T6: Korridori i Qarkullimit të Qëndrueshëm në Unazën e Brendshme					
B1: Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë					
B2: Izolimi termik, bashkë me ndërrimin e dritareve - Ndërtesat komunale					
B3: Auditimi Energjetik dhe Çertifikimi i Ndërtesave Komunale					
B4: Instalimi i njehsorëve të energjisë për konsumatorë individualë					
L1: Zhvillimi dhe implementimi i Konceptit me bazë në Lagje, me fokus në zonat e Gjelbra, Rekreative dhe Sportive					
L2: Shqyrtimi i planeve aktuale urbane për të ndihmuar në zvogëlimin e zgjerimit të pakontrolluar urban					
L3: Zhvillimi i Inventarit Gjithëpërfshirës të aseteve të Gjelbra dhe Sistemit të Financimit të Granteve					
E1: Rehabilitimi i Ndrçimit Publik - Zëvendësimi i Poçave Ekzistues me Poçat Efiçientë në Energji					

<i>Data e fillimit të implementimit të PVQGJ-së</i>	2021 <i>Viti 1</i>	2022 <i>Viti 2</i>	2023 <i>Viti 3</i>	2024 <i>Viti 4</i>	2025 & <i>5 & Tutje</i>
E2: Ndërprerësit inteligjentë të ndriçimit					
E3: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore					
E4: Furnizimi me energji termike përmes shfrytëzimit të energjisë diellore					
I1: Strategjia e Angazhimit dhe Plani i Veprimit për Promovimin e Eficiencës së energjisë					
W1: Investimet në sistemin e ujësjellësit (sistemi i gypave)					
W2: Sistemi i ripërdorimit të ujërave atmosferikë					
W3: Rritja e efikasitetit në shfrytëzim të ujit					
W4: Iniciativa për zvogëlimin e humbjeve të ujit					
WA1: Azhurnimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në Prishtinë					
WA2: Koncepti 3R-Reduktim, Ripërdorim, Riciklim i mbeturinave					
CC1: Zbatimi i planifikimit urban inteligjent dhe rezistent					
CC2: Përgatitja e Planit të Veprimit për Rreziqe Emergjente Klimatike					
CC3: Vlerësimi i Rrezikut të Përmbytjeve					
C1: Krijimi i Ekipit / Zyrtarit/es për Zbatimin e PVQGJ-së					
EN1: Sistem i ri i monitorimit të cilësisë së ajrit					

Faza e Planifikimit

Faza e Implementimit

7.4 Programimi i Implementimit

Kjo fazë e procesit PVQGJ mëton të përcaktojë dhe identifikojë qasjen me faza të realizimit dhe programimit, kundrejt projekteve, veprimeve e iniciativave, projekteve e masave të PVQGJ-së. Pjesë përbërëse të kësaj faze janë:

- **Themelimi i strukturave institucionale dhe qeverisëse të PVQGJ-së:**

Gjatë kësaj periudhe, Prijësi(at) Politik duhet të identifikojë dhe ndajë resurset për rolet e përmendura në strukturën qeverisëse të PVQGJ-së si më sipër, me vëmendje të posaçme tek Ekipi Teknik (Udhëheqësit Sektorial) i PVQGJ-së, si dhe Udhëheqësit e Projekteve PVQGJ, të cilët mbajnë përgjegjësi për kontrollin e menaxhimin efektiv të implementimit.

- **Angazhimi me Udhëheqësit e Projekteve dhe ndarja e buxheteve për zhvillim:**

Komiteti Drejtues i PVQGJ-së duhet të identifikojë dhe konfirmojë emrat e individëve kryesorë tek të gjithë partnerët e realizimit (përfshirë stafin brenda dhe jashtë Komunës), të cilët identifikohen për secilin "Veprim". Udhëheqësit e Projekteve, të emëruar për kualifikimet e duhura të tyre, marrin përgjegjësinë për shtytjen përpara të zhvillimit, e pastaj dhe zbatimin e projekteve. Në këtë fazë është me rëndësi të ndahen mjetet e nevojshme për të mundësuar realizimin efektiv të projektit ose iniciativës.

- **Termet e Referencës (TeR) të Projekteve:**

Udhëheqësit e Projekteve bazohen tek informatat e nivelit të lartë në këtë plan për të zhvilluar termat e referencës me detaje, për implementimin e projekteve që iu caktohen atyre. Si pjesë e këtij procesi, do të ketë rëndësi të merren parasysh një numër çështjesh në implementim, duke përfshirë sa vijon:

Çështja	Përshkrimi
Programi i Zhvillimit dhe Realizimit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nevoja për të marrë parasysh periudhat paraprake që lidhen me zbatimin e projekteve të caktuara, sidomos atyre që kërkojnë studime të mëtejshme në kuptimin e arritshmërisë

Çështja	Përshkrimi
	<p>(fizibilitetit), angazhimit të palëve të interesit, si dhe argumentimit të rentabilitetit (sidomos kur propozohen projekte të shtrenjta infrastrukturore).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Këtu ka rëndësi të theksohet se ka nevojë për afate kohore realiste për hartimin, miratimin e zbatimin e projekteve.
Rezultatet e Projektit:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqendrimi në rezultatet e hollësishme të veprimeve të propozuara, në kuptimin e ndikimeve, dobive dhe ndryshimeve që shënohen pas implementimit; përputhja me databazën e treguesve të PVQGJ-së.
Rreziqet në realizim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ka nevojë të merren parasysh rreziqet e mundshme ndaj realizimit, si dhe planet përkatëse rezervë, si dhe të trajtohen mirëfilli pengesat e mundshme ndaj implementimit.
Opsionet e financimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikimi i organizatave specifike financuese (të brendshme e të jashtme) të cilat duhen kontaktuar për të shqyrtuar interesimin e tyre specifik për mbështetjen e zhvillimit dhe pastaj realizimit të projekteve të caktuara investuese.
Vlera për paratë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i argumenteve të rentabilitetit, për të ndihmuar në arsyetimin e investimeve në skema dhe iniciativa. Kjo përfshin vlerësimin e dobive të përgjithshme (ekonomike, sociale dhe mjedisore) krahasuar me kostot (kapitale dhe të ardhurat) për të mbështetur vendim-marrjen përfundimtare për investim, si dhe procedim të mëtutjeshëm me veprime.

- **Buxhetet e dakorduara për Veprime:**

Komiteti Drejtues i PVQGJ-së do të përpilojë buxhetet që duhen dorëzuar si pjesë e proceseve përkatëse komunale, për të siguruar që buxhetet për shtytjen e veprimeve të miratohen zyrtarisht në ciklin vjetor buxhetor të qytetit.

- **Zhvillimi i një Plani Zbatimi me Faza:**

Në përcaktimin e tërësisë së ndërhyrjeve me faza, është e rëndësishme që programi i zbatimit të ketë fleksibilitetin e mjaftueshëm për të pasqyruar ndryshimet e caktuara në Plan (për shembull, si rezultat i angazhimit të palëve të interesit, apo si rezultat

i studimeve të fizibilitetit) dhe zhvillimin e skemave, duke përfshirë potencialin për realizim më të shpejtë apo më të ngadaltë se sa pritet.

Në zhvillimin e programeve me faza, ndërhyrjet duhen priorizuar, ashtu që:

- shumë prej tyre do të bazohen në zhvillime të mëtejshme dhe studime të fizibilitetit, si dhe mund të modifikohen si rezultat i tyre, duke përfshirë dhe përcaktimin e përllogaritjeve më të sakta të investimeve kapitale (CAPEX) dhe operacionale (OPEX). Sapo skemat të jenë gati për zbatim, duhen vendosur mjetet dhe buxhetet përkatëse, duke definuar fazat e projekteve që shpjen drejt zbatimit të plotë;
- të zbatohet një proces i qartë, që përqendron vëmendjen në demonstrimin e ndikimeve të pritura të skemave, derisa të realizohet Planit; dhe
- Të ketë përqendrim tek planifikimi efektiv i së ardhmes, duke shqyrtuar mundësitë për zhvillimin dhe implementimin e “pakove” të skemave (kudo që është e mundur dhe e dobishme), të cilat ofrojnë më shumë efikasitet dhe kursime të mjeteve.

- **Vendosja e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit:**

Monitorimi i implementimit duhet të bëhet si në baza afatshkurtra, ashtu dhe në ato afatgjata, për të gjitha veprimet dhe iniciativat e Qytetit të Gjelbër, duke shfaqur statusin e projekteve dhe përparimin kundrejt fazave të përmbushjes.

Si pjesë e procesit të përgjithshëm të planifikimit të veprimeve, do të ketë nevojë për një renditje hapash, për të vendosur programe dhe agjenda realiste të skemave, duke përfshirë specifikimin e fazës së monitorimit e vlerësimit, shqyrtimet e programimit sipas nevojës, si dhe analizën e të dhënave të monitorimit të performancës.

- **Realizimi i partneriteteve:**

Shumë nga masat e paraqitura brenda PVQGJ-së angazhojnë partnerë dhe subjekte të ndryshme, kështu që pjesëmarrja dhe angazhimi i tyre në hartimin e planit të implementimit janë të rëndësishme. Një sërë

çështjesh të implementimit duhen adresuar, duke përfshirë rishikimin e partneriteteve dhe përgjegjësive përkatëse (veçanërisht subjektet kyçe) për ndërhyrjet individuale, identifikimin e organizatave dhe subjekteve kyçe të përfshira në skema e programe, duke nxjerrë kështu fusha ku burimet/mjetet mund të bashkohen dhe koordinohen. Do të shfrytëzohen dhe mundësitë e hulumtimit të qasjeve inovative për financimin dhe kontributet për zhvillimin e skemave.

7.5 Monitorimi i Ndikimit të PVQGJ-së

Përveç monitorimit të progresit të implementimit për Veprimet e Sektorëve të ndryshëm që janë trajtuar në këtë plan, duhet të ketë dhe monitorim të rregullt të progresit të arritur kundrejt Qëllimeve Strategjike dhe Caqeve Afatmesme që janë vendosur. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e nivelit të ndikimit që PVQGJ-ja sjell në performancën e përgjithshme mjedisore të Prishtinës gjatë kohëzgjatjes së Planit.

Për secilin nga treguesit që gjurmohet, plani i monitorimit të ndikimit të PVQGJ-së duhet të identifikojë drejtorinë komunale apo agjencinë/subjektin e jashtëm që është përgjegjës për sigurimin e të dhënave të kërkuara. Është me rëndësi që Koordinatorin/ia e Qytetit të Gjelbër të angazhohet rregullisht me bartësit e treguesve gjatë realizimit të Planit, për të siguruar pasqyra të qarta të performancës.

Për disa nga Treguesit e Performancës Sektoriale, do të ketë nevojë të rishikohet Databaza e Treguesve PVQGJ më detajisht, si dhe të bashkëpunohet me agjencitë e tjera për të vendosur njësitë matëse të ndikimit (d.m.th. të dalat) të secilit veprim të programuar. Treguesit që mbulojnë secilin nga sektorët PVQGJ të Prishtinës janë paraqitur më poshtë – përfshirë të dhënat e burimit dhe metodën e grumbullimit. Sipas rastit, janë paraqitur edhe caqet afatmesme dhe afatgjatë që përdoren për matjen e nivelit të suksesit, derisa programi realizohet gjatë pesë viteve të ardhshme.

Tabela vijuese 7.2 po ashtu rendit listën e plotë të treguesve dhe të dhënave që nevojiten të përpilohen dhe rishikohen, si pjesë e kornizës së monitorimit, duke përfshirë përgjegjësinë për secilin grup të treguesve.

Tabela 7.2: Qëllimet Strategjike dhe Caqet

Synimet Strategjike	Caqet	Treguesit & Matja	Shpeshësia e monitorimit	Përgjegjësia
SG1 Zbatimi i PMQU-së së Qytetit	<ul style="list-style-type: none"> Të rriten mundësitë e përzgjedhjes së mënyrës së udhëtimit, duke përmirësuar cilësinë dhe lidhshmërinë me transportin publik të rregullt dhe rrjetet e qarkullimit aktiv, që përfundimisht çon në nivele më të larta të kënaqshmërisë në udhëtim të qytetarëve që përdorin këto mënyra transporti. 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i kënaqshmërisë së publikut me shërbimet e transportit publik të qytetit dhe infrastrukturën, si dhe elementet infrastrukturorë për ecje dhe çiklizëm përmes një studimi social (<i>gjendja bazë për këtë tregues do të përcaktohet gjatë vitit 2021</i>) Përqindja e popullsisë në distancë prej 500 m nga një terminal i transportit publik apo një shtegu të ndarë për biçikleta (<i>gjendja bazë për këtë tregues do të përcaktohet gjatë vitit 2021</i>) 	Vjetore	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik) / Trafiku Urban / Operatorët Privatë të Autobusëve
	<ul style="list-style-type: none"> Të rriten nivelet e udhëtimit të qëndrueshëm në të gjithë qytetin, matur me rritjen në përqindje të mënyrave të qarkullimit për transport publik, ecje dhe çiklizëm. 	<ul style="list-style-type: none"> Përqindjet e mënyrave të udhëtimit (ditari vjetor i udhëtimeve - mostra e popullsisë) 	Vjetore	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik)
	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet përqindja e automjeteve me lëndë djegëse alternative (me emetime të ulëta) brenda fondit të automjeteve. 	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e flotës së automjeteve të transportit publik të qytetit që përdorin lëndë djegëse alternative 	Vjetore	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Transport dhe Trafik) / Trafiku Urban / Operatorët Privatë të Autobusëve
SG2 Përmirësimi i efikasitetit në përdorim të resurseve në ndërtim dhe atyre të energjisë	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet përqindja e projekteve ndërtimore me certifikata të gjelbra të objekteve, si përqindje e të gjitha projekteve që marrin leje ndërtimi brenda viti. 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i çertifikimeve të objekteve 	Vjetore	Drejtoria e Urbanizmit
SG3 Përmirësimi i Performancës Industriale	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet niveli i dialogut me kompanitë industriale për sa i përket efijencës së konsumit të energjisë, si dhe zbatimit të praktikave të mira mjedisore. 	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i masave të efijencës së energjisë të zbatuara nga firmat - anketë kualitative (<i>gjendja bazë duhet të përcaktohet më 2021</i>) Niveli i zbatimit të praktikave të mira në praktikën mjedisore nga firmat industriale - anketë kualitative (<i>gjendja bazë duhet të përcaktohet më 2021</i>) 	Vjetore	Drejtoria e Urbanizmit / Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave
SG4 Të sigurohet furnizimi i energjisë së pastër, inteligjente dhe të integruar	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet niveli i energjisë së prodhuar nga energjia diellore dhe të zvogëlohet varësia nga termocentralet me qymyr. Të zvogëlohet humbjet teknike në sistemin e shpërndarjes në 6% nga niveli aktual prej 10.2%. 	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e energjisë së furnizuar nga centralet energjetike pa linjit Kapacitetet e instaluar të energjisë së ripërtërishme Niveli i humbjeve teknike në sistemin e shpërndarjes 	Vjetore	Komuna e Prishtinës / Kompania e Ngruhjes Qendrore 'Termokos' / Korporata Energjetike e Kosovës

SG5 Shërbime efikase dhe moderne të Ujit	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet vetëdija për çështjet e efikasitetit të ujit, përmes nismave dhe fushatave të vetëdijesimit. Të ulen humbjet fizike të ujit në qytet për 20%, krahasuar me gjendjen bazë të vitit 2021, përmes një sërë programesh të infrastrukturës dhe operimit e mirëmbajtjes (OeM) 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i vetëdijes së publikut për çështjet e efikasitetit të ujit - anketë sociale (<i>gjendja bazë duhet të përcaktohet më 2021</i>). Konsumi i ujit për kokë banori (l/c/d) Përqindja e Humbjeve të ujit 	Vjetore	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
SG6 Menaxhimi Modern dhe i Qëndrueshëm i Mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"> Gjithsej 25% të mbeturinave urbane të riciklohen brenda Prishtinës deri në vitin 2030. 	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e mbeturinave të ricikluara në vit 	Vjetore	Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi"
SG2 Hapësirat e gjelbra të ndërlidhura me lagjet	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet qasja në hapësira të gjelbra ashtu që të gjithë qytetarët të kenë qasje në hapësira të gjelbra cilësore (të mëdha apo të vogla) brenda 300 metrash nga shtëpia e tyre. Hartimi dhe miratimi i një strategjie të re për zhvillimin e qytetit që përfshin sigurimin dhe promovon zhvillimin dhe lidhshmërinë e linjave të trafikut urban dhe linjave të qarkullimit aktiv (ecje/ciklizëm) brenda lagjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> Përqindja e zonave të banuara brenda 300 m nga hapësirat e gjelbra 	Vjetore	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm / Drejtoria e Urbanizmit / Instituti i Planifikimit Hapësinor
SG8 Menaxhimi i Ndryshimeve Klimatike dhe Adaptueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet niveli i njohurive lidhur me dobësitë në fushën e ndryshimeve klimatike, të cilat kërkojnë planifikim aktiv për adaptim (planifikimi urban që merr parasysh rreziqet e fatkeqësive). 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i vetëdijes së qytetarëve për çështjet mjedisore dhe çështjet e ndryshimeve klimatike - anketë kualitative Numri i pronave të rrezikuara nga ngjarjet ekstreme klimatike Evidenca e masave të politikave në Planet dhe Politikat e Komunës. 	Vjetore	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm / Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
SG9 Sistemi mjedisor dhe i gjelbër i qytetit	<ul style="list-style-type: none"> Të përmirësohet matja e cilësisë së ajrit, vlerësimi në lokacione dhe projeksionet, duke përfshirë zvogëlimin e ndotësve vijues: koncentrimi mesatar vjetor i PM2.5 dhe PM10, si dhe koncentrimi mesatar ditor me SO2 dhe NOx. Të krijohet Ekipi për Zbatimin e PVQGJ-së. 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i cilësisë së ajrit të vlerësuar (PM2.5, PM10, SO2 dhe NOx) në pikat e vlerësimit brenda një viti. Krijimi i Ekipit Zbatues të PVQGJ-së brenda Komunës. 	Vjetore Vjetore	Komuna e Prishtinës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
S010 Dialog efektiv me palët e interesit	<ul style="list-style-type: none"> Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile të Qytetit ndjehen të angazhuar në çështjet mjedisore në Prishtinë. 	<ul style="list-style-type: none"> Anketë sociale për të matur perceptimin e publikut. 	Vjetore	Zyra për Informim Publik, pjesë e Kabinetit të Kryetarit
SG11 Zbatimi i Teknologjive SMART	<ul style="list-style-type: none"> Të rritet numri i veprimeve të PVQGJ-së që përfshijnë me sukses aplikimin e teknologjisë SMART. 	<ul style="list-style-type: none"> Numri i veprimeve SMART të implementuara në mbështetje të masave të PVQGJ-së. 	Vjetore	Komuna e Prishtinës (Të gjitha departamentet)

Komuna do të bëjë monitorim të rregullt të treguesve sektorialë të PVQGJ-së për të parë progresin krahas Qëllimeve Strategjike të PVQGJ-së dhe caqeve që janë vendosur. Një ilustrim i marrëdhënieve midis Qëllimeve Strategjike dhe veprimeve të propozuara është dhënë tek Tabela 7.3: Kontributi i veprimeve të PVQGJ-së së Prishtinës më poshtë.

Shumë nga Veprimet do të kontribuojnë në më shumë se një synim strategjik. Janë përcaktuar dy nivele dobie apo përfitimi:


- Dobia primare – veprimi shënjestron posaçërisht qëllimin strategjik, si dhe është krijuar për të sjellë dobi në atë fushë. Këto theksohen me ngjyrë të **gjelbër të errët**.
- Dobia sekondare – veprimi nuk është projektuar posaçërisht për kontribut në një qëllim strategjik, por mund të mbështesë përmirësimet e tij. Këto theksohen me ngjyrë të **gjelbër të çelët**.

7.6 Monitorimi i Ndikimit të Skemave

Në kornizën e monitorimit dhe vlerësimit të PVQGJ-së, do të përfshihet dhe monitorimi i ndikimit të skemave individuale, për të ndihmuar në shqyrtimin e efektshmërisë së ndërhyrjeve të propozuara në realizimin e vizionit dhe qëllimeve strategjike të PVQGJ-së. Secila skemë e re e PVQGJ-së ofron mundësi për të mësuar nga përvoja, si dhe për të përmirësuar nivelin e të kuptuarit të performancës së veglave e masave të ndryshme, të cilat janë përfshirë në PVQGJ për të përmirësuar performancën mjedisore. Kjo mund të arrihet vetëm nëse ka matje efektive 'para dhe pas', të cilat ndihmojnë në zbulimin e ndikimit të skemave tek treguesit kryesorë të performancës, si dhe krahas qëllimeve dhe caqeve kryesore strategjike të PVQGJ-së.

Treguesit e rezultateve ofrojnë informata thelbësore në lidhje me performancën e një projekti, e së bashku me të dhënat e inputeve me resurse, mundësojnë që të vlerësohen edhe faktorët si efektshmëria mbi kosto. Është me rëndësi të theksohen ndërlidhjet midis masave, rezultateve dhe qëllimeve strategjike të PVQGJ-së, për të demonstruar qartë se këto janë duke u realizuar. Një shembull i vlerësimit të ndikimit të një skeme të tillë është dhënë më poshtë, me fokus tek zhvillimi i investimeve për çiklizëm në të gjithë qytetin (Masa T4), si dhe ndikimet dhe kontributet që kjo masë ofron kundrejt qëllimeve strategjike të PVQGJ-së.

Tabela 7.4 Ndërlidhja shkakore zinxhirore midis veprimeve të PVQGJ-së dhe qëllimeve strategjik



7.7 Raporti Vjetor & Planifikimi i Veprimeve të PVQGJ-së në të Ardhmen

Në bazë të vlerësimit të veprimeve individuale, performancës së tyre për sa i përket kontributit në përmbushjen e caqeve dhe qëllimeve strategjike në PVQGJ, plani mund të ketë nevojë për modifikime. Ngjarje të paparashikueshme mund të ndikojnë në planin e zbatimit të PVQGJ-së, për shembull, një vërshim i madh në qytet mund të shkaktojë që Komuna t'i japë përparësi riparimeve kritike të infrastrukturës rrugore duke lënë anash ndonjë nga investimet e tjera të planifikuara.

Si pjesë e planit të përgjithshëm të monitorimit të PVQGJ-së, proceset përkatëse të menaxhimit cilësor duhen zhvilluar e zbatuar për të regjistruar e ruajtur të dhënat në mënyrë qendrore dhe të qëndrueshme, për të ndihmuar në konfirmimin e atyre të dhënave me zyrtarët që udhëheqin Sektorët dhe Projektet. Çdo vit duhet të publikohet një Raport Monitorimi i PVQGJ-së, i cili do të jetë në dispozicion për palët e jashtme të interesit dhe publikun e gjerë. Ky do të ofrojë një përmbledhje të qartë dhe të lehtë për lexim të performancës dhe progresit në sektorët e PVQGJ-së, në kuptimin e zbatimit të veprimeve.

Varësisht nga progresi në realizimin e skemave të PVQGJ-së, mund të ketë nevojë për veprime korigjuese, të cilat pikësisht shqyrtohen nga Komiteti Drejtues i PVQGJ-së. Nëse nevojitet ndonjë ndryshim në Veprime apo plane investimesh në PVQGJ, Kryetari i Komunës, bashkë me Nënkryetarin, do të njoftohen dhe do t'iu kërkohet të marrin një vendim përfundimtar. Më pastaj, Asamblesë Komunale i duhet dorëzuar një plan i azhurnuar, bashkë me afatet zbatuese të ndryshuara, si dhe mjetet financiare të nevojshme për to, për miratim nga Asambleja.

Komiteti Drejtues i PVQGJ-së është përgjegjës për angazhimin me Zyrtarët/Udhëheqësit përkatës të Projekteve dhe Sektorëve, për të siguruar që azhurnimet/ndryshimet e tilla në planet e monitorimit të marrin aprovimet përkatëse. Do të ketë nevojë dhe për bashkëpunim të thellë me një numër subjektësh të jashtme në Prishtinë, për të siguruar që të dhënat për treguesit të grumbullohen në të gjithë sektorët, si dhe që të ketë bashkëpunim efektiv midis drejtorive brenda Komunës së

Prishtinës, për të harmonizuar veprimet e PVQGJ-së me aktivitetet e tjera të planifikuara në të gjithë qytetin.

Mott MacDonald - Referenca e Dokumentit: 100407427

Klasifikimi i informacionit:

Standardi

This document is issued for the party which commissioned it and for specific purposes connected with the above-captioned project only. It should not be relied upon by any other party or used for any other purpose.

We accept no responsibility for the consequences of this document being relied upon by any other party, or being used for any other purpose, or containing any error or omission which is due to an error or omission in data supplied to us by other parties.

This document contains confidential information and proprietary intellectual property. It should not be shown to other parties without consent from us and from the party which commissioned it.

Shtojcat



A. Të Dhënat Kryesore të Databazës së Treguesve

A.1 Treguesit e Gjendjes

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjëlber (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
1	Cilësia e aseteve mjedisore	Ajri	Koncentrimi mesatar vjetor i PM2.5	µg/m ³	Thelbësor	10	10 - 20	20	25	2016	29.3	KUQE
1.1	Cilësia e aseteve mjedisore	Ajri	Koncentrimi mesatar vjetor i PM10	µg/m ³	Opsionale	20	20 - 50	50	50	2016	37.01	PORTOKALLI
1.2	Cilësia e aseteve mjedisore	Ajri	Koncentrimi mesatar Ditor me SO ₂	µg/m ³	Opsionale	20	20 - 50	50	50	N/A	N/A	N/A
1.3	Cilësia e aseteve mjedisore	Ajri	Përqendrimi mesatar ditor i NOx	µg/m ³	Opsionale	40	40 - 80	80	40	N/A	N/A	N/A
1.1.1	Cilësia e aseteve mjedisore	Ajri	Përqendrimi mesatar vjetor i TSP	µg/m ³	Shtesë	30	30 - 70	70	N/A	N/A	N/A	N/A
2	Cilësia e aseteve mjedisore	Trupat Ujorë	Kërkesa biokimike e oksigjenit (BOD) në lumenj dhe liqene	mg/L	Thelbësor	2	2 - 4	4	25-80 bazuar në cilësinë e lumit	2018	6.4	KUQE
2.1	Cilësia e aseteve mjedisore	Trupat Ujorë	Përqendrimi i amoniakut NH ₄ në lumenj dhe liqene	mg/L	Opsionale	0.15	0.15 - 0.2	0.2	0.2-1 bazuar në cilësinë e lumit	2018	0.14	E GJELBËR
3	Cilësia e aseteve mjedisore	Uji i pijes	Përqindja e mostrave të ujit në një vit që përputhen me standardet kombëtare të	%	Thelbësor	97%	97% - 90%	90%	97	N/A	98,9	E GJELBËR

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjellbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
4	Cilësia e aseteve mjedisore	Dheu	Numri i zonave të kontaminuara	CSs / 1000 inh (ose km ²)	Thelbësor	10	10 - 20	20	N/A	N/A	N/A	N/A
4.1.a	Cilësia e aseteve mjedisore	Dheu	Përqendrimi i merkurit në dhe	mg/kg	Opsionale	0.3	0.3 - 10	10	1.5	N/A	N/A	N/A
4.1.b	Cilësia e aseteve mjedisore	Dheu	Përqendrimi i kadmiumit në dhe	mg/kg	Opsionale	0.8	0.8 - 12	12	3	N/A	N/A	N/A
4.1.c	Cilësia e aseteve mjedisore	Dheu	Përqendrimi i zinkut në dhe	mg/kg	Opsionale	140	140 - 720	720	300	N/A	N/A	N/A
4.2	Cilësia e aseteve mjedisore	Dheu	Përqendrimi i vajit mineral në tokë duke përdorur spektroskopinë infra të kuqe	mg/kg	Opsionale	50	50 - 5000	5000		N/A	N/A	N/A
5	Disponueshmëria e resurseve	Përdorimi i ujit	Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit	%	Thelbësor	20%	20% - 40%	40%	13	N/A	N/A	N/A
6	Disponueshmëria e resurseve	Hapësira e gjellbër	Raporti i hapësirave të lira të gjelbra për 100,000 banorë	m ² /frymë	Thelbësor	10	10 - 7	7	N/A	N/A	127,6	E GJELBËR
6.1	Disponueshmëria e resurseve	Hapësira e gjellbër	Pjesa e zonave të gjelbra brenda kufijve urbanë	%	Opsionale	50%	50% - 30%	30%	N/A	N/A	26	KUQE
7	Disponueshmëria e resurseve	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Bollëku i specieve të shpendëve, të gjitha llojeve	Përqindja vjetore e ndryshimit	Thelbësor	0%	më pak se 2% rënie	-2%	N/A	N/A	N/A	N/A
7.1	Disponueshmëria e resurseve	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Prania e specieve të tjera	Përqindja vjetore e ndryshimit	Opsionale	0%	më pak se 2% rënie	-2%	N/A	N/A	N/A	N/A
8	Rreziqet nga Ndryshimet klimatike	Zbutja e emetimeve të GS	Emetimet vjetore të ekuivalentit të CO ₂ për frymë	Tonë / vit / kokë banori	Thelbësor	5	5 - 10	10	4.98	2016	4.98	E GJELBËR
8.1	Rreziqet nga Ndryshimet klimatike	Zbutja e emetimeve të GS	Emetimet vjetore të CO ₂ për njësi të PVB-së	Tonë / m. USD të PVB-së	Opsionale	0.35	0.35 - 0.8	0.8	1.1	N/A	0,48	PORTOKALLI

ID#	Tipi/Sektor	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjellbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
9	Rreziqet nga Ndryshimet klimatike	Përshtatja e Rezistencës ndaj rrezikut të katastrofave natyrore	Dëmi i vlerësuar ekonomik nga katastrofat natyrore, përmytjet, thatësirat, tërmetet etj, si pjesë e PVB-së	%	Thelbësor	0,50%	0.5% - 1%	1.00%	N/A	N/A	N/A	N/A
9,1	Rreziqet nga Ndryshimet klimatike	Përshtatja e Rezistencës ndaj rrezikut të katastrofave natyrore	Përqindja e infrastrukturës publike në rrezik	%	Opsionale	10%	10% - 20%	20%	N/A	N/A	N/A	N/A
9,2	Rreziqet nga Ndryshimet klimatike	Përshtatja e Rezistencës ndaj rrezikut të katastrofave natyrore	Përqindja e ekonomive familjare në rrezik	%	Opsionale	10%	10% - 20%	20%	N/A	N/A	N/A	N/A
Shto	Cilësia e asetëve mjedisore	Ajri	Përqendrimi mesatar mujor i SO2	µg/m3	Shtesë	20	20 - 50	50		2016	20.98	PORTOKALLI
Shto	Cilësia e asetëve mjedisore	Ajri	Përqendrimi mesatar ditor i NO2	µg/m3	Shtesë	40	40 - 80	80		2016	41.46	PORTOKALLI
Shto	Disponueshmëria e resurseve	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Numri total i specieve të shpendëve	No	Shtesë					2014	62	N/A
Shto	Disponueshmëria e resurseve	Biodiversiteti dhe ekosistemet	Numri total i specieve të tjera	No	Shtesë					2014	31	N/A
Shto	Cilësia e asetëve mjedisore	Dheu	Zona e tokës bujqësore të kontaminuar	ha	Shtesë					2015	0	N/A

A.2 Treguesit e Trysnisë

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
10	Transporti	Efiçienca e energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur	Mosha mesatare e flotës së automjeteve gjithsej, si dhe sipas llojit	Vite	Thelbësor	6	6-12	12	10	2018	13	KUQE
10,1	Transporti	Efiçienca e energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur	Përqindja e automjeteve dizel në flotën e përgjithshme të automjeteve	%	Opsionale	20%	20%-30%	30%		2018	62	KUQE
10,2	Transporti	Efiçienca e energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur	Standardet e karburanteve për automjete të lehta udhëtarësh dhe automjete komerciale	EURO	Opsionale	6	5	4		2018	4	KUQE
10,3	Transporti	Efiçienca e energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur	Përqindja e automjeteve të udhëtarëve me energji elektrike, qeliza hibride lëndësh djegëse, gaz të lëngshëm naftë (LPG) dhe gaz natyror të kompresuar (CNG) (gjithsej dhe sipas llojit)	%	Opsionale	3%	1%-3%	1%		2018	1.1	PORTOKALLI
11	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Shfrytëzimi i përbashkët i mënyrave të transportit, automjete, motoçikleta, taksi, autobus, metro, tramvaj, biçikletë, këmbësorë	Transporti privat %	Thelbësor	30%	30-50%	50%		2018	51	KUQE
11,1	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Përqindja e mënyrave të të ndryshme të transportit gjatë të gjitha udhëtimeve	%	Opsionale	30%	30-50%	50%		2018	51	KUQE
11,2	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Shkalla e motorizimit	Numri i automjeteve për frymë	Opsionale	0.3	0,3-0,4	0,4		2018	0.35	PORTOKALLI
11,3	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Numri mesatar i automjeteve dhe motoçikletave për familje	Numri i automjeteve për familje	Opsionale	0.5	0,5-1	1		2018	1.5	KUQE

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (në e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
11,4	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Kilometra rrugë dedikuar ekskluzivisht për transport publik për 100000 banorë	km	Opsionale	40	10-40	10		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
11,5	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Kilometra shtigje për biçikleta për 100,000 banorë	km	Opsionale	25	15-25	15		2018	14.9	KUQE
11,6	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Pjesa e popullsisë me qasje në transport publik në më pak se 15 minuta në këmbë	%	Opsionale	80%	60%-80%	60%		2018	77	PORTOKALLI
11,7	Transporti	Zgjedhja e mënyrës së transportimit	Shpeshësia e shërbimit të autobusëve	Numri mesatar i udhëtarëve në stacion në orë, në rrjetin total të autobusëve	Opsionale	30	30-6	6		2018	50	GJELBËR
12	Transporti	Trafiku i ngarkuar në rrugë	Shpejtësia mesatare e udhëtimit të përgjithshëm primar gjatë orarit të pikut	km/h	Thelbësor	30	15-30	15		2018	13	KUQE
12,1	Transporti	Trafiku i ngarkuar në rrugë	Shpejtësia mesatare ditore e udhëtimit me autobusë në rrugët kryesore	km/h	Opsionale	25	15-25	15		2018	18	PORTOKALLI
13	Transporti	Qëndrueshmëria e sistemeve të transportit	Ndërprerja e sistemeve të transportit publik në rast fatkeqësie	n.a.	Thelbësor	Sistemet e autobusëve dhe hekurudhave tranzit janë në gjendje të funksionojnë normalisht në rast katastrofash	Sistemet e autobusëve dhe hekurudhav e tranzit janë në gjendje të funksionojnë në rast katastrofash, por me efikasitet të ulur	Sistemet e autobusëve dhe hekurudhav e tranzit nuk janë në gjendje të funksionojnë në rast katastrofash		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
13.1	Transporti	Qëndrueshmëria e sistemeve të transportit	Efikasiteti i sistemeve emergjente të transportit në rast fatkeqësie	n.a.	Opsionale	Emergency transport systems are able to run normally in case of disaster	Emergency transport systems are able to run in case of disaster, but with limited efficiency	Emergency transport systems are not able to run properly in case of disaster		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
14	Ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike nga ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike brenda ndërtesave	kWh / m ²	Thelbësor	47	47 – 75	75		2012	23.76	GJELBËR
14.1	Ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike nga ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike në objekte banesore	kWh / m ²	Opsionale	21	21 – 26	26		2012	163.82	KUQE
14.2	Ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike nga ndërtesat	Konsumi i energjisë elektrike në objekte jo-banesore	kWh / m ²	Opsionale	122	122 – 213	213		2012	157.03	PORTOKALLI
15	Ndërtesat	Konsumi i karburantit fosil për ngrohje	Konsumi i ngrohjes ftohjes në ndërtesa, lëndët djegëse fosile në objekte banimi, lëndët djegëse fosile	kWh / m ²	Thelbësor	104	104 – 148	148		2012	126.52	PORTOKALLI
15.1	Ndërtesat	Konsumi i karburantit fosil për ngrohje	Konsumi i ngrohjes/ftohjes në objekte banimi, lëndë djegëse fosile	kWh / m ²	Opsionale	96	96 – 126	126		2012	218.93	KUQE
15.2	Ndërtesat	Konsumi i karburantit fosil për ngrohje	Konsumi i ngrohjes/ftohjes në objekte jo-banesore, lëndë djegëse fosile	kWh / m ²	Opsionale	127	127 – 210	210		2012	176.4	PORTOKALLI
15.3	Ndërtesat	Standardet e Ndërtesave	Pjesa e ndërmarrjeve të qytetit me certifikatë ISO50001/EMAS ose të ngjashme	%	Opsionale	NA	NA	NA		2012	0	KUQE
15.4	Ndërtesat	Standardet e Ndërtesave	Vlera totale e projekteve me certifikim të gjelblër të ndërtimit si pjesë e vlerës totale të	%	Opsionale	50%	25-50%	25%		2012	0	KUQE

ID#	Tipi/Sektor	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjellbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
			projekteve që marrin një leje ndërtimi në vit									
16	Industria	Konsumi i energjisë elektrike nga Industria	Konsumi i energjisë elektrike në industri për njësi të PBB-së industriale	kWh / 2010 USD	Thelbësor	0.3	0.3 - 0.4	0,4		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
17	Industria	Konsumi i ngrohjes	Konsumi i nxehtësisë në industri për njësi të PBB-së industriale	MJ / 2010 USD	Thelbësor	0.1	0.1 – 0.25	0.25		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
18	Industria	Konsumi i lëndëve fosile në proceset industriale	Intensiteti i emetimit të metaleve të rënda Pb nga industritë prodhuese	Kg ekuivalentë të metaleve të rënda të liruara për milion USD GVA	Thelbësor	0.02	0,02-0,04	0,04		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
18.1	Industria	Konsumi i lëndëve fosile në proceset industriale	Djegia e karburantit fosil në proceset industriale për njësi të PBB-së industriale	MJ / USD	Opsionale	1.4	1.4 – 2.2	2.2		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
18.2	Industria	Konsumi i lëndëve fosile në proceset industriale	Pjesa e konsumit të energjisë industriale nga energjia e ripërtërishme	%	Opsionale	20%	10%-20%	10%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
19	Industria	Trajtimi i mbetjeve industriale	Përqindja e mbeturinave industriale të ricikluara si pjesë e mbeturinave totale industriale të prodhuara	%	Thelbësor	95%	80 – 95% (90%)	80%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
20	Industria	Ujërat e zeza industriale	Përqindja e ujërave të ndotura industriale që trajtohen sipas standardeve kombëtare në fuqi	%	Thelbësor	60%	40%-60%	40%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
21	Energjia	Furnizimi i energjisë elektrike	Përqindja e popullatës me kycje të autorizuar në energji elektrike	%	Thelbësor	90%	70%-90%	70%		NA	100	GJELBËR
21.1	Energjia	Furnizimi i energjisë elektrike	Numri mesatar vjetor i ndërprerjeve elektrike për konsumator	# / në vit / konsumator	Opsionale	10	10-13	13		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjellbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
22	Energjia	Furnizimi i energjisë termike	Përqindja e popullsisë me qasje në ngrohje/ftohje	%	Thelbësor	90%	70%-90%	70%		NA	91	GJELBËR
23	Energjia	Zhvillimi i sigurimit të energjisë së rinovueshme	Raporti i energjisë totale që fitohet nga BRE-të si përqindje e konsumit total të energjisë së qytetit në TJ	%	Thelbësor	20%	10%-20%	10%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
24	Energjia	Qëndrueshmëria e rrjetit të energjisë elektrike në klimë ekstreme	Përqindja mesatare e popullsisë që ka pësuar ndërprerje të zgjatura të energjisë në raste të klimës ekstreme në 5 vitet e fundit	%	Thelbësor	10%	10%-25%	25%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
25	Uji	Konsumi i ujit	Konsumi i ujit për kokë banori	L / ditë / kokë banori	Thelbësor	120-200	80–200 or 200-250	< 80; > 250		NA	128	GJELBËR
25.1	Uji	Konsumi i ujit	Konsumi i ujit për njësi të BPV-së së qytetit	L / ditë / USD	Opsionale	0.022	0.022 – 0.055	0.055		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
25.2	Uji	Konsumi i ujit	Njësi uji konsumuar në termocentrale për njësi të energjisë primare të gjeneruar	l / MW / h	Opsionale	Shih Shtojcën 9	Shih Shtojcën 9	Shih Shtojcën 9		2018	3.19	GJELBËR
25.3	Uji	Konsumi i ujit	Konsumi i ujit industrial si përqindje e konsumit të përgjithshëm urban të ujit	%	Opsionale	17%	17 – 50%	50%		2018	30	PORTOKALLI
26	Uji	Efikasiteti i rrjeteve të ujësjellësit	Humbjet e ujit	%	Thelbësor	30%	30%-45%	45%		2018	55	KUQE
26,1	Uji	Efikasiteti i rrjeteve të ujësjellësit	Mesatarja vjetore e numrit ditor të orëve të furnizimit me ujë të pandërprerë për ekonomi familjare	h/day	Opsionale	20	12-20	12		2018	23.8	GJELBËR
27	Uji	Trajtimi i ujërave të zeza	Përqindja e ujërave të zeza urbane dhe komerciale që trajtohen sipas standardeve kombëtare në fuqi	%	Thelbësor	60%	40%-60%	40%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
27.1	Uji	Trajtimi i ujërave të zeza	Përqindja e ndërtesave jo industriale të pajisura për të ripërdorur ujin gri	%	Opsionale	80%	60%-80%	60%		NA	0	KUQE
27.2	Uji	Trajtimi i ujërave të zeza	Përqindja e ujërave të zeza nga aktivitetet e prodhimit të energjisë të cilat trajtohen sipas standardeve shtetërore në fuqi	%	Opsionale	60%	40%-60%	40%		NA	0	KUQE
28	Uji	Qëndrueshmëria ndaj përmbytjeve	Përqindja e banesave të dëmtuara nga përmbytjet më intenzive në 10 vitet e fundit	%	Thelbësor	0,50%	0,5%-3%	3%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
28.1	Uji	Qëndrueshmëria ndaj përmbytjeve	Numri i vjetor i ujit të rreshjeve ose vërshimeve të kanalizimeve për 100 km gjatësi të rrjetit	Numri i ngjarjeve në vit	Opsionale	20	20-50	50		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
28.2	Uji	Qëndrueshmëria ndaj përmbytjeve	Ndërgjegjësimi dhe gatishmëria ndaj fatkeqësive natyrore	n.a.	Opsionale	Qytetarët janë të vetëdijshëm për rrezikun e katastrofës natyrore dhe dinë si të reagojnë	Qytetarët janë të vetëdijshëm për rrezikun e katastrofës natyrore por nuk kanë qëndrime rezistente	Qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet e katastrofave natyrore dhe nuk kanë qëndrime rezistente		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
29	Mbeturinat inerte	Prodhimi i mbeturinave inerte	Gjenerimi total i mbetjeve të ngurta për frymë	Tonë / vit / kokë banori	Thelbësor	300	300-500	500		2018	338	PORTOKALLI
29.1	Mbeturinat inerte	Prodhimi i mbeturinave inerte	BPV për konsum vendor material	USD / kg	Opsionale	1	1-2,5	2,5		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
30	Mbeturinat inerte	Grumbullimi i mbeturinave inerte	Pjesa e popullsisë me mbledhje javore të mbetjeve të ngurta komunale (MNK)	%	Thelbësor	90%	80%-90%	80%		2018	100	GJELBËR

ID#	Tipi/Sektor	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
31	Mbeturinat inerte	Trajtimi i mbeturinave inerte	Proporcioni i Mbetjeve Komunale te Ngurta (MNK) që klasifikohet dhe riciklohet, në total dhe sipas llojit të mbetjeve p.sh. bateri, qelqi, letre, shishe, PVC, metale.	%	Thelbësor	25%	15%-25%	15%		NA	1	KUQE
31,1	Mbeturinat inerte	Trajtimi i mbeturinave inerte	Përqindja e Mbetjeve Komunale te Ngurta (MNK) që hidhet në deponi të hapura, deponi të kontrolluara, trupa uji, ose që digjen	%	Opsionale	10%	10%-20%	20%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
31,2	Mbeturinat inerte	Trajtimi i mbeturinave inerte	Përqindja e mbeturinave të mbetjeve të ngurta komunale (MNK) të cilat deponohen në përputhje me standardet e BE-së për deponitë sanitare	%	Opsionale	90%	80%-90%	80%		2018	70	KUQE
31,3	Mbeturinat inerte	Trajtimi i mbeturinave inerte	Përqindja e mbeturinave solide të grumbulluara dhe të kompostuara	%	Opsionale	20%	5%-20%	5%		2018	4	KUQE
32	Mbeturinat inerte	Kapaciteti i efikasitetit të deponive	Jetëgjatësia e mbetur e deponive aktuale	Vite	Thelbësor	8	5-8	5		2018	1	KUQE
33	Shfrytëzimi i tokës	Dendësia e shfrytëzimit të integruar të tokës	Dendësia e popullsisë në zonën urbane	Banorë / km2	Thelbësor	7.000-20.000	4,000-7,000; 20,000-25,000	<4,000; >25,000		2018	4891	PORTOKALLI
33,1	Shfrytëzimi i tokës	Dendësia e shfrytëzimit të integruar të tokës	Distanca mesatare e udhëtimeve	km	Opsionale	5	5-10	10		NA	6.7	PORTOKALLI
33,2	Shfrytëzimi i tokës	Dendësia e shfrytëzimit të integruar të tokës	Kohëzgjatja mesatare e udhëtimeve	Min	Opsionale	30	30-60	60		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
33,3	Shfrytëzimi i tokës	Dendësia e shfrytëzimit të integruar të tokës	Përmasat e popullatës që jeton në 20 minuta distancë nga shërbimet e përditshme dyqane ushqimore klinika etj.	%	Opsionale	75%	50%-75%	50%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR

ID#	Tipi/Sektori	Tema/Burimi	Indikatorët	Njësia	Klasifikimi	Standardi i Gjelbër (i mirë)	Standardi i Verdhë (shqetësuese)	Standardi i Kuq (kritike)	Standardi Normal	Viti i fundit me të dhëna të qasshme	Vlera e treguesit (më e fundit e qasshme)	Flamuri i treguesit
34	Shfrytëzimi i tokës	Përhapja urbane	Shkalla mesatare e rritjes vjetore të zonave të ndërtuara	%	Thelbësor	3%	3%-5%	5%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
34.1	Shfrytëzimi i tokës	Përhapja urbane	Përqindja e zhvillimit urban që ndodh në tokat ekzistuese urbane, e jo në toka të pazëna	%	Opsionale	40%	20%-40%	20%		2012	41	GJELBËR
35	Shfrytëzimi i tokës	Shfrytëzimi i zonave ekzistuese të ndërtuara	Shkalla e përdorimit të hapësirave afariste	%	Thelbësor	6%	6 – 10%	10%		NA	Nuk ka të dhëna	PA FLAMUR
35.1	Shfrytëzimi i tokës	Shfrytëzimi i zonave ekzistuese të ndërtuara	Përqindja e objekteve shumëkatëshe në totalin e njësive banesore	%	Opsionale	NA	NA	NA		NA	61	PA FLAMUR

B. Përmbledhje e Strategjive dhe Planeve Kryesore

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Programe Gjithëpërfshirëse					
Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH)	Shtetërore	2016-2021	Program Strategjik	Strategjia 5-vjeçare e Zhvillimit Kombëtar për 2016-2021 është një dokument i përgatitur nga institucionet e Kosovës, nën rolin udhëheqës dhe koordinues të Zyrës së Planifikimit Strategjik (ZPS) të mandatuar nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me mbështetjen teknike të Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (2016-2021) përfaqëson një listë të përparësive kryesore. Ky është një dokument që synon të adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës. Krijimi i një dokumenti të tillë bazohet në parimin se një nga pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik është koordinimi i politikave të zhvillimit dhe proceseve institucionale, siç identifikohen nga institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. SKZH-ja strukturalisht është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Shtyllat e Industrive Konkurruese dhe të Infrastrukturës përshkruajnë drejtimet e zhvillimit të sektorit industrial (shfrytëzimi i potencialit mineral, përpjekjet për rigjallërimin e Trepçës), sektorit të energjisë (zhvillimi i kapaciteteve të reja të qëndrueshme të gjenerimit të energjisë, krijimi i një tregu të hapur të energjisë, zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i burimeve të ripërtëritshme), infrastruktura hekurudhore dhe rrugore, zhvillimi i agrobiznesit, përdorimi racional i burimeve ujore dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe mbeturinave.	Forcimi institucional i politikës makroekonomike, Kapitali Njerëzor, Qeverisja e Zotit & Sundimi i Ligjit, Konkurrenca, Infrastruktura, Menaxhimi i burimeve të Qëndrueshme

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA)	Shtetërore	2016	Program Strategjik	MSA, duke qenë marrëveshja e parë kontraktuale midis dy palëve, përfaqëson një fazë të re të marrëdhënieve politike midis Kosovës dhe BE. Si një marrëveshje ndërkombëtare, ajo përcakton mekanizmat zyrtarë dhe afatet kohore për zbatimin e të gjitha reformave të cilat në mënyrë progresive do ta përafrojnë Kosovën me BE-në në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Për më tepër, MSA do të përcaktojë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me vendet anëtare të BE dhe institucionet për zbatimin e procesit të Stabilizim Asociimit (MSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Në lidhje me fushën e tij të Veprimit, përveç çështjeve politike dhe detyrimeve ligjore (përfshirë ato që ndikojnë në rendin e brendshëm juridik), MSA-ja mbulon të gjitha fushat e qeverisjes.	Dialogu politik; Bashkëpunimi rajonal; Lëvizja e lirë e mallrave; Furnizimi i shërbimeve dhe kapitalit; Përafrimi i ligjit të Kosovës me Acquis të BE-së, zbatimin e ligjit dhe rregullat e konkurrencës; Liria, Siguria dhe Drejtësia; Politikat e bashkëpunimit; Bashkëpunimi Financiar, dhe: Dispozitat Institucionale.
Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian të Kosovës 2020	Shtetërore	2012-2020	Program Strategjik	Kjo strategji synon të mbështesë aspiratat e Kosovës drejt anëtarësimit dhe integrimin në BE. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që deri në vitin 2020 Kosova të përgatitet më mirë për Integrimin Evropian. Për të arritur këtë qëllim, strategjia identifikon pesë objektiva prioritarë që duhet të arrihen: (i) Efektiviteti i qeverisjes; (ii) Lufta kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar; (iii) Zhvillimi ekonomik; (iv) Angazhimi i palëve të interesit; (v) Marrëdhëniet e avancuara (kontraktuale) me Bashkimin Evropian.	Integrimi Evropian, Efektiviteti i Qeverisjes, Korrupsioni dhe Krimi i Organizuar, Zhvillimi Ekonomik, Masat, Angazhimi i Palëve të interesit, etj.
Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin (PKVM)	Shtetërore	2013-2022	Program Strategjik	Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) konsiderohet si pjesë e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të vendit. SMK synon të sigurojë përgjigje për nevojat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë kosovare dhe adreson në mënyrë specifike detyrimet e menaxhimit mjedisor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. SMK përcakton objektivat dhe përparësitë që duhet të zbatohen përmes Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin (PKVM), kështu që mund të shihet si një strategji që duhet të harmonizohet me kërkesat sociale dhe ekonomike. Ndërkohë, gjithashtu të vetëdijshëm se ndërsa shtohet presioni mbi burimet natyrore dhe mjedisin,	Sfidat dhe Mbrojtja e Mjedisit, Burimet Natyrore, Zhvillimet & Kërkesat Sociale & Ekonomike, Objektivat, Ndryshimet Klimatike, Biodiversiteti, Bujqësia, Ajri, Uji, Toka, Trashëgimia Kulturore, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
				<p>duhet që masat për të mbrojtur këto burime - të tilla si ajri, uji, dheu, trashëgimia kulturore e kështu me radhë, janë edhe më të rëndësishme për brezat e ardhshëm. Dhe kjo është përgjegjësi e të gjithë qytetarëve. Nën një premisë të tillë, kjo strategji rekomandon një integrim të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët në Kosovë. PKVM përfshin masa dhe aktivitete për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe mjetet për zbatimin e tyre.</p>	
Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit (SKB)	Shtetërore	2011-2020	Program Strategjik	<p>Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin është një dokument themelor për mbrojtjen e natyrës, i cili përcakton objektivat afatgjata për ruajtjen e biodiversitetit dhe diversitetin e peizazhit, vlerën e mbrojtur të natyrës, dhe gjithashtu mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social, kulturor në Republikën e Kosovës. Strategjia identifikon veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave përmes Planit të Veprimit. Një hap i fundit brenda procesit përgatitor ishte përgatitja e planeve dhe projekteve për implementimin e veprimeve brenda pesë zonave pilot të zgjedhura të Kosovës. Kjo do të lejojë zbatimin në këto zona pilot, të cilat do të jenë më pak të kushtueshme dhe ku vështirësitë në nivelin lokal do të identifikohen përpara angazhimeve për zbatim në të gjithë vendin. Duke ditur faktin se kërcënimet kryesore për biodiversitetin janë aktivitetet njerëzore, kjo Strategji thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së njerëzve dhe menaxhimit të përbashkët të të gjitha aspekteve të ruajtjes së biodiversitetit. Prandaj, bashkëpunimi efektiv midis sektorëve të ndryshëm dhe partnerëve është jetik dhe sqarimi i roleve dhe përgjegjësi të të gjitha palëve të përfshira është i nevojshëm.</p>	<p>Biodiversiteti, Integrimi në BE, Speciet, Habitatet, Peizazhi, Mineralet, Zonat Fosile dhe të Mbrojtura, Bujqësia, Pylltaria, Gjuetia, Peshkimi dhe Turizmi, Ujërat, Transporti, Minierat dhe Energjia, Planifikimi Hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis</p>
Strategjia e Cilësisë së Ajrit dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Cilësisë së Ajrit	Shtetërore	2013-2022	Program Strategjik	<p>Politikat që lidhen me Strategjinë për Cilësinë e Ajrit synojnë të zhvillojnë dhe implementojnë instrumente specifike për të rritur nivelin e cilësisë së jetës, duke siguruar bazën për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Të sigurojë një kornizë me të cilën</p>	<p>Ndotja e Ajrit, Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, Ndikimi Ekonomik dhe Social, Ndikimet në Mjedis, Familja, Ngruhja Publike, Vlerësimi i Ndotjes së Ajrit nga</p>

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
				do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet e BE-së dhe parimet e praktikave më të mira. Strategjia, përfshin: parimet dhe kriteret për përcaktimin e qëllimeve dhe përparësive, vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit, objektivat dhe masat për të mbrojtur dhe përmirësuar cilësinë e ajrit, duke përfshirë masat prioritare, aktivitetet dhe dinamikën e implementimit të këtyre masave.	Energjia, Ndryshimi I Klimës, Gjenerimi Termo-Elektrik.
Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike	Shtetërore	2019-2028	Program Strategjik	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SNK) 2019-2028, përcakton politikat për uljen e emetimeve të gazrave serë (GS) dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo Strategji është hapi fillestar në procesin e politikës së menaxhimit të zbutjes së GS dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për dhjetë vitet e ardhshme. Është po ashtu mundësi për të nxjerrë masat lehtësuese dhe adaptuese që do të stimulojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Është e rëndësishme të reagojmë dhe parashikojmë ndikimet e ndryshimit klimatik në Kosovë. Ndërsa ndryshimi i klimës përfaqëson një sfidë të madhe, ajo gjithashtu paraqet një mundësi për inovacion në menaxhimin e burimeve ujore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një ekonomie moderne, veçanërisht me anë të Rritjeve / zhvillimeve të Reja (p.sh. energjia e erës dhe diellit, zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër, prodhimi (i qëndrueshëm) i biokarburanteve, djegia termike, riciklimi i ujërave të ndotura, dhe teknologjive për ndërtesat, transportin dhe industrive neutral prej karbonit	Ndryshimi Klimatik, Politikat, Korniza Ligjore, Përshtatja e Direktivave të BE-së, Emetimet e Gazeve Serë (GS), Menaxhimi i Zbutjes së GS, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Energjia Diellore, Infrastruktura E Gjelbër, Riciklimi i Ujërave të Zeza, etj.
Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë	Shtetërore	2017 - 2036	Program Strategjik	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë (SUK) është një dokument i planifikimit afatgjatë, i cili përmban vizionin, misionin, objektivat, qëllimin, veprimet, aktivitetet dhe masat për zhvillimin e politikës së ujit në Republikën e Kosovës, Strategjia Shtetërore e Ujërave rendit objektivat strategjike dhe orientimet për zhvillimin e resurseve ujore, bazuar mbi gjendjen ekzistuese të sektorit të ujërave, elaborimin e kërkesave, strukturat menaxhuese, detyrimet ndërkombëtare dhe	Përdorimi dhe Mbrojtja e Ujit, Ndryshimi Klimatik, Furnizimi me Ujë, Grumbullimi i Ujërave të Ndotura, Trajtimi i Ujërave të Ndotura, Ujitja, Kullimi, Menaxhimi i Rrezikut nga Përmbytja, Parandalimi i Erozionit dhe Gjenerimi i Energjisë Hidroelektrike, Investimet, Politikat dhe Rregulloret. Zhvillimi

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
				kërkesat për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe cilësisë së ujit, mbrojtja nga ujërat dhe mbrojtja e ekosistemeve ujorë. Ai do të shërbejë gjithashtu për të ndërlidhur planet e sektorëve të ndryshëm, veçanërisht të sektorit të planifikimit urban dhe hapësinor, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose indirekt me sektorin e ujit (furnizimi me ujë, shëndetësia, bujqësia, industria, energjia, turizmi, peshkimi, etj.) Strategjia mbulon një periudhë 20 vjeçare dhe do të vlejë për atë periudhë kohore të miratuar.	Institucional, Menaxhimi i Informacionit, Monitorimi i Mjedisit.
Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	Shtetërore	2013-2022	Program Strategjik	Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i masave, në bazë të të cilave Republika e Kosovës do të duhet të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që krijon aktualisht, si dhe të krijojë një sistem të qëndrueshëm të menaxhimit. Strategjia për Menaxhimin e Mbetjeve përcakton udhëzime dhe qëllime në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën dhjetë vjeçare (2013-2022), në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave dhe mundësitë ekonomike. Strategjia është një dokument që përfshin nivelet administrative qendrore dhe lokale dhe sektorë të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë në fushën e ujit, minierave, shëndetësisë, veterinarisë, planifikimit hapësinor, ndërtimit, industrisë etj.	Menaxhimi i Mbetjeve, Reduktimi i Prodhimit të Mbetjeve, Gjenerimi i Energjisë nga Mbeturinat, Riciklimi, Mbrojtja e Mjedisit, Politika dhe Direktivat e BE-së për Menaxhimin e Mbetjeve, etj.
Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës	Shtetërore	2017-2026	Program Strategjik	Strategjia e Energjisë e Kosovës 2017-2026 përcakton objektivat themelore të Qeverisë së Kosovës në zhvillimin e sektorit të energjisë, duke marrë parasysh zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, furnizimin e qëndrueshëm dhe të besueshëm të energjisë për klientët fundore, përdorimin efikas të energjisë, zhvillimin e kapacitetet gjeneruese konvencionale dhe të rinovueshme, krijimi i një tregu konkurrues, zhvillimi i sistemit të gazit dhe krijimi i vendeve të reja të punës në sektorin e energjisë. Ajo ka përcaktuar pesë objektiva strategjikë: 1. Siguria e furnizimit dhe stabiliteti i sistemit të energjisë; 2. Integrimi në tregun rajonal të energjisë; 3. Rritja e kapacitetit ekzistues të sistemeve termike dhe	Siguria e një furnizimi të qëndrueshëm, me cilësi të lartë, të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike me kapacitete adekuate për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të energjisë, integrimi në tregun rajonal të energjisë, rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemit termik dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja, zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror, efikasiteti i energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
				ndërtimi i kapaciteteve të reja; 4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; 5. Arritja e qëllimeve të efikasitetit të energjisë dhe energjisë së rinovueshme drejt detyrimeve ndaj Traktatit për Themelimin e KomNjësisë të Energjisë dhe MSA-së. Vëmendje e veçantë në program i kushtohet mbrojtjes së mjedisit.	mbrojtjen e mjedisit, forcimin e kornizës institucionale
Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë (ESIP)	Shtetërore	2018-2020	Implementimi i Programit	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020 është një dokument që paraqet aktivitetet e hollësishme për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026. Ai përfshin një listë me 27 objektiva specifike dhe 97 aktivitete të parashikuara për tu ndërmarrë për zhvillimin e sektorit të energjisë deri në vitin 2020. Projektet kryesore që parashikohen të zhvillohen gjatë kësaj periudhe janë: fillimi i ndërtimit të Termocentralit të ri Kosova e Re; fillimi i rehabilitimit të TC Kosova B; krijimin e një tregu të përbashkët me Republikën e Shqipërisë si një hap drejt integritit në tregun e EJK; zgjerimi i ngrohjes qendrore të Prishtinës si dhe Gjakovës; ndërmarrja e masave për të zvogëluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes, si dhe një sërë projektesh në fushën e efikasitetit të energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë si dhe mbrojtjen e mjedisit.	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social, Objektet e Gazifikimit, Mbeturinat, Ngrohja, Reduktimi i Emetimeve, Panelet Fotovoltaike, Turbinat me Erë, Termocentralet e Vogla, Pompat termike, Investimet, Korniza e Legjislacionit, etj.
Dokumenti i Strategjisë dhe Politikave të Kosovës për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë	Shtetërore	2010-2020	Dokument i Programit Strategjik & Politikave	Strategjia synon të qeverisë zhvillimin e pyjeve gjatë një periudhe dhjetëvjeçare të ardhshme. Objektivi i strategjisë dhe planifikimit të sektorit të pylltarisë është t'u sigurojë institucioneve shtetërore, publikut, sektorit privat dhe organizatave joqeveritare një informacion të saktë dhe me kohë në lidhje me statusin e burimeve pyjore, nevojat për ndërhyrje, etj. Sistemi i Planifikimit të Pyjeve përbëhet nga një numër modulesh të zhvilluara për të siguruar të gjitha këto lloje të informacionit: planifikimi strategjik, planifikimi i menaxhimit dhe planifikimi operacional.	Burimet dhe Menaxhimi i Pyjeve, Silvikultura, Menaxhimi i Informacionit, Mbrojtja e Mjedisit Pyjor, Grumbullimi dhe Transporti i Drurit, Ndërtimi i Kapaciteteve, Shfrytëzimi i Drurit - Zhvillimi i Industrisë Pyjore, Rregullimet Institucionale, Instrumentet e Politikave,
Strategjia e Kosovës për Konsolidimin e Tokës	Shtetërore	2010-2020	Program Strategjik	Strategjia e Konsolidimit të Tokës paraqet një udhëzim shumë të rëndësishëm dhe një dokument bazë të politikave dhe planeve të veprimit të	Burimet Bujqësore. Burimet Pyjore, Politika e Zhvillimit Rural, Partneriteti Publiko-Privat,

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Strategjia Sektoriale & Transportit Multimodal, dhe Plani 5-vjeçar i Veprimit.	Shtetërore	2015-2025	Programi Strategjik & Plani i Zbatimit	Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe menaxhimin e duhur të tokës. Strategjia e Konsolidimit të Tokës synon rregullimin e tokës për rritjen e madhësisë, shfrytëzimin më racional dhe rritjen e konkurrencës në fermë, rregullimin ligjor të pronës, planifikimin e shfrytëzimit të tokës, mbrojtjen e mjedisit, aktivitetet alternative në fermë, rritjen e të ardhurave të fermës dhe përmirësimin e jetës së popullsisë që jeton në zonat rurale. Konsolidimi i Tokës është një strategji me shumë qëllime që mund të përballet me të gjitha llojet e shqetësimeve të reja, kur trajton transformimin e tokës bujqësore në lokalitete. Mund të përkufizohet gjerësisht si ndryshimi i formës, pronësisë dhe shfrytëzimit të tokës - në të gjitha kuptimet.	Rregullimi Ligjor i Pronës, Planifikimi i Shfrytëzimit të Tokës, Mbrojtja e Mjedisit, Regjistrimi i Tokës, etj.
				Strategjia parashikon modele të zhvillimit të infrastrukturës së transportit, zbatimi i të cilave do t'i mundësojë vendit që të ketë një infrastrukturë të zhvilluar transporti dhe, njëkohësisht, të ketë qasje më të lehtë në tregjet ndërkombëtare të mallrave, shërbimeve dhe tregjeve të punës. Kjo strategji përcakton qartë objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit në përgjithësi, për ndërtimin e rrugëve moderne, të lidhura me korridoret pan-evropiane, ndërtimin e hekurudhës moderne, ajrit, infrastrukturës detare dhe infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke krijuar kushte për transport të sigurt dhe respektim të standardeve ndërkombëtare për ruajtjen e mjedisit. Përveç çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me infrastrukturën e transportit, ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e saj, strategjia parashikon gjithashtu aktivitete përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës, zbatimi i të cilave përkon dhe plotëson programin e Qeverisë për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të transportit.	Infrastruktura e Transportit, Shërbimet dhe Tregu i Punës, Transporti Multimodal, Korridoret Evropiane, Hekurudhat, Ajri, Infrastruktura Detare & Infrastruktura e Komunikimeve Elektronike, Ndërtimi i Kapaciteteve, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës	Shtetërore	2012-2025	Program Strategjik	Strategjia e Minerave është një dokument i përgatitur për të siguruar shfrytëzim real dhe racional të burimeve minerale me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve minerare. Ky dokument duhet të shërbejë si udhëzues për institucionet përkatëse në kryerjen e menaxhimit të përgjegjshëm të pasurive minerale dhe synon vlerësimin e burimeve ekzistuese të minierave dhe identifikimin e burimeve të reja minerale. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është krijimi i parakushteve për një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit minierar, i cili, nga ana tjetër, duhet të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies sociale në Republikën e Kosovës. Kjo strategji bazohet në katër shtylla themelore të cilat përcaktojnë se si institucionet përkatëse dhe sektori i minierave do të angazhohen në hulumtimin dhe zhvillimin e burimeve minerare dhe sektorin e minierave në përgjithësi.	Fuqizimi i Sektorit të Minerave, Miratimi i Legjislacionit, Reforma Ekonomike Strukturore dhe Edukimi i Gjeneratave të Reja, Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik, Tërheqja e Investimeve, Kapacitetet Njerëzore dhe Institucionale, etj.
Strategjia për Vetëqeverisje Lokale	Shtetërore	2016-2026	Program Strategjik	Strategjia për objektivat e vetëqeverisjes lokale është që (i) Të rrisë qëndrueshmërinë lokale ekonomike, sociale dhe strukturore për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modaliteteve financiare do të sjellin risi në zhvillimin e komunave; (ii) Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullim efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratën profesionale dhe efikase të komunave; (iii) Forcimi i kapaciteteve institucionale të qeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësime të qëndrueshme në shërbimet komunale për qytetarët; (iv) forcimi i partneritetit midis qeverisë lokale, shoqërisë civile dhe bizneseve me qëllim krijimin e një qytetarie aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive; dhe (v) Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe afirmimi i larmisë kulturore, etnike dhe gjuhësore në komuna për të ndikuar në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor.	Qeverisja Lokale, Qëndrueshmëria Sociale dhe Strukturore, Kapacitetet Institucionale, Shërbimet Komunale, Shoqëria Civile dhe Bizneset, Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore, Zhvillimi Ekonomik dhe Kulturor, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal (ZHEL)	Shtetërore	2019-2023	Program Strategjik	Strategjia ZHEL paraqet një dokument strategjik të bazuar në planin e veprimit që synon hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillimin ekonomik lokal. Ky dokument përcakton mënyrën sesi të realizohet vizioni për komunat me qeverisje efikase, arsim cilësor, mjedis të pastër, shëndet dhe mirëqenie sociale, mjedis të përshtatshëm të biznesit dhe bujqësi të zhvilluar në mënyrë që të përmirësohet cilësia e jetës. Strategjia mbështet ndërtimin e kapaciteteve qeverisëse, duke përmirësuar zbatimin e ligjit, duke krijuar klimë partneriteti me bizneset, mundësi për aktivitete rinore dhe hapësirë për grupe të marginalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale. Kjo strategji adreson aspekte të zhvillimit ekonomik lokal që janë të orientuara drejt partneritetit me të gjithë aktorët e interesuar, duke synuar rritjen e punësimit, uljen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësive të jetesës.	Qeverisja Lokale Efiçente, Zbatim i Ligjit, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, Kapacitetet Institucionale, Shërbimet Komunale, Shoqëria Civile dhe Bizneset, Partneriteti i Palëve të Interesit, Ulja e Varfërisë, Zhvillimi Ekonomik dhe Kulturor, etj.
Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i Prishtinës	Lokale	2012-2022	Plani Zhvillimor i Qytetit	Ky është një plan multi-sektorial që përcakton caqet afatgjata për qytetin për të arritur zhvillimin ekonomik, social dhe hapësinor, me planin që mbulon të gjithë zonën e komunës, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale.	Zhvillimi Ekonomik, Social, Arsimi, Shëndetësia, Transporti, Sportet, Rinia, Tregtia, Zonat e Biznesit, etj.
Planet Sektoriale					
Plani i Veprimit për Biodiversitet	Shtetërore	2011 - 2020	Plani i veprimit	Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) identifikojnë problemet kryesore dhe renditin zgjidhjet e ndërlidhura (veprimet strategjike) duke siguruar drejtimin e Objektivave Strategjike, të cilat duhet të adresohen në Planin e Veprimit. Nën secilin Objektiv Strategjik, renditen disa Masa, dhe përshkruhen aktivitetet ose projektet. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës përcakton qartë formatin e Planit të Veprimit, të nevojshëm për qëllime praktike të planifikimit dhe financimit. Plani i veprimit identifikon aktivitetet specifike, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse, burimet e siguruar ose të mundshme të financimit dhe kornizën kohore të implementimit.	Biodiversiteti, Integrimi në BE, Speciet, Habitatet, Peizazhi, Mineralet, Zonat Fosile dhe të Mbrojtura, Bujqësia, Pyltaria, Gjuetia, Peshkimi dhe Turizmi, Ujërat, Transporti, Minierat dhe Energjia, Planifikimi Hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Plani i Veprimit për Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike (PVNK)	Shtetërore	2018-2020	Plani i Veprimit	Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (PVNK) për zbatimin e Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike, 2019-2021, paraqet aktivitete të hollësishme për zbatimin e masave të parashikuara në strategjinë e ndryshimit të klimës. Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019-2021 paraqet një listë të 11 objektivave specifike dhe 28 aktiviteteve që pritet të ndërmerren për të zvogëluar gazrat serë dhe për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike deri në vitin 2021. Planifikimi i terrenit për të përmirësuar balancën e ujit; Themelimi i Eco-fond; Organizimi i programeve të Shëndetit Publik për të adresuar rreziqet shëndetësore nga ndikimet e ndryshimeve të klimës, si dhe një numër projektesh që do të kontribuojnë në zvogëlimin e gazrave serë dhe krijimin e kushteve për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike.	Ndryshimi Klimatik, Politikat, Korniza Ligjore, Përshtatja e Direktivave të BE-Së, Emetimet e Gazeve Serë, Menaxhimi i Zbutjes së GS, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Energjia Diellore, Infrastruktura e Gjellbër, Riciklimi i Ujërave të Zeza, etj.
Plani Kombëtar i Reduktimit të Emisioneve	Shtetërore	2018-2027	Plani i veprimit	Ky dokument ofron përshkrimin e një Plani Kombëtar të Reduktimit të Emetimeve (PKRE) për të zvogëluar emetimet e ndotësve kryesorë nga impiantet e mëdha me djegie dhe ka të bëjë me synimet e zvogëlimit të emisioneve për impiantet ekzistuese të djegies me një input termik të vlerësuar prej 50MW ose më shumë, të cilave u ishte dhënë leja për emetimet para 31 Dhjetor 1992. Për secilin impiant me djegie, të përfshirë në PKRE, ky dokument specifikon kohën për të arritur kërkesat e Direktivave 2010/75/EU1 për oksidet e azotit (NOx), dioksidit të squfurit (SO2) dhe pluhurit. Për operatorët që operojnë impiantin e djegies dhe grupet e tyre, PKRE përfshin kufijtë e emetimeve të përgjithshme vjetore të paktën prej SO2, NOx dhe pluhurit. PKRE i Kosovës përfshin Termo-Centralet Kosova A dhe B, sepse ata nuk kanë arritur në kohën e duhur për të përmbushur kriteret e vendosura nga D/2001/80 EC, për këtë arsye është vendosur që të marrë pjesë në këtë mekanizëm derogimi/shmangie nga pajtueshmëria e menjëhershme me vlerat kufitare të emetimit të Direktivës 2010/75/EU.	Reduktimi i Emetimeve, Impiantet e Djegies, Mekanizmi i Derogimit/Shmangies, Efektet Mjedisore, Vlerat Tavan të Emetimeve Totale të Pluhurit.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE)	Shtetërore	2011-2020	Plani i veprimit	PKVBRE përmban një analizë të arritjeve kundrejt objektivit kombëtar sipas sektorëve (energji elektrike, ngrohja dhe ftohja, dhe transporti) dhe në tërësi, informacion në lidhje me masat e ndërmarra për të promovuar përdorimin e BRE-ve dhe analizën e efikasitetit të tyre, progresin në heqjen e pengesave administrative për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, masat për përmirësimin e transmetimit dhe shpërndarjes brenda sistemit të energjisë elektrike për të mundësuar integrimin më të madh të objekteve/stabilimenteve duke përdorur burime të ripërtëritshme të energjisë, vlerësimin e kursimit të gazrave serë që rezultojnë nga rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe të gjitha të dhënat e tjera përkatëse të kërkuara nga neni 22 i Direktivës 2009/28/EC.	Politikat e Energjisë së Rinovueshme, Synimet, Konsumi, Zhvillimi i Infrastrukturës Elektrike, Investimet, Funkionimi i Rrjetit, Hidrocentrali, Infrastruktura e Ngrhjes dhe Ftohjes Qendrore, Biokarburantet & Biolikuidet të tjera - Qëndrueshmëria
Plani i 3-të Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë (PKVEE)	Shtetërore	2016-2018	Plani i veprimit	Plani i 3-të Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë në Kosovë (PKVEE) 2016-2018, ka për qëllim të jetë një dokument sektorial më i përparuar dhe më gjithëpërfshirës në ekonominë e Kosovës, në përputhje me strategjinë kombëtare dhe objektivat politikë të Kosovës dhe në përputhje me Direktivën e Eficiencës së Energjisë (DEE). Implementimi i masave të eficiencës së energjisë do të kontribuojë në uljen e konsumit të brendshëm. Reduktimi i konsumit të energjisë do të shërbente për të ulur koston e energjisë dhe si rezultat do të ndihmojë bizneset dhe do të rrisë investimet në sektorin privat.	Reduktimi i konsumit të energjisë, sistemi i transmetimit të energjisë dhe zvogëlimi i humbjeve të transmetimit, Balanca Afatgjatë e Energjisë, Kërkesa dhe Prodhimi i Energjisë, Kursimi i Energjisë, etj.
Plani Hapësinor i Kosovës / Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	Shtetërore	2010-2020+	Programi Strategjik & Plani Rregullator	Plani Hapësinor i Kosovës është dokumenti i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim të përshpejtuar ekonomik, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës, por njëkohësisht mbrojtjen e burimeve, trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Plani ndihmon zhvillimin e zgjerimit hapësinor në nivel kombëtar, komunal dhe urban, hartimin e Strategjisë së Përgjithshme për Zhvillim të Kosovës. Ai udhëzon sektorët dhe agjencitë qeveritare në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe vendimeve për investimet publike me një dimension	Demografia dhe Zhvillimi Shoqëror, Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës, Strehimi, Uji, Toka, Pyjet, Trashëgimia Kulturore & Natyrore, Përmbytjet, Erozioni, Turizmi, Energjia, Ndryshimet Klimatike, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Plani i Veprimit për Konsolidimin e Tokës	Shtetërore	2010-2020	Plani i veprimit	të veçantë hapësinor dhe mbështet zhvillimin e ekuilibruar midis zonave të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.	Zonat Kadastrale, Konsolidimi i Tokave, Buxhetimi, Rritja e Kapacitetit dhe Aftësive, Kriteret e Përzgjedhjes, Veprimet, etj.
Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës (PZHK)	Lokale	2012-2022	Plani Zhvillimor	Ky është një plan strategjik shumë sektorësh që përcakton qëllimet afatgjata për menaxhimin dhe zhvillimin e zonës urbane. Qëllimi i përgjithshëm është përmirësimi i kushteve brenda qytetit përmes identifikimit të problemeve kryesore dhe zhvillimit më pas të një sërë planesh veprimi sektorial për të adresuar këto çështje. Plani synon të adresojë sfidat me të cilat përballen qytetarët dhe zonat urbane të Prishtinës, të cilat janë të shumta duke përfshirë ndërtimet ilegale, të cilat dita ditës e bëjnë më të vështirë jetën urbane, si; bllokim trafiku, mungesë hapësirash të gjelbra, mungesë parkimi, zhurmë, ndotje mjedisore nga automjetet, mungesë e infrastrukturës adekuate etj. Planet Rregulluese Urbane (PRU) përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat për vendndodhjen e ndërtesave në parcela specifike të tokës urbane. Plani Zhvillimor Komunal është baza për çdo PRU, dhe Planet Rregulluese brenda Komunës së Prishtinës janë hartuar për zonat vijuese: Arbëria III, Dardania, Dodona, Kalabria, Lakrishte, Mati I, Mati III, Medrese-Çamëri, Muhaxherët, Pejtoni , Prishtina e Re (3 zona: Lindje, Qendër, Perëndim) Qendra 1, Qendra 2, Ulpiana, Sofalia, Tophane, Zona Ekonomike, Kodra e Trimave 1, Bblocks B17, B18, B19, B20 e Mat 1, "Tërësia urbane B" e Prishtinës së Re - Lindje.	Planet Rregulluese Urbane, Zhvillimet Sociale dhe Ekonomike, Transporti, Trafiku, Siguria Rrugore, Zonat e Gjelbra, Mjedisi, Terrenet e Lojërave, Sportet, Kultura, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) i Qytetit të Prishtinës	Lokale	2018	Plani i Mobilitetit	Ky dokument përcakton sfondin e problemeve të transportit në Prishtinë, të mbështetur nga të dhënat kryesore të grumbulluara përmes një pune të gjerë studimore/ pyetësorëve dhe të përforcuar me reagime nga një gamë e gjerë e organizatave dhe grupeve të interesit. Pastaj, paraqet një vizion të ri për transportin dhe kornizën strategjike, përpara se të përshkruajë elementët e ndryshëm që mbështesin kornizën e re të transportit. Dokumenti përfundon me detaje mbi investimet dhe planet e veprimit të nevojshme për të siguruar vizionin e lëvizshmërisë urbane të qytetit dhe një kornizë të rekomanduar monitorimi që do të vlerësojë se sa mirë ndërhyrjet që do të sjellin objektivat e reja të PMQU.	Transporti, Trafiku, Siguria Rrugore, Zonat e Gjelbra, Mjedisi, Terrenet e Lojërave, Sportet, Kultura, etj.
Politikat Gjithëpërfshirëse					
Programi i Reformës Ekonomike (PRE)	Shtetërore	2019-2021	Programi Ekonomik	Kuadri i përgjithshëm i politikave PRE është një kombinim i: (1) një politike fiskale të bazuar në rregulla të orientuara drejt stabilitetit të financave publike dhe, brenda hapësirës fiskale të mundshme, duke mbështetur rritjen ekonomike përmes investimeve kapitale, rritjen e fondeve për fushat prioritare të zhvillimit dhe stimulimet tatimore për prodhuesit vendas, dhe (2) një sërë reformash prioritare strukturore që adresojnë pengesat kryesore të rritjes ekonomike, duke mbështetur zhvillimin e sektorëve ekonomikë konkurrues dhe duke siguruar që rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe përmirëson mirëqenien. Procesi i hartimit të PRE 2019-2021 u drejtua nga Ministri i Financave si Koordinator Kombëtar dhe u koordinua nga Ministria e Financave, Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) në Zyrën e Kryeministrit dhe koordinatorët e fushave të politikave nga ministritë e linjës. Koordinatorët takoheshin rregullisht për të diskutuar përmbajtjen e masave, qëndrueshmërinë e tyre me dokumentet përkatëse të planifikimit strategjik dhe me udhëzimet e politikave të marra përmes Dialogut Ekonomik dhe Fiskal me Komisionin Evropian.	Zhvillimi dhe Rritja Ekonomike, Treguesit e Performancës, Produktet e Brendshme Bruto, Varfëria, Stabiliteti i Vendit, Taksat, Hapësira Fiskale, Investimet Kapitale, etj.

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike	Shtetërore	2018-2022	Program Strategjik	Strategjia, PZHSP 2018-2022, siguron një kornizë ndërhyrjesh për t'u zbatuar në të gjitha nivelet, qendrore dhe lokale, brenda sektorëve kryesorë të industrisë dhe kompanive të synuara. Këto ndërhyrje do të mbështesin zhvillimin e sektorit privat, duke synuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Strategjia synon të zhvillojë dhe zbatojë politikat industriale dhe të NVM-ve për të rritur produktivitetin e sektorit privat, për të rritur investimet në industri dhe ndërmarrje, për të përmirësuar qasjen në infrastrukturën cilësore dhe zbatimin e politikave tregtare të nevojshme për të integruar bizneset e Kosovës në tregjet ndërkombëtare, dhe për të siguruar të drejtat e pronës industriale për të mbrojtur investimet në inovacione, inkurajojnë zhvillimin e produkteve me vlerë të lartë dhe ofrojnë siguri për sipërmarrjet e huaja që hyjnë në tregun e Kosovës, se të drejtat e tyre mbrohen.	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, Zhvillimi i Politikave Tregtare, Konkurrenca, Eksporti dhe Investimet, Zhvillimi i Infrastrukturës së Cilësisë, Zhvillimi i Sektorëve të Industrisë, Performanca e Ndërmarrjeve, Politikat e Mjedisit të Zhvillimit të Biznesit, Zinxhirët e Vlerave të Orientuar në Eksport, etj
Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike	Shtetërore	2015-2020	Program Strategjik	Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 përcakton objektivat dhe politikat strategjike që Qeveria e Republikës së Kosovës synon të arrijë në periudhën e ardhshme afatmesme në mënyrë që të përmirësojë funksionimin dhe modernizimin e administratës publike, të përmbushë kërkesat ligjore dhe të përmirësojë dorëzimin e shërbimeve. Zbatimi i kësaj Strategjie synon krijimin e kushteve në mënyrë që administrata të orientohet drejt plotësimit të nevojave specifike të qytetarëve dhe bizneseve dhe të punojë për interesat e tyre. Pritet të bëhen përpjekje për zvogëlimin e barrierave procedurale dhe administrative, uljen e kostove dhe kohën e harxhuar gjatë marrjes së shërbimeve administrative, duke marrë parasysh qasjen e duhur për personat me aftësi të kufizuara.	Administrata Publike, Objektivat Strategjike, Qeverisja Lokale, Ofrimi i Shërbimit Publik, Pengesat Administrative, Personat me Aftësi të Kufizuara, etj.
Plani i Zhvillimit të Arsimit në Komunën e Prishtinës	Lokale	2018-2022	Plani Zhvillimor	Komuna e Prishtinës u zgjodh për Projektin "Rrjeti i Arsimit dhe Punësimit të Kosovës - (RRAPK)" për hartimin e "Planit të Zhvillimit të Arsimit të Komunës së Prishtinës 2018-2022". Plani ofron një analizë të	Menaxhimi Institucional dhe Sigurimi i Cilësisë, Zbatimi i Kurrikulës, Teknologjia Arsimore, Përfshirja në Arsimin

Titulli	Përhapja	Periudha kohore	Lloji i Dokumentit	Fushëveprimi	Fushëveprimi
				<p>situatës për të identifikuar sfidat dhe çështjet kryesore. Bazuar në këto, janë përcaktuar objektivat strategjikë, janë vendosur rezultatet e pritura dhe janë formuluar masa dhe aktivitete që do të shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e arsimit në Komunën e Prishtinës. Përveç kësaj, janë caktuar tregues për secilin objektiv, dhe supozimet dhe rreziqet e nevojshme të identifikuara që mund të ndikojnë në implementimin e këtij Plani.</p>	<p>Parashkollor, Mjedisi i Sigurt dhe Miqësor i Shkollës, etj.</p>

C. Lista e grupeve të interesit të PVQGJ

Emri i Organizatës	Lloji i Organizatës	Përshkrimi
Shoqata "UNI-TRANS" / Drejtues i Shoqatës	Shoqatë	Shoqatë e kompanive private të transportit - (5 kompani autobusësh = 24 Yjet, Arbëria, Vreshtat, Qendra 1, Qendra 2)
Klubi Alpin Prishtinë	Organizatë e Shoqërisë Civile	Sportet alpinistike, ndërgjegjësimi i publikut mbi biodiversitetin dhe përmirësimi i cilësisë së jetës me aktivitete alpinizmi
Al-Tec	Biznes Privat	Kompani private; kompania e parë vendase që prodhon ushqim për qen, mace dhe peshk nga mbeturinat e kafshëve.
Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës	Shoqatë	Shoqata e kompanive private të arkitekturës dhe arkitektëve individualë
Balkan Green Foundation	Organizatë e Shoqërisë Civile	Promovon përparim gjithëpërfshirës dhe të barabartë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm brenda Ballkanit Perëndimor.
Corporate Social Responsibility -CSR Kosovo	Shoqatë	Përfaqësues i kompanive private për përgjegjësinë shoqërore të korporatës.
Eco Kos L.L.C	Biznes Privat	Kompani private, e licencuar për të menaxhuar vajrat e mbeturinave të ushqimit të përdorur. Mbledhja (kryesisht nga restorantet, dhe familjet në Prishtinë dhe pjesë të tjera të Kosovës).
Elen	Biznes Privat	Kompani private, me fokus energjinë diellore; merret me produkte dhe shërbime në këtë fushë.
Fondacioni Jeshil	Organizatë e Shoqërisë Civile	Sigurimi i zgjidhjeve të qëndrueshme urbane dhe rurale për rritje harmonike në Kosovë duke përdorur etikën dhe parimet e permakulturës
GAIA Kosovo	Organizatë e Shoqërisë Civile	Organizatë mjedisore, vullnetare.
Green Energy Kosova	Organizatë e Shoqërisë Civile	OJQ që promovon energjinë e gjelbër.
Instituti për Shkencë dhe Teknologji INSI	Biznes Privat	Kompani Konsulente e Komunës së Prishtinës për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale
Izolim Plast	Biznes Privat	Kompani private, grumbullon vaj motorik të automobilave dhe riciklon.
Jaha Solar	Biznes Privat	Kompani private, prodhuesi i parë dhe aktualisht i vetmi i paneleve diellore fotovoltaike në Kosovë.
Kosovo Manufacturing Club	Shoqatë	Përfaqësues i kompanive private
Let's do it Kosova	Organizatë e Shoqërisë Civile	Let's Do It Kosovo është një organizatë që merret me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, duke i organizuar qytetarët për të trajtuar çështjet mjedisore, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme siç janë aksionet e pastrimit, fushatat e ndërgjegjësimit dhe aktivitete të tjera vullnetare
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Kryetari i Komunës së Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Nënkryetari i Komunës së Prishtinës

Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Koordinatori i Projektit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Udhëheqës i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian / Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektori i Energjisë - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektori i Mbeturinave - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektori i Përdorimit të tokës dhe Biodiversitetit - Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Ndryshimet Klimatike - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektori i Ujërave - Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektorët e Industrisë dhe Ndërtesave - Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Ekipi teknik / Sektori i Transporti - Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Shefi i Sektorit për Shërbime Publike - Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Shërbimeve Publike
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Zyrtar i Lartë për Planifikim - Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Zyrtar i Lartë për Media / Zyra për Marrëdhënie me Publikun / Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Shefi i Sektorit për Investime Kapitale - Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Kontratave
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Drejtoria e Parqeve
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Drejtoria e Bujqësisë
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Drejtoria e Urbanizmit
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale
Komuna e Prishtinës	Pushtet Lokal	Drejtoria e Arsimit
NP 'Hortikultura'	Ndërmarrje Publike	NP Hortikultura kujdeset për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra publike në territorin e qytetit të Prishtinës
KRU 'Prishtina'	Kompani Rajonale e Ujësjellësit	Furnizimi me ujë të pijshëm dhe sistemi i kanalizimit për Komunën e Prishtinës
KRM 'Pastrimi'	Kompania Rajonale e Mbetjeve	Transporti dhe ruajtja e mbeturinave në territorin e Komunave të Prishtinës, F. Kosovës, Obiliqit dhe Lipjanit. Pastrimi dhe larja e rrugëve.
'Termokos' Sh.A.	Kompani e Ngrohjes Qendrore	Termokos është furnizuesi lokal i ngrohjes qendrore në Prishtinë.
NTP 'Trafiku Urban'	Ndërmarrje Komunale e Transportit Publik	Kompania e transportit publik që operon në Komunën e Prishtinës
NPB Sh.A.	Ndërmarrje Publike Banesore	NPB është pronë e Komunës së Prishtinës dhe menaxhon pasurisë së saj e cila përbëhet prej patundshmërisë ku përfshihen banesa, lokale afariste, depo, garazha dhe truall.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Qeveria qendrore	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit
Komuna e Prishtinës	Komiteti i Shërbimeve Publike	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Komiteti i Zhvillimit Ekonomik dhe Rural	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Komiteti i Pronës	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Komiteti i Politikave dhe Financave	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Komunitetet dhe njerëzit me aftësi të kufizuara	Anëtarët e Komitetit të Kuvendit Komunal të Prishtinës
Komuna e Prishtinës	Asambleja e Kuvendit Komunal të Prishtinës	Kryetari i Asamblesë së Kuvendit Komunal të Prishtinës
PRO Planning	Organizata e Shoqërisë Civile	OJQ për promovimin dhe avancimin e zhvillimit dhe strehimit hapësinor dhe urban në Kosovë.
Procredit Bank në Kosovë	Biznes Privat	Shërbimet bankare dhe: Sistemi i brendshëm i Menaxhimit të Mjedisit, Menaxhimi i Riskut Mjedisor në Huadhënie dhe Huatë e Gjelbër
Rent Bike / biçikletë me qira	Biznes Privat	Kompani private, duke marrë me qira shërbimin e biçikletave, përfshirë biçikletat malore.
TE PEMA Teknologji ekologjike	Organizata e Shoqërisë Civile	TE PEMA Projekti synon krijimin e hapësirave të gjelbra në zonat urbane.
TEB Bank	Biznes Privat	Kompani private; Banka Turke - Shërbimet bankare dhe huatë e gjelbra.
Termokiss	Organizata e Shoqërisë Civile	Termokiss është një qendër e drejtuar nga komuniteti në Prishtinë me misionin e shkëmbimit urban, civil, reflektimit dhe ndryshimeve. Aktivitetet dhe proceset organizuese menaxhohen nga komuniteti.
Instituti për Politikën e Zhvillimit INDEP	Organizata e Shoqërisë Civile	Një qendër studimi dhe një qendër avokimi që ofron zgjidhje të pavarura të politikave të bazuara në kërkime.
Unioni i Shoqatës së Taksive	Shoqatë	Shoqatë e kompanive private të taksive
WWF Kosovo	Organizata e Shoqërisë Civile	Mbrojtjen e mjedisit; mbrojtjen e vlerave të zonave të mbrojtura dhe aktivitetet e tyre të zhvillimit dhe edukimit.

Fjalorth

Plani i Ahtisaarit	propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit për Kosovën, paraqitur nga i Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e statusit të Kosovës
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Kosovës
Caktimi	Caktimi që bëhet për të marrë shërbimet konsulente dhe asistencën për Qytetin në hartimin e PVQGJ-së, në pajtim me Metodologjinë e PVQGJ të BERZH-it
Banka ose BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, që ka selinë e regjistruar në One Exchange Square, Londër EC2A 2JN Mbretëria e Bashkuar
Qyteti ose Prishtina	Qyteti i Prishtinës
Kushtetuta	Kushtetuta e re e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008
Konsulenti	Mott MacDonald Limited, me seli të regjistruar në adresën 8-10 Sydenham Road, Croydon CR0 2EE, Britani e Madhe
CSDP	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes
CSP	Propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës
DSHPMSH	Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Metodologjia PVQGJ e BERZH-it:	Metodologjia e Programit për Qytetet e Gjelbra, hartuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe që gjendet në faqen e internetit të Bankës
BERZH ose Banka	Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, që ka selinë e regjistruar në One Exchange Square, Londër EC2A 2JN Mbretëria e Bashkuar
EE	Efiçienca e energjisë
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
PVQGJ	Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër, hartuar në përputhje me Metodologjinë PVQGJ

GCF	Fondi për Klimën e Gjelbër, shih www.greenclimate.fund
BPV	Bruto-Produkti Vendor
GET	Tranzicioni i Gjelbër i Ekonomisë
GHG	Gazrat me efekt serrë
QEK	Qeveria e Kosovës
HK	Hekurudhat e Kosovës
ICLEI	Këshilli Ndërkombëtar për Iniciativat Lokale Mjedisore
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
AKMM	Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit
KoM	Takimi nismëtar i PVQGJ-së së Prishtinës, që është mbajtur në objektin e Komunës së Prishtinës, më 3 korrik 2019
Ligji për Mbrojtje të Mjedisit	Ligji nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit.
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Republika e Kosovës
MF	Ministria e Financave
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
Strategjia e re IKM	Strategjia e re e Bankës për Sektorin e Infrastrukturës Komunale dhe Mjedisore 2019-2024, për financimet e gjelbra dhe të qëndrueshme për së paku 100 qytete deri më 2024
OJQ	Organizatë joqeveritare
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
KDKP	Kryetari dhe Drejtoritë Komunale të Prishtinës
KKP	Kuvendi Komunal i Prishtinës
PVQGJ i Prishtinës ose Projekti	Plani i Veprimit për Qytet të Gjelbër për Qytetin e Prishtinës
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
MD	Materie grimcash (partikula)

Komuna e Prishtinës	Administrata e qytetit, përbërë nga njësi të vetëqeverisjes lokale, si dhe
Grupi i Konsultimeve Publike	grupi i konsultimit që do të formohet nga anëtarët e OJQ-ve kryesore dhe aktivistët që kanë interesim për angazhimin e palëve të interesit për PVQGJ-në e Prishtinës
NP	Ndërmarrje Publike
TGJR	Trysnia-Gjendja-Reagimi tek Qytetet e Gjelbra
Raport	Raporti për Kornizën e Politikave dhe atë Rregullatore
BRE	Burimet e ripërtërishme të energjisë
RKS	Shkurtesa e shtetit të Kosovës
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asocim
SZHQ	Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PRRU	Plani Rregullues Urban
OKB	Kombet e Bashkuara
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
OKBFCCC	Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administratë të Përkohshme në Kosovë
ITUZ	Impiant për trajtimin e ujërave të zeza

